



**Universiteti
European i
Tiranës**

D I S E R T A C I O N

“KRIMINALITETI I TË MITURVE NË SHQIPËRI:

Analizë e rolit të kuadrit ligjor, sistemit gjyqësor, përgjegjësisë penale, tipeve të ndëshkimit dhe tendencat e kriminalitetit gjatë periudhës 1991-2018.“

ALFRED BALLA

Dorëzuar:

Universitetit Evropian të Tiranës, Shkollës Doktorale.

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në

“Shkenca Juridike”, me profil “E drejtë penale”,

për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Skënder Kaçupi

Tiranë, 2020

65.937 fjalë.

DEKLARATA E AUTORËSISË

© *E drejta e autorit: Alfred Balla.*

Ky punim është vepër origjinale e imja e hartuar në bazë të hulumtimeve, kërkimeve disa vjeçare, intervistave dhe eksperiencës sime profesionale. Për përdorimin e materialeve dhe literaturës së përfshirë në këtë disertacion, kam respektuar të gjithë elementët e citimit dhe referencave në respekt të të drejtave të autorit dhe legjislacionit në fuqi.

Studimi nuk është publikuar i plotë më parë në asnjë organ, media apo faqe në internet.

Ndalohet çdo përdorim dhe riprodhim, botim, shpërndarje, kopjim, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorit.

Shkurtime:

ASHMDF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
AS	Akademia e Sigurisë.
DPA	Departamenti i Administratës Publike.
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
KP	Kodi Penal.
KPP	Kodi i Procedurës Penale.
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor.
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit.
KDIMDHP	Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
KKD	Komisioneri kundër diskriminimit.
KRSH	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
KM	Këshilli i Ministrave.
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve.
MD	Ministria e Drejtësisë.
MB	Ministria e Brendëshme.
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
KPM	Ligji (Kodi) Penal për të Miturit në Shqipëri.
RSH	Republika e Shqipërisë.
SPAK	Struktura e Posaçme Anti Korrupsion.
SHM	Shkolla e Magjistraturës.
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm.
PP	Prokuroria e Përgjithshme.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.

FALENDERIME

Falenderimi, në rradhë të parë për realizimin e këtij punimi shkon për udhëheqësin tim shkencor Prof. Dr. Skënder Kaçupi për sugjerimin, mbështetjen, ndihmën dhe inkurajimin në realizimin e këtij studimi.

Një falenderim i veçantë shkon për kolegët e mij Vitjuna, Mirela, Eljon, Gentjan dhe të gjithë avokatët, gjyqtarët e prokurorët e intervistuar ndër vite.

Për përkrahjen gjatë përgatitjes së këtij disertacioni, një falenderim shkon për drejtuesit dhe anëtarët e Fakultetit Juridik të Universitetit Evropian të Tiranës dhe katedrës përkatëse.

Gjithashtu një falenderim special shkon për familjen time: prindërit, bashkëshorten dhe fëmijët e mij të cilët më kanë mbështetur dhe inkurajuar në përgatitjen e këtij studimi modest.

Abstrakt:

Shqipëria ka mbi njëzet e pesë vjet që po noton në ujërat ndërkombëtare të drejtësisë botërore për të gjetur rrjedhën e një sistemi efikas për të gjithë shqiptarët, e cila do të bënte të mundur stabilitetin social, politik dhe ekonomik në vend dhe do të na çonte në mënyrë natyrale drejt Evropës së bashkuar, si aspiratë finale e të gjitha forcave politike në vend dhe e mbi 85 % të shqiptarëve. Në këtë rrugë të gjatë e jo të lehtë të konsolidimit të drejtësisë, kuptohet që ka patur e do ketë probleme, ashtu si në çdo aspekt të jetës shqiptare.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme të politikave shtetërore e shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të këtyre politikave qëndrojnë parimet themelore të Kushtetutës, të konventave të OKB-së dhe të instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se të miturit, për shkak të veçorive të moshës dhe të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të posaçme nga familja dhe institucionet shtetërore.

Kujdes i veçantë në këtë kuadër duhet treguar ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e drejtësisë për të mitur. Administrimi i drejtësisë për të miturit, ka një rëndësi praktike për sistemet e ndryshme ligjore në gjithë botën. Ai pasqyron interesat e shoqërisë për të promovuar shtetin e së drejtës dhe ka për synim riintegrimin shoqëror të fëmijëve të akuzuar për shkeljen e ligjit.

Drejtësia për të miturit nuk mbulon vetëm situatat në të cilat është shfaqur një konflikt me legjislacionin penal por përfshin edhe çështje të tilla si parandalimi i kriminalitetit, zbatimi i ligjit, gjykimi dhe rehabilitimi. Drejtësia për të mitur është një fushë kyçe e politikës sociale e cila merret me fëmijët e marginalizuar dhe të harruar nga ndryshimet social-ekonomike të cilët janë target kryesor i kriminalitetit minoril e numri i të cilëve për fat të keq, është gjithnjë në rritje.

Fusha e veprimit të standardeve ndërkombëtare që lidhen me drejtësinë për të miturit, e ndikuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, pasqyron këtë realitet: ***“Sistemi i drejtësisë për të mitur përbëhet nga ligjet, politikat, udhëzuesit, normat zakonore, sistemet, profesionistët, dhe institucionet të cilët trajtojnë posaçërisht të miturit në konflikt me ligjin”***.

Për shkak të nevojave specifike dhe rrethanave të fëmijëve, funksionimi i këtij sistemi duhet të jetë i ndryshëm nga funksionimi i sistemit të drejtësisë për të rritur. Megjithatë, në realitet ka probleme me sistemin e drejtësisë për të miturit për shkak të mungesës së institucioneve të parashikuara shprehimisht në ligjin Nr.37, të vitit 2017 që ka të bëjë me Kodin e Drejtësisë për të Mitur në Shqipëri.

Ky punim modest mundohet të vendosë një gur të vlefshëm në murin e drejtësisë së re që po ndërtohet me themele: Reformën në Drejtësi të miratuar në vitin 2016.

Çelës: Drejtësia për të mitur-it, sistemi gjyqësor, administrimi i drejtësisë, kodi penal për të mitur.

Abstract:

Albania has been, for more than twenty five years, navigating through the international waters of global Justice, as part of its attempts to finding the most appropriate and efficient stream of the system for the Albanian people, which in this case would result in springing the social, political and economic stability in the country, leading it towards the natural path of a unified Europe as is the great aspiration of all political forces and over 85 % of the Albanian people. As imaginable throughout the course of this long and not easy path of the Albanian Justice System consolidation, it is comprehensible that there have been obstacles and issues to overcome, as in every aspect of the entire range spread of Albanian life.

The Protection of Children's Rights constitutes one of the main lanes of Albania's social policies, the basis of which is composed of and is entwined with the fundamental principles of the Constitution, the UN conventions and other international mechanisms ratified by the Republic of Albania, that put the stress on the fact juvenile subjects, due to their specific age feature/trait and lack of emotional, intellectual and physical maturity, are in need of highly particular protection and attention from their families and state bodies.

In this regard, a special care has been demonstrated towards the under-aged offenders of law by improving, amending and up-grading continuously the Justice System for the Juvenile subjects. The correct management of Juvenile Justice bares a significant importance practice for various legal systems world-wide, as it reflects the interest of society in promoting the rule of law and aims to reintegrate juveniles charged as offenders of law. Juvenile Justice does not include only the moments or situations in which the core of them is an issue or a breach that concerns the Criminal Legislation, likewise it covers matters such as criminality preclude and prevention, law enforcement, judicial process and rehabilitation. Juvenile Justice is a key player in the policy that deals with marginalized and omitted children due to socio-economic differences and as the figures clearly show, unfortunately, their number has seen an ongoing increase.

The scope of international standards related to juvenile justice, influenced by the Convention on the Rights of the Child, reflects this reality: *“The juvenile justice system consists of laws, policies, guidelines, customary norms, systems, professionals, and special treatment facilities for under-aged offenders of law”*.

Due to specific needs and circumstances of children, the functioning of this system should be different from the functioning of the adult justice system. However, in reality, problems are being encountered with the juvenile justice system due to the lack of institutions expressly provided for in Law No. 37 of 2017 related to the Juvenile Justice Code.

This modest paper tries to lay a foundation stone on the wall of new justice being built on the foundation of the 2016 Justice Reform.

Key words: *Juvenile Justice, judiciary system, justice management, Juvenile Criminal Code.*

TABELA E PËRMBAJTJES

Deklarata e Autorësisë	fq.1
Lista e shkurtimeve.....	fq.2
Falenderime	fq.3
Abstrakti	fq.4
Abstract	fq.5

KAPITULLI I: Hyrje.

1.1 Qëllimi i studimit.....	fq.10
1.2 Hipoteza e punimit.....	fq.11
1.3 Pyetjet kërkimore.....	fq.18
1.4 Metodologjia.....	fq.19
1.5 Mundësitë dhe kufizimet.....	fq.20
1.6 Rëndësia e punimit.....	fq.20
1.7 Struktura e punimit.....	fq.21

KAPITULLI II: – Literatura dhe Kuadri Teorik.

2.1 Kuadri Teorik.....	fq.22
2.1.1 Shkolla klasike.....	fq.24
2.1.2 Shkolla pozitive.....	fq.25
2.1.3 Shkolla e Chicago-s.....	fq.28
2.1.4 Teoria e shoqërimit të diferencuar.....	fq.29
2.1.5 Teoria e mungesës së ligjeve (Anomia).....	fq.29
2.1.6 Teoria e nënkulturës.....	fq.30
2.1.7 Teoria e etiketimit.....	fq.31

2.2	Faktorët që ndikojnë në kriminalitetin rinor (te 14-18 vjeçarët).....	fq.32
2.2.1	Faktorët psikologjikë.....	fq.33
2.2.2	Faktorët sociologjikë.....	fq.33
2.2.3	Ndikimi i familjes.....	fq.34
2.3	Modelet e sjelljes.	fq.37
2.3.1	Proceset e motivimit dhe të njohjes.....	fq.37
2.4	Kriminaliteti i të miturve dhe lëvizjet migruese.....	fq.38
2.5	Migrimi i brëndshëm dhe urbanizimi informal	fq.38
2.6	Mosha për përgjegjësi penale.....	fq.40

KAPITULLI III: Kriminaliteti, kuadri ligjor dhe sistemi gjyqësor në Shqipëri.

3.1	Përcaktimi i termave të kriminalitetit.....	fq.42
3.2	Kriminaliteti i të miturve dhe aktet ndërkombëtare.....	fq.48
3.3	Trajtimi i të miturve para reformës së vitit 2017.....	fq.50
3.4	Rregulla për hetimin dhe gjykimin e të miturve përpara reformës së vitit 2017.....	fq.51
3.5	Rregulla të posaçme për dënimin e të miturve.....	fq.58
3.6	Trajtimi i të miturve të dënuar me burgim.....	fq.61
3.7	Trajtimi i të miturve pas reformës së vitit 2017.....	fq.64
3.8	Kufizimi i lirisë personale i të miturit.....	fq.69
3.9	Rregulla të posaçme për dënimin e të miturve.....	fq.72
3.10	Organizimi i drejtësisë penale për të mitur.....	fq.74

KAPITULLI IV: Kuadri ligjor, përgjegjësia penale në Shqipëri

4.1	Kuadri ligjor dhe një vështrim historik	fq.75
4.2	Faktorët që kanë ndikuar në kriminalitetin “fëminor” dhe një vështrim krahasimor.....	fq.81
4.3	Përgjegjësi penale e të miturve në konflikt me ligjin.	fq.87
4.4	Pjekuria e të miturit, aftësia intelektuale dhe volitive që lidhen me përgjegjësinë penale	fq.93
4.5	Përgjegjësia e të miturit.....	fq.99
4.6	I mituri katërmëdhjetëvjeçar.	fq.100

4.7 I mituri nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.	fq.101
---	--------

KAPITULLI V: Kuadri ligjor, ndëshkimi penal në Shqipëri.

5.1 Koncepti i kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të të miturve në veçanti.....	fq.104
5.2. Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri.....	fq.106
5.3. Specifikat e kriminalitetit të të miturve në konflikt me ligjin.....	fq.108
5.4. Kuadri ligjor i procesit penal të të miturit në konflikt me ligjin.....	fq.112
5.4.1 Standardet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur dhe raporti me të drejtën kombëtare.	fq.112
5.4.2 E drejta e brendshme dhe autoritetet institucionale në fushën e drejtësisë penale për të mitur.	fq.118
5.5 Specifikat e procesit penal të të miturit në konflikt me ligjin (sipas legjislacionit të brendshëm).....	fq.124
5.5.1 Faza hetim - gjykim	fq.124
5.5.2 Faza dënim - ndëshkim.....	fq.128
5.5.3 Faza Riedukim.....	fq.138
5.6 Marrëdhënia midis kriminalitetit, kuadrit ligjor dhe praktikave të ndëshkimit.....	fq.146
5.6.1 Marrëdhënia ndërmjet praktikave të ndëshkimit dhe kuadrit ligjor.	fq.147
5.6.2 Marrëdhënia ndërmjet kriminalitetit dhe praktikave të ndëshkimit.	fq.149

KAPITULLI VI – Përfundime dhe rekomandime mbi kriminalitetin minoren në Shqipëri.

6.1 Përfundime.....	fq.159
6.2 Rekomandime.....	fq.160

TABELA, GRAFIKË, TË DHËNA BASHKËNGJITUR ME FOTO.....	fq.173
--	--------

LISTA E REFERENCAVE.....	fq.178
--------------------------	--------

**Nuk mund të ketë zbulim më të thellë të shpirtit të një shoqërie,
sesa mënyra me të cilën ajo i trajton fëmijët e saj.**

Nelson Mandela

(May 1995)

KAPITULLI -I- HYRJA

1.1 Qëllimi i studimit.

Në studimin e sistemit penal e atij të procedurës penale shqiptare, një vend të rëndësishëm zë edhe studimi i problematikës penale, procedurale, kriminalogjike, penalogjike etj., të drejtësisë penale për të miturit.

Brezi i ri në Shqipëri si në çdo vend tjetër në zhvillim, ka problematikën e tij shoqërore, sociale, arsimore, kriminale e cila është specifike për këtë kategori të popullsisë. Ky brez është në hapat e parë të njohjes me rregullimet strikte që vendosin legjislacioni penal e ai procedural penal për të gjitha shtresat e shoqërisë.

Parandalimi i kriminalitetit tek të miturit, është një pjesë thelbësore e parandalimit të krimit në shoqëri. Duke u përfshirë në veprimtari të ligjshme dhe shoqërisht të dobishme dhe duke treguar një prirje dhe pikëpamje humaniste ndaj shoqërisë e jetës, të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminogjene. Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit tek të rinjtë kërkon përpjekje prej gjithë shoqërisë, për të siguruar zhvillimin harmonik të adoleshentëve, duke respektuar dhe nxitur zhvillimin e personalitetit të tyre që nga fëmijëria e hershme.

Sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri nga ana e tij, duhet të sigurojë disa garanci procedurale e penale të cilat do të trajtohen gjerësisht gjatë këtij studimi.

Në fokus të këtij punimi doktoral është kriminaliteti në moshën e të miturve gjatë tre dekadave të fundit në Shqipëri krahasuar me periudha të ndryshme kohore si dhe me atë të vendeve fqinje e më tej, studimi i bazës ligjore procedurale e penale që merret me këtë shtresë, tendencat e kriminalitetit në këtë brez dhe vëzhgimi në vend i disa realiteteve problematike dhe negative në këtë sistem e konkretisht:

Rritje e kriminalitetit tek moshat e mitura. Të dhënat nga institucionet që mbulojnë veprimtarinë penale flasin për një rritje të numrit të krimeve që kanë për autorë fëmijë të moshës së mitur (14-18 vjeçarë). Kjo më bën të ngre pyetjen: Çfarë mund të shpjegojë këtë tendencë?

Rritje e rasteve të ndëshkimit të të miturve me burgim. Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë dhe gjykatat, tregojnë për rritje të numrit të rasteve kur fëmijë të moshës së mitur janë ndëshkuar me burgim për veprimtarinë e tyre penale. Pyetja që ngrihet në këtë rast është nëse praktikat e dënimit të fëmijëve në moshë të mitur kontribuojnë në parandalimin apo shtimin e numrit të krimeve që kanë për autorë fëmijë të moshës së mitur?

Trajtimi nga prokurori dhe gjykata jo të specializuara të rasteve penalisht të ndëshkueshme që kanë për autorë fëmijë të moshës së mitur. Të dhënat për rastet tregojnë se, shqyrtimi i tyre është bërë nga prokurorë dhe gjykata jo të specializuara për fëmijë por nga personel hetues e gjykatës që trajtojnë të gjitha rastet e ndëshkueshme penalisht, ose nga seksione për të miturit por me prokurorë e gjyqtarë jo të specializuar në gjykimin e kësaj kategorie. Pyetja që del nga ky realitet është nëse hetimi dhe gjykimi i fëmijëve në moshë të mitur që kanë kryer vepra të dënueshme penalisht ndihmohet ose jo nga trajtimi dhe gjykimi i tyre nga prokurori e gjykata të zakonshme.?

Kuadri Ligjor mbetet i papërcaktuar dhe shprehur qartë¹ përsa i takon kriminalitetit të fëmijëve në moshë të mitur, moshës së përgjegjësisë penale, ndëshkimit të dhënë, dhe specifikimit të gjykatës. Ende nuk egziston një kuadër i plotë ligjor që të merret në mënyrë të fokusuar me kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur. Trajtimi i krimeve të fëmijëve të mitur thjesht rregullohet dhe zhvillohet mbi bazën e një numri ligjesh dhe aktesh të përgjithshme.

¹ (Deri në periudhën e miratimit të Kodit Penal për të Miturit).

Çështja që ngrihet këtu është nëse kjo ndihmon apo jo në trajtimin dhe të ardhmen e atyre fëmijëve të mitur që janë përfshirë në veprimtari kriminale dhe të ndëshkueshme penalisht?

1.2 Hipoteza e punimit.

Si hipoteze e këtij studimi ngrihet: Vihet re se problematika e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur në Shqipëri ka mangësi në drejtim të trajtimit institucional e atij ligjor.

Cila është lidhja shkakësore dhe variablat që analizohen në këtë studim?

Ky studim trajton fenomenin e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur i cili:

- trajtohet nga një këndvështrim juridik;
- analizohet nga pikëpamja e shkallës dhe tendencave që e karakterizojnë;
- e sheh të lidhur me rolin e kuadrit ligjor, sistemit gjyqësor, moshës së përgjegjësisë penale, dhe llojin e ndëshkimit të dhënë.

Si variabël i varur, kriminaliteti i të miturve:

së pari, nga pikëpamja e definimit, përfaqëson një veprim ose mosveprim i cili:

= ka për autor një fëmijë të moshës së mitur.

= është i dënueshëm penalisht.

së dyti, përfshin sjellje kriminale të llojeve të ndryshme:

= nga pikëpamja e objektit kundër të cilit kryhet ato mund të ndahen:

+kundër pronës private ose publike (përvetësim, shkatërrim, dëmtim, etj.)

+kundër personit (rrahje, kërcënim, plagosje, vrasje, etj.)

+kundër personit juridik si p.sh. institucionit publik ose privat, biznesi të vogël, të mesëm, ose të madh (përvetësim, dëmtim, shpërdorim, etj.)

= nga pikëpamja e natyrës së veprës penale:

+ veprë e karakterit fizik (rrahje, grabitje, kërcënim, plagosje, vrasje, etj.)

+ veprë e karakterit material (vjedhje, grabitje, dëmtim, shkatërrim, etj.)

+ veprë e karakterit inteligjent (vjedhje identiteti elektronik, ndërhyrje me thyerje kodi në sistemet elektronike të entiteteve individuale, private, publike, etj.)

së treti, nga pikëpamja e sfondit social, ekonomik, dhe kulturor, vëzhgohet se ka lidhje me fëmijë të mitur të cilët karakterizohen nga një e shkuar dhe e tashme problematike nga pikëpamja:

= ekonomike (varfëri, mungesë të ardhurash.)

= sociale (në marrëdhëniet: familjare, shkollore, me fëmijët e tjerë.)

= psikologjike (preferencë për veprimtari të paligjshme, personazhe të botës së kriminit.)

= arsimore (mos-frekuentim i shkollës ose lënie përgjysmë në nivelet fillore, 9-vjeçare, e mesme.)

së katërti, nga pikëpamja e variancës, mund të dallohen tre nivele të ndryshme të kriminalitetit në moshat e mitura:

= nivel i ulët kriminaliteti.

= nivel i mesëm kriminaliteti.

= nivel i lartë kriminaliteti.

së pesti, nga pikëpamja e marrëdhënieve, ka lidhje me/dhe reflekton rolin e një numri faktorësh të cilët përfshijnë:

= faktorë të natyrës ekonomike:

+ niveli i të ardhurave të familjes.

+ gjendja fizike/materiale e ambjentit, banesës, apo ambjentit rrethues.

= faktorë të natyrës sociale:

+ trajtimi në familje.

+ marrëdhëniet në shkollë dhe ato me shokët.

= faktorë të natyrës psikologjike:

+ modelet e preferuara të sjelljes sociale.

+ prirja individuale e sjelljes.

= faktorë të natyrës juridike :

+ kuadri ligjor.

+ sistemi gjyqësor.

+ pragu i përgjegjesisë penale.

+ tipet e ndëshkimit për veprat penale.

së gjashti, nga pikëpamja e tendencave, shfaq dinamika të ndryshme që reflektojnë rolin dhe influencën pozitive ose negative të faktorëve influencers:

- = tendenca të rënies së kriminalitetit.
- = tendenca të qëndrimit të kriminalitetit në nivele të njëjta.
- = tendenca të rritjes së kriminalitetit.

“Kwadri Ligjor për kriminalitetin e moshës së mitur“, si variabël i pavarur në këtë studim:

së pari, nga pikëpamja e definimit, përfaqëson ato ligje apo akte nënligjore të cilat:

- = prekin, trajtojnë, dhe shprehen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe specifike për kriminalitetin tek fëmijët e moshës së mitur.
- = kanë për autorësi dhe gjejnë shprehje në:
 - + ligje të formuluar nga legjislativi.
 - + akte normative të nxjerra nga egzekutivi.
 - + vendime të konfirmuara nga gjyqësori.

së dyti, nga pikëpamja e brendisë, përfaqëson një faktor që shpreh parimet që qëndrojnë prapa konceptimit të:

- + përgjegjësisë penale.
- + menaxhimin të rasteve nga gjykatat.
- + ndëshkimet që duhen aplikuar në rastet e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur;

së treti, si faktor influencers, kwadri ligjor për kriminalitetin tek moshat e mitura përfaqëson një faktor të rëndësishëm sepse:

- = reflekton një marrëdhënie aktive me kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur;
- = influencon në mënyrë indirekte mbi shkallën e kriminalitetit tek moshat e mitura.

Influenca është indirekte sepse përçohet përmes rolit që luajnë:

- + përcaktimi ligjor i pragut të përgjegjësisë penale.
- + organizimi dhe orientimi i sistemit gjyqësor në trajtimin e rasteve të kriminalitetit për fëmijët në moshë të mitur;

+ hapësirat që lejon për llojin e ndëshkimit që jepet në rastet e kriminalitetit të fëmijëve në moshë të mitur;

= influencon në mënyrë direkte dhe përcakton karakterin e influencës së tre faktorëve të tjerë që lidhen me kriminalitetin e fëmijëve në moshën e mitur:

+ influencon mbi përgjegjësinë penale. E ushtron influencën dhe përcakton rolin që luan ky faktor përmes përcaktimit nëse pragu i përgjegjësisë penale:

do të jetë i ulët, mesatar, ose i lartë

shkon drejt rënies, të qendruarit njësoj, apo drejt rritjes;

+ influencon mbi trajtimin dhe rolin që luan sistemi gjyqësor mbi shkallën e kriminalitetit. E ushtron influencën dhe përcakton rolin që luan ky faktor përmes përcaktimit nëse rastet e krimeve që kanë për autorë fëmijë të moshës së mitur do të gjykohen nga:

gjykata/gjykatës të përgjithshëm (dmth., që trajtojnë krimet e të rriturve).

gjykata/gjykatës të specializuar (dmth., që merren vetëm me rastet e krimeve të fëmijëve të mitur).

+ influencon mbi rolin që luan faktori i tipit të ndëshkimit që aplikohet. E ushtron dhe përcakton rolin që luan ky faktor përmes hapësirës që përcakton për:

shfajësimin ose dënimin;

dënimin përmes riedukimit apo burgosjes;

burgimit për një kohë të shkurtër apo kohë të gjatë;

= mund të ushtrorë një influencë është pozitive, edhe neutrale, edhe negative:

+ pozitive, kur kuadri ligjor e trajton çështjen e kriminalitetit në të gjithë gjerësinë, thellësinë, dhe aspektet e tij;

+ negative, kur kuadri ligjor dështon ta trajtojë kriminalitetin e fëmijëve në moshën e mitur në të gjitha aspektet dhe problemet që lidhen me këtë fenomen ose që kanë të bëjnë me hapësirat dhe standardet e trajtimit të këtij fenomeni nga sistemi gjyqësor;

+ neutrale/ asnjë, kur kuadri ligjor e trajton kriminalitetin e fëmijëve të moshës së mitur në mënyrë të paplotë;

“Sistemi Gjyqësor”, si Variabël i Pavarur në këtë studim:

së pari, nga pikëpamja e definimit përfaqëson rolin e kombinuar të Gjykatave dhe Procedurës Penale në trajtimin e kriminalitetit që ka për autor fëmijë të moshës së mitur;

së dyti, e realizon rolin e vet përmes:

= organizimit të strukturave,

= trajtimit profesionalist,

= kompetencave të përcaktuara

= praktikimit të masave (arrestim, paraburgim, gjykim)

së treti, si faktor influencues, gjykatat dhe procedura penale përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm për shkallën dhe tendencat e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur sepse:

= ka lidhje me kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur;

= influencon direkt të ardhmen e fëmijëve të mitur në varësi të faktit nëse trajtimi i rasteve kriminale me autorë fëmijë të moshës së mitur:

+ është ose jo profesional, i kryer nga struktura përkatëse, dhe mbi bazën e kompetencave të përcaktuar qartë;

+ praktikon ose jo arrestimin, paraburgimin, apo gjykimin e fëmijëve të përfshirë në veprimtari kriminale;

= ushtron një influencë e cila:

+ mund të jetë edhe pozitive, dmth ndikon që fëmija t’i largohet dhe mospërfshihet më në të ardhmen në aktivitete kriminale;

+ mund të jetë edhe negative, dmth që kontribuon në orientimin e fëmijës në të ardhmen drejt aktiviteteve kriminale dhe penalisht të dënueshme;

= kontribuon në tendencat që karakterizon kriminalitetin tek fëmijët e moshës së mitur:

+ drejt rënies së shkallës së kriminalitetit;

+ në uljen e shkallës së kriminalitetit;

“Përgjegjësia Penale,” si Variabël i Pavarur në këtë studim:

së pari, nga pikëpamja e definimit përfaqëson aftësinë e individit për të marrë përgjegjësi penale për veprimet e tij pavarësisht nga fakti se:

- = veprimet janë kryer kundër entiteteve publike ose private (individë, institucione, subjekte)
- = veprimet kanë karakter fizik, material, apo inteligjent;
- = fëmija reflekton jetë problematike (sociale, ekonomike, psikologjike)

së dyti, brenda bandës “moshë e mitur“ përfshin disa grupmosha:

- = fëmijët e grupmoshës 6-10 vjeç (periudha e fëmijërisë së hershme.)
- = fëmijët e grupmoshës 11-14 vjeç (periudha e pubertetit.)
- = fëmijët e grupmoshës 15-18 vjeç (periudha e adoleshencës.)

së treti, si faktor influencues, pragu i përgjegjësisë penale përfaqëson një faktor të rëndësishëm për shkallën dhe tendencat e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur sepse:

- = reflekton një lidhje me kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur;
- = influencon në mënyrë direkte perspektivën dhe të ardhmen kriminale të fëmijëve të mitur në varësi të faktit nëse pragu i përgjegjësisë penale është:
 - + i ulët (përfshin edhe fëmijët e moshës 6 vjeç.)
 - + i moderuar (përfshin fëmijët e moshës 14 vjeç e lart.)
 - + i lartë (përfshin fëmijët e moshës 18 vjeç e lart.)

= ushtron një influencë e cila:

- + mund të jetë edhe pozitive, d.m.th krijon kushtet, influencon, dhe rezulton në largimin dhe mospërfshirjen në të ardhmen në aktivitete kriminale të fëmijëve në moshën e mitur;
- + mund të jetë edhe neutrale, dmth që nuk luan rol përcaktues as në frenimin, as në nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijës në të ardhmen, (p.sh. aktivitete kriminale);
- + mund të jetë edhe negative, dmth që influencon dhe shpie në orientimin e fëmijës së mitur drejt aktiviteteve kriminale dhe penalisht të dënueshme në të ardhmen;

= kontribuon në tendencat që karakterizon kriminalitetin tek fëmijët e moshës së mitur:

- + drejt rënies së shkallës së kriminalitetit.
- + në mbajtjen e kriminalitetit në nivele të njëjta.
- + në uljen e shkallës së kriminalitetit;

“Tipi i ndëshkimit të dhënë” si variabël i pavarur në këtë studim:

së pari, nga pikëpamja e definimit përfaqëson masën e ndëshkimit të fëmijës së mitur për krimin e kryer i cili:

= është proporcional me krimin e kryer

= synon realizimin e dy objektivave:

+ ndëshkimin e krimit;

+ dhënien e mesazhit të mospërsëritjes së tij

së dyti, gjen shprehje në disa tipe:

= shfajësim, dmth fëmija çlirohet nga marrja e përgjegjësisë penale për veprimin e kryer.

= riedukim, dmth fëmijët dërgohen për riedukim nga pikëpamja e respektimit të normave dhe sjelljes korrekte qytetare në një institucion që ofron kushte për riedukim dhe arsimim;

= burgim, dmth fëmija ngarkohet për veprën e kryer me dënimin e caktuar nga gjykata;

së treti, si faktor influencues, tipi i ndëshkimit të praktikuar përfaqëson një faktor të rëndësishëm për shkallën dhe tendencat e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur sepse:

= reflekton një lidhje me kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur;

= influencon direkt në perspektivën e fëmijës së mitur, në varësi të tipit të dënimit që aplikohet, nëse fëmija orientohet drejt:

+ shoqërizimit me botën kriminale,

+ largimit nga bota dhe aktivitetet e krimit,

= ushtron një influencë e cila mund të jetë edhe pozitive, edhe neutrale, edhe negative:

+ mund të jetë pozitive ose neutrale nëse tipi i ndëshkimit që praktikohet favorizon riedukimin;

+ mund të jetë negative nëse tipi i ndëshkimit që praktikohet favorizon qoftë shfajësimin, qoftë burgimin;

= kontribuon në tendencat e përfshirjes ose jo në të ardhmen të fëmijëve të ndëshkuar në kontigjentin e personave kriminale, tek të cilat mund të jenë:

+ tendencë për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në aktivitete kriminale;

+ tendencë për ulje të numrit të fëmijëve të përfshirë në aktivitete kriminale;

1.3 Pyetjet kërkimore.

Fenomeni i trajtuar në këtë punim doktoral është fokusuar në kontekstin e Shqipërisë dhe synon të trajtojë përveç problematikave të renditura në vëzhgimet e mësipërme edhe këto problematika:

Së pari: Si janë dinamikat e kriminalitetit tek të miturit në vitet 1991-2018 pas hapjes së Shqipërisë në aspektin gjeopolitik, ekonomik etj., drejt botës perëndimore.? Çfarë niveli tregojnë ato?

Së dyti: Çfarë dinamike paraqet kriminalitetit tek të miturit nëse ai ka tendenca rritje, qëndrim në të njëjtin nivel, apo tendenca rënie?

Së treti: Çfarë faktorësh influencojnë dhe kontribuojnë në dinamikat që karakterizon kriminalitetin tek moshat e mitura aktualisht në vendin tonë?

Së katërti: Si i përgjigjet legjislacioni aktual problematikës kriminale të prodhuar nga shtresa më e pambrojtur e shoqërisë, të rinjtë 14-18 vjeçarë?

Së pesti: Sa efektiv është ligji (kodi i ri) për hetimin e gjykimin e të miturve në konflikt me ligjin? Çfarë problematikash janë hasur në praktikë? (Kjo pyetje u shtua gjatë kohës së studimit doktoral, ndërkohë që u miratua KPM (Kodi Penal për të Miturit).

Së gjashti: Sa duhet të jetë mosha minimale për përgjegjësinë penale për kundërvajtjet dhe për krimet? Sa duhet të jetë mosha për heqjen e lirisë për një të mitur? A duhet ndryshuar ajo aktuale?

Së shtati: Çfarë duhet të ndryshojë në Shqipëri me qëllim që struktura aktuale ligjore të mund të krijojë e sigurojë një sistem efikas drejtësie penale për të miturit?

Së teti: Si do bëhet ndërgjegjësimi i popullatës në përgjithësi dhe i asaj të mitur në veçanti për të modifikuar sjelljen ndaj një të mituri që ka kryer një krim apo kundërvajtje penale?

1.4 Metodologjia e kërkimit.

Metodologjia e kërkimit është variabël i qëllimeve që kam dashur të arrij për këtë punim. Metodatat e kërkimit hulumtimor shkencor u zbatuan sipas hipotezës apo pyetjeve që ngrihen në kapituj të veçantë të punimit. Në këtë studim janë përdorur metoda e mbledhjes së të dhënave sasimore, cilësore, analiza e tyre, metoda e analizës dokumentare, studimi i krahasuar i të dhënave, studimi i rastit etj. dhe konkretisht:

- Mbledhja e të dhënave për legjislacionin shqiptar ndër vite për praktikën e drejtësisë për të miturit duke u bërë analiza e tyre.
- Mbledhja e të dhënave nga legjislacionet e përparuara perëndimore si ai italian, francez, amerikan etj. për praktikën e drejtësisë për të miturit duke u bërë analiza e tyre.
- Është bërë analiza e problematikës së të drejtës penale për të miturit aktualisht në Shqipëri.

- **Të dhënat e përdorura për këtë studim janë marrë nga disa burime të ndryshme:**

- **Burime qeveritare:** (Rregjistra, dokumenta, akte, praktika të marra nga Ministria e Drejtësisë Shqiptare, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme Gjykatore e Lartë, Praktika gjyqësore etj.)
- **Institucione akademike:** (Qendra kërkimore me banka të dhënash, praktika online e Gjykatës së Strasburgut etj.)
- **Sondazhe & intervista të kryera:** (Në kampione njerëzish kryesisht gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ndihmës ligjorë, jurist, operatorë të së drejtës të cilët janë intervistuar lidhur me problemet e hasura në praktikë dhe teori)
- **Burime sekondare** (nga studiues të tjerë, organizata të vendit dhe të huaja në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve si UNICEF, CRCA Albania, etj, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar gjatë diskutimit e hartimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur)

1.5 Mundësitë dhe kufizimet.

Ligji kryesor (KPM) që regullon mardhënien procedurale-penale të të miturve në konflikt me ligjin ka vetëm një kohë të shkurtër që është miratuar dhe ky ligj ende nuk është konsoliduar në praktikë, ndaj dhe trajtimet teorike të tij do jenë ende herët të arrijnë në konkluzione afatgjata.

Literatura shkencore dhe doktrina juridike e mirëfilltë shqiptare me këtë tematikë specifike, është e varfër në Shqipëri gjë që më ka bërë të hulumtoj nëpër literaturën e huaj.

Mundësi tjetër e mirë, kanë qenë rastet praktike të trajtuara nga ana ime gjatë përvojës si këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë, konkretisht gjatë punës së përditshme në Kolegjin Penal të kësaj Gjykate e cila është marrë me unifikimin e praktikës.

Fakti që Shqipëria po mundohet të implementojë legjislacionin e vendeve të Evropës Perëndimore edhe në drejtësi, e bën situatën më të favorshme në drejtim të mundësive për ballafaqimin e ideve të autorëve e studiuesve të ndryshëm në fushën e drejtësisë penale për të miturit.

1.6 Rëndësia e punimit.

Ndërlidhja organike mes elementit moshë dhe veprës penale është shumë e rëndësishme në të drejtën penale. Kështu që, me të drejtë lind vend për një studim të thelluar mbi konceptin “*moshë në të drejtën penale*”. Pikërisht për shkak të moshës dhe specifikave tjera që kanë të bëjnë me të miturit në të drejtat penale të shteteve bashkëkohore, kjo kategori kryerësish gëzon trajtim tjetër, trajtim më të butë, më të favorshëm në krahasim me autorët madhorë të veprave penale.

Përgjigja ndaj pyetjes nëse ky trajtim i privilegjuar i të miturve ka rritur numrin e delinkuencës së të miturve, do gjendet në fund të këtij trajtimi.

Trajtimi i diferencuar i subjekteve proceduralo-penalë ka bërë të mundur që ligjvënësi me ligjin Nr.37/2017, ka miratuar “*Kodin e drejtësisë për të mitur*”. Ky ligj është një “*risi*” në lëmin e të drejtës penale. Ligji është miratuar në datë 30.03.2017, dhe ka hyrë në fuqi më 1 Janar të vitit 2018, dhe parashikon ngritjen e një sërë mekanizmave dhe instrumentave ligjor që do të garantojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Ky Kod siguron përfrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93/Bashkimit Evropian datë 13.12.2011, përveç përputhjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Në zbatim të plotë të këtij Kodi, janë parashikuar një seri masash nga Qeveria konkretisht në Planin e Veprimit të saj e të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur. Kështu, në sektorin e drejtësisë, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve trajtohet në 3 drejtime kryesore: - përmirësimi i aksesit në drejtësi; - informim dhe edukim ligjor; dhe - parandalim, riintegrim e rehabilitim.

Analiza e administrimit të sistemit të drejtësisë për të miturit ka një rëndësi të madhe sepse kriminaliteti i të miturve është një problem jo vetëm ligjor, por tepër kritik nga këndvështrimi shoqëror ²që ndikon në cilësinë e ardhshme të jetës. Në këto kushte, kriminaliteti i të miturve duhet të jetë çështje e një studimi ndërdisiplinor. Kriminologë, sociologë, psikologë, mjekë, biologë, edukatorë, juristë, etj., kanë pjesën e tyre të padiskutueshme të kontributit në efektivitetin e sistemit, në arritjet dhe vlerat e tij. Madje edhe sociologët kanë rrënuar shumë në këtë fushë të udhëhequr nga parimi *“Ne përpiqemi për t’u mësuar fëmijëve tanë gjithçka për jetën, ndërkohë që janë fëmijët tanë që na mësojnë se çfarë është jeta”*.

Studimi ndihmon në mbushjen sadopak të boshllëkut kërkimor në këtë fushë të veçantë të kërkimit shkencor në Shqipëri duke dhënë në fund të studimit rekomandime konkrete për të përmirësuar legjislacionin aktual të drejtësisë për të mitur në Shqipëri.

1.7 Struktura e punimit.

Punimi doktoral është konceptuar i ndarë në 6 kapituj me nëndarje sipas problematikave duke lënë vend për thellimin e çdo trajtimi shkencor në të ardhmen nga ana ime por edhe e studjuesve të tjerë.

Kapitulli 1- Hyrja: Ky kapitull trajton rëndësinë e fenomenit dhe arsyet prapa studimit të tij. Trajtohet ana konceptuale e disertacionit duke spjeguar: qëllimin e studimit, hipotezat e ngritura gjatë tij, pyetjet kërkimore, metodologjinë e kërkimit shkencor, kufizimet dhe mundësitë, rëndësinë e punimit, dhe së fundmi strukturën e punimit.

² *Drejtësia për të mitur në Shqipëri, Studim CRCA.*

Kapitulli 2 – Kuadri Teorik: Ky kapitull sjell literaturën që egziston mbi kriminalitetin e fëmijëve në moshë të mitur dhe kryesisht shkollat e ndryshme që kanë trajtuar këtë problematikë në botë. Kapitulli trajton perspektivat e studimit, supozimet nistore, hipotezat kryesore, modelet shpjeguese, dhe metodologjinë e përdorur në këtë studim.

Kapitulli 3 – Kriminaliteti, Kuadri Ligjor, Sistemi Gjyqësor në Shqipëri: Ky kapitull trajton dinamikat e kriminalitetit tek fëmijët e mitur në Shqipëri duke e parë të lidhur me rolin e kuadrit ligjor, sistemit gjyqësor, dhe marrëdhënieve që egzistojnë mes kuadrit ligjor dhe sistemit gjyqësor.

Kapitulli 4 – Kuadri Ligjor, Përgjegjësia Penale në Shqipëri: Ky kapitull trajton dinamikat e kriminalitetit tek fëmijët e mitur në Shqipëri duke e parë të lidhur me rolin e përgjegjësive penale, kuadrit ligjor, dhe marrëdhënieve mes kuadrit ligjor dhe pragut të përgjegjësive penale.

Kapitulli 5 – Kuadri Ligjor, Ndëshkimi Penal në Shqipëri: Ky kapitull trajton dinamikat e kriminalitetit tek fëmijët e mitur në Shqipëri duke e parë të lidhur me rolin e tipit të ndëshkimit penal, kuadrit ligjor, dhe marrëdhënieve mes kuadrit ligjor dhe tipit të ndëshkimit.

Kapitulli 6 – Konkluzione: Ky kapitull përmbledh gjetjet e studimit rreth dinamikave që karakterizojnë në Shqipëri marrëdhëniet mes kriminalitetit, kuadrit ligjor, sistemit gjyqësor, përgjegjësive penale, dhe tipit të ndëshkimit.

KAPITULLI 2

– Literatura dhe Kuadri Teorik.-

2.1 Kuadri Teorik.

Parë në një këndvështrim juridik, më poshtë do të trajtohen disa nga teoritë më të njohura që ekzistojnë e marrin përsipër të shpjegojnë fenomenin e kriminalitetit tek fëmijët e moshës së mitur dhe shpjegimet më të mira nga pikëpamja e dinamikave që vërehen dhe faktorëve që qëndrojnë prapa tyre dhe influencojnë kriminalitetin tek kjo moshë.

Për hir të së vërtetës, në literaturën juridike penale shqiptare mungojnë analiza të thella të fenomenit të kriminalitetit të të miturve, teori juridike të përqëndruara në këtë fenomen apo trajtime shkencore, me përjashtim të trajtimeve që janë bërë nga disa autorë në fushën e së drejtës penale, kriminalogjisë apo penalogjisë ku do të përmend profesorët Skënder Kaçupi, Vasilika Hysi, Ismet Elezi, Luan Gjonçaj etj.

Në kuadrin teorik ndërkombëtar, fenomeni është trajtuar prej vitesh si pjesë e kriminalitetit në përgjithësi por edhe si përqëndrim në problematikën e të miturve ose të quajtur problematikë minorile. Më poshtë renditen disa prej tyre:

Në zhargonin e përditshmëm devijanca sociale përbëhet tërësia e sjelljeve që thyejnë kompleksin e vlerave, të cilat në një moment të caktuar historik dhe në një kontekst të caktuar shoqëror, janë të vlefshme dhe thelbësore në përputhje me kulturën e grupit mbizotërues shoqëror. Nuk ka një ide të vetme të konceptit të devijimit, gjë që ka marrë më shumë kuptime dhe vlera me kalimin e kohës.

Lidhur me etimologjinë e fjalës “*devijim*” (shmangie), duhet të shprehemi se ky term vjen nga latinishtja e vonë, konkretisht *deflexere* (devijoj) dhe do të thotë të largohesh nga e drejta, nga normat dhe përbën atë që romakët e quanin mungesë e *criterium*, apo *mungesë e aftësisë për të gjykuar*, e urtësisë dhe e arsyes. Në gjuhën e përditshme, devijimi tregon vështirësinë ose pamundësinë që has individit për t’u përshtatur me normat etike dhe të sjelljes në ambientin ku jeton. Kjo paaftësi për t’u përshtatur sjell si rrjedhojë lënien mënjane të subjektit, nga ambienti përkatës shoqëror.³ Nga *pikëpamja sociologjike*,⁴ devijimi karakterizohet nga sjellje dhe qëndrime të cilat janë larg normave shoqërore të shkruara ose që nuk janë në përputhje me rregullat e shoqërisë.

Termi “*devijim*” u përdor për herë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë viteve '30 me qëllimin për të mbledhur në një koncept të vetëm disa probleme sociale. Në të vërtetë, krimi përbën vetëm një nga disa kategori të gjera të devijimit, që mund të përfshijë në brendinë e vet

³ <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>

⁴ Po aty.

çdo lloj dukurie shoqërore që vjen në kundërshtim me normat, penale ose jo, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e një shoqërie.⁵

Veçanërisht në fushën e të miturve haset një “përdorim i cilësuar” i nocionit *devijim*. Falë tij u bë e mundur të përcaktoheshin vështirësitë në procesin e rritjes dhe të aktivizimit në shoqëri të subjektit. Adoleshentët e sotëm, ndryshe nga brezat e mëparshëm, përjetojnë gjendje papërshtatjeje dhe problematike, të cilat shkaktohen nga vështirësitë për të hyrë në marrëdhënie me të tjerët dhe për të gjetur veten në shoqërinë e sotme plot kontradikta. Problemet dhe papërshtatja nuk shprehen në shkelje të normave bazë të jetës civile, por mund të përfaqësojnë hapat e para të një rruge që mund të çojë në devijim dhe në veprime antishoqërore.

*Devijimi i të miturve është përcaktuar si tërësia e veprimeve, që përbëjnë figurë të një vepre penale, të cilat kryhen nga persona të moshës 14–18 vjeç.*⁶

Në ditët e sotme, pjesa dërmuese e kriminologëve pohojnë se kriminaliteti është një fenomen i lidhur ngushtë me llojin e shoqërisë dhe është një pasqyrim i tipareve themelore të saj, prandaj nëse duam të kuptojmë dukurinë e kriminalitetit është e domosdoshme njohja e bazave të çdo shoqërie, me të mirat dhe të këqijat e veta.⁷

*Herrero Herrero*⁸ studiuesi Spanjoll i kriminalitetit e përkufizon kriminalitetin si një fenomen shoqëror të përbërë, nga tërësia e shkeljeve që drejtohen kundër normave bazë të bashkëjetesës, të konsumuara në një vend dhe kohë të caktuar.

Pavarësisht nga orientimi teorik, mund të thuhet se devijimi lind bashkë me krimin në lidhje me speciet gjinore, sipas parimit që kriminelin është përherë një devijant por një devijant nuk mund të jetë domosdoshmërisht një kriminel. Devijimi dhe delikuenca, për këtë arsye, nuk janë sjellje të përcaktuara në terma absolutë, por në drejtim të kundërt midis sjelljeve të caktuara dhe rregullave sociale.

TRAJTIMI I KRIMINALITETIT NGA SHKOLLA TË NDRYSHME NDËR VITE :

2.1.1 Shkolla klasike.

⁵ Giunchi, A., “Mediazione penale minorile”, fq 9.

⁶ Giunchi, A., vep cit, fq 18.

⁷ Selami Zalli punim shkencor 2008

⁸ *Delincuencia de menores: tratamiento criminologico y juridico (es tudios de criminologia y politica criminal,*

Shkolla përfshin interpretimet klasike të krimit, i cili u shfaq në shekullin e tetëmbëdhjetë. Idetë më të rëndësishme të kësaj shkolle janë: koncepti i qenieve njerëzore si njerëz racionalë në një shkallë që mund të shprehë një zgjedhje të lirë, të drejtat civile, rregullimin e provave dhe dëshmive e sigurinë e aktgjykimeve.

Në shekullin e tetëmbëdhjetë, ne shohim ndryshime të vazhdueshme sociale, veçanërisht në sistemin gjyqësor. Ligji, në bazë të strukturave fetare mesjetare, ishte produkt i interpretimeve arbitrare gjyqësore. Për shkak të mbizotërimit të Reformimit dhe të natyralizmit filozofik, ai filloi ta shikojë njeriun si qenie racionale dhe e konsideroi si koncept themelor dinjitetin njerëzor.

Shkolla klasike ka kontribuar në një konceptim humanist të sistemit ligjor dhe të drejtësisë penale, sipas të cilit ligji duhet të mbrojtë si shoqërinë, ashtu edhe individin. Qëllimi i tij ishte për të vepruar si një pengesë ndaj sjelljeve kriminale, dhe për këtë arsye njerëzit konsiderohen të jenë racionalë, të lirë për të vepruar, si dhe të aftë për të peshuar kënaqësinë që do të rrjedhë nga çdo sjellje e paligjshme në lidhje me dënimin.

Interesi i shkollës klasike drejt legjislacionit dhe drejtësisë penale nuk lidhet me sjelljen kriminale, por shfaqet si një qasje e rëndësishme e bazuar në nevojën për të demonstruar për një person racional që nuk do të përfitojë nga shkelja e të drejtave të tjerëve.

E bënë të njohur punën për funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, **Cesare Beccaria**⁹ dhe **Jeremy Bentham**¹⁰, të cilët ishin kundërshtarë të sistemit gjyqësor të kohës, i cili ishte krejtësisht arbitrar, duke propozuar ndërkohë për të vënë në bazën e ligjeve dhe administrimit gjyqësor racionalitetin dhe të Drejtat e Njeriut.

2.1.2 Shkolla pozitive¹¹

I ndryshëm është interpretimi i pozitivistëve, të cilët e shihnin sjelljen njerëzore të përcaktuar nga tipare biologjike, psikologjike dhe sociale. Karakteristikat kryesore të mendimit të kriminologjisë pozitviste përbëhen nga një pamje deterministe e botës dhe në interes të vetë sjelljes kriminale në vend të të drejtave, parandalimit të krimit, dhe rehabilitimit të shkelësve.

⁹ (1738-1794, Italian, kriminalogjist, jurist, filozof, politikan)

¹⁰ (1748-1832, Anglez, filozof, jurist, reformist),

¹¹ <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>

Shkolla pozitive u ndikua nga filozofia pozitive, sipas të cilit qeniet njerëzore janë përgjegjës për fatet e tyre, në gjendje për të përshtatur sjelljen e tyre dhe të institucioneve sociale dhe për të krijuar një shoqëri që do të kënaqte aspiratat e tyre. Kjo shkollë u ndikua edhe nga koncepti i evolucionit (të zhvilluar më vonë gjerësisht nga Darvini në teorinë e tij), që çoi në përkufizimin e kriminelëve si qenie jo të evoluara. Ajo së fundmi ra nën ndikimin e antropologjisë në zhvillim, që në studimin e popullatave, duke mos gjetur organizime sociale të ngjashme me modelin evropian, arriti në përfundimin se shoqëritë e tjera ishin më pak të evoluara, më primitive, dhe më afër natyrës origjinale njerëzore. Ndër përfaqësuesit më me ndikim të kësaj shkolle është padyshim **Cesare Lombroso**¹², i konsideruar si babai i kriminologjisë moderne, sipas të cilit kriminelit është një primitiv në të cilin janë të pranishme instinktet e egra e të pakontrollueshme.

Duke e vështruar një kafkë në një këndvështrim anatomik ai vuri re një anomali morfologjike të përbërë nga një çarje e lindur e trurit, tipike e kafshëve më inferiore; kjo e çoi atë në përfundimin se kjo simetri ishte tipike e individit kriminel. Krimineli, atëherë, për këto karakteristika primitive fizike dhe psikologjike është i detyruar për të kryer krime. Ai shpiku kështu termin "kriminel i lindur". Më vonë, i njëjti Lombroso e zgjeroi teorinë e tij duke vënë në krah të shkaqeve biologjike edhe faktorët ekonomike e socialë.

Këto konsiderata janë zhvilluar më pas nga studenti i tij, **Enrico Ferri**¹³, i cili identifikoi si faktor shkaktar të delikuencës ato të tipit fizik (gjeografia, etniciteti, klima); ato të tipit antropologjik (mosha, gjinia, psikika), dhe ato sociale (traditat, feja, ekonomia).

Një tjetër studim është bërë nga **Raffaele Garofalo**¹⁴, i cili duke individualizuar në bazë të sjelljes kriminale një kombinim të shkaqeve natyrore dhe mjedisore, e përshkroi këtë qëndrim si "mungesa e ndjeshmërisë altruiste", duke supozuar se anomalitë fizike dhe mendore kanë qenë më të shpeshta në mesin e anëtarëve të "racave inferiore të caktuara".

Të tjerë pozitivistë kryen përpjekje të rëndësishme në fushën e biologjisë. Duke parë në historinë e familjes së kriminelëve, ata vunë re se "sjellja kriminale" është e trashëguar, duke treguar kështu edhe tipare të caktuara të trupit, të cilat janë të rëndësishme për një predispozicion për të

¹² (1835-1909, Italian, mjek, kriminalogjist)

¹³ (1856-1929, Italian, kriminalog)

¹⁴ (1851-1934, Italian, kriminalog)

kryer vepra penale. Më vonë, u përpoqën të shpjegojnë duke administruar teste të inteligjencës kundrejt të devijuarve, sikur kriminaliteti ishte rezultat i mungesës së inteligjencës.

2.1.3 Shkolla e Chicago-s¹⁵

Shkolla e Chicagos trajton çështjen e zhvillimit dhe të ndryshimit në sjelljen e njeriut shkaktuar nga mjedisi fizik dhe social në të cilën jeton, duke e konsideruar komunitetin si faktori më i rëndësishëm që ndikon në sjelljen e individëve, mbi bazë të studimeve mbi individin dhe qytetet.

Studiuesit e shkencave shoqërore në fillim të shekullit të njëzetë u përballën me shumë fenomene të reja sociale, si industrializimi, zhvillimet e qyteteve të mëdha, apo emigracioni masiv. Në veçanti, qytetet konsideroheshin si përcaktuesit kryesorë të problemeve sociale. Bazuar në vëzhgimet e bëra, nëpërmjet të cilave u bë e qartë se qyteti ishte një vend ku jeta shoqërore është sipërfaqësore, njerëzit janë anonimë, dhe marrëdhëniet kalimtare, hulumtuesit përcaktuan dobësimin e marrëdhënieve primare shoqërore si një proces të shpërbërjes shoqërore, i cili u bë çelësi kryesor për të kuptuar origjinën e krimit.

Rritja e qyteteve, sipas një modeli në zona koncentrike, i krijoi Shkollës së Çikagos, bazat për të shpjeguar krimin dhe delikuencën. Teoria u shpreh se ka përdorime mbizotëruese të sipërfaqes brenda çdo zone. Zona e tranzicionit, e cila ndodhej ngjitur me lagjen qendrore të biznesit, kishte një nivel më të lartë të shpërbërjes shoqërore në lidhje me zonat e tjera, për shkak të shkallës tjetër të lëvizshmërisë, paraqitjes së degraduar të lagjeve dhe mbi të gjitha prej pranisë së emigrantëve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndikimi që ky model i qytetit dhe shpërbërjes shoqërore vijon të ketë tek të rinjtë. Ky zhvillim konceptual përkufizohet si "teoria e transmetimit kulturor", e cila thotë se të rinjtë që jetojnë në zonat e pazhvilluara kanë më shumë gjasa të jenë në kontakt me kriminelët e të ndikohen nga ata.

¹⁵ (<http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>)

Por, në mesin e të gjithë qasjeve ka qenë ndërveprimi simbolik, perspektiva më e frytshme e Shkollës së Çikagos. Ndërveprimi simbolik që zhvilluar nga ideja se sjellja njerëzore vjen si rezultat i simboleve sociale të shkëmbyera nga individët. Ideja themelore është se mendja dhe vetvetja nuk janë të lindura, por ndërtohen nga mjedisi shoqëror. Kjo vjen nëpërmjet procesit të komunikimit apo të simbolizimit që individët përcaktojnë për veten dhe të tjerët.

Në fakt, ato janë simbole që bartin brenda tyre kuptimin për të ndikuar në mënyrën se si ne shohim botën përreth nesh. Ne priremi që të vetëpërcaktojmë veten të bazuar në këndvështrimin e asaj që të tjerët mendojnë për ne. Me fjalë të tjera, ne përkufizojmë identitetin tonë pasqyruar tek të tjerët; prandaj ne mund të kemi shumë identitete pavarësisht nga konteksti në të cilin ne e gjejmë veten. Në jetën shoqërore, kjo mund të ndodhë për të kornizuar situatën gabimisht dhe silllet në një mënyrë që është jokonsistente. Pra duhet të përcaktojë gjendjen e duhur për t'u përgjigjur me një formë të pranueshme të sjelljes. E gjithë kjo i lejonte Shkollës së Chicagos për të kuptuar devijimin, duke pasur parasysh sjelljen e njeriut si "relativ". Sjellja e njeriut, pra, nuk do të qeveriset nga çdo sistem rregullash universale, e as nga parimet absolute.

2.1.4 Teoria e shoqërimit të diferencuar.¹⁶

Edwin Sutherland¹⁷, autori kryesor i teorisë së shoqërimit të diferencuar, i cili thotë se sjellja kriminale është e mësuar në një mjedis social, ashtu si çdo sjellje tjetër.

Me termin "Shoqërim i diferencuar", Sutherland mendonte se "përmbajtja e modeleve të shoqërimit" ndryshon sipas individëve. Në përgjithësi, teoria thotë se sjellja kriminale është e mësuar nëpërmjet shoqërimit me njerëzit me të cilët keni ruajtur marrëdhëniet intime, në një proces të komunikimit ndërveprues. Brenda këtij komunikimi janë mësuar si teknikat e nevojshme për kryerjen e krimit, ashtu dhe motivet për të ndërmarrë një sjellje kriminale.

2.1.5 Teoria e mungesës së ligjeve. (Anomia)¹⁸

Koncepti i mungesës së ligjeve është i lidhur me punën e dy dijetarëve: **Emile Durkheim**¹⁹ dhe **Robert Merton**²⁰.

¹⁶ Edwin Sutherland e Cressey <http://vettorato.unisal.it/>

¹⁷ (1883-1950), Usa, sociology.

¹⁸ <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>

Për Durkheim, termi "mungesë ligjesh" është i lidhur me mungesën e standardeve brenda një shoqërie, duke iu referuar faktit se kur rregullat e përgjithshme procedurale (ato që rregullojnë marrëdhëniet me të tjerët) boshatisen nga efikasiteti dhe domethënia, njerëzit nuk dinë më se çfarë të presin nga njëri-tjetri. Më vonë, Durkheim ka përdorur termin *anomi* në referim me gjendjen moralisht të çrregullt, për të cilën njerëzit kanë pak kontroll mbi sjelljen e tyre.

Teoria e mungesës së ligjeve e Merton, ndërkohë, bazohet në konceptin e devijimit sesa në atë të kriminalitetit. Merton vuri në dukje se në shoqëri disa qëllimet të caktuara janë theksuar më shumë se të tjerat (p.sh., suksesi ekonomik), dhe se shoqëria konsideron legjitime mjete të caktuara për arritjen e këtyre qëllimeve. Kur këto qëllime theksohen më shumë, krijohen kushtet për paligjshmëri: jo të gjithë individët mund të kenë një mundësi të barabartë për sukses ekonomik nëpërmjet mjeteve të ligjshme, prandaj ata përpiqen për të arritur të njëjtin qëllim edhe me mjete të paligjshme. Për shkak të shpërbërjes sociale, jo të gjitha qëllimet e suksesit janë të arritshme nga të gjithë. Grupe të caktuara shoqërore si shtresat e ulëta dhe pakicat mund të jenë në disavantazh kur kërkojnë për të fituar pozitat e suksesit duke vuajtur kështu gjendjen e *anomizmit*²¹.

Në përfundim, Merton u përpoq të shpjegojë se si një strukturë sociopatologjike, e paaftë që t'u sigurojë të gjithë anëtarëve të njëjtat mundësi, përfundimisht mund të çojë në një tension, duke i shtyrë individët ndaj devijimit. Pra, janë shtresat e ulëta duke vuajtur në një masë më të madhe kushtet e mungesës së ligjeve e që janë më të përfshira në aktivitete të devijuara.

2.1.6 Teoria e nënkulturës²².

Në vitet '50 dhe '60, të shekullit të kaluar, teoritë kriminologjike kanë patur si objekt studimi "*kriminalitetin e të miturve*." Shumë studiues në veçanti janë përpjekur të shpjegojnë se cila ishte për ta forma më e zakonshme e delikuencës në grupe, nëpërmjet analizës së origjinës e kontekstit, duke vlerësuar kështu dhe konceptin e nënkulturës.

¹⁹ francez, (1858-1917), sociolog, psikolog, filozof.

²⁰ Usa, (1910-2003), sociolog).

²¹ ([http://www.d.umn.edu/cla/faculty/jhamlin/2111/Readings/Merton Anomie.pdf](http://www.d.umn.edu/cla/faculty/jhamlin/2111/Readings/Merton%20Anomie.pdf))

²² (<http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>)

Duke studiuar bandat e të rinjve dhe nënkulturat kriminale, kriminologët u përpoqën të kombinojnë punën e Shkollës së Çikagos me teorinë e *anomizmit* të Merton-it. Një ndikim të rëndësishëm në teorinë e nënkulturave në vitet pesëdhjetë ka ushtruar puna e **Solomon Kobrin**²³, i cili ka studiuar në mënyrë të veçantë marrëdhëniet ekzistuese midis brezave të gjinisë mashkullore brenda komunitetit të një klase më të ulët. Nga këto vëzhgime, Kobrin zhvilloi konceptin e komunitetit të integruar. Kur komunitetet janë të integruar dhe të organizuar, kjo do të thotë se ekziston një kontroll social mbi sjelljen e të rinjve, i cili rrjedh nga fakti se anëtarët e organizatave kriminale janë të interesuar në kontrollin dhe parandalimin e dhunës në zonën ku ata jetojnë.²⁴

Një tjetër studiues, **Alber K. Cohen**²⁵, thotë se nënkulturat e të rinjve u karakterizuan nga një qëndrim joutilitar, abuziv dhe negativ; të rinjtë deviantë ndjenin kënaqësi duke shkaktuar parehati për të tjerët, në përpjekje për të fyer vlerat e klasave të mesme e duke u përfshirë kështu në forma të ndryshme të kriminalitetit, me synime të menjëhershme. Sipas tij, të gjithë të rinjtë janë në kërkim të një statusi social, por jo të gjithë mund ta arrijnë atë me të njëjtat mundësi, veçanërisht fëmijët e klasave të ulëta të cilët nuk kanë përparësi materiale dhe simbolike.

Zhënjimi nga statusi mund të sjellë lloje të ndryshme të përshtatjes ndaj vlerave të klasës së mesme, duke vendosur kështu rregulla dhe standarde të reja, të cilat legjitimojnë sjellje të caktuara që çojnë në krijimin e një forme të re kulturore: një nënkulture kriminale.

Cohen argumenton se, tensionet e prodhuara nga mosintegrimi social krijojnë një vështirësi të përbashkët për shumë të rinj në klasat më të varura. Pra, nëse ata të ndjehen kriminelë, ka të bëjë shumë mënyra se si ata ndërveprojnë me anëtarët e nënkulturës delikuede, duke i konsideruar përbërësit e zakonshëm si "të tjerë të rëndësishëm" dhe duke identifikuar zgjidhjen e problemeve me nënkulturën kriminale.

Sipas **Richard Cloward**²⁶ dhe **Lloyd Ohlin**²⁷, autorë të teorisë së mundësive të ndryshme, nuk ka më shumë se një mënyrë nëpërmjet së cilës të rinjtë mund të përmbushin synimet e tyre. Në

²³ (usa, 1910-1996, pionier i studimit të kriminalitetit tek të rinjtë)

²⁴ (<http://news.usc.edu/14398/Criminologist-Solomon-Kobrin>).

²⁵ (lindur në usa 1918, kriminolog)

²⁶ (usa, 1926-2001, sociolog)

²⁷ Amerikan: sociolog, kriminolog dhe ekspert i denimeve (1918-1990)

zonat urbane të banuara nga shtresat e ulëta, ku mundësitë legjitime ishin pak, këto synime ndryshonin; por, nga ana e tyre, këto janë të kufizuara në qasje, si në rastin e strukturës së ligjshme. Pra, pozita në shoqëri përcakton kapacitetin për të përdorur dy kanale (të ligjshme apo të paligjshme) për të patur sukses.²⁸

Këta dy autorë argumentojnë se të gjitha format e nënkulturës delikuate varen nga shkalla e pranishme e përfshirjes në komunitet, duke e parë atë si një strukturë të trajnimit, si fakti që individët të cilët bëjnë rrugën e tyre në biznesin e nëntokës mund të jenë në gjendje për të marrë mjetet e nevojshme për të filluar një biznes legjitim.

2.1.7 Teoria e Etiketimit²⁹

Teoria e Etiketimit solli një përparim të madh teorik në fillim të viteve gjashtëdhjetë. Dijetarët argumentuan se teoritë e së kaluarës i kishin kushtuar shumë vëmendje devijimit individual, duke neglizhuar mënyrat në të cilat shoqëria reagon ndaj saj. Ky pozicion teorik ishte i njohur si Shkolla e Perceptimit Social. Duke marrë rolin e një kriminelit në sfond, teoria e Etiketimit tregoi interes në agjencitë përgjegjëse për kontrollin e krimit (policisë, gjyqësisë).

Sipas Becker, një prej teoricienëve kryesorë të kësaj shkolle, devijimi varet nga pikëpamja e vëzhguesit, pasi që anëtarët e grupeve të ndryshme kanë koncepte të ndryshme të asaj që është e drejtë dhe e kënaqshme, të cilat ndryshojnë në varësi të situatës. Përveç kësaj, për shkak se ka devijime është e nevojshme që të ketë një reagim kur ato janë kryer. Devijimi, për t'u kualifikuar si i tillë, duhet të jetë zbuluar nga një grup që beson se kjo nuk është një sjellje e dhënë. Nëse ligji pasqyron vlerat e atij grupi, sjellja do të konsiderohet si një krim dhe autori i saj është një kriminel.

Qasja e etiketimit mbulon dy aspekte. Shpjegimi se si dhe pse individë të caktuar janë emërtuar të tillë dhe efektet e etiketimit mbi sjelljen devijante.

²⁸ (http://www.unipegaso.it/materiali/LMG-01/annoV/SocGiur_Grado/ModV/Lezione_V.pdf)

²⁹ (<http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/cimmino/cap1.htm>)

Aspekti i parë është për të gjetur shkaqet e etiketimit, nga të cilat më e famshme është përpunimi i bërë nga Becker, ku "grupet shoqërore të krijojnë devijim duke krijuar rregulla, shkelja e të cilave përbën një akt të devijuar, dhe t'i zbatojnë për njerëz të veçantë të etiketuar si *të jashtëmit*. Nga kjo pikëpamje, devijimi nuk është cilësia e aktit që një person kryen, por është pasojë e zbatimit të rregullave dhe sanksioneve mbi fajtorin."

Lidhur me aspektin e dytë, përkatësisht pasojat e pësura nga personat e etiketuar, ai mund të zbulojë dy mënyrat e këtij procesi: në njërën anë efektet kriminogjene të etiketës së devijantit, dhe nga ana tjetër efektet e etiketës mbi imazhin e saj. Të dy proceset mund të çojnë në një zgjerim të devijimit, duke i dhënë udhë një karriere të devijuar.

“Individi - thotë Lemert - nuk vlerëson ndikimin që akti origjinal (devijimi primar), mund të ketë në imazhin e vet. Secili ka ndjeshmërinë e vet ndaj reagimeve të të tjerëve. Personi i etiketuar, në qoftë se nuk ka një imazh të mirëpërcaktuar të vetvetes, ai apo ajo mund të arrijë të pranojë atë që ofrohet nga personi tjetër, duke ndryshuar kështu identitetin e tij apo saj.”

Devijimi, atëherë, fitohet nëpërmjet një procesi të shkëmbimit reciprok, i cili përfundon kur personi i etiketuar pranon etiketën si një identitet të vërtetë. Kjo shpesh nënkupton se devijanti bëhet pjesë e një nënkulture që prodhon devijim të mëtejshëm. Procesi i etiketimit e drejton pra, për te devijimi i mesëm.

2. 2 Faktorët që ndikojnë në kriminalitetin rinor (14-18 vjeçarët)

Sipas Fondit të Emergjencës të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), numri botëror i fëmijëve të privuar nga liria si rezultat i konfliktit me ligjin është vlerësuar të jetë jo më pak se një milion.³⁰ Këta fëmijë mund të hasin autoritetet e zbatimit të ligjit për një numër të gjerë arsyesh. Kryerja e një veprë penale, duke përfshirë vepra penale politike dhe veprave të veçanta në fëmijëri është një arsye për konflikt me ligjin³¹. Më shumë se kaq, fëmijët mund të arrestohen si

³⁰ *The United Nations Children's Fund, UNICEF*

³¹ *Treguesit e Drejtësisë për Fëmijë 2013, Botim i Qeverisë së Kosovës*

një rezultat i gjetjes para një rreziku një situatë të delikuençës. Ata madje mund ta gjejnë veten në paraburgim si pasojë e zbatimit në mënyrë të parregullt ose arbitrar të ligjit prej autoriteteve që veprojnë në këtë sektor. Shkaqet sociale që sjellin fëmijët në konflikt me ligjin përfshijnë varfërinë, familjet e shkatërruara, mungesën e arsimit dhe punësimit, migrimin, keqpërdorimet e substancave narkotike, presioni i bashkëmoshatarëve brenda grupit, mungesa e orientimit prindëror, dhunën, abuzimin dhe shfrytëzimin³².

Prandaj, është mjaft e rëndësishme për këtë trajtim që të njohim *faktorët e rrezikut* që ndikojnë tek adoleshentët për të ndërmarrë qëndrime kriminale.

2.2.1 Faktorët psikologjikë.

Këtu përfshihen faktorët *emocionalë* dhe ato të *personalitetit*, ashtu si dhe vështirësitë në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. *Emocionet janë ndjenja subjektive që i përgjigjen nxitjeve të jashtme e shoqërohen me aktivitet fiziologjik të cilat prodhojnë ndryshime në sjellje.* Duke folur në terma të përgjithshëm, asnjë lloj personaliteti nuk ka lidhje me kriminalitetin, por ka mundësi se ata që bëhen kriminelë të shtyhen nga zemërimi, cënimi i egos, kritikën, ndjenja e turpërimit, përjashtimi, apo veprimet jo të mira nga njerëzit që i rrethojnë. Ky zemërim kthehet në urrejtje, e cila i mbijeton kohës dhe shfaqet me anë të fjalëve ose veprimeve të dhunshme, agresive dhe shpërthyes. Sjellja agresive lidhet me sjelljen kriminale.³³

Në raste të tjera, kriminaliteti është shprehje e armiqësisë, ankthit, frikës ose neurozave më të thella. Një *shkak i rëndësishëm është mungesa e dashurisë.* Në disa raste, kriminaliteti lind në adoleshentë që në thelb janë të shëndetshëm, por që janë shtyrë në rrugë të gabuar nga të tjerë. Për këtë, *dinamika e sjelljes së kriminelëve është e ndryshme, edhe pse rezultatet janë të ngjashme.*

Në favor të papërshtatjes janë dhe disa cilësi individuale (*pamjaftueshmëria intelektuale, çrregullimet emocionale*) që rrisin rrezikun për të rinjtë. Prandaj, ekzistojnë struktura alternative për përmirësimin e të miturit për parandalimin e fenomenit të devijimit deri tek burgu si masa më e fundit dhe ekstreme represive.

³² *Manual for the Measurement of Juvenile Justice.pdf (United Nations Office of Drugs and Crime - UNICEF)2006*

³³ *Giunchi, A., vep cit, fq 1-9.*

2.2.2 Faktorët sociologjikë.

Adoleshenca është periudha në të cilën të rinjtë bëhen pjesëtarë të një grupi, ku padyshim disa prej tyre hyjnë në grupe problematike dhe përshtaten me normat antishoqërore të vendosura në to. Edhe pse sjellja kriminale ose antishoqërore është e papranueshme për shoqërinë në përgjithësi, mund të kërkohej si kusht për të hyrë në një bandë. Kërkimet kanë treguar se normat e sjelljes së grupit ndryshojnë në varësi të grupeve të ndryshme.

Tek faktorët sociologjikë përfshihen ndikimet sociale dhe kulturore. Rëndësi marrin ndikimi i precedentëve familjarë, nivelet social-ekonomike, ndikimi i fqinjëve dhe komunitetit, pasuria, vlerat dhe mënyra e jetesës, dhuna në kulturë, mungesa e qetësisë dhe ndryshimet kulturore, braktisja e shkollës, konsumi i drogave dhe alkoolit etj. Të gjithë këto janë tregues të ekzistencës së elementëve jofunksionalë brenda shoqërisë.

Që i mituri apo e mitura të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme duhet që gjatë procesit të socializimit të mbështetet nga shkolla dhe shoqëria në përgjithësi. Familja, shkolla dhe shoqëria përfaqësojnë vendin ku i riu ose e reja fiton rregullat e para morale, ndërjegjen ku jeta mbështetet jo vetëm mbi të drejta, por dhe mbi detyrime. Kur raporti i individit me familjen, shkollën dhe agjentët e tjerë të socializimit është i vështirë, favorizohet devijanca³⁴.

Ekziston një raport i ngushtë mes kriminalitetit të të miturve dhe lindjes së shoqërisë komplekse. Kështu, situata aktuale e adoleshentëve është e lidhur ngushtë me ndryshimet që ka pësuar kohët e fundit shoqëria postindustriale. Ndryshimi i shoqërisë bashkëkohore krijon lloje të reja përjashtimi, sidomos braktisjen e shkollës që pasqyrohet në tregun e punës duke provokuar probleme të papunësisë.

Lloje të tjera përjashtimi hasen në pikëpamjen kulturore, që kanë të bëjnë kryesisht me identifikimin e vetes, me zhvillimin e personalitetit, etj.

Sot, të rinjtë *bombardohen nga informacionet*, imazhet dhe mesazhet nxitëse që përçohen nga interneti, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të medias etj., dhe e jetojnë periudhën e vështirë të adoleshencës në një sistem shoqëror me rënie drastike të vlerave morale e të qëndrueshme.

³⁴ (Selami Zalli, punim shkencor 2008)

2.2.3 Ndikimi i familjes.

Në çdo shoqëri, familja është një njësi shoqërore ku individët qëndrojnë të lidhur për shkak të lidhjeve të gjakut ose të afërisë, që veprojnë sipas interesave të përbashkëta. Në familje kemi statute të përcaktuara, një autoritet, dhe praninë e personave madhorë e të mitur.

Në kohët moderne po haset gjithnjë e më tepër *familja e shpërbërë*. Një familje bëhet e tillë atëherë kur brenda saj gjendet vetëm fëmija. Mund të përmenden disa shembuj:

Familje të divorcuara, ku mungon kujdesi familjar dhe ndarja e çiftit ka bërë që të humbë kontrolli i prindërve mbi fëmijët. Shpesh, mes ish-bashkëshortëve fillojnë konfliktet për arsyen se kush prej tyre do ta ushtrojë përgjegjësinë prindërore, duke përkeqësuar kështu ndikimin tek fëmija.

Familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike, si në fshat dhe qytet, ku kontributi i prindërve nuk plotëson dot nevojat e anëtarëve të saj.

Fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes që rriten në mëshirë të fatit nga të afërm apo institucionet shtetërore për këtë shtresë.

Fëmijë që kanë ngelur pa një kujdes mbikqyrës, pasi prindërit u janë larguar për punësim jashtë shtetit, janë duke vuajtur dënimin etj. dhe askush nuk kujdeset për ta.

Fëmijë që merren me veprimtari minimale fituese në rrugë ose punë të ndryshme për të ndihmuar veten ose familjet e tyre e për pasojë nuk mund të frekuentojnë shkollën ose e kanë braktisur atë.

Fëmijë që nuk njohin të dy prindërit, kryesisht fëmijë që lihen e braktisen në shtëpitë e fëmijës apo rriten nga të afërm të tyre;

Fëmijë që kanë braktisur prindërit (për arsye të ndryshme) apo vatrën familjare dhe nuk jetojnë më me ta.

Fëmijë të cilët kanë të pranishëm vetëm njërin prind dhe nuk u dihet tjetri.

Një familje e plotësuar me të dy prindërit, të lidhur e pa probleme në çift ndikon drejtpërdrejt në personalitetin e fëmijës në të ardhmen. E kundërta ndodh me fëmijët që rriten me një prind ose pa asnjë, me prindër të divorcuar apo me probleme në çift, prindër të droguar apo alkoolizuar, të dhunshëm në familje e shoqëri, që janë duke vuajtur dënimin, etj. Këta fëmijë traumatizohen që në vegjëli dhe janë kontigjent më i gatshëm për një të ardhme kriminale sesa kategoria e parë e përmendur më lart.

Kur adoleshentët formojnë ndjenjën e identitetit, ata përpiqen të fitojnë më tepër pavarësi. Reagimi i prindërve ndaj kësaj pavarësie përcakton shpesh klimën e marrëdhënieve brenda familjes. Disa konflikte në këtë të fundit duket se janë të pashmangshme. Periudha e pubertetit shoqërohet me një dëshirë për pavarësi të theksuar të adoleshentëve dhe konfliktet me prindërit të cilët nuk ndihen gati për këtë “etje” për pavarësi. Veprimet devijante të adoleshentit lidhen me marrëdhëniet me prindërit që nuk ushtrojnë kontrollin e efektshëm e për më tepër nuk perceptojnë drejt zhvillimin e fëmijës. Pra, këtu nxjerr krye kriza e “funksionit prindëror” që ka kuptim të dyfishtë të “modelit të referimit” dhe të “pengesës për tu kapërcyer”.

Familja tradicionale patriarkale ka përfaqësuar një ambient shoqëror të privilegjuar ku kërkesat e individit gjenin vëmendje dhe shpesh zgjidhje të mundshme të problemeve. Me fjalë të tjera, familja përfaqësonte një sistem shoqëror bazë me vlera jo vetëm të mbështetjes e solidaritetit mes anëtarëve të saj, por dhe një ambient ku trashëgoheshin përvojat e brezave me vlera edukuese e kulturore.

Familja moderne, me pak anëtarë brenda saj, jo vetëm që ka humbur pjesën më të madhe të funksioneve edukuese, por nuk arrin të sigurojë mbështetjen e duhur emocionale dhe ngrohtësinë e mjaftueshme për fëmijët.³⁵

Përvoja e përditshme tregon se shpesh, prindërit nuk kanë marrëdhëniet e duhura me fëmijët, për shkak të punës ose angazhimit të plotë ndaj karrierës. Gjendjet e konfliktit në familje shtohen e shpesh përfundojnë në ndarje (divorc). Armiqësitë dhe tensionet emocionale i shkarkohen pjesës më të pambrojtur, fëmijëve, që përdoren dhe si mjete shantazhi midis prindërve. Problemet e

³⁵ Candanil Valencia, M.I., Echeverry Vargas, D.M., Villa Ruiz, A. M., vep cit, faqe 23.

komunikimit në familje që janë studiuar e trajtuar nga psikoterapia familjare janë gjithnjë e më të vazhdueshme.

Një dukuri tjetër që zhvillohet brenda familjes është edhe dhuna ndaj fëmijëve, e cila shpesh mbetet e padënuar. Abuzimet psikike dhe fizike ushtrohen ndaj fëmijëve jo vetëm nga prindërit, por edhe nga mësuesit, kujdestarët e institucioneve të ndryshme, policia, e individë të tjerë të caktuar të shoqërisë. Dhuna e ushtruar mbi ta në moshë të njomë lë gjurmë të fshehura në personalitetin që po formohet, dhe me rritjen e moshës ky personalitet shpërthen kundër rregullave, duke pasqyruar kështu elementët e dhunës që ka vuajtur në fëmijëri. Këto qëndrime shpesh shndërrohen në sjellje kriminale.

Ndër faktorë të riskut renditet jo vetëm dhuna, por edhe varfëria³⁶ dhe presionet e tjera shoqërore dhe ekonomike shpesh e shkatërrojnë aftësinë e familjes për të rritur siç duhet fëmijët. Të gjitha këto probleme që mblidhen në fëmijëri shërbejnë si nxitës, që i mituri apo e mitura të dojë të largohet prej tyre duke zgjedhur rrugën e gabuar, zakonisht atë të krimit.

2.3 Modelet e sjelljes.

Modelimi është një proces i cili nis me vëzhgimin e të tjerëve dhe vazhdon me përpunimin e një lloji sjelljeje që ka ngjashmëri me modelin e vëzhguar. Modelimi si proces haset shpesh tek fëmijët; një fëmijë që vëren fëmijë të tjerë të pabindur ndaj rregullave, mund të priret të imitojë shembullin e tyre.

Fëmijët mund të imitojnë çdo lloj sjelljeje, duke nisur që nga sulmi fizik e deri tek gjykimi moral. Ky është një faktor tjetër që ndikon tek të miturit për t'i shtyrë në rrugën e krimit. Ata vërejnë sjelljen e bashkëmoshatarëve të tyre, e cila mund të jetë e kundërligjshme, dhe të gjendur në situatë presioni imitojnë këtë sjellje në mënyrë që të fitojnë miratimin e bashkëmoshatarëve të tyre.

2.3.1 Proceset e motivimit dhe të njohjes.

³⁶ Sipas raportit "Varfëria në Shqipëri" të vitit 2001, rreth 29.6% e popullsisë janë të varfër, ndërsa mbi 500.000 individë janë shumë të varfër.

Ndikimet sociale nuk përfshijnë vetëm imitimet e modeleve të sjelljeve. Individu duhet të jetë i inkurajuar që t'i kushtojë vëmendje një sjelljeje të modeluar në mënyrë që ta grumbullojë atë në mendje dhe ta përdorë në rastin e duhur.

Ky proces njohës dhe motivimi na ndihmon të kuptojmë arsyen e modelimit të fëmijëve. Me rritjen e moshës, fëmijët shndërrohen në vëzhgues që priren të kapin tiparet e spikatura të dikujt. Është kjo arsyeja që fëmijët priren të imitojnë qëndrimet më të dukshme të një grupi individësh, ndryshe nga adoleshentët dhe të rriturit që riprodhojnë sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve të veçantë.

Përsa i përket zhvillimit, modeli është mjaft i rëndësishëm sepse i përgjigjet kërkesave të fëmijës. Krimineli i shfaq impulset e veta pasi ka parë që njerëz të tjerë të njohur veprojnë në po këtë mënyrë për të zgjidhur problemet e tyre. Krimineli mund të ndihmohet duke treguar me saktësi qëndrime specifike që ai të përshtatet me një shoqëri komplekse dhe të industrializuar.

2.4 Kriminaliteti i të miturve dhe lëvizjet migruese.³⁷

Të ardhurit ose të huajt janë parë gjithnjë si armiq ose keqbërës.³⁸ Ata bien në sy së tepërmi për shkak të gjuhës, veshjes, sjelljes, etj. Këto elementë jo vetëm që tërheqin vëmendjen, por edhe bëjnë që vendasit e shtetit ku ata janë shpërngulur, t'u shmangen. Nëse të huajt rrinë në grupe, rritet ndjenja e frikës ose rrezikut dhe vështirësohet largimi nga mentaliteti i origjinës dhe vendit nga ku vijnë.

Shpesh, kriminaliteti i të miturve është lidhur me emigrimin. Lëvizjet migruese sjellin mjaft konflikte të ndërlikuara që nuk mund të zgjidhen në mënyrë të përgjithshme, siç është integrimi i të huajve.

Faktorët konkurrues në sjelljet devijante të të rinjve që vijnë si rrjedhojë e lëvizjeve migruese janë të ndryshëm. Këta faktorë shtohen kur fëmijët shoqërojnë prindërit e tyre, në krahasim me rastin kur rriten në vendin e tyre. Në çdo rast, problemet e përshtatjes dhe të frustrimit janë më të mëdha tek emigrantët sesa tek lëvizjet migruese brenda vendit.

³⁷ Në shtetin tonë nuk gjenden tepër emigrantë, të cilët do të sillnin një ndryshim të tillë në shoqëri sa të konsideroheshin problematikë me sjelljen e tyre. Kjo pjesë trajtohet për të krijuar një pamje sa më të plotë lidhur me problemin e kriminalitetit të të miturve.

³⁸ E njëjta pozitë për të ardhurit nga lëvizjet migruese brenda vëndit, jo rrallë trajtohet ndryshe nga studiues të veçantë në Shqipëri.

2.5 Migrimi i brendshëm dhe urbanizimi informal

Ky fenomen është një dukuri mjaft e përhapur gjatë kësaj dekade. Urbanizimi po sillet në jetë kryesisht nëpërmjet krijimit të vendbanimeve jo legale nga familje më të ardhura të ulëta³⁹. Në aspektin social, problemet e shkaktuara nga lëvizja demografike e popullsisë dhe urbanizimi shoqërohen nga:

- *varfëria ekonomike dhe braktisja e burimeve tradicionale të jetesës dhe punës e cila ka qenë e siguar dhe e detyrueshme përpara viteve '90.*
- *braktisja e të moshuarve në vendbanimet e mëparshme;*
- *braktisja e shkollës nga fëmijët për shkak të varfërisë dhe kapaciteteve të kufizuara arsimore në zonat urbane;*
- *papunësia tek të rinjtë dhe vështirësitë e përfshirjes në jetën urbane që mund t'i shtyjnë në aktivitete kriminale;*
- *rritja e numrit të grave kryefamiljare etj...*

Sigurisht që emigrantët të etiketuar si “ardhacakët” kryejnë krime në këto vende, por duket se ka tendencë që këtyre t’u vishet, pa bazë dhe prova të verifikuara, kryerja e sjelljeve kriminale dhe arsyeja si shkaktarë të rritjes e kriminalitetit në këto vende.⁴⁰ E njëjta situatë dhe tendencë paraqitet në Shqipëri.

Në vendet fqinje kufitare Itali dhe Greqi, ksenofobia është prezente në sjelljen ndaj të huajve, veçanërisht ndaj shqiptarëve, edhe pse nga vendasit atje mund të kryhen krime nga më të rëndat të cilat fatmirësisht janë të papara e të padëgjua në Shqipëri. Në këto vende, ndodh fenomeni i “hiberbolizimit të kseno kriminalitetit” duke qenë se për një krim të zakonshëm nga të huajt ka një reagim të bujshëm nga autoritetet, media, e shoqëria, ndërsa gjestet e mëdha “humane” si p.sh nga shqiptarët, që japin jetë nga jeta e tyre, kalohen në heshtje si diçka e zakonshme.

Në Shqipëri kjo situatë nuk ekziston në këtë formë, por në formën e “kriminalit migrator” duke qenë se ekziston një lloj tendence për të prezantuar të ardhurit nga zona specifike të vendit përgjithësisht nga veriu i Shqipërisë në veçanti, si faktor me tendencë të caktuara kriminale. Në rastin më të parë, kjo kategori sulmohet dhe etiketohet në mënyrë ekstreme. Po kjo logjikë dhe

³⁹ *Ndikimi Social i Emigracionit dhe Migrimit Rural-Urban në Evropën qendrore dhe Lindore Përmbledhje Ekzekutive per Shqipërinë Prill 2012*
Autorë: Ilir Gedeshi Elira Jorgoni

⁴⁰ Halili, R., *Kriminologjia, Prishtinë 2008, fq 244.*

linjë arsytimi vepron dhe ndaj fëmijëve të të ardhurve, kur pranohet se të miturit e ardhur, kryesisht veriorë, bëjnë punë të ndryshme si shitës ambulante, lavazhierë, etj. ndërsa fëmijët autoktonë e kryesisht romë ushtrojnë veprimtari lypje si dhe përfshihen në aktivitet kriminal si në përvetësime në vlera të vogla, shpërndarës droge etj.

2.6 Mosha për përgjegjësi penale.

Mosha për përgjegjësinë penale ndryshon në varësi të shtetit, dhe kryesisht ajo në shkallë botërore është nga 8-20 vjeç. Shqipëria ka fiksuar aktualisht një moshë për t'u ndjekur penalisht e cila fillon nga 14 vjeç për krimet e deri tek 16 vjeç për kundërvajtjet penale. Sot në Evropë e më gjerë nuk ka ende një moshë minimale standarde e cila mund të pranohet si kufi për të filluar përgjegjësinë penale. Pjesa më e madhe e shteteve evropiane kanë miratuar një moshë e cila është më e lartë se ajo që është në fuqi në Angli dhe Uells. Shtete të tjera, të tilla si Qipro, Irlanda, Lihtenshtajni apo Zvicra, ua atribuojnë përgjegjësinë penale një moshe më të re. Për më tepër, nuk ka tendencë të qartë që mund të konstatohet nga shqyrtimi i teksteve dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare.

Rregullat e Pekinit⁴¹ të cilat edhe pse nuk janë të detyrueshme ligjrisht, mund të ofrojnë disa tregues të ekzistencës së një konsensusi ndërkombëtar, por nuk specifikojnë moshën në të cilën përgjegjësia penale duhet të jetë fikse. Këto rregulla thjesht ftojnë shtetet (me moshë shumë të ulët të përgjegjësive penale), për të rregulluar sistemin dhe neni 40 (3) (a) i Konventës së OKB-së kërkon nga shtetet palë për të krijuar një moshë minimale nën të cilën do të supozohet se fëmijët nuk kanë kapacitet për të shkelur ligjin penal, por nuk përmban dispozita për faktin se sa duhet të jetë mosha.

Nocioni i moshës për përgjegjësi penale nuk është shumë i trajtuar në literaturën juridike botërore, por studimet kryesore tregojnë se ky nocion ka të bëjë e lidhet me kapacitetin e një personi për t'u angazhuar në një sjellje kriminale. Gjithashtu, kjo lidhet me procesin i cili një person (të mitur) e bën përgjegjës për një sjellje të tillë. Dallimi në mes të përgjegjësive si

⁴¹ -"Tërësia e rregullave standarde minimale në lidhje me drejtësinë e të miturve", ("The Beijing Rules" (Rregullat e Pekinit), miratuar në datë 29.11.1985 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 40/33).

kapacitet dhe si përgjegjësia para ligjit është i rëndësishëm për rezultatet pragmatike të studimeve të ardhshme.

Fëmijët e ditëve të sotme janë duke u zhvilluar më shpejt se në të shkuarën. Moshat 10-16 vjeçare kanë botëkuptim më të zhvilluar (falë ndikimit të arsimit, shkencës, teknologjisë,) sesa fëmijët 10-16 vjeçarë në shekujt 18-19, dhe ky zhvillim evoluon edhe brenda një shekulli apo disa dekadave.

Mosha për përgjegjësi penale në Evropë dhe në disa shtete të botës paraqitet si më poshtë:

	SHTETI	MOSHA/VJEÇ	SHTETI	MOSHA/VJEÇ
	Albania	14-16	Australia	10
	Austria	14	United States	6-12
	Belgium	16	Brazil	18
	Croatia	14	India	7
	Czech Republic	15	Myanmar	7
	Denmark	15	Nigeria	7
	Estonia	14	Pakistan	7
	Finland	15	Singapore	7
	France	13	Sudan	7
	Germany	14	Tanzania	7
	Hungary	12	Indonesia	8
	Iceland	15	Kenya	8
	Ireland	12	Bangladesh	9
	Italy	14	Ethiopia	9
	Netherlands	12	Iran	9 (vajzat); 15 (djemtë)
	Norway	15	Israel	12
	Poland	15	Hong Kong	10
	Portugal	16	Nepal	10
	Romania	14	new Zealand	10
	Russia	14	South Africa	10
	Switzerland	10	Algeria	13

Slovenia	14	China	14
Spain	14	Thailand	10
Sweden	15	Japan	14
Scotland (UK)	12	Bolivia	14
Turkey	12	Canada	12
United Kingdom	10	Costa Rica	12
Ukraine	14	Vietnam	14
DR Congo	16	Morocco	12
Colombia	18	Uganda	12
Ecuador	18	Chile	16
Mexico	18	Paraguay	14
Peru	18	South Korea	14
Uruguay	18	Taiwan	14
Argentina	16	Egypt	15
Uzbekistan	15	Philippines	15

KAPITULLI 3

Kriminaliteti, kuadri ligjor dhe sistemi gjyqësor në Shqipëri.

3.1. Përcaktimi i termave të kriminalitetit

Në preambulën e Deklaratës së të Drejtave të Fëmijëve, të njohur ndryshe si “Deklarata e Gjenevës” e vitit 1924, është shpallur se “*njerëzimi i detyrohet fëmijës më të mirën që ai ka të për të dhënë*”⁴².

E drejta penale për të miturit, si tërësi normash ligjore dhe institutesh juridike, ka si synim trajtimin e të miturit si autor veprash penale. Normat ligjore të së drejtës penale për të miturit përbëjnë garancinë për personat më të dobët dhe vulnerabël, prandaj funksioni i saj mund të arrihet vetëm nëse respektohen të drejtat dhe mbrojtja e të miturit.

E drejta penale për të miturit është e lidhur, dhe për këtë arsye duhet t’i referohet mësimëve dhe përfundimeve që vijnë nga fusha e kriminologjisë, dhe u përkasin fushave të shkencave sociale. Këto shkenca kanë për objekt studimi fenomenet, sjelljen dhe mjetet sociale, kulturore, politike, juridike apo penale që historikisht kanë evoluar për të shpjeguar dhe për t’i bërë ballë kriminalitetit.

Nga studimet e shkencës së kriminalitetit vërehet se tendenca e kriminalitetit rritet me arritjen e moshës së pubertetit, derisa arrin kulmin e saj në mbushjen e moshës midis 20-25 vjeç, dhe në disa shtete të caktuara edhe në moshë më të vogël. Kjo tendencë synon të mbetet e vazhdueshme deri në harkun e moshës deri në 40 vjeç, dhe më pas pëson një ulje të ndjeshme nga mosha 60 vjeç, duke pushuar më pas me arritjen e moshës së thyer.⁴³ Studimet e sociologut *Adolphe Quetelet* në fillimin e shekullit të 19-të tregojnë qartazi tendencën se kriminaliteti ka një lidhje të

⁴² <https://www.humanium.org/en/text-2/> (konsultuar më 20.10.2019).

⁴³ F.Mantovani, *Il problema della criminalita*, Cedam, 1984, f.5.

drejtpërdrejtë me moshën. Kjo tendencë synon rritjen e saj në moshën e adoleshencës e derisa arrin maksimumin e saj rreth moshës 25 vjeç.⁴⁴ Kjo lidhje mes moshës dhe krimit shihet nga ana e autorëve si një lidhje universale, por me variacione të ndryshme në secilën shoqëri.

Përkufizimi i të miturit të pandehur, përveç kuptimit përshkrues të gjendjes së tij në një proces penal që nënkupton nevojën e tij për reagimin e tij në proces, mbart edhe kuptimin e nevojës për përkujdesje dhe edukim. Pikërisht bashkimi i këtyre nevojave në një nivel të caktuar ekuilibri, përcakton edhe mënyrën apo masën me të cilën procesi për të miturit bën trajtimin e të miturit në konflikt me ligjin në një kohë dhe në një shtet të caktuar.

Nëse mund të kryhet një analizë e shpejtë lidhur me përcaktimin e ekuilibrit midis nevojave të mbrojtjes së shoqërisë dhe gjendjes së veçantë të të miturit në proces (nevojave të tij specifike), mund të vërejmë se në Romën e Lashtë, Ligji i Dymbëdhjetë Tabelave i përjashtonte të miturit (*impuberes*) nga përgjegjësia penale, me përjashtim të rastit që ata ishin thuajse të rritur (*pubertate proximi*), në periudhën klasike të sistemit juridik romak. I njëjti parim zbatohet edhe në të drejtën e popujve gjermanikë, e cila u zbatua në Evropë deri në fillimin e periudhës së Mesjetës. Baza ideologjike e kësaj qasjeje qëndronte në faktin se që një subjekt të mund të thirrej nën përgjegjësi penale për veprimet apo mosveprimet e tij, me pasojat që vinin nga kjo, ai duhet të kishte një zotësi apo një aftësi për të kuptuar dhe dalluar veprimet penalisht të ndaluara, si dhe një autonomi veprimi që vështirësisht përkon me moshën e mitur. Në periudhën e Mesjetës, ky parim ka pësuar një farë kufizimi, pasi në Angli mund të burgoseshin persona të mitur nga mosha 9 vjeç e sipër, apo edhe të dënoheshin me dënim me vdekje. Duke filluar nga shekulli i 17-të, nën ndikimin e humanizmit, të shkollës e të Kishës, u zhvillua ideja se fëmijët kanë nevojë të veçanta dhe duhen trajtuar ndryshe nga të rriturit. Tashmë është gjerësisht e pranuar se fëmijët e moshës së mitur deri në 18 vjeç kanë një shkallë përgjegjësie më të ulët sesa personat e rritur.

Niveli i ekuilibrit mes nevojave të mbrojtjes së shoqërisë dhe gjendjes së veçantë të të miturit në proces (nevojave të tij specifike), pikërisht, ka ndryshuar në Republikën e Shqipërisë, duke i lënë vend tashmë një pike të re evolucioni, dhe për rrjedhojë, edhe një ekuilibri të ri për trajtimin e të miturit, pas ndryshimeve të ndodhura në vitin 2017 me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Pragu i moshës për përgjegjësi penale, dallimi në trajtimin e të miturit në procesin penal, parashikimi i masave të posaçme për të miturin dhe specializimi i organit gjyqësor, janë elementë përbërës të sistemit për të përballuar kriminalitetin e të miturve në Shqipëri.

⁴⁴ A. Quetelet, A., *Research on the propensity for crime at different ages*, F. Sylvester, Trans., Cincinnati, OH: Anderson, 1984.

Në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është përcaktuar se fëmijët (...) kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal. Në bazë të nenit 27 të Kushtetutës, liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent. Pra, ndonëse Kushtetuta i njeh një mbrojtje të posaçme fëmijës apo të miturit, ajo nuk përkufizon termin “fëmijë” apo “i mitur”.

Sipas legjislacionit shqiptar, me termin “fëmijë”, apo “i mitur” konsiderohet personi nën moshën 18 vjeç. Kështu, në nenin 54 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Rregullat për caktimin e dënimit për të miturin parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Në këtë dispozitë, në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë jepet përkufizimi i parë në lidhje me termin “i mitur”, si individ që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM) parashikon rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, norma procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, por rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18-21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij.

Në nenin 3, pika 3 e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, përkufizohet si “i mitur” çdo person nën moshën 18 vjeç. Kategoria e personit të mitur, sipas legjislacionit penal shqiptar ndahet në dy kategori të miturist: të mitur që nuk mbajnë përgjegjësi penale, pra që janë penalisht të papërgjegjshëm dhe të mitur që mbajnë përgjegjësi penale, të cilët konsiderohen penalisht të përgjegjshëm. Kjo kategori e fundit, sa i përket përgjegjësisë penale të të miturit, ndahet në varësi të llojit të veprës penale. Për veprat penale të llojit “krim”, i mituri ka përgjegjësi penale nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Ndërsa për veprat si kundërvajtje penale, i mituri ka përgjegjësi penale nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Është e rëndësishme të theksohet se dallimi i llojit të veprës penale, në çdo rast, bëhet në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal. Sipas

këtyre përcaktimeve, e vetmja mënyrë për të vendosur nëse kemi të bëjmë me një krim ose me një kundërvajtje është referimi në dispozitën inkriminuese përkatëse në pjesën e posaçme të Kodit Penal, e cila duhet të parashikojë shprehimisht llojin e veprës penale.

Në lidhje me sistemin ligjor për të miturit në Shqipëri, ligjvënësi përcakton një ndalim absolut për atribuimin e përgjegjshmërisë penale për fëmijët e mitur deri në moshën 14 vjeç, si për krime, ashtu edhe për kundërvajtje, ndërsa për fëmijët e mitur të moshës nga 14 deri në 18 vjeç, ligjvënësi vendos një prezumim përgjegjshmërie, përkatësisht për krime nga mosha 14 vjeç e në vijim dhe për kundërvajtje nga mosha 16 vjeç e në vijim.

Duke qenë ndarja e veprave penale në krime dhe kundërvajtje një tagër i ligjvënësit dhe që nuk lidhet në fakt me kuptueshmërinë dhe pasjen e aftësisë për të kuptuar rëndësinë e veprës penale, për fëmijët e mitur të moshës nga 14 deri në 18 vjeç, do të kishte qenë më e përshtatshme përcaktimi i përgjegjshmërisë, pra, i aftësisë së të miturit për të kuptuar rëndësinë dhe pasojat e veprës penale, rast pas rast nga ana e gjykatës sesa përcaktimi në mënyrë paraprake dhe abstrakte të kësaj aftësie në mënyrë të prezumuar për këtë grup të miturish.

Në bazë të legjislacionit penal shqiptar, me kriminalitet të të miturit, do të kuptohet kryerja e veprave penale, si krime, ashtu edhe kundërvajtje nga ana e personit, i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Ky përcaktim është në përputhje edhe me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.⁴⁵ Në bazë të këtij dokumenti, parashikohet se për qëllime të këtyre Rregullave, i mitur është çdo person nën moshën 18 vjeçare. Mosha nën të cilën personi nuk mund të privohet nga liria do të përcaktohet me ligj. Ky parashikim i legjislacionit shqiptar është në përputhje të plotë edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, sipas së cilës me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.⁴⁶

Shoqëria shqiptare, përcakton disa pritshmëri sociale në varësi të moshës, prej nga të cilave priten sjellje të caktuar nga të miturit, të rriturit dhe ata që janë në moshë të thyer. Mospërshtatja e të miturit në shoqërinë ku ai jeton përbën shumë forma të devijimeve dhe sjelljeve problematike, të cilat shpeshherë mund të përbëjnë edhe sjellje që konsiderohen vepra penale. Është e nevojshme që për të analizuar fenomenin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë dhe

⁴⁵ Rezoluta 45/113, të datës 14 dhjetor, 1990.

⁴⁶ Neni 1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989.

mospërshtatjen e tyre duhet të mbështetemi dhe marrim në konsideratë të gjithë faktorët dhe në të gjitha nivelet që ata veprojnë. Pikërisht, kjo mospërshtatje e të miturit shkaktohet nga:

(i) faktorë makrosocialë, sikundër janë ndryshimet e thella sociale, krizat e strukturave dhe të institucioneve që tradicionalisht ishin parashikuar për shoqërizimin e të miturve. Të tillë mund të konsiderohen ndryshimi i regjimit politik nga ai monist në atë demokratik, suprimimi i institucioneve të riedukimit për të miturit që kanë ekzistuar gjatë regjimit të mëparshëm, kriza ekonomike, apo niveli i lartë i papunësisë, etj.;

ii) faktorë mikrosocialë, sikundër janë papërshtatshmëria e familjeve për të realizuar detyrën civile-sociale të edukimit të fëmijëve të mitur, apo prishja e familjes apo ndryshimi i grupit social për shkak të zhvendosjes, apo ndryshimit të vlerave;

(iii) faktorë individualë të natyrës psiko-patologjike, apo të asaj ambientale. Të tilla mund të konsiderohen vështirësia e shoqërizimit, vështirësia e të sjellurit në raport me autoritetet publike, papërshtatshmëria arsimore, papërshtatshmëria për të punuar, shoqërimi me banda të të rinjve nëkonflikt me ligjin, varësia nga substancat narkotike dhe/ose nga alkooli, endja nëpër rrugë apo ushtrimi i prostitucionit, etj.

Shqipëria rreshtohet ndër ato vende që i ka dedikuar një vëmendje të veçantë kriminalitetit të të miturve dhe për rrjedhojë dhe kuadrit ligjor e më tej edhe sistemit gjyqësor. Modeli i politikës penale në Shqipëri në thelb, mund të konsiderohet ai i Rregullave minimale të Pekinit për administrimin e drejtësisë penale për të mitur, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nëpërmjet Rezolutës Nr.40/33, datë 29 nëntor 1985.

Ky model mund të konsiderohet me një përkushtim më të theksuar drejt nevojave dhe kërkesës së të miturit sesa nevojave për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi i të miturve. Megjithatë, Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr.20/2003, duket se ka zbehur disi qasjen garantuese për mbrojtjen e të miturit dhe parandalimin e tij për të kryer vepra penale, duke shtuar si në objektin e saj përveç parandalimit të kriminalitetit të të miturve dhe përsëritjen e tij edhe nevojat dhe interesat e viktimës.

Për shpjegimin e kriminalitetit të të miturve, ekzistojnë teori të ndryshme, të cilat përpiqen të shpjegojnë nga pikëpamja psikologjike kriminalitetin e të miturve. Një pjesë e doktrinës e konsideron kriminalitetin e të miturve, si një sjellje jo të ekuilibruar nga pikëpamja emocionale.

Ndërsa një pjesë tjetër e doktrinës, e konsideron kriminalitetin e të miturve, si veprim kundër shoqëror të vazhdueshëm, apo si një sjellje devijante në raport me normat e shoqërisë.⁴⁷

Pra, kriminaliteti i të miturve, mund të kuptohet si një dukuri që bazohet në devijimin, d.m.th. shmangien e të miturit nga respektimi i normave shoqërore-juridike, për të marrë një rol dhe një identitet të caktuar në shoqëri dhe krijuar një tërheqje vëmendjeje qoftë edhe duke shkelur ligjin penal.

Kriminaliteti i të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazën e legjislacioni vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e mbledhura. Shprehja e kriminalitetit të të miturve vërehet përmes kryerjes së veprave penale të vjedhjes, vjedhjes në bashkëpunim, vjedhjes me dhunë, armëmbajtjes pa leje, plagosjes, prodhimit të lëndëve narkotike, marrëdhënieve seksuale me të mitur, etj.

Sa i përket shkaqeve, mund të thuhet se të shumta janë studimet që merren me interpretimin e statistikave dhe të dhënave për kriminalitetin e të miturve.

Së pari, mund të renditen shkaqet ekonomike për shkak të vështirësisë ekonomike të familjarëve, të cilat izolojnë dhe emargjinalizojnë një të mitur, duke e shtyrë atë drejt krimit. Në këtë drejtim nga të dhënat statistikore mund të arrihet në përfundimin se ishullimi dhe veçimi i të miturve të emargjinalizuar mund t'i shndërrojë ata që jetojnë në zona të varfra, të veçuara dhe periferike, apo që iu përkasin grupeve të pakicave etnike, në kriminelë të vegjël, për shkak të vështirësive për t'u pranuar në gjendjen e tyre sikundër janë nga shoqëria.

Situata familjare problematike, mund të jenë shkak kryesor ku mund të lindë një konflikt mes të miturit dhe shoqërisë, sikundër janë: ndarja në familje, abuzimet, vdekjet ose fatkeqësitë, etj. Në vija të përgjithshme familja përbën vatrën kryesore nga ku mund të lindin kriminelë të ardhshëm të mitur, pasi shpërqendrimi i prindërve të zënë me problemet e tyre të shumta e të përditshme, një kontroll tepër i rreptë, ose një liri e tepruar, mund të shkaktojnë reagime të dhunshme dhe të pakontrolluara, si brenda ambientit familjar ashtu edhe jashtë tij.

Dukuria e *baby gang-ut*⁴⁸, është një shkak tjetër që shton në rritjen e kriminalitetit të të miturve. Të miturit në moshën e adoleshencës janë të prirë për t'u shoqërizuar dhe mbledhur me bashkë-

⁴⁷ Më tepër shih kapitullin 2

moshatarë me karakteristika të ngjashme, si mosha, shkolla, lagjja, interesat e përbashkëta, etj. Moshë e adoleshencës përbën një periudhë mjaft delikate, e cila mund të bëhet e vështirë në prani të disa situatave të vështira familjare dhe/ose personale. Nevoja për ta përballuar këtë situatë, shtyn në ndjenjën për të qenë pjesë e një grupimi. Kjo dukuri përforcon idenë e pranimit më të lehtë nga shoqëria, duke e shtyrë të miturin adoleshent që të bëhet pjesë e një grupimi kriminal. Ky lloj grupimi dallohet për nga dëshira e pjesëtarëve të tij për t'u respektuar nga shoqëria dhe shkelja e normave shoqërore për t'u ndjerë të rëndësishëm dhe tërhequr vëmendjen. Kjo dukuri sot është në rritje e sipër edhe në Shqipëri.

3.2 Kriminaliteti i të miturve dhe aktet ndërkombëtare.

Për trajtimin e të miturve, veçanërisht për ata të mitur që procedohen penalisht, ekziston një rregullim i veçantë ligjor, kombëtar dhe ndërkombëtar, që konsiston në trajtimin e tyre të diferencuar dhe që ka qëllim mbrojtjen e të miturve që procedohen penalisht për vepra penale, në të gjitha fazat e procedimit, duke filluar që nga hetimi, duke vazhduar me gjykimin dhe, më pas, me dënimin e tyre, si dhe për krijimin e kushteve optimale për riedukim gjatë vuajtjes së dënimit të dhënë. Po kështu, ka rregulla të veçanta për ata që thirren në procedim si të dëmtuar apo dëshmitarë.

Organizmat e ndryshme ndërkombëtare të formuara prej shteteve kanë miratuar akte të ndryshme që përcaktojnë standardet minimale dhe rekomandojnë masa të posaçme për parandalimin e krimeve nga të miturit, si dhe trajtimin e tyre gjatë dhe pas procedimit penal. Si Organizata e Kombeve të Bashkuara ashtu edhe Këshilli i Evropës kanë miratuar traktate, konventa, rezoluta, të shoqëruara herë pas here nga protokolle të ndryshme shtesë si dhe, në vijim të tyre, rekomandime dhe deklarata. Një pjesë e instrumenteve ndërkombëtare lidhur me kriminalitetin e të miturve kanë karakter të fortë detyrues. Në disa të tjera, karakteri detyrues është më pak evident (të ashtuquajturat “ligj i butë”). Kështu p.sh. normat ligjore janë detyruese ndërsa rekomandimet janë “më të dobëta”.⁴⁹

Aktet kryesore ndërkombëtare në të cilat parashikohet qartë vëmendja dhe kujdesi për të miturit që procedohen penalisht janë:

⁴⁸ Organizime adoleshentes me drejtim kriminal në imitim të grupeve kriminale të ndryshme nëpër botë.

⁴⁹ Unicef, *Drejtesia për të Mitur në Shqipëri, Tiranë, 2008, fq. 12.*

1. Konventa “*Për të drejtat e fëmijës*” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në nëntor të vitit 1989.

Ky akt ndërkombëtar detyruet, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 shkurt 1992, është baza e administrimit të drejtësisë për të rinjtë, sepse jo vetëm ofron një sërë masash për mbrojtjen e interesave të tyre, por edhe përcakton masa për mbrojtjen e fëmijëve të mitur në konflikt me ligjin.

2. “*Rregullat standarde minimale për administrimin e drejtësisë për të mitur,*” të quajtura ndryshe “*Rregullat e Pekinit*”, Nr.40/33, e datës 29 nëntor 1985, miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Ky dokument zgjeron dhe zhvillon më tej përmbajtjen e dispozitave të Konventës “*Për të drejtat e fëmijëve*”, duke u ndalur veçanërisht tek rregullat e procedimit penal, ndalimit, hetimit, gjyqimit dhe trajtimit në institucionet e edukimit. Akti rekomandon ngritjen, organizimin dhe zhvillimin e strukturave shtetërore dhe policore të veçanta e të specializuara për të rinjtë. Në mënyrë të veçantë ai trajton të drejtat e fëmijëve në procesin penal, në konflikt me ligjin, si dhe trajtimin e tyre në institucionet e ndryshme të riedukimit. Për të gjitha organet e zbatimit të ligjit, përfshirë edhe policinë, kërkohet që të jenë të vëmendshme e të rishikojnë praktikën e punës me moshën e të miturve.

3- “*Rregullat për mbrojtjen e të rinjve të privuar nga liria*”, Nr.45/113, e datës 14 dhjetor 1990, miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Ky dokument përmban parime të rëndësishme për barazinë në mbrojtje, trajtimin e të miturve në procesin penal. Në të, rekomandohen rastet e aplikimit ndaj të miturve të masave të përshtatshme të sigurisë, të shpejtësisë së hetimit, të mosabuzimit, gjyqimit, etj. Qëllimi i këtij akti është të mbrohen të rinjtë dhe paraburgimi e dënimi ndaj tyre të përdoren vetëm kur është e pashmangshme dhe për aq kohë sa është e domosdoshme.

Në vijim instrumente ndërkombëtare të tjera si: Rregullat standarde për masat jondaluese; Konventat 138 dhe 182 të Organizatës Botërore të Punës (ILO); si dhe Rrjetin e Bashkimit Evropian “*Për parandalimin e krimit*”.

Në kuadrin rajonal, mund të përmendim: *Konventën e Evropiane e të Drejtave të Njeriut KEDNJ dhe Protokollet Nr.1; 2; 4; 5, 6; 7,11; të Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar); Konventën Evropiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve; Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve; Konventën Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese” dhe Protokollin Nr.1 dhe 2; të Konventës Evropiane mbi të Drejtat Sociale; Konventën Evropiane për mbikqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht, etj.*

3.3 Trajtimi i të miturve para reformës së vitit 2017.

Mbi bazën e një vështrimi të përgjithshëm, por edhe të detajuar vërehet se legjislacioni shqiptar, bazuar edhe në aktet e ndryshme ndërkombëtare, ka pasur në vëmendje mbrojtjen si dhe tregimin e një kujdesi të posaçëm për të miturin. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligji themeltar, kodet dhe aktet e tjera ligjore, kanë pranuar edhe parimet e normat e akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve. Gjatë periudhës 1990-2019, të gjitha fushat e sistemit të drejtësisë për të miturit kanë qenë në një proces reformimi të pandërprerë.

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e të miturve që procedohen penalisht për kryerje të veprave penale ka treguar të jetë në drejtimin e njohjes së nevojave të veçanta të të miturit, por megjithatë, ai nuk ka arritur të njihet dhe të zbatohet drejt, në praktikën ku edhe për shkak të ngarkesës së madhe dhe mungesës së alternativave reale të dënimit dhe trajtimit të të miturit, nuk ka sjellë ndoshta efektin e duhur në kriminalitetin e të miturve. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse ligjvënësi shqiptar, ka miratuar në vitin 2017, si pjesë të reformës së rëndësishme edhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit.

Përpara kësaj reforme, ligjet kryesore që ishin në fuqi parashikonin rregulla të veçanta për mbrojtjen e të miturve. Kështu, rregulla të tilla parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal; Kodin e Procedurës Penale; Kodin e Punës, ligjin “Për Policinë e Shtetit”; ligjin “Për Policinë Gjyqësore”; ligjin “Për kundërvajtjet administrative”; ligjin “Për ruajtjen e rendit e të qetësisë”; ligjin “Për Kodin Rrugor”; ligjin “Për tubimet”; ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar”; Ligjin “Për të drejtat e të miturve”, etj.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjejmë të shprehur se “*Fëmijët dhe të rinjtë .kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti ...*”.⁵⁰

Përpara reformës së vitit 2017, në mënyrë të veçantë, Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale përmbajnë një sërë dispozitash për mbrojtjen e tyre në procesin penal, që do trajtohen më poshtë.

Kodi Penal, i miratuar me ligjin Nr.7885, datë 27.01.1995, ka parashikuar disa vepra penale për aktet kriminale të kryera kundër të miturve, si dhe ka përcaktuar rregulla të ndryshme nga ato për të rriturit për dënimin e të miturve të akuzuar për kryerjen e veprave penale.

Kodi i Procedurës Penale, i miratuar me ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995, ka përcaktuar rregullat për hetimin, gjykimin, dënimin dhe vuajtjen e dënimit për të miturit e proceduar penalisht.

3.4 Rregulla të veçanta për hetimin dhe gjykimin e të miturve përpara reformës së vitit 2017.

Rregullat e veçanta për hetimin e të miturve janë parashikuar nëpër dispozitat procedurale e penale të kohës:

Sipas nenit 12 të Kodit Penal, të titulluar “Moshë për përgjegjësi penale”,⁵¹ ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Në Kodin e Procedurës Penale, në nenin me titull “Verifikimi i moshës së të pandehurit”,⁵² parashikohet se, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe, kur është rasti, urdhëron ekspertimin. Kur edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur. Pra, në bazë të kësaj dispozite është parashikuar se verifikimi i moshës duhet të bëhet nga Policia Gjyqësore, prokurori apo gjykata sa herë lind dyshimi për çdo shkak që duket, apo pretendohet nga i mituri ose prindërit e tij. Kur është rasti, mund të caktohen edhe ekspertë që të vlerësojnë moshën e të miturit. Në qoftë se nga verifikimet

⁵⁰ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 54, paragrafi 1

⁵¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995, neni 12

⁵² Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995, neni 41

e bëra moshë nuk mund të përcaktohet dhe ka dyshime që ai të jetë i mitur, atëherë ai konsiderohet i tillë nga vetë ligji.

Mungesa e pragut të moshës së caktuar nga Kodi Penal për kryerjen e një veprë penale, përbën shkak për mofillimin e procedimit. Sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, “Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë kur personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale”.⁵³

Në dispozitat e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet kujdesi i veçantë i legjislacionit procedural për trajtimin e të miturit lidhur vërtetimin e përgjegjësisë penale, në varësi të rëndësisë së veprës penale që kanë kryer. Pra, deri në moshën 14 vjeç, personat e mitur nuk mund të procedohen penalisht për asnjë lloj veprë penale. Ndërsa kur mbushin moshën 14 vjeç ata përgjigjen vetëm për krime, dhe kur bëhen 16 vjeç përgjigjen edhe për kundërvajtjet penale.

Organet e procedimit penal, sipas rastiit prokuroria ose gjykata, duhet të verifikojnë me kujdes moshën e të miturit, duke u bazuar në dokumentet e gjendjes civile dhe, kur nuk ka të tilla, duhet të bëjnë verifikimet e nevojshme dhe të caktojnë ekspertë për përcaktimin e saktë të moshës së të pandehurit. Kur ky përcaktim nuk mund të bëhet i saktë dhe mbetet e dyshimtë nëse i mituri e ka mbushur moshën ose jo për veprën që dyshohet, atëherë personi do të konsiderohet i mitur dhe procedimi penal nuk do të fillohet. Në qoftë se vërtetimi i moshës bëhet pas fillimit të procedimit penal, çështja duhet të pushohet në bazë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.⁵⁴

Neni 35 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga organi që procedon. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin e parë, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit”.⁵⁵

⁵³ Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁴ Neni 328 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁵ Neni 35 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në nenin 49 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se “Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”.⁵⁶ Mungesa e një mbrojtësi për personin e mitur përbënte shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit procedural, duke synuar kjo dispozitë në kuadrin e njohjes së nevojave të posaçme që ka i mituri, të garantonte të drejtat procedurale dhe zhvillimin e një gjykimi sa më pranë nevojave të të miturit.⁵⁷

Nga këto dy dispozita të Kodit të Procedurës Penale rezultonte se për të miturit, caktimi i avokatit ishte një veprim i detyrueshëm, në ndryshim nga të rriturit, të cilëve u sigurohej mbrojtësi vetëm sipas rasteve të parashikuara me ligj, pra nëse personi i rritur e kërkonte vetë mbrojtësin. Ndërsa për personin e mitur, organi që procedon penalisht duhet t’i caktojë një mbrojtës të pandehurit të mitur, detyrimisht edhe kur i mituri nuk e kërkonte atë. Përpos këtij detyrimi për sigurimin e mbrojtësit, një e drejtë tjetër posaçërisht e parashikuar për të miturin ishte prania e një psikologu për të miturin. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, është vlerësuar se “në nenin 49 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar shprehimisht: “Kur i pandehuri është nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, ..., ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”; kurse në pikën 5 të po kësaj dispozite, parashikohet, se “... kur kërkohet prania e mbrojtësit, dhe kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendës një mbrojtës tjetër, i cili, ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit”.

Si gjatë fazës së hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimi, të miturit në konflikt me ligjin duhet t’i sigurohet prania e psikologu gjatë marrjes në pyetje të tij. Ky detyrim ka për qëllim të sigurojë që në pyetjen e të miturit përmes ndihmës së një psikologu, i cili ka cilësitë dhe aftësitë e nevojshme për komunikimin me të miturin, të mundësojë faktin dhe të kuptojë natyrën e akuzës që i është ngritur, si dhe të ndërveprojë në mënyrë efektive në procesin penal. Në këtë të fundit përveçse i mituri mund të bëjë deklarime dhe ushtrojë të gjitha të drejtat e mbrojtjes së tij, ai duhet të kuptojë provat, veçanërisht dëshmitë, duke ia shpjeguar ato në mënyrë të përshtatshme për moshën e tij.

Ndërsa lidhur me personalitetin e të pandehurit të mitur, neni 42 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare dhe

⁵⁶ Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁷ Komentari, Procedura Penale, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, 2009, f.85.

shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit dhe të caktojë masa të përshtatshme penale. Organi procedues mbledh informacione nga personat që kanë pasur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve”.⁵⁸

Këto të dhëna ishin shumë të nevojshme për vlerësimin e kontekstit ku jetonte i mituri, përcaktimin e karakteristikave të personalitetit të tij, me qëllim që dënimi që mund t’i jepet të miturit të ishte sa më efektiv dhe të synonte në edukimin e të miturit duke i ridhënë një mundësi të miturit për t’u korrigjuar dhe integruar në shoqëri. Nëpërmjet këtyre të dhënave, gjykata informohet për kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të miturit dhe mbi këtë bazë përcakton qëndrimin që duhet mbajtur ndaj të miturit, sipas rastit dhe alternativave, duke e përjashtuar nga dënimi, duke ia dhënë dënimin me kusht, duke e mbyllur në një institucion edukimi apo duke e dënuar me burgim.

Lidhur me masat e sigurimit, neni 229 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se “*Kur i pandehuri është i mitur, për caktimin e masave të sigurimit (izolimin) gjykata mban parasysht kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete*”.⁵⁹ Në këtë dispozitë bëhet fjalë për të miturit, të cilët dyshohen se mund të kenë kryer vepra penale, për të cilët gjykata duhet të vendosë nëse ata do të procedohen në gjendje të lirë, apo ndaj tyre do të caktohet masa izolimi. Sikundër mund të vërehet, për të miturit caktohet një kriter, të cilin gjykata që do të vendosë për masën e sigurimit duhet ta mbajë parasysht për çdo rast konkret. Nëse rrethanat e çështjes përlligjin masën e (izolimit) paraburgimit të të miturit në vendimmarrjen e saj, gjykata duhet të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë që të mos ndërpritej procesi edukativ, sikundër mund të jetë shkolla, kurse të ndryshme, etj. Kjo dispozitë duhet parë si rrjedhojë e zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, bazuar në standardet e përcaktuara nga Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, dhe duhet parë ngushtë edhe me nenin 3 pika 9, 10 dhe 15 të Ligjit Nr.37/2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.⁶⁰

Për sa i përket veprave penale: kundërvajtje penale, në legjislacionin shqiptar, në bazë të përcaktimeve të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale⁶¹, të miturit që kanë mbushur moshën

⁵⁸ Neni 42 i Kodit të Procedurës Penale.

⁵⁹ Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁰ <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/229> (konsultuar më datë 31.10.2019), § 12.

⁶¹ Neni 230 i Kodit të Procedurës Penale.

penale, nuk mund të arrestohen kur dyshohen për kundërvajtje penale. Kundërvajtjet sipas doktrinës juridike dhe ligjit penal janë ato vepra (veprime ose mosveprime) me rrezikshmëri të vogël të parashikuara shprehimisht nga dispozita përkatëse e Kodit Penal, të cilat dënohen me gjobë ose me burgim në maksimum deri në dy vjet. Pra, për këto lloje veprash penale, i mituri nuk mund të arrestohet edhe kur ai mund të kapet në flagrancë.

Për organet proceduese parashikohen detyrime të veçanta, kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur. Në një rrethanë të tillë, prokurori apo policia gjyqësore lajmërojnë detyrimisht prindin apo kujdestarin e të miturit. Në këto raste, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur.⁶² Kjo është një mënyrë tjetër për të lehtësuar të miturin që është arrestuar në flagrancë nga Policia. Në këtë rast, prokurorit i jepet e drejta ta nxjerrë të miturin nga burgu dhe të urdhërojë që ai të qëndrojë në shtëpinë e vet ose në një vend tjetër të ruajtur, që mund të jenë të afërmit apo institucionet e edukimit të të miturve.

Vëmendja për gjykimin e të miturve është drejtuar edhe në lidhje me organizimin gjyqësor. Sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit të Republikës. Kur disa nga procedimet që kanë lidhje midis tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat gjykatës që shqyrton çështjet me të mitur, kompetente për të gjitha procedimet është kjo e fundit. Kur i pandehuri në kohën e gjykimin është madhor, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qenë i mitur, çështja gjykohet nga gjykata (seksioni) që shqyrton çështjet me të mitur.⁶³

Krijimi i këtyre seksioneve mund të konsiderohet si një hap përpara drejt ngritjes së gjykatave për të miturit, të cilat do të shqyrtojnë çdo çështje, penale e civile, ku të miturit do të janë palë ose të interesuar. Kjo shtesë e bërë në Kodin e Procedurës Penale ka hyrë në fuqi. Ndërkohë, aktualisht është në fuqi (vepron që nga data 01.09.2009) dekreti i Presidentit të Republikës Nr.6218, datë 07.07.2009, “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”.⁶⁴

Sipas dekretit të sipërpërmendur, në territorin e Republikës së Shqipërisë krijohen seksionet penale për gjykimin e të miturve. Këto seksione krijohen dhe veprojnë sipas ndarjes së mëposhtme:

⁶² Neni 225 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶³ Neni 13, paragrafi 4 dhe neni 81 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁴ Fletore Zyrtare Nr.103, datë 13.07.2009, faqe 4971.

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Dibër, Krujë, Kurbin, Mat dhe Tiranë.
2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Durrës dhe Kavajë.
3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër dhe Tropojë.
4. Në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Berat, Fier, Lushnje dhe Vlorë.
5. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Korçë dhe Pogradec.
6. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në Rrethet Gjyqësore Gjirokastrë, Përmet dhe Sarandë.
7. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në Rrethin Gjyqësor Elbasan.

Dekreti i mësipërm ka shfuqizuar dekretin Nr.5351, datë 11.06.2007, *“Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”*.

Aktualisht në vendin tonë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të lartë të Prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë etj., është duke u përgatitur një hartë e re gjyqësore e cila mund të reduktojë numrin e Gjykatave në Rrethe të vogla administrative dhe kjo situatë do të ndikoj edhe në seksionet e krijuara sipas dekretit të sapocituar.

Në lidhje me mbrojtjen e personalitetit të të miturit nga publikimi dhe jehona e procesit, legjislacioni procedural penal parashikon se kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve, gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me dyer të mbyllura.⁶⁵ Ky, përjashtim nga parimi kushtetutës i gjyimit publik (me dyer të hapura), parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës⁶⁶, bëhet për të shmangur ekspozimin e të miturve dhe për të krijuar ambient të përshtatshëm për gjykimin e tyre që synon edukimin dhe integrimin e tyre të shpejtë.

⁶⁵ Neni 340 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁶ Neni 42 i Kushtetutës.

Gjithashtu, kjo situatë zbatohet edhe kur është e nevojshme kur duhen që të pyeten dëshmitarë të mitur. Në bazë të ligjit procedural pyetja e të miturit, mund të bëhet nga kryetari i trupit gjykues, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve dhe, në këto raste, ai mund të ndihmohet nga një familjar i tij ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve. Kur çmohet se pyetja e drejtpërdrejtë e të miturit nuk e dëmton gjendjen psikologjike të tij, kryetari urdhëron që pyetja të vazhdojë sipas rregullave të përgjithshme. Në varësi të situatës, ky urdhër i gjykatës, mund të revokohet gjatë pyetjes.⁶⁷

Parashikimi i këtyre dispozitave të mësipërme, synon drejt urdhërimit që pjesëmarrja në gjykim e të miturve të jetë e përshtatshme për moshën e tyre, si dhe që t'i japë mundësi të miturve të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes duke kuptuar procesin që zhvillohet ndaj tyre dhe të ndërveprojnë në pajtim me nevojat e veçanta të tyre dhe parimet e procesit të drejtë e të rregullt.

Normat e veçanta lidhur me pyetjen e të miturve, gjejnë zbatim edhe në fazën e hetimeve paraprake. Në këtë fazë, prokurori apo oficeri i Policisë Gjyqësore, në rast se merr në pyetje një person në moshë të mitur, duhet t'i garantojë këtij të fundit praninë e ndihmës së një familjari të tij ose dhe të një specialist, psikolog në fushën e edukimit të fëmijëve.

Një masë mbrojtëse në rastet kur kemi të bëjmë me të pandehur apo dëshmitarë të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale, është ajo e ndalimit të publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të miturve. Gjykata mund të lejojë publikimin e pamjeve vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.⁶⁸

Sipas nenit 104 të Kodit të Procedurës Penale⁶⁹, shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose punonjësi i një enti publik, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore. Në këtë rast, prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.

Situata mediatike aktuale në vendin tonë, në këtë drejtim lë për të dëshiruar. Shpesh shohim në median e shtypur, elektronike dhe atë audio vizive ku nuk respektohet parimi i anonimitetit dhe ruajtjes së privatësisë së të miturve kur ata ndodhen në konflikt me ligjin, shoqërohen nga organet e policisë, ndalohen apo arrestohen me urdhër të prokurorit apo me vendim të gjykatës.

Në rastet e ankimeve kundër vendimeve të gjykatës, është parashikuar se i pandehuri mund ta tërheqë ankimin e bërë nga mbrojtësi i tij, por kur ai nuk ka zotësinë juridike për të vepruar,

⁶⁷ Neni 361 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁸ Neni 103 i Kodit të Procedurës Penale.

⁶⁹ Neni 104 i Kodit të Procedurës Penale.

duhet të merret edhe pëlqimi i kujdestarit të tij.⁷⁰ Ky përcaktim ligjor ka si qëllim të mbrojë interesat e të miturit, duke siguruar edhe ndihmën e prindit e të kujdestarit për rastin e ankimit kundër vendimit të gjykatës, për të shmangur çdo deformim të vullnetit të të miturit.

3.5 Rregulla të posaçme për dënimin e të miturve.

Legjislacioni shqiptar ka parashikuar edhe një sërë dispozitash të veçanta për të miturit e gjykuar penalisht në fazën e dënimit.

Faza e dënimit përbën një çast mjaft të rëndësishëm të gjykimit penal, veçanërisht për ata që përket gjykimit penal të të miturve, gjykata që jep një dënim penal për të miturin, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, duhet në çdo rast të ketë marrë në parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe nevojat e veçanta të tij.

Përpara reformës së vitit 2017, për caktimin e dënimit ndaj të miturit zbatoheshin të njëjtat norma si edhe për të rriturit. Ndërsa disa dispozita të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë rregulla të veçanta lidhur me caktimin e llojit dhe të masës së dënimit për të miturit, që synojnë diferencimin favorizues për ta. Kështu, neni 51 i Kodit Penal, parashikonte se për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.⁷¹ Ndërsa dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë.⁷²

Nëse rrezikshmëria e veprës penale është e pakët, dhe nëse rezulton nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj një arsye e përligjur, apo nisur nga sjellja e mëparshme e të miturit, gjykata mund ta përjashtojë të miturin nga dënimi. Në këtë rast, gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.⁷³ Zbatimi i kësaj dispozite në praktikë ka qenë problematike, për shkak se për zbatimin e saj është e nevojshme, ndër të tjerash, parashikimi i institucioneve të

⁷⁰ Neni 410 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷¹ Neni 51 i Kodit Penal.

⁷² Neni 31 i Kodit Penal.

⁷³ Neni 52 i Kodit Penal.

edukimit, të cilat ende nuk janë krijuar dhe kanë kushtëzuar në një farë mase zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit për të miturit dhe vetë kriminalitetin e personave të mitur.

Ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi apo ndaj atyre që nuk kanë përgjegjësi penale për shkak të mospasjes së moshës së parashikuar, mund të jepen masa edukuese.⁷⁴ Masë edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi. Vendimi gjyqësor lidhur me caktimin e masave edukuese mund të revokohet kurdoherë, nëse zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë. Gjithsesi, në çdo rast, gjykata kryesisht, është e detyruar që, pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj. Masa edukuese me vendosjen e të miturit në një institucion riedukimi duhet të bëhet në rastet kur vepra e kryer është e lehtë dhe nga shqyrtimi i rrethanave të çështjes, zhvillimit psikik dhe emocional i të miturit, vlerësohet si i nevojshëm dhe korrigjimi i sjelljeve të tij të miturit, të cilat kanë qenë përcaktuese në kryerjen e veprës penale.

Në Republikën e Shqipërisë, edhe pse mund të kemi një numër të lartë të fëmijëve që braktisin shkollën, këto lloj institucionesh nuk ekzistojnë aktualisht edhe pas miratimit të reformës së të drejtës për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Institucione të tilla ende nuk janë krijuar, ose janë në rrugë e sipër të krijimit të tyre si rrjedhojë e bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me njësitë bashkiake në gjithë vendin. Zakonisht të miturit që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale e kanë braktisur shkollën jo për shkak të dënimit, por para se ata të mbushnin moshën 14 vjeç. Në qoftë se do të ekzistonin këto lloj institucionesh, raporti i vlerësimit për të miturin duhet të synonte një rrugëtim lidhur me edukimin dhe përmirësimin e të miturit dhe nevojave të tij për shoqërizim.

Institucionet e edukimit, nuk duhet të konceptohen si një lloj institucioni për vuajtjen e dënimit. Të miturit e vendosur në këto institucione, do të duhet të trajtohen si të mitur që ndjekin programet e institucioneve të edukimit me synimin për t'u përmirësuar dhe nuk duhet të konsiderohen të dënuar, por si të mitur në nevojë për të t'u edukuar në mënyrë të posaçme. Përpara viteve 1990, në Shqipëri kanë ekzistuar institucione të ndryshme me mërtime që variojnë nga "Shkolla e vagabondëve" tek 'Shkolla e Riedukimit', e cila kishte si qëllim zbatimin e një programi ri-edukimi, përmirësimi, si dhe punësimi të personave të mitur që manifestonin sjellje kriminale deri sa nuk kishin arritur moshën për përgjegjësi penale.

⁷⁴ Neni 46 i Kodit Penal.

Mungesa e institucioneve të posaçme të edukimit për të miturit që kanë kryer vepra penale, i ka vënë gjykatat shqiptare në pozitë të vështirë gjatë gjykimit dhe trajtimit të të miturve, qoftë kur janë të detyruara të marrin vendim për të vendosur një masë sigurimi, por sidomos kur japin vendime dënimi me burgim. Mungesa e një alternative efektive, sikundër është dërgimi i të miturit në një institucion të posaçëm për edukim, shpeshherë “i detyron” gjykatat të gjenden përpara dy rrugëve për vendimmarrje: ose të vendosin dënimin në burg, me pasojat që dihen për zhvillimin e personalitetit të të miturit, ose ta lënë atë të lirë, ku edhe për këtë zgjedhje pasojat janë tashmë të njohura në lidhje me gjendjen e kriminalitetit e të miturve.

Shumica e studimeve në lidhje me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, dëshmojnë faktin se institucionet sidomos ato rezidenciale, duke përfshirë edhe institucionet e përkujdesjes për të miturit, janë vendet që shquhen për shkeljen e të drejtave themelore të miturve dhe për trajtimin çnjerëzor të tyre. Në fakt, studimet psikologjike kanë vënë në pah faktin se pikërisht një trajtim i ndarë i të miturve në konflikt me ligjin në raport me bashkëmoshatarët e tyre, do t’i shkaktojë të parëve një stigmë të përhershme dhe do të bëhej shkas për mos zhvillimin e fëmijës dhe mos integrimin e tyre dhe kthimin e tyre në një kontingjent për krimin në moshë të rritur. Ndoshta qasja më e mire do të ishte ajo shumëdisiplinore, bazuar në programe me bazë në komunitet, në të cilat duhet të përfshihen shumë aktorë, si familja, fëmijët, shkolla, komuniteti dhe njësitë e qeverisjes vendore, OJF-të, Agjencitë për të mitur etj.

Përpara reformës së vitit 2017, praktika gjyqësore nuk ka zbatuar shpesh, zgjedhjen si formë alternative të dënimit atë të kryerjes së një pune me interes publik, kjo edhe për faktin sepse fëmijët 14-16 nuk lejohen të punojnë.

Në bazë të nenit 5, pika “1” shkronja “d”, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është përcaktuar rasti se kur një i mitur ndalohet ligjërisht për qëllim edukimi të mbikqyrur ose për ndalimin e tij të ligjshëm me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor. Kjo dispozitë ka të bëjë me ndalimin e të miturve, duke autorizuar edhe kujdestarinë e tyre parandaluese në proces dhe mundësinë e privimit të tyre nga liria e tyre personale për të kontrolluar arsimimin e tyre.

Nëse masa e ndalimit të përkohshëm për të miturin nuk paraqet probleme të dallueshme nga sa u tha në paragrafin e mëparshëm menjëherë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për kufizimin e lirisë

për qëllime edukative të të miturve që nuk kanë moshën e parashikuar për përgjegjësi penale. Në fakt, kufizimi i lirisë për qëllime edukative përbën një institut me përkufizim të paqartë, duke iu referuar si masave parandaluese ashtu edhe një lloj hibridizimi të masave të paraburgimit. Në një rast, në të cili i mituri ishte dyshuar për kryerjen e disa krimeve duke u arrestuar dhe vendosur në një institucion paraburgimi, dhe pasi ishte vendosur shmangia, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ('GjEDNj') e ka konsideruar privimin e të miturit nga liria për qëllime edukimi. Në rastin konkret, gjykata vlerësoi se, papërshtatshmërinë e institucionit të paraburgimit me qëllimin, zbatimin e masës së privimit të lirisë, ç'ka ka çuar në një shkelje të Nenit 5 të Konventës Evropiane.⁷⁵

Në një rast tjetër, i mituri kishte vuajtur dënimin e vendosur nga gjykata penale, por në kohën e lirimit të tij, ai ishte pa shtëpi; prandaj gjykata penale kishte urdhëruar vazhdimin e masës shtrënguese të tij për qëllime edukative në një institucion tjetër penitenciar; megjithëse i mituri nuk ishte as i dyshuar dhe as i akuzuar për vepra penale të tjera. GjEDNj-ja vlerësoi se, i mituri ishte vendosur në një institucion penitenciar, i cili në praktikë, nuk ishte i përshtatshëm për arritjen e qëllimeve edukative të përcaktuara nga neni 5, pika "1" shkronja "d" e Konventës Evropiane.⁷⁶

3.6 Trajtimi i të miturve të dënuar me burgim.

Legjislacioni shqiptar edhe përpara reformës së vitit 2017, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë trajtimit të të miturve të dënuar me burgim, duke filluar që nga faza e ekzekutimit deri në edukimin dhe përfundimin e dënimit.

Kështu, në Kodin e Procedurës Penale, në ligjin Nr.8331, datë 21.04.1998, "*Për ekzekutimin e vendimeve penale*"; në ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998, "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim*", si dhe në Rregulloren e përgjithshme të burgjeve, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.303, datë 25.03.2009, është e shprehur në mënyrë të qartë kujdesi i ligjvënësit dhe pasja në konsideratë e nevojave të veçanta që ka trajtimi i të miturit të dënuar në raport me trajtimin e personave të rritur të dënuar.

⁷⁵ Gjykata Evropiane, vendimi datë 29.02.1988, *Bouamar k. Belgjikës*, par. 52.

⁷⁶ Gjykata Evropiane, vendimi datë 16.05.2002, *D.G. k. Irlandës*, par. 79.

Kodi Penal parashikon se të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit.⁷⁷ Kjo dispozitë është interpretuar me kuptimin se, institucionet e vuajtjes së dënimit për të miturit duhet të jenë dhe në fakt janë të ndara, pasi ato kanë edhe qëllime të tjera edukimi, në raport me institucionet e vuajtjes së dënimit për personat e rritur.

Në trajtimin e personave të dënuar, parim themelor mbetet ai i respektimit të dinjitetit të njeriut dhe të të drejtave themelore të personit të dënuar. Trajtimi i të dënuarve duhet të bëhet pa njëanshmëri apo diskriminim për shkaqe të tilla si ato të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar. Të dënuarve duhet t'u sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë". Këto parime zbatohen edhe për të miturit, ndaj të cilëve parashikohen edhe parime të tjera shtesë që synojnë edukimin dhe largimin e tyre nga kriminaliteti.

Trajtimi i të dënuarve duhet të bëhet në bazë të parimit të individualizimit, sipas karakteristikave individuale të secilit person të dënuar. Individualizimi bëhet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar nga jeta normale.⁷⁸ Ky parim paraqet një rëndësi themelore, që i garanton personit të dënuar, duke përfshirë edhe të miturin, njohjen e të drejtave dhe respektimin e dinjitetit të tij pranë institucionit të vuajtjes së dënimit.

Në rastin e të miturve, trajtimi në institucione bëhet sipas grupimit sipas moshës dhe veprës penale të kryer prej tyre. Ky trajtim mundëson shmangien e dukurisë së përsëritjes së kriminalitetit dhe përhapjes së "mësimeve" mes të miturve për kryerjen e veprave të tjera kriminale, pasi të jetë përfunduar procesi i vuajtjes dhe ai i edukimit të të miturve të dënuar. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, një rëndësi të veçantë ka ndjekja e disa objektivave gjatë ekzekutimit të dënimit të cilat përfshijnë, arsimin, formimin profesional, zhvillimin e aftësive të tjera individuale, veprimtaritë kulturore, çlodhëse dhe sportive, punën, asistencën shpirtërore dhe veprimtari të tjera në grup. Ndjekja e këtyre objektivave me një qasje shumë dimensionale, ka si qëllim jo vetëm korrigjimin dhe përmirësimin e sjelljes së të miturit, por edhe përshtatjen e tij për t'u integruar në shoqëri.

⁷⁷ Neni 33 i Kodit Penal.

⁷⁸ Neni 10, i ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

Një rëndësi të veçantë në trajtimin e të miturve kanë edhe kontaktet me botën e jashtme dhe familjen, të cilave iu është kushtuar një kujdes përmes parashikimit të programeve individuale dhe grupore. Ligji parashikon që trajtimi i të dënuarve të bëhet duke siguruar mjediset e përshtatshme dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.⁷⁹

Gjithashtu, në drejtim të arsimimit dhe formimit kulturor e profesional, parashikohet që të realizohen programe përmes organizimit të arsimit të detyrueshëm për të miturit, si dhe të kurseve të aftësimit profesional në fushën e punës. Ndjekja e programeve të studimeve profesionale, përmes korrespondencës është e parashikuar, krahas shërbimit të leximit dhe përdorimit të sistemeve të tjera informative pranë bibliotekës së institucionit.⁸⁰ Një kujdes i veçantë sipas ligjit i është kushtuar formimit kulturor dhe profesional të personave të dënuar me moshë deri 25 vjeç. Dispozita e mësipërme e ligjit garanton respektimin e së drejtës së arsimimit për të miturit e dënuar. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale në Vaqarr është ngritur një shkollë e arsimit të detyrueshëm që shërben për arsimin e miturve që janë dënuar me burgim.

Një program i posaçëm dhe favorizues është parashikuar për të dënuarit e mitur në mënyrë që ata të ruajnë dhe të zhvillojnë lidhjet me familjet e tyre⁸¹. Lidhja me familjen, vlerësohet një nevojë e rëndësishme për mirëritjen e të miturve në kushtet e burgimit.

Një trajtim i ndryshëm për të miturit është i parashikuar edhe në rastin e masave disiplinore. Trajtimi që i bëhet të dënuarve të mitur kur ndaj tyre aplikohen masat disiplinore gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, mund të zbatohen vetëm deri në gjysmën e kohës së parashikuar.⁸² Duke qenë se procedura disiplinore ka pasoja për procesin e ekzekutimit dhe atë të edukimit të të miturit, prania e një mbrojtësi dhe e përfaqësuesit ligjor të të miturit duhet të konsiderohet tepër e nevojshme gjatë procedurës mbi zbatimin e masës disiplinore.

Përcaktimet ligjore të mësipërme mbi trajtimin e të miturve në kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, shtjellohen edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.303, datë 25.03.2009. Në këtë Rregullore, adresohen, rregulla të veçanta për të dënuarit e mitur në lidhje me shpërndarjen e tyre nëpër

⁷⁹ Neni 32 i ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

⁸⁰ Neni 37 i ligjit Nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

⁸¹ Shih ligjin Nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", neni 40

⁸² Shih ligjin Nr.8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", neni 53

institucionet përkatëse të ekzekutimit të vendimeve penale; vendosjen nëpër dhoma; ajrimin; procedimin disiplinor; takimet me autoritetet apo subjektet procedurale të ekzekutimit të vendimeve penale; qëllimin e përkujdesit social; arsimimit dhe punësimit, etj.⁸³

Analiza e kriminalitetit të të miturve në Shqipëri, kërkon të marrësh në konsideratë një sërë faktorësh, të cilët nuk lidhen vetëm me ligjin, por edhe me institucionet ligjzbatuese, parimet mbi të cilat funksion dhe organizohet sistemi i drejtësisë penale për të mitur, organet gjyqësore dhe roli i tyre, si dhe kontekstin ekonomiko-social të një vendi të caktuar. Për këtë arsye, kriminaliteti i të miturve duhet të përbëjë një çështje ndërdisiplinore, ku ekspertë jo vetëm nga fusha e ligjit, por edhe e psikologjisë, kriminologjisë, arsimit dhe pedagogjisë duhet të kontribuojnë për njohjen dhe adresimin e tij në mënyrën e duhur. Të dhënat studimore kanë treguar se ka lidhje organike mes kriminalitetit të miturve dhe sistemit ligjor, gjyqësor dhe atij penitenciar në Shqipëri.

3.7 Trajtimi i të miturve pas reformës së vitit 2017.

Ligjvënësi shqiptar bashkë me reformën e Kodit të Procedurës Penale, ka miratuar në vitin 2017 “Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur” me Ligjin Nr.37/2007, datë 30.03.2017. Sipas qëllimit të ligjvënësit, Kodi i Drejtësisë për të Miturit është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, (...), parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Ky Kod synon përjasjen e plotë të një drejtësie miqësore për të mitur. Me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Shqipëria ka shënuar një evolucion, duke hedhur hapa përpara dhe vendosur një nivel të ri ekuilibri, në trajtimin e të miturit. Sipas relacionit shoqërues të këtij Kodi, evidentohet se në Shqipëri janë hedhur hapa pozitive në përjasjen e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare të garantuara në aktet ndërkombëtare⁸⁴. Megjithatë, ka mungesa në instrumentet ligjore për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe në fokusin e duhur në drejtim të ri-integrimit të tyre përmes edukimit, trajnimit dhe punësimit.

⁸³ *Shih Rregulloren e përgjithshme e burgjeve, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.303, datë 25.03.2009, nenet 20, 21, 24, 52, 63, 77, 81 dhe 83*

⁸⁴ *Shih relacionin shoqërues, aksesuar në: <https://www.parlament.al/files/projektligje/relacion-kodi-i-drejtësisë-per-te-miturit-ne-rsh-Resized.pdf>*

Përveç drejtimeve, të cilat kanë udhëhequr sistemin juridik shqiptar për trajtimin e të miturit, është theksuar nevoja dhe dallimi në trajtimin e të miturit në procesin penal, duke parashikuar një sistem më të plotë e të pavarur të drejtësisë penale për të mitur, si dhe është përforcuar nevoja për specializimin e gjyqtarëve që gjykojnë kriminalitetin e të miturve në konflikt me ligjin.

Në lidhje me këtë element të fundit të sistemit të drejtësisë penale të re për të miturit, mendoj se qëllimi i ligjvënësit nuk ka arritur të çohet deri në fund të tij. Kjo përderisa nuk u arrit të përcaktohej krijimi i gjykatave të veçanta, të ndara nga gjykatat e zakonshme, të cilat do të ishin kompetente për gjykimin e kriminalitetit për të miturit, apo edhe për çështje të tjera familjare po në lidhje me të miturit si për shembull ekziston në Itali “Tribunale dei minori”.(Gjykatë për të miturit.)

Ndonëse është parashikuar parimi i specialitetit ku kriminaliteti i të miturve tërheq gjykimin e çështjeve të kriminalitetit të të miturve të kryera së bashku me rritur, në raport me seksionet e zakonshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ka një përjashtim kur lënda e gjykimit është në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sepse në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe procedimet e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.⁸⁵ Ky përjashtim do të thotë gjykimin e të miturit nga gjyqtarë që jo domosdoshmërisht janë të specializuar dhe trajnuar për drejtësinë penale për të mitur. Kjo gjë është specifike në Gjykatën SPAK ku janë të njëjtët gjyqtarë që kanë qenë në gjykim në strukturën e vjetër të Gjykatës kundër Krimeve të Rënda, në ndryshim nga Prokuroria SPAK e cila nuk trashëgoj të njëjtët prokurorë.

Një përjashtim tjetër është edhe ai i parashikuar nga pika “4” e nenit 25 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, sipas të cilës parashikohet se vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, veprimi kryhet nga një “person jo i specializuar”. Në këtë rast, personi jo i specializuar, pas marrjes së masave paraprake, njofton menjëherë personin/strukturat e specializuara për të vazhduar këtë proces.⁸⁶

⁸⁵ Neni 80, pika “1” e Kodit të Procedurës Penale.

⁸⁶ Neni 25, pika “4” e Ligjit Nr. 37/2017, datë 30.03.2017, ‘Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur’.

Sipas nenit 27 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, kriminaliteti i të miturve gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Reforma e vitit 2017, duket se është ndalur vetëm në nevojën e parashikimit të specializimit të gjyqtarëve që do të gjykojnë të miturin.⁸⁷

Me qëllim që të zbatohet në mënyrë efektive dhe të plotë, sistemi i ri i drejtësisë penale për të mitur, do të kishte qenë e nevojshme krijimi i gjykatave të veçanta kompetente për gjykimin e kriminalitetit për të miturit. Kjo do të mundësonte garantimin e respektimit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm, në sistemin e drejtësisë shqiptare. Si të tillë përmendim shembullin e drejtësisë italiane.

Sipas përkufizimit Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, “i mitur në konflikt me ligjin”, është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.⁸⁸

Ky Kod zbatohet vetëm për procedurën e administrimit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe për të miturit viktime dhe/ose dëshmitarë të veprave penale.⁸⁹ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, për qëllime të përgjegjësisë penale për krimet, e konsideron si të mitur, personin, i cili ka mbushur moshën 14 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së krimit. Ndërsa, për qëllime të përgjegjësisë për kundërvajtjet penale, konsideron si të mitur, personin, i cili ka mbushur moshën 16 vjeç, por jo 18 vjeç në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.⁹⁰

Në këtë Kod parashikohen për herë të parë një sërë parimesh të përgjithshme të drejtësisë për fëmijët sikundër janë:

- ✓ heqja e lirisë si alternative e fundit e dënimit,
- ✓ e drejta e pjesëmarrjes së fëmijës;
- ✓ afati i përfundimit të procedurës;
- ✓ e drejta e privatësisë;
- ✓ të drejtat procedurale,

⁸⁷ Neni 27, pika “3” e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁸⁸ Neni 2, pika “4” e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁸⁹ Neni 4 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

⁹⁰ Neni 7 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

- ✓ kujdesi i detyrueshëm i mbrojtjes me psikolog,
- ✓ mbrojtja dhe pasja e një personi të besuar,
- ✓ mbrojtja e jetës private,
- ✓ vlerësimi individual i të miturit,
- ✓ përfitimi i shërbimeve pa pagesë, etj.

Sipas dispozitave të këtij Kodi, por edhe nisur nga aktet ndërkombëtre që rregullojnë këtë fushë, tashmë **interesi më i lartë i fëmijës, përbën një parim themelor** që duhet të udhëheqë të gjithë vendimmarrjen e organeve që merren me vendimmarrjen dhe administrimin e drejtësisë penale për të miturit. Ky parim sipas qëllimit të ligjvënësit, duhet të gjejë zbatim pikësëpari në të drejtën penale. Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël, prandaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër detyrimet më të rëndësishme të reformës në sistemin e drejtësisë penale. Jo vetë kaq, por vendimet dhe aktet e organeve kompetente duhet të përmbajnë një arsyetim të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar, dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë të të miturit.

Në zbatimin e këtij parimi duhet të mbahen parasysh: nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore. Në çdo vendim dhe procedurë lidhur me drejtësinë penale për të mitur duhet të mbahet në konsideratë e drejta e të miturit për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.⁹¹

Një **parim** tjetër i rëndësishëm që është parashikuar nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, **është ai i proporcionalitetit**. Sipas këtij parimi, çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin, kushtet personale,

⁹¹ Neni 12 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta. Për arritjen e qëllimeve të këtij Kodi dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje me drejtësinë për të mitur, në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal.⁹²

Një element i rëndësishëm për gjykimin e të miturit dhe përcaktimin e nevojave të veçanta është edhe raporti i vlerësimit individual të të miturit. Ky raport përcakton nivelin e zhvillimit, mënyrën e jetesës, edukimin dhe kushtet e zhvillimit, arsimimin, gjendjen shëndetësore, mjedisin familjar dhe kushtet e tjera të të miturit, të cilat i lejojnë organet e hetimit, gjykimin e vuajtjes së dënimit, për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta. Raporti i vlerësimit individual përshkruan nevojat e veçanta të të miturit, rrezikun e kryerjes së veprës penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit dhe rekomandon masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri.⁹³ Paraqitja e raportit të vlerësimit individual është e detyrueshme kur përcaktohet masa alternative e shmangies; caktohet lloji i dënimit; ekzekutohet vendimi i dënimit; si dhe kur shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht.

Një institut i ri, i parashikuar për herë të parë nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, për gjykimin e kriminalitetin për të miturit është ai i shmangies nga ndjekja penale ose nga dënimi. Organi kompetent në procedimin për të miturit, në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale vlerëson interesin më të lartë të të miturit, rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin e parashikuar për atë vepër, moshën e të miturit, shkallën e fajësisë, dëmin e shkaktuar, efektin frikësues të ndjekjes penale, sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, si dhe raportin e vlerësimit individual.⁹⁴ Masa e shmangies nga organi kompetent zbatohet nëse, nuk rezulton se ka shkaqe pafajësie për personin e mitur, pra nëse ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë. I mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit, dhe nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale ose nuk është përsëritës. I mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies

⁹² Neni 13 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

⁹³ Neni 47 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

⁹⁴ Neni 55 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

d) i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit;

dh) dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korigjimit të sjelljes së tij

Nga analiza e parimeve që karakterizojnë gjykimin e të miturit në konflikt me ligjin, mund të thuhet se sistemi penal shqiptar i drejtësisë penale për të mitur, synon rikuperimin e të miturit, përmes mjeteve të përjashtimit nga përgjegjësia penale dhe procedurat paragjyqësore, shmangien mesa është e mundur të disa prej tyre dhe mes parashikimit të një sërë masave alternative të dënimit të ndryshme posaçërisht për të miturin.

3.8 Kufizimi i lirisë personale i të miturit.

Përsa i takon kufizimit të lirisë personale të të miturit në rast flagrance apo dyshimesh, neni 27, pika “ç” e Kushtetutës, parashikojnë se liria e personit nuk mund të kufizohet për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.⁹⁵ Krahas këtij përcaktimi kushtetues, dispozita mbi kufizimin e lirisë personale parashikon edhe Kodi i Procedurës Penale. Neni 15 i KDPM, përmban disa parashikime shtesë në lidhje me kriminalitetin e të miturve. Kështu, në bazë të nenit 15 parashikohet se arrestimi, ndalimi ose burgosja e një të mituri përbëjnë masën e fundit për t’iu drejtuar nëse qëllimi, pra nevojat për sigurim ose parandalim nuk mund të garantohen sipas një mase tjetër më të butë.

Në lidhje me masat e sigurimit, është parashikuar në mënyrë të shprehur përkohshmëria e zgjatjes së masës brenda një periudhe sa më të shkurtër, si dhe detyrimi për shqyrtimin e tyre në mënyrë periodike të rregullt.⁹⁶ Në bazë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, është e domosdoshme që të gjitha vendimet për masat paraprake të maten në kohë dhe rivlerësohen rregullisht nga organet ligjzbatuese.

Evidentohet se ligjvënësi nuk ka parashikuar se çfarë ndodh lidhur me kohëzgjatjen e tepërt të masës së paraburgimit caktuar me vendim gjyqësor ndaj të miturit, apo rastin kur gjykata nuk merr kryesisht në shqyrtimin masën e vendosur më parë ndaj një të dyshuari të mitur çdo një muaj. Mendoj se, në këtë rast do të zbatohet sentenca unifikuese e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Nr.01, datë 08.01.2009, me të cilën është theksuar se: “(...)

⁹⁵ Neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁹⁶ Neni 15 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

është në përgjegjësinë e prokurorit kompetent të ndërmarrë nismën e të përmbushë, në afat dhe në përmbajtje, detyrimet përkatëse sipas afateve e procedurave që parashikohen nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që gjykata të rishqyrtojë periodikisht legjitimitetin e zbatimit të masës së sigurimit të arrestit, të cilën ajo gjykatë ia ka caktuar individit pikërisht mbi kërkesën e vetë organit të prokurorisë. Nëse ky i fundit nuk përmbush detyrimin në afat, i arrestuari legjitimohet të kërkojë rishqyrtimin e masës së sigurimit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata urdhëron prokurorin të riparojë shkeljen e ligjës duke depozituar menjëherë informacionin dhe të dhënat mbi gjendjen e procedimit, të cilat i nënshtrohet hetimit gjyqësor dhe debatit mes palëve. Dispozita e pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, nëpërmjet parashikimit të intervalit dy mujor ndërmjet dy gjykimeve për rivlerësimin e ligjshmërisë së masës së arrestit, synon që i arrestuari të ketë të garantuar të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e vlefshmërisë së ligjshmërisë së masës ndaj tij në intervale kohore të arsyeshme. Mos respektimi apo vonesa nga prokurori në përmbushjen e detyrimit për informim nuk përbën në vetvete shkak për të legjitimuar pranimin e kërkesës për revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit. Nga ana tjetër, kjo shkelje e ligjit nga ana e prokurorit legjitimon të drejtën e të arrestuarit për t'i kërkuar gjykatës përmbushjen menjëherë të detyrimit për informim nga prokurori. Duke qenë pjesë e respektimit të procesit të rregullt ligjor, gjykata e mban parasysh edhe këtë rrethanë, duke e çmuar atë në harmoni me rrethanat e tjera që rezultojnë në gjykim nga informimi për të arrestuarin dhe të dhënat në lidhje me gjendjen procedimit, për të ardhur në përfundimin nëse është vendi për revokim a ndryshim të masës së sigurimit.”⁹⁷

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, ka parashikuar në mënyrë të qartë kriteret e veçanta kur vendoset paraburgimi për të miturit në konflikt me ligjin.

Përsa i takon kushteve për caktimin e masës së sigurisë për të miturin, përveç parashikimeve të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale⁹⁸, dhe sipas nenit 86 të KDPM⁹⁹, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekzistojnë edhe këto kritere:

a) sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet;

⁹⁷ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.1, datë 08.01.2009.

⁹⁸ Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale.

⁹⁹ Neni 86 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri:

i) përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër;

ii) përpiket t'i shmanget drejtësisë.

Risi e padiskutueshme e përcaktimeve ligjore të KDPM, është edhe parashikimi i masave të veçanta të sigurimit për të miturit e dyshuar për kryerjen e një vepre penale, sikundër janë:

(a) vendosja e të miturit nën mbikqyrje. Kjo masë realizohet përmes marrjes përsipër nga ana e prindit, të afërmit, institucionit ose personit të specializuar që të garantojë sjelljen e të miturit dhe të mbikqyrë nëse sjellja është e përshtatshme. Vendosja në mbikqyrje, bëhet vetëm me pëlqimin e të miturit dhe të personit që do ta mbikqyrë atë.

(b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar. Vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar bëhet ndaj të miturit, interesat e të cilit kërkojnë një vëmendje dhe mbikqyrje të posaçme dhe që për rrethanat konkrete nuk mund të realizohet nga ana e prindit ose personave të afërm. Ky shërbim mundësohet nga institucionet ose persona juridikë të licencuar edhe për këtë qëllim dhe në përputhje me ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij do të bëhet sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Këto masa, nisur nga rëndësia dhe kujdesi i veçantë që reforma juridike e vitit 2017 tregon për të miturin, mendoj se janë masa sigurimi alternative në raport me masat e sigurimit të parashikuara nga neni 232 i K.Pr. Penale, pasi në të kundërt nuk do të kishte kuptim parashikimi i tyre në KDPM. Neni 5 i KDPM, i jep përparësi zbatimit të dispozitave që janë më të favorshme për personin e mitur dhe një zbatim më të drejtë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Është e rëndësishme të theksohet se në lidhje me caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 81, pika "3" e KDPM, gjyqtari dëgjon personalisht të miturin dhe jep vendimin menjëherë.¹⁰⁰ Me miratimin e reformës së vitit 2017, në gjykimin ndaj të miturit nuk parashikohet më gjykimi në mungesë të të miturit.

Në bazë të nenit 86 të KDPM, masa e arrestit në burg mund të vendoset për të miturin vetëm si një alternative vetëm nëse, sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet

¹⁰⁰ Neni 81 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet, por çështja shtrohet në ç'raport ekziston ky përcaktim kur edhe pse nuk plotësohet ky minimum, shkalla e rrezikut është e tillë që i mituri përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër; apo provohet se i mituri përpiqet t'i shmanget drejtësisë. Pra, parashikimi i minimumit të veprës penale është në raport alternativ apo kumulativ në lidhje me rrezikun që paraqet i mituri. Kjo çështje paraqet diskutim dhe praktika gjyqësore ende nuk ka mbajtur një qëndrim përfundimtar, kjo për shkak se nga njëra anë kemi të bëjmë me interesin më të lartë të të miturit dhe nevojës së veçantë që ekziston ndaj tij, nga ana tjetër kemi të bëjmë me interesin publik të mbrojtjes së shoqërisë nga krimi, ku personi i dyshuar, qoftë edhe i mitur, paraqet një rrezik serioz për të tjerët apo provohet se do t'i shmanget drejtësisë. Nisur nga roli i interesave të përfshira, mendoj se kriteri i minimumit të veprës penale duhet të konsiderohet së bashku në mënyrë kumulative në raport me rrezikshmërinë shoqërore që mund të ketë personi i mitur i dyshuar për kryerjen e një veprë penale.

Në lidhje me kohëzgjatjen e masës së sigurisë, neni 87, pika "4" e KDPM, parashikon që i mituri nuk mund të ndalohej për një periudhë më të gjatë se gjysma e periudhës së paraburgimit të vendosur për të rritur. Në nenin 263 të K.Pr. Penale, janë parashikuar afatet e paraburgimit paraprak në burg.

Këto dispozita parashikojnë që periudha e paraburgimit nuk duhet të kalojë (a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale; (b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim, (c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm¹⁰¹.

Për të realizuar të drejtën e procedimit të të miturit brenda një kohe sa më të shkurtër, neni 88 i KDPM, ka parashikuar afate kohore, në bazë të të cilit çështja e një të mituri në konflikt me ligjin i dërgohet gjykatës jo më vonë se 3 muaj nga regjistrimi i emrit në regjistër. Gjykata e Shkallës së Parë e përfundon shqyrtimin e çështjes brenda afatit më të shkurtër të mundshëm, por jo më vonë se 6 muaj nga data e depozitimit të dokumenteve në Gjykatë. Për rrjedhojë, ligji ka parashikuar që çështja e një të mituri në konflikt me ligjin nuk duhet të kalojë 9 muaj (si vit shkollor).

¹⁰¹ Neni 263 i Kodit të Procedurës Penale.

3.9 Rregulla të posaçme për dënimin e të miturve.

Me reformën juridike të vitit 2017, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë rëndësinë që ka qëllimi i dënimit për personat e mitur. Dënimi për këta persona synon: ri-integrimin e të miturit në shoqëri, rehabilitimin e tij në përshtatjen e tij në shoqëri, parandalimi i kryerjes së veprave penale të mëtejshme.

Në caktimin e dënimit ndaj personave të mitur, ligjvënësi ka parashikuar një sërë parimesh themelore si, interesi më i lartë i fëmijës, parimi i raportit të vlerësimit individual, garantimi i mirëqenies së të miturit; rrethanat dhe rrezikshmëria e veprës penale, mosha e të miturit dhe me rrethanat individuale të tij, si dhe nevojat e veçanta të të miturit. Nxitja e ri-integrimit të të miturit dhe përfshirja e tij për të pasur në të ardhmen një rol të dobishëm në shoqëri; hartimi dhe parashikimi i një plani individual për korigjimin e të miturit, përshtatshmëria e masës së dënimit, e cila duhet të mundësojë korigjimin e te miturit.

Ashtu si në rastin e masave të sigurimit, ligjvënësi i vitit 2017, ka parashikuar një sërë llojesh dënimi të veçanta të cilat janë parashikuar në funksion të përshtatjes së tyre më të mirë me nevojat dhe specifikat e dënimit të personave të mitur; parashikimi i llojeve të dënimit dhe funksioni i tyre në kryesore ose plotësues, sikundër janë, dënimi me burgim, dënimet jo me burgim krahas pezullimit të dënimit me burg dhe vënies në provë.

Në dënimet jo me burgim përfshihen, dënimet kryesore si: kufizimi i lirisë, gjoba. Dënimet plotësuese, si qëndrimi në shtëpi, kryerja e një pune me interes publik, ndalimi për kryerjen e një veprimtarie, përmbushja e detyrimeve të caktuara, përbëjnë një risi të padiskutueshme të përcaktimeve ligjore të KDPM.

Zbatimi i dënimeve penale ndaj të miturve në bazë të nenit 96 të KPDM¹⁰², mund të bëhet duke aplikuar:

- a) vetëm një dënim kryesor,
- b) një dënim kryesor dhe një dënim plotësues,
- c) një dënim kryesor a plotësues dhe një ose disa masa alternative të shmangies,
- d) vetëm një dënim plotësues, sikundër mund të jetë për shembull kryerja e një pune me interes publik).

¹⁰² Neni 96 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

KDPM, ka përcaktuar gjithashtu, edhe një sërë kriteresh substanciale që gjykata duhet të ketë parasysh në caktimin e dënimit me burgim ndaj një personi të mitur. Në bazë të të cilave, parashikohet kriteri dysHEME, i minimumit të dënimit me burgim me 7 vjet burgim.

Gjykata duhet të vlerësojë, së pari, nëse lloji i dënimit me burgim është mjeti i vetëm që do të përmbushte qëllimin, pra edukimin dhe korrigjimin e të miturit që është deklaruar fajtor nga ana e gjykatës. Nëse pas një shqyrtimi të plotë do të rezultojë se lloji i dënimit me burgim është mjeti i fundit dhe i vetëm që mund t'ia arrijë qëllimit, atëherë gjykata do të vlerësojë përmbushjen e kriterëve vijues, si prania e shkaqeve në bazë të të cilave, ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë.

Gjithmonë gjykata duhet të ketë parasysh faktin se ndaj të miturit mund të aplikohet një masë dënimi, e cila mund të shkojë deri në ½ e dënimit me burgim që parashikohet për veprën penale, dhe gjithsesi, masa e dënimit me burgim për të miturit nuk duhet të jetë më shumë se 12 vjet.

Edhe në rastin e zbatimit të dënimit kryesor të llojit gjobë, në rastin e të miturit gjykata duhet të vlerësojë, së pari aftësinë paguese të të miturit ose familjes së tij. Pra, nëse ai ka të ardhura monetare nga një burim i ligjshëm. Së dyti, caktimi i masës së gjobës për të miturin duhet të jetë deri sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri. Pra, do të vlerësohet nëse lloji i dënimit kryesor me gjobë, do t'i shërbejë arritjes së qëllimit të dënimit dhe a do të korrigjojë sjelljen e të miturit.

Kritere janë parashikuar edhe për caktimin e dënimit me kufizim lirie. Vendosja e të miturit në një institucion të caktuar nën mbikqyrje, pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme, mund të bëhet për një kohë jo më të gjatë se tre vjet.

Në lidhje me kriminalitetin e të miturve në Shqipëri, statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë konfirmojnë trendin e rritjes së tij gjatë viteve. Nga të dhënat rezulton se krimet ndaj pasurisë zënë një përqindje më të lartë. Sipas statistikave të Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme nga viti 2005 deri në vitin 2018, në Shqipëri janë dënuar gjithsej 7006 të mitur për kryerjen e veprave penale të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre janë dënuar me dënimin me burgim deri në 2 vjet. Po sipas këtyre të dhënave, përqindja më e lartë të miturve të dënuar është ajo me arsim (9 vjeçar e të mesëm), e cila shkon rreth 90% të të miturve të dënuar.

3.10 Organizimi i drejtësisë penale për të mitur.

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur, përbëhet nga seksione të veçanta të prokurorive të rretheve, të cilat kanë në përbërjen e tyre prokurorë të specializuar për kriminalitetin e të miturve. Në bazë të nenit 2 të ligjit Nr.97/2016, “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, seksioni i posaçëm për të miturit ngrihet, në çdo rast, në prokuroritë pranë gjykatave në të cilat janë krijuar sipas ligjit seksionet përkatëse për gjykimin e të miturve.

Sipas nenit 27 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, i mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me gjyqtarët e specializuar ka nxjerrë Vendimin Nr.79, datë 30.05.2019, “*Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur*”. Nëpërmjet këtij vendimi, organi më i lartë i qeverisjes së sistemit gjyqësor ka udhëzuar që në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, duhet të caktohen së paku 3 gjyqtarë, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, nëse për shkak të numrit të gjyqtarëve në këto gjykata, nuk mund të krijohen për gjykimin e këtyre çështjeve, seksione të specializuara me së paku 6 gjyqtarë.¹⁰³

Në bazë të ligjit Nr.97/2016, “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, në nenin 9, titulluar, “konfidencialiteti i të dhënave” parashikohet se organit të prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t’u japë personave të tretë të dhëna që cenojnë të drejtat e të miturve.¹⁰⁴

¹⁰³ Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Nr.79, datë 30.05.2019, <http://www.kld.al/vendime/vendim-nr-79-dat%C3%AB-30-05-2019>

¹⁰⁴ Neni 9 i ligjit Nr. 97/2016, “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”.

KAPITULLI IV:

Kuadri ligjor, përgjegjësia penale në Shqipëri.

4.1 Kuadri ligjor dhe vështrim historik.

Përgjegjësia penale është elementi subjektiv apo psikik i veprës penale. Ky është nocioni i ngushtë i përgjegjësisë penale. Në teorinë e së drejtës penale njihet edhe kuptimi i gjerë apo kuptimi objektiv-subjektiv i përgjegjësisë penale.¹⁰⁵ Sipas këtij kuptimi, përgjegjësia penale përbëhet prej veprës penale si element objektiv dhe përgjegjësisë dhe fajësisë si elemente subjektive.

Një person konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike që të kuptojë apo është i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojën e veprës që kryen, dhe është në gjendje që t'i kontrollojë sjelljet e tij.

Pra, përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementeve: elementit intelektual apo aftësia intelektuale (mendore) që përbën elementin konjitiv dhe elementit volitiv apo të dëshirës-vullnetit.

Përgjegjshmëria është bazë dhe themel i fajësisë, sepse një person nuk mund të konsiderohet i fajshëm nëse nuk është i përgjegjshëm. Sikundër shumë kode penale të shteteve të tjera, edhe kodi ynë penal nuk e përcakton nocionin e përgjegjshmërisë, por përcakton papërgjegjshmërinë, përkatësisht kur autori i veprës penale konsiderohet i papërgjegjshëm.

Që të bëhet një analizë objektive e administrimit të sistemit të drejtësisë për të mitur, kërkohet që të punohet me shumë përbërës që kanë të bëjnë jo vetëm me të lexuarit e ligjit, por edhe të një sërë vendimesh në bazë dhe për zbatim të tij, studimit të raporteve dhe rezultateve të monitorimit të hallkave të sistemit, sugjerimeve e raporteve të partnerëve ndërkombëtarë, dokumenteve politike të qeverisë, nivelit të koordinimit të sistemit, elasticitetit dhe fleksibilitetit të strukturave, termave financiarë, etj.

Kërkohet që të gjithë analizat dhe deduksionet t'i përgjigjen pyetjes: Sa është mbajtur parasysh interesi më i lartë i fëmijës? A është administruar mirë apo keq sistemi i drejtësisë për të mitur? Sa është qasja me standardet ndërkombëtare? Cila do të konsiderohet mosha për përgjegjësi penale? Po mosha prag i përgjegjësisë penale? A ka nevojë përmirësimi kuadri ligjor ekzistues?

¹⁰⁵ *Codice Penale, Libro II. Milano. dott Giuffrè, editore 2000.*

Analiza e administrimit të sistemit të drejtësisë për të miturit ka një rëndësi të madhe sepse kriminaliteti i të miturve është një problem jo vetëm ligjor, por tepër kritik nga këndvështrimi shoqëror ¹⁰⁶që ndikon në cilësinë e ardhshme të jetës. Në këto kushte, kriminaliteti i të miturve duhet të jetë çështje e një studimi ndërdisiplinor. Kriminologë, sociologë, psikologë, mjekë, biologë, edukatorë, juristë, etj. kanë pjesën e tyre të padiskutueshme të kontributit në efektivitetin e sistemit, në arritjet dhe vlerat e tij. Madje edhe sociologët kanë rrëmuar shumë në këtë fushë të udhëhequr nga parimi *“Ne përpiqemi për t’u mësuar fëmijëve tanë gjithçka për jetën, ndërkohë që janë fëmijët tanë që na mësojnë se çfarë është jeta”*.

Të drejtat e të miturve janë pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë dhe respektimi i këtyre të drejtave është një *“conditio sine qua non”* që ky sistem drejtësie të ecë përpara, ndonëse respektimi i të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin ka problematikat e veta dhe sfida që duhet të trajtohen me vëmendjen e duhur të të gjithë institucioneve, sepse kanë të bëjnë me të drejtat e një kategorie tepër të ndjeshme. Pavarësisht se termi *“i mitur në konflikt me ligjin”* është futur në përdorim me Kodin Penal të të miturve, por edhe në të shkuarën i mituri ka pasur një regjim të privilegjuar për sa i përket trajtimit të tij.

Në aspektin gramatikor, i mitur konsiderohet personi që nuk ka arritur akoma moshën e pjekurisë, duke mos u bërë ende zot i vetes dhe i përgjegjshëm për veprimet e tij. Duke iu referuar nenit 1, të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i mitur do të konsiderohet çdo fëmijë që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Ndërsa, referuar fjalorit ligjor *“Oxford – Dictionary of Law”*, i mitur cilësohet personi ndërmjet moshës 10-17 vjeç, i/e cili/a ka kryer një krim dhe personi rreth moshës 14-17 vjeç që kryen një krim, cilësohet si i/e ri/e. Po kështu, edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dokumentat e saj, kriminelin e mitur e përkufizon si: *“...çdo fëmijë apo adoleshent të cilit/së cilës i ngarkohet kryerja e një vepre penale ose është deklaruar fajtor/e për kryerjen e saj...”*¹⁰⁷.

Kodet penale shqiptare ndër vite e kanë trajtuar moshën për përgjegjësi penale në raport me llojin e veprës penale të kryer.

¹⁰⁶ *Drejtësia për të mitur në Shqipëri, Studim CRCA.*

¹⁰⁷ *Përmbledhje e akteve ndërkombëtare, botim i UNICEF.*

Në kodin penal shqiptar, të vitit 1924¹⁰⁸ në nenin 40. trajtohej mosha për përgjegjësi penale ku ligjvënësi shprehej se “...ata që në bërje e sipër të fajit nuk kanë mbushur moshën e trembëdhjetë vjetëve, quhen pa gjykim, dhe nuk janë të gjegjeshëm për fajin që bëjnë, por me vendim të gjykatës së delikteve, u dorëzohen prindërve a kujdestarëve, pasi ju merret etërpremtim, ose dërgohen në strehë urtësimore për t’u ndaluëm dhe stërvitum, për një kohë moshtariën e tyre”.¹⁰⁹

Nëse faji ishte krim që passjell dënim me vdekje, burgim ose burgim të përjetshëm, të miturit burgoseshin për urtësim nga pesë deri në dhjetë vite. Për çdo krim tjetër që passjell dënime të tjera, ndaj të miturve jepeshin dënime me burgim për urtësim, në masën e ¼ së dënimit, të paraparë për të rriturit. Kur të miturit kanë mbushur moshën 15 vjeç, por janë më të vegjël se 18 vjeç, për rastin kur krimi sillte dënim me vdekje ose burgim apo burgim të përjetshëm, fëmijët dënoheshin me burgim për urtësim nga 7 deri në 15 vite. Për çdo formë tjetër krimi, i mituri dënohej me 1/3 e dënimit të dhënë për të rritur. Kur masa e dënimit kryesor ishte gjobë, për të miturit shqiptohej (jepej) në gjysmën e masës së asaj që zbatohet për të rriturit. I mituri përjashtohej nga përgjegjësia penale kur provohej se krimi ishte kryer nën sindromën e çmendurisë, si dhe kur provohej mosdashja e të miturit në krim për shkak të dhunës së ushtruar për kryerjen e tij, shtyrjen në krim nga respekti apo urdhri nga prindërit, kujdestarët apo tutorët, nuk përbëntë dhunë.

Gjithashtu, sipas nenit 42¹¹⁰ të këtij kodi penal, nuk quhen faj veprat e bëra në mbrojtje të jetës apo të shëndetit nga sulme të çfarëdoshme, si dhe vetëurdhërimi për shkak të tronditjes psikike shkaktuar nga vjedhje momenti, apo dëmtimi të pasurisë së të miturit.

Në nenin 45 të këtij Kodi, parashikohen masat e ndëshkimit të të miturit në rastin kur provohet se ka bashkëvepruar me dy apo më shumë persona për kryerjen e krimit. Në këto rrethana, vepra konsiderohej rënduese dhe masa e ndëshkimit ishte më e madhe, konkretisht jo më pak se 10 vite burgim, kur krimi passjell dënimin me vdekje ose burgim apo burgim të përjetshëm, dhe në raste të tjera, masa e dënimit ulej nga 1/6 deri në 1/3 e masës së dënimit, të dhënë për të rriturit.

Republika e Zogut, me dekretin e 3 qershorit 1927, miratoi Kodin Penal Shqiptar dhe Ligjin “*Mbi Aplikimin e Kodit Penal*”. Të dy aktet e mësipërme hynë në fuqi më datë 1 janar 1928.

¹⁰⁸ 14 Kodi Penal i Perendorisë Osmane. Tiranë, 1924. Fq 8-13.

¹⁰⁹ Nëse, gjatë kësaj periudhe kohe, pa i mbushur pesëmbëdhjetë vjet, “...vogëlushët kryejnë ndonjë krim, ata që ishin ngarkuar më ruajtjen e tyre, gjobiteshin deri në 100 (njëqind) lira....”.

¹¹⁰ (shtojca 22.05.1927)

Në Nenin 54 të këtij kodi penal parashikohej mosha për përgjegjësi penale në terma eksplicite: “...Nuk bahen ndjekje kundra atij, i cili kur ka krye fajin, nuk ka mbushë moshën 10 vjeç. Por, po të jetë se faji i bamun sjell ndëshkimin me vdekje, me burgim të përjetshëm, me burgim të randë ose burgim jo më pak se 1 vit, gjyqi, mbi kërkimin e prokurorit, mund t’urdhnoj që fajtori i vogël të mbyllet në një institut-edukimi dhe përmirësimi, kur ekzistojnë të këtilla; kjo mbyllje vazhdon deri sa të mbushi moshën 20 vjeç dhe gjyqi kurdoherë ka të drejtë të revokojë këtë vendim të mbylljes, e t’urdhënojë që ay i vogël tu dorëzohet prindve ose atij të cilit ligja i ngarkon kujdesin. Në rast se gjyqi urdhënon t’i dorëzohet prindëve ose kujdestarit, i porosit këta që të kujdesen për rruajtjen dhe edukimin dhe të vërejnë sjelljen e tij, se, në rast që këta nuk e vërejnë, kështu i vogli ban ndonjë delikt të ç’do lloji, kanë me pague një gjobë të lehtë nga një qind deri në pesëqind franga ari, të cilën e cakton n’atë vendim...”

Neni 55 parashikonte se: “...Nuk bahen ndjekje kundër atij, i cili në kohën kur ka ba faji ka pasë mbushun moshën 10 vjeç, por jo 15 vjeç dhe nuk ka pasun një fuqi mendore çmuëse. Por, në rast që faji i banum ndëshkohet mbas ligjës me vdekje, me burgim të përjetshëm, me burgim të randë ose me burgim jo më pak se 1 vit, aplikohen dispozitat e paragrafit II, të nenit të ma sipërm. Në qoftë se, fajtori e ka pasun fuqinë çmuëse të nalt-përmendum, ndëshkimi i veprës së tij bahet simbas rregullave të poshtshenueme: 1. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm caktohet burgim nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet. 2. Ndëshkimet e tjera zbriten, si mbas rregulli, që tregon paragrafi IV e V, i nenit 48. 3. Ndëshkimet me ndalim nga ofiqet publike dhe me vrejtim të Autoritetit të sigurimit publik, nuk aplikohen. Këto ndëshkime vuhet në institute të caktueme për të vegjlit dhe nuk mund të merren si bazë për përsëritje.

Neni 56 parashikonte se: “...Ay, që kur ka ba fajin ka pasë mbushë moshën 15 vjeç e jo atë 18 vjeç, ndëshkohet si mbas rregullave të poshtëshenueme: 1. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm, epet një ndëshkim nga 12 deri në 20 vjet burgim të randë. 2. Kur faji sjell ndëshkim të përkohshëm që kalon të 12 vjetët, epet po asilloj ndëshkimi nga 6 deri në 12 vjet; në qoftë se kalon të 6 vjetët, por jo të 12-ët, epet asilloj ndëshkimi nga 3 deri në 6 vjet dhe në rastet e tjera ndëshkimi zbritet në gjysëm. 3. Ndëshkimeve me gjobë u zbritet një e treta. Në qoftë se në kohën e dënimit fajtori nuk ka mbushë 18 vjetët, gjyqi mund t’urdhnojë që ndëshkimi kundra lirisë personale të vuhet në një institut përmirësimi, dhe ndalimet nga ofiqet publike dhe të nënvumunit në vrejtim të posaçme t’autoritetit të sigurimit publik, nuk aplikohen.”

Zhvillimet historike në Shqipëri vijuan me ndryshime në formën e qeverisjes dhe në legjislacionin penal në përgjithësi dhe në atë kundrejt të miturve në veçanti. Konkretisht në Kodin Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë¹¹¹, në nenin 7, parashikohej se mosha për përgjegjësi penale ishte mosha 14 vjeç, si për krime ashtu edhe për kundërvajtje penale.

Për sa i përket dënimit, në nenin 21 të këtij kodi parashikohej se, i mituri i cili nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç, dënohej jo më shumë se me gjysmën e dënimit me heqje lirie.¹¹²

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë i vitit 1995 ka parashikuar si moshë për përgjegjësi penale për krimet, atë 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtjet penale 16 vjeç.

Në vijim, edhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit¹¹³ i miratuar së fundmi dhe që ka hyrë në fuqi në datë 1 janar 2018, është mbështetur në parimet e sanksionuara në KRSH-së, në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, në aktet ndërkombëtare dhe në rregulla të njohura në nivel ndërkombëtar, lidhur me administrimin e drejtësisë penale për të mitur.¹¹⁴

KDPM është përgatitur gjithashtu me asistencën dhe mbështetjen e ekspertëve më të mirë të BE-së e më gjerë. Ky ligj, së bashku me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, implementojnë konceptet më bashkohore për trajtimin e delikuentëve të mitur. Ashtu sikurse përcaktohet edhe në këtë Kod, dispozitat e tij nuk mund të interpretohen apo zbatohen në kapërcim të dispozitave ligjore ndërkombëtare, duke kufizuar kështu, garancitë dhe rregullat standard minimum lidhur me drejtësinë penale për të mitur, si dhe të drejtat e shprehura në aktet ndërkombëtare, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, ka aderuar apo nënshkruar, Acquis e BE-së dhe KDF të OKB-së.¹¹⁵ Sipas këtij kodi dhe kodit penal, “Moshë minimale e përgjegjësisë penale është mosha 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal.”

Ndër aktet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur përmendim: Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve (1989)”, ratifikuar nga Parlamenti më 27 shkurt 1992 dhe Protokollin shtesë i saj, datë 18 janar 2002, “Për shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve”,

¹¹¹ Në kohën e komunizmit përgjatë viteve 1977 me ligjin Nr.5591, datë 15.06.1977

¹¹² Bëhet fjalë për çdo dënim që parashikonte dispozita përkatëse

¹¹³ Ligji Nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, botuar në FZ Nr.92, fq.5210.

¹¹⁴ Neni 1/1, i ligjit Nr.37/2017

¹¹⁵ Po aty, neni 1/2, i ligjit.

“Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ 1948)”, si dhe “Deklarata për të Drejtat e Fëmijës.”¹¹⁶

Në nenin 1 të saj, jepet përkufizimi i termit “fëmijë”, sipas të cilit, është fëmijë çdo qenie njerëzore, nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve, kur ligji i brendshëm vendos ndryshe. Moshë e përgjegjësisë penale për të miturit, varion nga njëri vend në tjetrin, duke krijuar një grupim të gjerë moshash nën këtë përkufizim, nga 7 në 18 vjeç e sipër.

Legjislacioni italian njihet si përparimtar në trajtimin e të miturve qysh në krye të herës me direktivat e qarkores “Orlando” të cilat “u përkthyen” në Kodin e ri Penal, i cili hyri në fuqi në 1913 në të njëjtën kohë me Kodin e Procedurës Penale, me rritje të moshës së përgjegjësisë nga 9 deri në 14 vjeç dhe ulje të moshës së përgjegjësisë të plotë nga 21 në 18 vjeç. Gjithashtu, u prezantua si një përjashtim i një logjike të rreptë ndëshkuese, instituti i “faljes gjyqësore” (neni 169), për të garantuar “...kthimin e të miturve dhe të rinjve adoleshentë në rrugë të drejtë, larg veseve dhe krimit, e bashkëjetesës shoqërore me vlerat e moralit dhe ligjit...”¹¹⁷. Aktualisht sipas legjislacionit italian konsiderohet i mitur personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeçare por jo atë tetëmbëdhjetë vjeçare.

Futja e masave të sigurisë për të miturit në kodin Zanardelli¹¹⁸ ishte gjithashtu, shumë e rëndësishme. Kështu, nga njëra anë, i mituri nuk dënohet në moshën 14 vjeçare, sepse ai nuk konsiderohet i pjekur në mënyrë të mjaftueshme për t'u nënshtuar një aktgjykimi me përgjegjësi penale.

4.2 FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË KRIMINALITETIN FËMINOR DHE NJË VËSHTRIM KRAHASIMOR.

¹¹⁶ Konventa “Për të Drejtat e Fëmijës”, miratuar nga OKB, 20.11.1989 Kjo konventë është një instrument i rëndësishëm ndërkombëtar, i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në datë 28 shkurt 1992 dhe si e tillë, ajo është bërë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe e zbatueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Katër janë parimet bazë të Konventës: 75 - Mosdiskriminimi (neni 2, i konventës); - interesi më i lartë i fëmijës (neni 3); - e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6); - e drejta e pjesëmarrjes (neni 12).

¹¹⁷ Raporti ministror mbi draftin përfundimtar të një Kodi të ri Penal, në punën përgatitore për Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, vol.V, Romë, 1929, fq. 220.

¹¹⁸ Kodi Penal Italian i vitit 1889 (zakonisht i referuar si “Kodi Zanardelli” nga Giuseppe Zanardelli), ishte kodi penal në fuqi në Mbretërinë e Italisë nga viti 1890 deri në vitin 1930. Giuseppe Zanardelli (lindi në Brescia, 26 tetor 1826 dhe vdiq në Toscolano Maderno, 26 dhjetor 1903) ishte një patriot dhe politikan italian i shquar i asaj kohe, ministër i Drejtësisë në qeverinë Depretis të 1881, president i Dhomës së Deputetëve, 1892-1894, etj.

Nga studime të ndryshme, të para në raport me kriminalitetin e të miturve rezulton se përfshirja e të miturve në konflikt me ligjin është rezultat i faktorëve psiko-social, individual dhe familjarë, faktorë të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin. Një pjesë e të miturve në konflikt me ligjin vijnë nga familja me problematikë të zhvilluar si dhunë në familje, histori tradhëtie, familje monogame apo familje të cilat për shkak të gjendjes ekonomike të rënduar apo gjakmarrjes nuk i kanë lejuar të miturit të vazhdojnë qoftë edhe shkollimin e detyrueshëm. Këta faktorë ndikojnë edhe te shpërndarja gjeografike e kriminalitetit “fëmijënor” duke qenë se sipas të dhënave statistikore të miturit në konflikt me ligjin jetojnë në zona heterogjene, në mënyrë të veçantë në zona rurale apo në zona me popullsi heterogjene përfshi këtu dhe qytetet “metropol”.

Një studim i UNICEF “Vlerësimi i impaktit të reformave në fushën e drejtësisë për fëmijët në disa vende (2006-2012)” dilte në konkluzionin tejet negativ se Shqipëria mbetet vendi me përqindjen më të lartë të dhënies së dënimit me burg për fëmijët. Në vitin 2012 Shqipëria rezultonte me 186 të mitur në paraburgim. Këto të dhëna shqetësuese, për një çështje shumë të ndjeshme për shoqërinë, e bënin të domosdoshme ndërhyrjen e menjëhershme dhe energjike për ndryshimin e kësaj praktike të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin. Drejtësia për të miturit u bë pjesë integrale dhe një komponent mjaft i rëndësishëm i Reformës në Sistemin e Drejtësisë.¹¹⁹

Në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020, të miratuar me VKM Nr.372, datë 26.04.2017¹²⁰, citohet se: “Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ende ka një përqsasje ndëshkuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Në një masë të madhe nuk arrin të marrë parasysh nevojat e tyre për mbrojtje, në respekt të të drejtave të tyre njerëzore dhe dinjitetit megjithëse ka patur disa përmirësime gjatë viteve të fundit.”

Që në vitin 2009, me prezantimin e Shërbimit të Provës, jepen dënime alternative deri në 58% të rasteve të të miturve. Numri i fëmijëve që kanë kaluar nga paraburgimi gjatë viteve të mëparshme përgjithësisht ka qenë i paqëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2015 (208 raste) ka patur një rënie të dukshme (rreth 40%) në krahasim me vitin 2014 (338 raste). Ditët e qëndrimit aty kanë pësuar rënie vetëm në vitin 2015 me një mesatare prej 125 ditësh (krahasuar me 140 në 2014). Gjithashtu, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët.

¹¹⁹ Strategjia e drejtësisë për të mitur dhe plani i veprimit, Ministria e Drejtësisë.

¹²⁰ <https://www.unicef.org/albania/media/1501/file/National%20Justice%20for%20Children%20Strategy%20Alb.pdf>

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2016) ndonëse vlerësonte punën e bërë për reformimin e sistemit gjyqësor,¹²¹ për sa i përket kuadrit ligjor lidhur me drejtësinë për të miturit, shprehej se duhet akoma punë për t'u përafuar me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu Komisioni Evropian deklaroi përmes këtij raporti se mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës mbeten të pamjaftueshme.¹²² Rekomandime për përmirësimin e këtyre problematikave vijnë të përsëritura që nga Progres Raporti vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2015) dhe duke qenë të përsëritura, atyre iu kushtohet vëmendje e veçantë në këtë Strategji.¹²³

Shqetësime të tjera të reflektuara në Progres Raportin e vitit 2015 janë niveli i lartë i përsëritjes së shkeljeve nga të miturit, mungesa e mundësive për ofrimin e riedukimit dhe mungesa e koordinimit ndërmjet drejtësisë dhe sistemeve të mbrojtjes së të miturve që dalin nga sistemi i drejtësisë, të cilët kanë nevojë për mbështetje që të ri-integrohen në shoqëri. Forcimi i Programit të Riintegritimit të të miturve rekomandohet gjithashtu nga analiza e përgatitur në kuadër të “Konventës për Integrimin Evropian”, bazuar në të dhënën se 90% e të miturve kthehen në recidivistë.¹²⁴ Edhe në Raportin “Për vlerësimin e kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, përgatitur nga Avokati i Popullit në vitin 2016 deklarohet ..se, nuk ka shërbime rehabilitimi ose ri-integrimi për fëmijët që kryejnë dënimet e tyre.¹²⁵ ..Mungojnë edhe shërbimet specifike për fëmijët që janë nën moshën e përgjegjësisë penale por që bien në kontakt me veprën penale. Duhet të ekzistojë një qasje më sociale dhe jo t'i jepet përparësi ndëshkimit por edukimit.¹²⁶”

Mosha e përgjegjësisë penale në vendet e BE-së

Mosha e përgjegjësisë penale në vendet e Bashkimit Evropian varion në vjeç si më poshtë:

Austria 14 ; Belgjika 16*/**18; Bullgaria 14 ; Qipro 7 ; Rep. Çeke 15; Danimarka 15; Estonia 14; Finlanda 15; Franca 10***/13; Gjermania 14; Greqia 8***/13; Hungaria 14; Irlanda 12;

¹²¹ Përmbledhje e Raportit, fq. 5.

¹²² Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

¹²³ https://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2017/11/01_Strategjia_e_Drejtesise_per_te_Mitur_2017-2020_Shqip.pdf

¹²⁴ Konventa për Integrimin evropian, Vlerësime dhe rekomandime 2015-2016, “Lëvizja evropiane në Shqipëri “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” Kapitulli 23, fq 27-29.

¹²⁵ Raporti “Me zërin e të miturve të privuar nga liria-vlerësim i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit” Avokati i Popullit dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve, me mbështetjen e UNICEF, dhjetor 2016, fq. 22.


¹²⁶ Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe rekomandime 2015-2016, “Lëvizja evropiane në Shqipëri “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” Kapitulli 23, fq 27-29.

Italia 14; Lituania 14**/16; Letonia 14; Luksemburgu 10; Malta 9; Holanda 12; Polonia 13; Portugalia 12****/16; Rumania 14**/16; Sllovakia 14/15; Sllovenia 14**/16; Spanja 14; Suedia 15; Britania e Madhe 10;

(shënim *vetëm për shkelje trafiku, **për krime serioze, ***vetëm masa edukative, ****mbrojtje e veçantë e fëmijëve)¹²⁷

Nëse i paraqesim grafikisht këto të dhëna atëherë grafiku do të ishte si më poshtë:

¹²⁷ Të dhëna të mara nga [www.albaniasave the children.net](http://www.albaniasave-the-children.net)



Herë pas herë në nivel lokal, rajonal ose global, ekspertë, studiues, penalistë, akademikë, etj i janë rikthyer problemit të moshës për fillimin e përgjegjësisë penale dhe problemit të trajtimit të të miturve të cilët ndonëse nuk e kanë arritur moshën e përgjegjësisë penale kanë kryer një veprë penale. E drejta ndërkombëtare e lidh me moshën ndarjen e të rriturve nga të miturit dhe fillimin e përgjegjësisë penale. Sistemi i drejtësisë për të miturit synon që këta të mbrohen dhe të edukohen dhe jo domosdoshmërisht të ndëshkohen. Adult, i rritur, madhor është personi që ka arritur moshën madhore. Zakonisht në pjesën më të madhe të legjislacioneve hasim moshën 18

vjeç si kufirin që e bën një individ të vet përgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e veta. Një 18 vjeçar ka të drejtën aktive e pasive të votimit, të lidhë martesë, kontrata, etj. E nëse një 18 vjeçar akuzohet për një vepër penale dhe procedohet përmes një procesi të drejtë gjyqësor të garantuar nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi e gjendet fajtor, dënohet. Ky është edhe qëndrimi i KDF¹²⁸. Kushtetuta e RSh nuk bën fjalë për një moshë, por vendos një mbrojtje të veçantë për fëmijët. Të miturit nga 0 -18 vjeç përbëjnë afërsisht 40% të popullsisë në Shqipëri¹²⁹.

Ky fakt është për tu marrë në konsideratë kur trajtojnë statusin e të miturit, të drejtat dhe përgjegjësitë e tij si dhe politika të caktuara. I mitur është personi i cili nuk e ka arritur moshën madhore dhe për rrjedhojë ka një status të veçantë. Këtë status e shohim edhe në fushën civile. Në ligjin për arsimin thuhet se fëmijët nga moshja 6-16 vjeç duhet të ndjekin arsimin e detyrueshëm 9 vjeçar, ndalohet shitja e alkoolit personave nën 18 vjeç, individët nën 18 vjeç nuk mund të marrin lejen e drejtimit të automjetit, nuk mund të lidhin martesë, nuk votojnë, etj. Për rrjedhojë, të miturit edhe përgjegjësinë penale nuk mund ta kenë si të rriturit. Për shkak të statusit të tyre të veçantë, në legjislacione të ndryshme, dhe edhe në atë të vendit tonë, gjejmë një sistem penalizimi të ndryshëm nga ai që aplikohet për të rriturit. Se sa i ndryshëm prej sistemit penal për të rriturit dhe sa i përgjigjet statusit të të miturit sistemi aktual, kjo është një çështje shumë e rëndësishme për tu marrë në analizë por shumë e vështirë të thuhet se do të ezaurohet plotësisht përmes këtij studimi.

Legjislacioni ynë penal i ka kushtuar një rëndësi të veçantë çështjeve të tilla si përcaktimi i moshës për përgjegjësi penale, verifikimit të saj dhe mosfillimit ose pushimit të procedimit në rast se personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve konstaton se në legjislacionin shqiptar ka një mungesë qartësie lidhur me statusin e fëmijëve ndërmjet moshës 14 -18 vjeç (në fusha të tilla si abuzimi seksual) gjë që mund të shkaktojë mos akordimin e mbrojtjes së veçantë ose të të drejtave për të cilat ata janë titullarë në bazë të KDF. Në këto kushte qartësia e legjislacionit është domosdoshmëri¹³⁰.

¹²⁸ *Konventës për të drejtat e fëmijëve*

¹²⁹ *Children in conflict with the law-Albania. Analytical Report. October 2006. Ministry of J & INSTAT*

¹³⁰ *Concluding Observations of the Committee on the Rights of the Child: ALBANIA COMMITTEE ON THE RIGHTS OF THE CHILD/C/15/Add.249. 28 January 2005, 38th session*

Mosha e përgjegjësisë penale përcakton moshën në të cilën veprimet e kryera nga fëmijët mund të trajtohen sipas ligjit penal. Kjo luhetet së tepërmi nga njëri shtet në tjetrin. Po ashtu, ka përkufizime të ndryshme ligjore të moshës në të cilën një fëmijë mund të mbahet i burgosur në godinat e sistemit të burgjeve. Legjislacioni ndërkombëtar është shumë i qartë në lidhje me faktin se cili duhet të konsiderohet fëmijë. Konventa për të drejtat e fëmijëve në nenin 1 të saj përcakton se “...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më para në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet”.

Instrumentet ndërkombëtare për drejtësinë penale kanë të njëjtin përkufizim për të miturit. Në Rregullat e Kombeve të Bashkuara “Për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria” rregulli Nr.11 a) parashikon se: *I mitur është çdo person nën 18 vjeç.*

Në disa shtete, asnjë person nën 18 vjeç nuk dënohet me burgim. Këta të rinj duhet të mbahen nën kujdestarinë e një agjencie sociale dhe jo në një vend i cili është pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Për të miturit burgimi duhet të jetë masa e fundit dhe të aplikohet për raste të veçanta.

Legjislacioni amerikan i drejtësisë penale për të mitur, “Federal Juvenile Delinquency Code”, USA.

Gjykata e parë për të mitur në USA u krijua në Illinois më 1899 dhe, siguroi një dallim ligjor, midis braktisjes së të miturve dhe krimit. Ligji që themeloi gjykatën, Ligji i Gjykatës për të Mitur të Illinois i vitit 1899, u krijua kryesisht për shkak të avokimit të grave të tilla si Jane Addams, Louise DeKoven Boëen, Lucy Flower dhe Julia Lathrop, të cilët ishin anëtarë të klubit me influencë të Çikagos. Gjykata e Çikagos u hap më 1 korrik 1899 me kryesimin e gjykatësit Tuthill, së bashku me disa anëtarë të Klubit të Gruas të Çikagos që vepruan si këshilltarë për prejardhjen e shkelësit të mitur. Krijimi i një gjykate për të mitur ndihmoi në përsëritjen e interpretimeve kulturore dhe ligjore të “*interesave më të mirë të fëmijës*”. “*Supozimi themelor i sistemit fillestar të të miturve dhe ai që vazhdon të mbizotërojë, ishte se të miturit ishin përgjithësisht më të përshtatshëm për rehabilitim sesa kriminelët e rritur*”. Politikat penale të drejtësisë për të mitur kanë njohur zhvillime pozitive, krahasuar me ato të 20 viteve më parë. Pas një rritjeje dramatike të krimit serioz të të miturve në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve

1990, legjislaturat në pothuajse çdo shtet, miratuan ligje për të mbajtur më shumë të dënuar të rinj të përgjegjshëm, përmes alternativave të dënimit për të rritur. Megjithatë, deri në vitin 2015, secili shtet vazhdon të rishqyrtojë politikat e tij dhe të rivendosë qasjet ndaj drejtësisë për të mitur, për të prodhuar përgjigje më efektive ndaj krimit të të rinjve dhe për të përmirësuar sistemet e përgjithshme të drejtësisë.

4.3 PËRGJEGJËSIA PENALE E TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

Referuar nenit 12 të Kodit Penal sanksionohet edhe moshja e përgjegjësisë penale në lidhje me kryerjen e krimit apo të një kundërvajtje penale. Konkretisht këtë nen specifikohet se:

“Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmëdhjetë vjeç.”

Të miturit për shkak të papjekurisë,¹³¹ aftësisë relative për të ushtruar të drejtat e tyre apo shkaqe të tjera që i bëjnë ata të cënueshëm dhe vulnerabël, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti. Mbrojtja duhet të sigurohet në të gjitha fazat e procesit penal dhe duhet të mbështetet te interesi më i lartë i të miturit dhe nevojat specifike të çdo fëmije me qëllim që tu përmbushen të drejtat në mënyrë të barabartë.

Sipas preambulës të Konventës mbi të drejtat e fëmijëve¹³², me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshja madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislativën të cilit ai i nënshtrohet¹³³. Një theks të veçantë kjo konventë vendos lidhur me detyrimin për Shtetet Palë¹³⁴ përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

A) Përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;

¹³¹ Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr.03, i vitit 2013.

¹³² Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

¹³³ Neni 1 i kësaj konvente.

¹³⁴ Shqipëria e ka miratuar këtë konventë më 28.02.1991.

B) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

Në këtë këndvështrim, në respektim edhe të konventës, shteti shqiptar si vend anëtar, në nenin 12 të kodit penal ka bërë një dallim për sa i përket moshës për përgjegjësi penale. Për sa më sipër duhet bërë dallimi ndërmjet një të mituri nën moshën katërbëdhjetë vjeçare dhe një të mituri në moshën katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeçare.

Madje ligjvënësi ka qenë i detajuar në Kodin Penal për të mitur ku në nenin 3 pika 11 të tij specifikohet se *“Moshë minimale e përgjegjësisë penale është moshë 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe moshë 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal.”*

Personi nën moshën 14 vjeçare, në prag përgjegjësie penale, nuk është i përgjegjshëm nga pikëpamja penale por nëse konsiderohet shoqërisht i rrezikshëm ndaj tij duhet të meren masa. Në ligjin Nr.18 të vitit 2017 *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”*¹³⁵ parashikohet marja e masave për¹³⁶ të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nën moshën për përgjegjësi penale¹³⁷ dhe mbikqyrjen e specializuar të tyre¹³⁸.

Qëllimi i këtij ligji lidhet me

a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimi të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

¹³⁵ Shpallur me dekret Nr.10060 datë 06.03.2017 të Presidentit të Republikës dhe njëkohësisht miratuar në datën 23.02.2017.

¹³⁶ Avokati i popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e popullit”* (të ndryshuar)

¹³⁷ *Strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rasti të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimit e tjera të nevojshme për riintegrimin e ti*

¹³⁸ *Masa e mbikqyrjes së specializuar për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes*

- c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;
- ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;
- e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.¹³⁹

Madje në nenin 3 të këtij ligji përcaktohet qartë se *“Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.”*

Në këtë ligj parashikohet edhe pragu i përgjegjësisë penale për të miturit nën katërmëbëdhjetë vjeç të cilët ndërmarin veprime shoqërisht të rrezikshme, konkretisht parashikohet masa e mbrojtjes për mbikqyrje të specializuar në mjedisin familjar apo masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në një përkujdesje alternative, që fokusohen më së shumti në një liri të mbikqyrur dhe integrimin në komunitet.

Ligji krijon një barrierë të veçantë mbrojtje për fëmijët në prag përgjegjësie penale duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe referimit të rasteve. Konkretisht strukturat e mbrojtjes së fëmijës¹⁴⁰ marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin shumëdisiplinor për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij, duke marrë në konsideratë:

¹³⁹ Shiko neni 2 i ligjit Nr.18/2017.

¹⁴⁰ Neni 65 i ligjit Nr.18 të vitit 2017.

- a) kushtet, të cilat lehtësuan përfshirjen e fëmijës në krim;
- b) nivelin e rrezikshmërisë shoqërore dhe veprën e kryer;
- c) mjedisin, në të cilin është rritur dhe ka jetuar fëmija;
- ç) rrezikun apo mundësinë që fëmija të kryejë një veprë tjetër penale;
- d) çdo faktor tjetër, i cili mund të ndihmojë për të kuptuar situatën e fëmijës.

Këto struktura mund të përshijnë në Planin Individual të Mbrojtjes edhe seanca këshillimi për prindërit e fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, të cilët nuk janë subjekt i një procedimi penal apo nuk janë dënuar penalisht për këtë gjë. Veprimtaria e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht është rregulluar me VKM Nr.314, datë 15.05.2019 për *“Organizimin, rregullimin dhe përcaktimin e rregullave specifike lidhur me strukturën dhe organikën e qendrës së parandalimit të krimeve të të miturve”*.¹⁴¹

Në kuadrin ligjor ekzistues¹⁴² parashikohen edhe masat e mbikqyrjes së specializuar për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale për fëmijën që dyshohet ose ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, zbatohet duke lejuar qëndrimin e fëmijës pranë familjes, me kusht që të mbikqyren aktivitetet e mëposhtme:

- a) shkuarja në shkollë në mënyrë të rregullt;
- b) pjesëmarrja në aktivitete të shërbimeve parashoqërore;
- c) ndjekja e një trajtimi mjekësor apo këshillimi psikologjik;
- ç) ndalimet për të shkuar apo frekuentuar vende të caktuara.

Në rast se është e pamundur që fëmija të lihet pranë familjes ose kur fëmija nuk përmbush kushtet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes, strukturat e mbrojtjes së fëmijës mund të propozojnë dhe të vendosin një nga masat e tjera të mbrojtjes, përfshirë edhe vendosjen e fëmijës te një nga të afërmit dhe duke i kërkuar fëmijës, në çdo rast, të respektojë kushtet e vendosura në Planin Individual të Mbrojtjes.

¹⁴¹ <https://drejtesia.gov.al/vkm/>

¹⁴² Neni 66 i ligjit Nr.18 të vitit 2017.

Nisur nga kuadri ligjor i mësipërm lind pyetja nëse kanë përgjegjësi institucionet arsimore dhe mësuesit lidhur me veprimet e ndërmara nga të miturit në prag të moshës katërbëdhjetë vjeçare?

Një nga parimet kyç kushtetues dhe me vlerë në të gjitha legjilacionet evropiane është parimi sipas së cilit *“përgjegjësia penale është individuale”*.¹⁴³

Nisur nga ky fakt është mëse e qartë se institucionet arsimore nuk mbartin përgjegjësi penale.

Lind pyetja a kanë përgjegjësi tjetër të çfarëdolloji krahas asaj penale?

Në Kushtetutën shqiptare, konkretisht në nenin 57 të kushtutës është parashikuar se *“Kushdo ka të drejtën për arsimim dhe se arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.”*

Ligji ka përcaktuar se nisur nga parimet kushtetuese arsimit i detyrueshëm është arsimit nëntëvjeçar, që përfshin fashën e moshës deri në katërbëdhjetë vjeç.¹⁴⁴

Kushtetuta si akt themelor mbi hierarkinë e normave ka përcaktuar qartazi se *“Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.”*¹⁴⁵

Pra nga një anë akti themelor shprehet mbi arsimin e detyrueshëm dhe nga ana tjetër mbi pavarësinë e institucioneve të arsimit të lartë duke mos garantuar këtë pavarësi për institucionet arsimore nëntëvjeçare.

Prej kësaj lind pyetja nëse këto institucione janë “imun” nga ligji?

Parë nga një këndvështrim krahasues jurisprudencë italiane¹⁴⁶ ka parashikuar se përgjegjësia e mësuesit dhe e prindërit konkurojnë më njëra – tjetrën, janë solidale dhe jo alternative të njëra tjetrës.

Vendim i mësipërm, i debatueshëm vjen në frymën e nenit 28 të kushtutës italiane sipas së cilit *“Të gjithë funksionarët edhe vartësit e shtetit dhe të enteve publike janë drejt për së drejti përgjegjës sipas ligjit penal, civil dhe administrativ për aktet që bien ndesh me këto ligje. Në këtë rast përgjegjësia është e shtetit dhe e enteve publike”*.

Në mbështetje dhe në dritën e kësaj dispozite kushtetuese vjen edhe neni 61 i ligjit Nr.312, të datës 11 korrik 1980 që ka të bëjë me përgjegjësinë që lidhet me dëmet e shkaktuara nga administrata e institucionit arsimor. Sipas kësaj dispozite *“përgjegjësia që lidhet me dëmet e shkaktuara administratës së institucionit arsimor të detyrueshëm publik dhe të gjithë*

¹⁴³ *Societa delinquere non potest.*

¹⁴⁴ *Parë si referencë se sipas mjekëve është moshë në të cilën mjekët mendojnë se aftësia intelektuale e trurit ka zhvillimin e duhur për të kuptuar veprimet e duhura dhe ato të gabuara.*

¹⁴⁵ *Neni 57 i Kushtetutës.*

¹⁴⁶ *Gjykata kushtetuese Italiane, sez.III, Nr.12501/2000*

institucioneve arsimore publike nga sjelljes e pahijshme të nxënësve, e bën përgjegjëse administratën për mosveprim në formën e fajit të rëndë apo dashjes". Gjithashtu vijon dispozita *"Administrata është përgjegjëse për dëmshpërbimin e të tretëve në rastin se dëmet janë shkaktuar nga nxënësit gjatë orarit të shkollës si rrjedhojë e mosveprimit të administratës shkollore"*.

Legjislacioni italian parashikon përgjegjësinë administrative dhe civile për mësuesit apo përgjegjësit e institucionit arsimor duke qenë se ka qenë mungesa e dilijencës së tyre që lidhet me mosmbikqyrjen e veprimtarisë së të miturve (në format e fajit të rëndë apo dashjes) që ka sjellë për pasojë shkaktimin e dëmeve.

Në këtë këndvështrim, legjislacioni italian është avangard duke konsideruar se krahas prindërit¹⁴⁷ dhe institucionet arsimore konsiderohen civilisht dhe administrativisht përgjegjës për veprimet e një të mituri në prag ose nën katërmbëdhjetë vjeç. Kjo për faktin se institucioni arsimor nëntë vjeçar është i detyrueshëm dhe se të miturit janë shtresa më vulnerabël e shoqërisë për shkak të aftësive konjitive dhe aftësive volitive të cinguar.

Pavarësisht dialektikës së zhvilluar të jursiprudencës italiane, Shqipëria po ndërmerr disa hapa që lidhen me zhvillimin e kuadrit ligjor dhe zbatimit të detyrimeve që lindin si rrjedhojë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara. Konkretisht me V.K.M Nr.635, datë 26.10.2018 në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 65, të Ligjit Nr.18/2017 *"Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave, ka vendosur lidhur me rregullimin e *"Veprimtarisë së strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer veprë penale"*.

Konkretisht vendimi rregullon veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës për trajtimin e fëmijës që është nën moshën e përgjegjësisë penale dhe që dyshohet apo ka kryer një veprë penale dhe parashikimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjitha autoritetet shtetërore, strukturat e mbrojtjes së fëmijës, institucionet publike apo private, organizatat jo-fitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo

¹⁴⁷ Të cilët mund të humbasin edhe përgjegjësinë prindërore mbi fëmijën.

ligjore të kryejnë referim, menaxhim, koordinim apo të ofrojnë një shërbim në kuadër të Ligjit Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

Në këtë vendim qartësohen edhe termat e mëposhtëm:

a) Fëmija i cili nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale është fëmija i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe fëmija që nuk ka mbushur 16 vjeç në rastet e kryerjes së një kundërvajtjeje penale.

b) Fëmija nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer një vepër penale, është fëmija, i cili nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe që identifikohet nga Strukturat e Policisë si i përfshirë në një aktivitet të paligjshëm dhe për të cilin nuk ka një vendim nga Prokuroria për mosfillimin e procedimit penal.

c) Fëmija nën moshën e përgjegjësisë penale në konflikt me ligjin, është fëmija për të cilin Prokurori ka marrë një vendim për mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 290, gërma “**b**” të Kodit Penal (“*Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit*”) për shkak se personi nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton se strukturat dhe mekanizmat e përfshira për mbrojtjen e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer vepër penale janë:

- a) Bashkia;
- b) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës në Bashki dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit;
- c) Policia;
- d) Prokuroria;
- e) Grupi teknik ndërsektorial.
- f) Autoritete apo shërbime të tjera në nivel lokal.

Duhet të kaloj një kohë e caktuar që të mund të arrijmë në konkluzione në lidhje me faktin se sa efektive janë këto organe në zbatim të detyrës së tyre të caktuar nga ligji.

4.4 PJEKURIA E TË MITURIT, AFTËSIA INTELEKTUALE DHE VOLITIVE QË LIDHEN ME PËRGJEGJËSINË PENALE

Sipas nenit 13 të Kodit Penal Shqiptar parashikohet se: *“Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore”*.

Nëse i bëjmë një analizë të detajuar dispozitës në të përcaktohen elementët kumulativë *“conditio sine qua non”* për përgjegjësi penale, që janë elementi intelektual dhe elementi volitiv, me pak fjalë është penalisht përgjegjës personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka aftësi për të kuptuar dhe aftësinë për të dëshiruar me produkt ardhjen e pasojave.

Aftësia konjitive (intelektuale) qëndron në aftësinë për të perceptuar drejt se sjellja sociale e ndërmarrë është apo jo shoqërisht e rrezikshme, aftësia për të kontrolluar impulset e veta dhe aftësia për t’u vetëpërcaktuar.

Për sa i përket të dhënave anagrafike ligjvënësi ka parashikuar duke marë parasysh tre mosha të ndryshme: Tetëmbëdhjetëvjeçarët, katërmëdhjetëvjeçarët dhe personat që qëndrojnë ndërmjet katërmëdhjetë vjeç dhe tetëmbëdhjetë vjeç.

Aftësia konjitive dhe momenti volitiv pavarësisht se nuk janë përcaktuar qartë nga ligjvënësi meren në konsideratë për përjashtimin e përgjegjësisë penale të një personi të rritur.¹⁴⁸

Një trajtim i diferencuar që nuk çon në përjashtimin e përgjegjësisë penale vihet re në pjesën e dytë të nenit 17 të kodit penal¹⁴⁹ që kanë të bëjnë me uljen e ekuilibrit ndërmjet aftësive volitive dhe konjitive që mund të jetë si pasojë e shurdhmemecërisë, intoksikimin nga substanca të ndryshme, dehja etj. Mosha për të cilën u fol më sipër është mosha mbi gjashtëmbëdhjetë vjeç (në rastin e krimeve).

Mosha e dytë (dhe jo më pak e rëndësishme) e mar në konsideratë nga ligjvënësi është mosha katërmëdhjetë vjeçare.

¹⁴⁸ Neni 17 i K. Penal *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose nevropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale.”*

¹⁴⁹ *“Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose nevropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit.”*

Ligjvënsi ka përcaktuar se “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç.*”¹⁵⁰

Parë nga një vështrim i gjithanshëm rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar mos ndëshkueshmëri absolute (duke përjashtuar nga përgjegjësia penale) personat nën moshën katërbëdhjetë vjeç duke qenë se këta të fundit nuk janë në gjendje të kuptojnë dhe të dëshirojnë ardhjen e pasojave. Ligji parashikon se në rastin e një të mituri nën moshën katërbëdhjetë vjeç i cili dyshohet se ka kryer apo ka kryer një krim duhet të meren masa që synojnë të neutralizojnë rrezikun duke qenë se kjo moshë nuk mund të procedohet penalisht por që gjithësesi mbetet shoqërisht e rrezikshme.

Mosha e tretë që meret në konsideratë nga ligjvënësi është mosha ndërmjet katërbëdhjetë vjeç dhe tetëmbëdhjetë vjeç, moshë e cila mbart detyrimin e përgjegjësisë penale.¹⁵¹ Duke qenë se bëhet fjalë për një moshë “*delikate*”, ligjvënësi ka parashikuar që këta të jenë subjekt i gjykatave për të mitur. Këta të fundit asistohen nga mjekë psikologë dhe psikiatër, ekspertë sociologë etj. Për këtë arsye për të miturit parashikohen institute speciale që diktojnë nevojat e tyre. Pikërisht për këtë arsye ligjvënsi ka përcaktuar se i mituri pavarësisht pozitës procedurale të tij duhet të asistohet gjithmonë nga një psikolog dhe raporti i vlerësimit individual duhet bërë nga një psikolog i ndryshëm nga personi që e asiston gjatë të gjitha fazave.

Mosha objekt studimi, pra të gjithë ata personat që nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale por kanë kryer një vepër penale meret parasysh nga ligjvënësi si shkak që lejon mosfillimin e procedimit penal. Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale në pikën 1, gërma b) *parashikon si shkak për mosfillimin e procedimit penal rastin kur personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.*

Në rastin konkret prokurori si organ procedues mer një vendimmarrje që lidhet me mosfillimin e procedimit penal por ka detyrimin që të referojnë menjëherë¹⁵² rastin tek punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në bashki ose në njësinë administrative ku ka vendbanimin fëmija, kur konstatojnë se fëmija i cili nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale është i përfshirë si autor apo bashkëpunëtor në një aktivitet të paligjshëm. Prokurori e referon rastin bashkë me vendimin për

¹⁵⁰ *Mosha për përgjegjësi penale, neni 12 i Kodit Penal.*

¹⁵¹ *Në varësi të veprës penale të kryer për sa kohë ligjvënësi bën dallimin ndërmjet krimeve dhe kundravajtjeve penale.*

¹⁵² *VKM Nr.635/2018 për “Veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer vepër penale”.*

mosfillimin e procedimit. Në vijim të qëllim edukues, për fëmijën nën moshën e përgjegjesisë penale, të cilët dyshohen apo janë në konflikt me ligjin, pas referimit nga prokurori dhe/ose punonjësi i policisë, ofrohet mbrojtja dhe trajtimi i përshtatshëm nga strukturat për mbrojtjen e fëmijës pranë bashkisë ose njësisë administrative ku ndodhet fëmija.

Ligji ngarkon punonjësën e mbrojtjes së fëmijës në bashki/ njësi administrative për çdo rast të referuar për fëmijën nën moshën e përgjegjesisë penale, i cili dyshohet apo është në konflikt me ligjin, hap dosjen përkatëse dhe plotëson atë sipas legjislacionit në fuqi. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës nën moshën e përgjegjesisë penale, harton Planin Individual të Mbrojtjes i cili përmban, sipas rastit masën e mbikqyrjes së specializuar, ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr të gjitha masat për të zbatuar një prej masave të mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj.¹⁵³

Referuar kriterit moshë nën përgjegjësi penale një ndër aktorët e rëndësishëm që ligji njih në këtë proces është Bashkia, e cila mbështet krijimin e programeve rehabilituese dhe integruese për fëmijët nën moshën e përgjegjesisë penale që dyshohet ose kanë kryer vepër penale.¹⁵⁴ Bashkia lehtëson bashkëpunimin dhe komunikimin me subjektet publike apo private lidhur me detyrimet që ky vendim i cakton punonjësve të mbrojtjes së fëmijës, për këtë kategori. Madje në frymë të ligjit Ministria e Drejtësisë ka lidhur memorandume bashkëpunimi me të gjitha bashkitë e vendit.¹⁵⁵

Problemi juridik i kriminalitetit të miturve risillet në vëmendje mbi të gjitha në ditët e sotme kur janë disa veprat penale të kryera nga të miturit.

Mikrokriminaliteti sikundër është vjedhja, kundërshtimi i punonjësve të rendit publik janë objekt i përditshëm i kronikave të “Zeza”. Studime të ndryshme janë përqëndruar në faktin se “Adoleshenca është rrugëtimi i të miturit për formimin e personalitetit të një të rrituri, dhe

¹⁵³ Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit e referimit të rasteve dhe grupin teknik ndërsektorial, vlerësojnë rastin duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit 18/2017. Në rastin kur vlerësohet se janë të pamjaftueshme seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës, ato mund të marrin masa për aftësim prindëror sipas përcaktimeve ligjore.

¹⁵⁴ Për zbatimin e këtij akti ngarkohen mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror dhe vendor sipas paragrafit 2, 3, 4, të nenit 34 të ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

¹⁵⁵ www.drejtësia.gov.al/drejtësia_per_te_miturit_mareveshje_bashkepunimi.

kryerja e një vepre penale nga ana e të miturit paraqet një manifestim të vuajtjes psikike, të maturuar gjatë jetës ndërmjet adoleshencës dhe pjekurisë.”¹⁵⁶

Vuajtja për të cilën u fol më sipër, në më të shumtët e rasteve gjenerohet gjatë adoleshencës është një thirrje “S.O.S” që i mituri i bën shoqërisë antikonformiste, me qëllim që kjo e fundit të zgjidhë problemet e të miturit.¹⁵⁷

Kuadri i tanishëm ligjor në vendin tonë që lidhet me kriminalitetin e të miturve ka për qëllim rehabilitimin dhe riedukimin e të miturve. Madje jo vetëm ligji, por edhe kushtetuta jonë ofron një mbrojtje të veçantë për të miturit sidomos në fushën penale.

Ndryshimet e fundit të kuadrit ligjor duke parashikuar dhe kodin e të miturve e kanë parashikuar masën e sigurimit “Arrest në burg” si një masë ekstreme e fundit që meret vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.¹⁵⁸

Si rezultat i kombinimit të normave kushtetuese dhe dispozitave të kodit të të miturve përcaktohen funksionet dhe limitet e *jus puniendi* në fushën e të miturve.

Në nivel ndërkombëtar Konventa për të drejtat e fëmijëve e miratuar nga O.K.B ratifikuar edhe nga shtetit shqiptar në datë 28.02.1992, parashikohet një mbrojtje e veçantë për të miturit e tillë sa të evitohet deri sa të jetë e mundur një përballje me sistemin e sanksioneve penale, pasi në rast të kundërt kjo do të linte gjurmë në jetën e një të mituri.¹⁵⁹

Situata e një të mituri në fazë zhvillimi dhe pjekurie kërkon një trajtim të veçantë nga ana e shoqërisë dhe ligjvënësit. Kjo është një arsye sepse ligjvënësit në vende të ndryshme kanë lidhur gjithnjë përgjegjësinë penale me faktorin moshë sepse nga eksperiencia formimi fizik dhe psikik i njeriut që në momentin e lindjes është pothuajse zero, është një fenomen progresiv që zhvillohet ngadalë deri sa njeriu arrin pjekurinë intelektuale.

¹⁵⁶ C. Neri, *Campo e fantasie transgenerazionali*, in *Riv. Psicoanalisi*, vol. XXXIX – N. 1, P. 43-82; R. Losso, *Psicoanalisi della famiglia, Persorsi teorico-clinici*, Franco Angeli, 2000.

¹⁵⁷ Winnicott, *Disa aspekte psikologjike të kriminalitetit të të miturve*, Cortina, 1986

¹⁵⁸ *Neni 15 i Kodit Penal për të Mitur*.

¹⁵⁹ D. Chicco, *Il discernimento dei fanciulli: il tema dell'imputabilità dei minori nella cultura giuridica contemporanea*, in *Famiglia e diritto*, 11, 2011, p.1043.

Rregulli i mosndëshkimit apo një trajtim më të butë për të miturit daton qysh nga “*ligji i XII tabelave*”¹⁶⁰ i cili bënte dallimin ndërmjet pjekurisë dhe jo pjekurisë duke parashikuar se të papjekurit do të “qortoheshin” vetëm nga ana e policisë.

Deri vonë në të drejtën romake kriteri i dallimit ishte kriteri i pubertetit, i cili ishte më i lehtë për t’u verifikuar në krahasim me kriterin e kohëve moderne që ka të bëjë me aftësinë volitive dhe konjitive.

Në të drejtën romake kriteri i pjekurisë seksuale ishte kriteri që bënte diferencën ndërmjet pjekurisë dhe papjekurisë dhe që korrespondonte me një zhvillim normal fizik dhe psikik.¹⁶¹

Në të drejtën klasike kategoritë ndaheshin në “*impuberes*”¹⁶² me nënkategori fëmijët¹⁶³, të cilët përjashtoheshin gjithnjë nga dënimi dhe “*admodum impubes*”¹⁶⁴ dhe “*pubertati proximus*”¹⁶⁵. Vetëm këta të fundit në të drejtën e justinianit konsideroheshin përgjegjës nëse gjendeshin në formën e dashjes apo të fajit.

Normativa moderne si avancim i normativës së hershme me dallimin se tashmë nuk meret në konsideratë zhvillimi fizik i subjektit por kapaciteti i tij intelektual duke iu nënshtruar ekspertimeve mjekësore herë pas here.¹⁶⁶

Me përgjegjësi penale kuptohet zbatimi i kërkesave të cilat lidhen së pari, me procedurën e marrjes në përgjegjësi penale të parashikuar nga legjislacioni procedural penal, së dyti, shqyrtimin dhe hetimin e çështjes gjatë gjykimit, së treti, marrjen e vendimit gjyqësor, së katërti, vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata, së pesti, kufizimet e tjera të përcaktuara në vendimin e gjykatës ndaj personit të marrë si i pandehur për kryerjen e veprës penale¹⁶⁷.

Masat edukuese parashikuar nga neni 46 KP¹⁶⁸ mund të jepen nga gjykata ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masat edukuese kanë të bëjnë me vendosjen e një të mituri në një institucion edukimi. Për shkak të situatës rezulton se kjo dispozitë nuk gjen zbatim në praktikë. Në këto kushte u pa si nevojë

¹⁶⁰ *E drejta romake (Patricët kundër plebenjve)*

¹⁶¹ I. Baviera, *Diritto minorile, II, Giuffrè, Milano 1976, p. 31.*

¹⁶² *Fëmijët deri në shtatë vjeç.*

¹⁶³ *Si person i cili edhe pse artikulon fjalë apo fjali nuk është koshient për rëndësinë e tyre.*

¹⁶⁴ *Personat nga shtatë vjeç deri në dhjetë vjeç e gjysëm.*

¹⁶⁵ *Të gjithë personat e moshës nga dhjetë vjeç e gjysëm deri në katërmëdhjetë vjeç.*

¹⁶⁶ M. Talamanca, *Istituzioni di diritto romano, Giuffrè, Milano, 1990, p. 156*

¹⁶⁷ 4 I. Elezi, S. Kaçupi., M. Haxhia., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009, Fq.87

¹⁶⁸ *Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer veprë penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.*

immediate krijimi i institucioneve që do të kishin për qëllim riedukimin e të miturve, pasi mungesa e tyre bën shumë herë që gjykata të mos ta aplikojë një dispozitë të tillë vetëm për shkakun se ky vendim nuk mund të ekzekutohet. Aktualisht Ministria e Drejtësisë dhe UNICEF-i në Tiranë po meren me burgun e Kavajës i cili konsiston në një burg të sigurisë së ulët por dhe për ekzekutimin e masave edukuese për të miturit që nuk kanë përgjegjësi penale. Sipas nenit 49 të Kodit Penal gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe rrethanat tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit pavarësisht nga rrethanat lehtësuese që përmenden në nenin 48 të Kodit Penal, por edhe këtu nuk renditet një e tillë si moshë.

Problemi i të drejtës së të miturve është rezultat i studimeve që datojnë nga shekulli i XII dhe që bëhet më e dukshme në shekullin XVI e XVII.¹⁶⁹

4.5 PËRGJEGJËSIA E TË MITURIT.

Nisur nga fakti se i mituri nuk ka arritur ende pjekurinë fizike dhe psikike për ta përfshirë si subjekt në të drejtë penale

Natyrshëm lind pyetja cili është kufiri i moshës ku një i mitur arrin pjekurinë intelektuale të tillë sa për tu konsideruar subjekt i ligjit?

Sipas legjislacionit të sotëm kufiri është moshë katërbëdhjetëvjeçare.

Shumë sisteme legjislative të huaja në fillim të viteve 900 konsideronin si kufi moshën 13, 14 dhe 15 vjeçare.¹⁷⁰

Moshë për përgjegjësi penale lidhet ngushtë me kriterin kronologjik, deri në moshën katërbëdhjetë vjeçare i mituri nuk mund të dënohet penalisht pasi konsiderohet apriori i papërgjegjshëm për shkak të moshës. Personi i cili gjendet ndërmjet moshës katërbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë vjeç është i përgjegjshëm penalisht vetëm nëse aftësia konjitive dhe aftësia intelektuale janë të tilla sa për tu marrë në konsideratë. Në mbështetje të këtij fakti ligjvënësi ka parashikuar nenin 41 të KPP *se në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të*

¹⁶⁹ L. Milani, *Devianza minorile, Vita e pensiero, Milano 1995, pp. 140 e 164.*

¹⁷⁰ *Si për shëmbull Kodi Penal Rus i 1960, ka konsideruar si moshë minimale moshën 17 vjeç, ndërsa Kodi Penal Polak i 1970 ka konsideruar si kufi moshë minimale moshën prej 18 vjeç, në të njëjtën mënyrë edhe Kodi Brazilian. Përfundim paraqet vetëm Kodi Penal i Republikës së San Marinos i vitit 1975 i cili konsideron si kufi minimal moshën dymbëdhjetë vjeçare. A. Ciannavei, fq. 145.*

besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. ... Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur.

Nisur nga këto parashikime ligjore lind pyetja nëse zgjedhja e ligjvënësit për të marë si referim moshën minimale prej katërmbëdhjetë vjeç është një referencë e saktë.

Për sa i përket aspektit social disa studjues mendojnë se zhvillimi i të miturve është më i herët në kohët e sotme dhe në këtë mënyrë është mëse e justifikueshme që të ulet moshë për përgjegjësi penale.

Disa studjues shprehen për një orientim të kundërt në mënyrë të tillë që të rritet moshë për përgjegjësi penale duke rritur “pragun”.¹⁷¹

Një debat i tillë ushqehet edhe nga të ashtuquajturat “*atake morale të panikut*” të mediave të cilat në vitet e fundit vënë në pah kronika të fokusuara në krime që kryhen nga ana e personave në prag moshë të përgjegjësisë penale. Kanë qenë pikërisht mediat të cilat i kanë bërë thirrje shoqërisë që të eliminojnë privilegjin e të miturve për të qenë të papërgjegjshëm penalisht për shkak të moshës. Media të ndryshme kërkojnë që të ulet kufiri i moshës që lidhet me përgjegjësinë penale në lidhje me kryerjen e krimeve.¹⁷²

4.6 I mituri katërmbëdhjetë vjeçar.

Kodi Penal në nenin 12 parashikon: “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.*”

Nga analiza juridike i dispozitës së mësipërme evidentohet një “*prezumim absolut*” i përgjegjësisë penale e cila ka për referencë moshën e subjektit dhe jo aftësinë konjitive apo aftësinë volitive të subjektit. Pra gjendemi përballë një situatë *iuris et de iure* duke qenë se gjykatësi kur konstaton moshën e të miturit të të pandehurit nuk mund të kundërvendosë

¹⁷¹ Gapulli-Grasso, *Infraquattordicenni: recluscenza criminale e prospettive di modificazione della normativa penale vigente*, in *Dir. fam. pers.*, 1993, fq. 747

¹⁷² *Kronikat e lajmeve në Top Channel, gazetare A. Hoxha.*

vullnetin e tij përballë vullnetit të ligjvënësit. Pra ligji është i qartë si referencë meret e dhëna anagrafike (mosha e të miturit).

Është mëse e qartë se ligjvënësi e ka përjashtuar të miturin nën moshën katërmbëdhjetë vjeçare nga përgjegjësia penale për shkak të parimit “*quod plerumque acidit*”, pasi është mëse e arsyeshme të mendosh që këta të mitur për shkak të moshës nuk gëzojnë¹⁷³ pjekurinë e duhur.¹⁷⁴ Por siç edhe nënvizon studiuesi Bettiol “*nëse ky limit është pak i lartë kjo justifikohet me faktin se i tillë është në jurisprudencën ndërkombëtare dhe atë të vendeve të zhvilluara*”

Për shkak se personaliteti i të miturit është në zhvillim e sipër, nëpërmjet këtij kufiri synohet të mos pengohet zhvillimi i rregullt i karakterit dhe personalitetit të të miturit. Pavarësisht rasteve praktike dhe kriminalitetit gjithnjë e në rritje të kryer nga të miturit që për shkak të moshës përjashtohen nga përgjegjësia penale, juridikisht konsiderohet një problem i tejkaluar.

Përjashtimi nga përgjegjësia penale nuk do të thotë se i mituri që konsiderohet shoqërisht i rrezikshëm duhet të lihet i pavëzhguar apo i lirë me çdo kriter. Sikundër u citua dhe më sipër ai nuk mund të ndiqet penalisht por konsiderohet shoqërisht i rrezikshëm dhe i “besohet” një sërë institucioneve si familja, shoqëria, bashkia etj që kanë për qëllim të kryejnë një rol patern por jo ndëshkues.

Që të aplikohen këto masa te të miturit duhet të verifikohet dhe jo të prezumohet rast pas rasti rrezikshmëria shoqërore. Prezumimi i pafajësisë parashikuar nga ligji është i pajetë për personat nën moshën për përgjegjësi penale, pra nuk mund të zbatohen ndaj tyre sanksione penale për shkak se nuk janë të përgjegjshëm nga pikëpamja e përgjegjësisë penale.

Në këtë këndvështrim organi procedues sa herë konstaton se personi i mitur është nën moshën për përgjegjësi penale procedon me vendim mosfillimi apo vendim pushimi (në varësi të fazës në të cilën ndodhet procedimi penal).

Neni 290 i K.Pr. Penale parashikon si shkak mosfillimi të procedimit penal: Procedimi penal nuk mund të fillojë kur: ...b) *personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;*

¹⁷³ Në më të shumtën e rasteve, prezumim

¹⁷⁴ A. Cadoppi - P. Veneziani, *Elementi di Diritto Penale, Pt. Gen., ed. IV, Milano, 2010, p. 357*

Ndërkohë që neni 328 i K.Pr. Penale parashikon si shkak pushimi të procedimit penal shkakun ç) kur personi nuk mund të meret i pandehur.

4.7 I MITURI NËN MOSHËN TETËMBËDHJETË VJEÇARE.

Sipas kodit të drejtësisë për të mitur “*I mitur në konflikt me ligjin*” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale”¹⁷⁵.

Për sa i përket të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeçare por ende nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare ligji parashikon se është përgjegjës penalisht vetëm nëse e ka kryer veprën penale me dashje me qëllim ardhjen e pasojës së dëshiruar. Si ta kuptojmë këtë shprehje?

Një pjesë e doktrinës shprehet se për të miturin i takon organit procedues të verifikojë dashjen tek i mituri dhe një fakt i tillë nuk duhet të prezumohet por të verifikohet rast pas rasti. Për faktin se bëhet fjalë për një moshë në të cilën subjektet arrijnë moshën e pjekurisë dhe të kërkuar nga legjislacioni penal në momente të ndryshme njëherëzi të shumë faktorëve që çojnë në pjekurinë psikike të subjektit. Përmendim këtu faktorët biologjik, faktorë fizik, social të cilat formësojnë individin dhe karakterin e tij. Pra sikundër u tha më sipër “barra e provës” i bie organit procedues dhe jo të miturit.

Lind pyetja çfarë ndodh nëse organi procedues nuk hulumton lidhur me aftësinë konjitive dhe intelektuale të të miturit? Çfarë sanksioni do të zbatohet në rastin konkret?

Në mungesë të një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese na vjen në ndihmë Gjykata Kushtetuese Italiane e cila ka folur lidhur me këtë fakt duke thënë se vendimi i dhënë është “*nul nga pikëpamja juridike*”.¹⁷⁶

Organit procedues i takon të provojë se një i mitur i moshës nën tetëmbëdhjetë vjeçare është i aftë të kuptoj dhe të dëshiroj ardhjen e pasojave. Për të dhënë një përgjigje të tillë duhet sqaruar koncepti “pjekuri”.

¹⁷⁵ Neni 3 pika 4 e ligjit Nr.37/2017.

¹⁷⁶ Cass. pen., sez. II, 8 maggio 1980, in Riv. pen., 1981, p. 510.

Koncepti “pjekuri” nga pikëpamja penale për të miturit ka të bëjë me faktin se aftësia intelektuale dhe aftësia konjitive e të miturit të jenë në nivelet e kërkuara nga ligji penal me qëllim që i mituri të konsiderohet përgjegjës penalisht. Pra konceptimi që i mituri të kontrollojë veprimet e tij me qëllim ardhjen e pasojave me konceptin e parashikuar nga neni 17 i Kodit Penal¹⁷⁷ si rrethanë përjashtuese është i ndryshëm. Pavarësisht se në të dyja rastet kërkohet aftësia për të kontrolluar veprimet të shoqëruara me pasojën kriminale, duke marrë në konsideratë moshën e të miturit aftësia e zhvillimit mendor të tij është shumë e ndryshme nga aftësia e zhvillimit mendor të personit të rritur. Pikërisht për këtë arsye aftësia intelektuale dhe konjitive e të miturit asociohet me konceptin e “pjekurisë” së tij. Ky term nuk adoptohet nga legjislati ynë në mënyrë specifike por është frut i interpretimit juridik. Pra doktrina juridike dhe jurisprudenca kanë rënë dakort se pjekuria nënkupton *“një zhvillim harmonik të personalitetit, zhvillim intelektual sipas moshës, kapaciteti për të vlerësuar arsyet që e kanë shtyrë për të kryer veprën penale, aftësia për të kuptuar vlerën morale të sjelljes, aftësia për të “peshuar” pasojat kriminale të veprimeve të veta, forcë karakteri, forcë për të kuptuar vlerën e normave morale, aftësi për të ndarë të mirën nga e keqja, një zhvillim normal sipas moshës së tyre, aftësi kritike për të gjykuar veprimet shoqërisht të rrezikshme, aftësia për të ndarë rregullat sociale nga to morale.”*¹⁷⁸

Gjithashtu për të qartësuar këtë koncept kanë dhënë një kontribut të madh literatura mjekësore dhe psikopedagogjike¹⁷⁹. Prej këtej rrjedh se koncepti “papjekuri” është i ndryshëm nga koncepti “turbullim psikik”. I mituri mund të jetë i papjekur por i shëndetshëm mendërisht.

Disa kohë më parë i vetmi që mund të verifikonte gjendjen mendore dhe aftësinë për të kontrolluar veprimet ishte mjeku. Kjo gjë bëhej për shkak se papjekurinë e lidhnin me kritere biologjike dhe organike siç janë vonesat mendore, papjekurinë psikomotorike për të cilat i mituri konsiderohej i papërgjegjshëm nëse nga ekspertiza psikiatrike apo nga analiza klinike të ndryshme siç është encefalograma, i mituri rezultonte mitoman, histerik, epileptik, paranojak, skizofren etj. duke pasur si referencë vetëm gjendjen mendore dhe pa marrë në konsideratë historinë dhe mënyrat e kryerjes së veprës penale.

¹⁷⁷ “Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose nevropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen veprë penale”

¹⁷⁸ G. Ponti, P. Gallina Fiorentini, cit. fq. 563- 564.

¹⁷⁹ T. Bandini – U. Gatti, Imputabilità e minore età, in Trattato di medicina legale e scienze affini, vol I, Milano, 1999, p. 667 ss

Dispozita e kodit penal për të mitur i referohet situatës kur një i mitur është klinikisht i shëndetshëm sepse sikundër u tha më sipër pamundësia për të dashur dhe për të kuptuar është e ndryshme nga prishja e ekuilibrit nevropsikik. Duke përdorur jo vetëm kriterin mjekësor por edhe sociologjik, psikologjik është më e lehtë të përjashtosh psh rastet e përgjegjesisë për të ashtuquajtura veprimet e “moshës” siç mund të jetë vjedhja e një fruti.

Ka dhe raste në të cilat i mituri edhe pse është gjendur korrekt nga pikëpamja organike dhe pa deformime të karakterit, nuk ka arritur atë shkallë të ndërgjegjes morale që ta bëjë të përgjegjshëm. Është rasti i një të mituri të rritur në një ambient të vështirë për shkak të problemeve në familje. Pra nuk mjaftojnë vetëm kriteret juridike por duhet të meren në konsideratë edhe kriteret sociologjike për të parë shkaqet e deviancës së të miturve në raport me ambientin në të cilin zhvillohet personaliteti i tyre.¹⁸⁰

Pra duhet pranuar se ekzistojnë nivele të ndryshme pjekurie, biologjike, intelektuale, afektive dhe sociale.¹⁸¹

Të ofrosh një panoramë të kriminalitetit të të miturve në Shqipëri nuk është diçka e lehtë që mund të bëhet thjeshtë në bazë të të dhënave statistikore por duke përmbledhur mund të thuhet se shkaqet e kriminalitetit të të miturve në Shqipëri përbëhen nga katër faktorë: familja, shoqëria, institucionet dhe mosha e adoleshencës (duke përfshirë këtu ndryshimet psiko-emocionale që karakterizojnë këtë moshë).

Për sa i përket faktorit të parë familjes, karakteristikë me sjellje devijante janë të miturit që vijnë nga familje me probleme sociale, me dhunë, divorce, familje me një prind etj., që çojnë jo detyrimisht në devijancë një të mitur.

¹⁸⁰ S.A. Ciannavei, cit, faq. 163

¹⁸¹ Për sa i përket të parës mjafton të marësh në konsideratë se sa e rëndësishme në nivelin psikologjik është zhvillimi harmonik i trupit se sa rregullime mund të shkaktohen si rezultat i defekteve trupore. Për sa i përket pjekurisë intelektuale i referohemi I.Q. (koeficienti i inteligjencës). Pjekuria efektive ka të bëjë me aftësinë e të miturit për të kontrolluar impluset dhe emocionet në raport me marrëdhëniet inter personale dhe për të marrë pjesë në ngjarjet e jetës. Së fundmi pjekuria sociale ka të bëjë me aftësinë e të miturit për të përshtatur me shoqërinë. U. Fornari, Psikiatria ligjore, Torino 1997, fq. 231.

Kapitulli V

Kwadri Ligjor, Ndëshkimi Penal në Shqipëri.

5.1. Koncepti i kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të të miturve në veçanti.

Shkenca që merret me studimin e krimit është kriminologjia, e cila e ka marrë emrin nga bashkimi i dy fjalëve në dy gjuhë të ndryshme: Crimen - krim (në latinisht) dhe Logos - Shkencë (në greqishten e vjetër). Kriminaliteti është përkufizuar në mënyra të ndryshme në varësi edhe të disiplinës që përfaqësojnë studiuesit e tij, si ligjore, sociale etj.

Në kontekstin sociologjik, disa autorë e përkufizojnë kriminalitetin si “*sjellje emocionalisht e çrregulluar*”; “*sjellje antisociale e vazhdueshme/e qëndrueshme*”, “*sjellje e adoleshentëve në një situatë zhgënjimi përtej çdo lloj kufiri*”; dhe për më pragmatistët si “*një sjellje që policia do ta konsideronte diviante në çdo lloj rrethane*”¹⁸².

Sociologu Emil Dyrkemi,¹⁸³ e ka përkufizuar kriminalitetin si pjesë përbërëse e të gjitha shoqërive. Për këtë arsye, grupi që qeveris shoqërinë, përcakton format e caktuara të sjelljes që i definojnë si të padëshirueshme dhe si të tilla të ndëshkueshme. Pra, kriminaliteti përbën të gjitha ato sjellje që çënojnë vlerat, normat dhe pritshmëritë e një shoqërie, duke variuar nga një shoqëri në tjetrën në bazë të vlerave që ato përfaqësojnë.

“*Sipas një përkufizimi, kriminaliteti paraqet grupin e të gjitha veprimeve që e rrezikojnë dhe/ose dëmtojnë vlerat themelore të njeriut (të mbrojtura me ligj). Ato vlera themelore mund të jenë individuale (jeta e njeriut, integriteti fizik apo trupor, liria, pasuria, siguria etj), apo kolektive - vlerat e përbashkëta (rregullimi shoqëror, siguria e shtetit / institucioni, sistemi ekonomik apo shoqëror i shtetit, etj)*”¹⁸⁴.

Shprehje formale e vlerave të forcës qeverisëse në një shoqëri janë ligjet, sipas të cilave, kriminaliteti në përgjithësi nënkupton veprat penale të sanksionuara në legjisllacionin penal.

¹⁸² *Kriminaliteti i te miturve ne shqiperi – Tafani.*

¹⁸³ *Emile Durkheim, sociolog francez, ka jetuar në periudhën 1858-1917 dhe njihet gjërësisht si themeluesi i shkollës sociologjike franceze.*

¹⁸⁴ <https://aab-edu.net/uploads/docs/librat/Kriminologjia%20-%20Alisabri%20%C5%A0ABANI%20&%20Muhamed%20BUDIMLI%C3%86.pdf>

Në literaturë dallohen dy forma kryesore të përkufizimit të kriminalitetit:

Së pari, përkufizimi “*juridik*” i kriminalitetit, i cili përfshin veprat penale dhe sjelljet tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji si të kundërligjshme dhe;

Së dyti, përkufizimi “*sociologjik*” i kriminalitetit, i cili përfshin sjelljet amorale dhe asociale që dëmtojnë shoqërinë.

Koncepti sociologjik është i lidhur ngushtë me konceptin juridik të kriminalitetit, pasi ndryshimi i vlerave dhe normave të një shoqërie ndikon drejtpërdrejtë në përcaktimin e sjelljeve të kundërligjshme. Për shembull, në Shqipëri gjatë regjimit komunist cënimi i lirisë së fjalës u ngrit deri në nivel kushtetues¹⁸⁵. Në nenin 55 të Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste, parashikohej shprehimisht se agjitacioni dhe propaganda kundër shtetit dënohej nga 3 deri në 10 vjet burgim dhe kryerja e kësaj vepre në kohë lufte ose kur kishte sjellë pasoja të rënda, ndëshkohej deri me vdekje. Aktualisht, në ligjin material penal nuk parashikohet si vepër penale “*agjitacioni dhe propaganda kundër shtetit*”, madje liria e fjalës është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara në fushën e të drejtave të njeriut¹⁸⁶.

Një formë e veçantë e kriminalitetit është kriminaliteti i të miturve. Në një kuptim të ngushtë ligjor, të miturit e përfshirë në sjellje kriminale janë analogët e kriminelëve të rritur¹⁸⁷. Kriminaliteti i të miturve në shoqëritë moderne, sipas statistikave, ka ardhur duke u rritur, duke u zhvilluar dhe evoluar, sidomos në vendet me zhvillim më të lartë shoqëror-ekonomik¹⁸⁸.

Sipas studimeve, të miturit e përfshirë në sjellje kriminale kanë shumë mundësi të vazhdojnë përfshirjen e tyre në vepra penale. Fëmijët në konflikt me ligjin janë 2 deri në 3 herë më shumë të rrezikuar për t’u përfshirë në vepra penale serioze, të dhunshme dhe kronike krahasuar me individët që përfshihen në vepra penale në mosha të rritura¹⁸⁹.

¹⁸⁵ Kushtetuta Popullore Socialiste e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në 28 Shkurt 1976, në nenin 55 të saj parashikonte: “Krijimi i çdo lloj organizate me karakter fashist, anti-demokratik, fetare dhe anti-socialist është e ndaluar. Aktivitet fashiste, anti-demokratike, fetare, luftë-nxitëse dhe anti-socialiste si dhe nxitja e urrejtjes kombëtare dhe racore”

¹⁸⁶ Konventa më e rëndësishme në këtë fushë është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), zbatimi i të cilës kontrollohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në nenin 10 të KEDNJ-së parashikohet se liria e shprehjes pa ndërhyrjen e autoriteteve publike është e garantuar.

¹⁸⁷ *Introduction to Criminal Justice*, Donald J. Newman, Patrick R. Anderson, New York, 1990, fq 569.

¹⁸⁸ *E drejta penale për të mitur*, 2005, Ismet Salihu

¹⁸⁹ <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/ojdp/186162.pdf> - *Child delinquency*, May 2003, faqe 1

Për këtë arsye, duke marrë në konsideratë faktorët që kanë të bëjnë me moshën, zhvillimin mendor, sociologjik e psikologjik të të miturit, është e nevojshme, që kriminaliteti i të miturve të trajtohet veçmas nga kriminaliteti i të rriturve. Evidentimi i faktorëve specifikë që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, trajtimi i veçantë i të miturve në ligjin penal material dhe procedural, ndikon në parandalimin e kriminalitetit të të miturve.

5.2. Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri.

Për të përcaktuar kriminalitetin e të miturve të Shqipëri, pra kryerjen e veprave penale nga personat 14-18 vjeç, i jemi referuar raporteve zyrtare të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit. Në përmbushje të detyrimeve Kushtetuese, Prokurori i Përgjithshëm ka raportuar çdo vit në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit. Është për tu theksuar fakti se në statistikat e marra nga raportet, nuk përfshihet shifra e “errët” e krimit¹⁹⁰.

Në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin (të miturit të marrë si persona nën hetim ose të pandehur), nga të dhënat statistikore rezulton ndër vite se:

- në vitin 2007 rezultojnë 580 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 34,57% më shumë se në vitin 2006¹⁹¹;
- në vitin 2008 rezultojnë 889 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 53,2% më shumë se në vitin 2007¹⁹²;
- në vitin 2009 rezultojnë 665 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 25,1% më pak se në vitin 2008¹⁹³;
- në vitin 2010 rezultojnë 870 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 30,8% më shumë se vitin paraardhës¹⁹⁴;
- në vitin 2011 rezultojnë 1015 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën një rritje prej 16,6% në krahasim me vitin 2010¹⁹⁵;
- në vitin 2012 rezultojnë 1310 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën një rritje prej 29 % në krahasim me vitin 2011¹⁹⁶,

¹⁹⁰ Shifra e “errët e krimit” është një përkufizim që përdoret për veprat penale të paraportuara dhe rrjedhimisht të panjohura për organet e zbatimit të ligjit.

¹⁹¹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2011, faqe 206.

¹⁹² Po aty.

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ Po aty.

¹⁹⁵ Po aty.

- në vitin 2013 rezultojnë 911 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën një ulje prej 30 % në krahasim me vitin 2012.¹⁹⁷
- në vitin 2014 rezultojnë 1013 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 11 % më shumë se në vitin 2013¹⁹⁸.
- në vitin 2015 rezultojnë 978 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën 3,5 % më pak se në vitin 2014¹⁹⁹;
- në vitin 2016 rezultojnë 753 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën një ulje prej 23 % krahasuar me një vit më parë²⁰⁰.
- në vitin 2017 rezultojnë 510 të pandehur të mitur të hetuar që përbën një ulje prej 32,3% krahasuar me një vit më parë²⁰¹.
- në vitin 2018 rezultojnë 481 të mitur në konflikt me ligjin²⁰².

Grafikisht, të dhënat për kriminalitetin e të miturve në Shqipëri, për vitet nga 2007-2018, do të paraqiteshin si më poshtë:

¹⁹⁶ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2012, faqe 221-222.

¹⁹⁷ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2013, faqe 201.


¹⁹⁸ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2014, faqe 227-228.

¹⁹⁹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2015, faqe 256.

²⁰⁰ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2016, faqe 234.

²⁰¹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2017, faqe 239.

²⁰² Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2018, faqe 259.



Nëse do të krahasojmë të dhënat statistikore për vitet që kemi marrë në studim, nga viti 2007 deri në vitin 2012 do të vëmë re një tendencë rritje të ndjeshme të numrit të të miturve të përfshirë në aktivitete kriminale. Nga viti 2013 deri në vitin 2018, konstatojmë një tendencë ulje të numrit të të miturve të moshës 14 deri 18 vjeç, të përfshirë në një hetim penal.

5.3. Specifikat e kriminalitetit të të miturve në konflikt me ligjin²⁰³.

Kriminaliteti i të miturve është pjesë e kriminalitetit të shoqërisë. Studimi i specifikave të delikuencës të të miturit është i domosdoshëm për të përcaktuar faktorët e riskut si dhe profilin e individëve që rrezikohen të përshihen në sjellje penale. Të dyja këto kritere janë mjaft të rëndësishëm në përpilimin e politikave penale efektive në parandalimin e kriminalitetit.

Në vitin 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kryer një studim²⁰⁴ që analizonte faktorët e riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve në konflikt me ligjin. Në punim janë prezantuar profilet e të miturve në Institucionet e Ekzekutimit të Vuajtjes së Dënimit, duke

²⁰³ Të miturit në konflikt me ligjin-analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve - Ani Beqo, Blerta Doçi.

²⁰⁴ Ani Beqo, Blerta Doçi. Të miturit në konflikt me ligjin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, 2015, Tiranë.

përdorur si metodologji përpunimin dhe analizimin e statistikave e të dhënave të tjera zyrtare si dhe intervistat e kryera me të miturit në konflikt me ligjin, të cilët kanë qënë në paraburgim ose të dënuar të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat.

Të miturit janë dënuar për vepra dhe grup vepra penale të ndryshme. Konkretisht, vepra penale kundër personit (vrasje e plagosje, krime seksuale), vepra penale kundër pasurisë (vjedhje), vepra penale kundër rendit dhe sigurisë (armëmbajtje pa leje, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor), vepra penale në fushën e narkotikëve (prodhim dhe tregtim lëndësh narkotike) etj. Nga studimet paraardhëse, evidencat ekzistuese si dhe të dhënat zyrtare, rezulton se kriminaliteti te të miturit në vendin tonë paraqet këto karakteristika:

- ***Në përgjithësi të miturit e akuzuar, apo të dënuar për kryerjen e veprave penale janë pak të arsimuar, apo të kualifikuar profesionalisht.***
- ***Pjesa më e madhe e të miturve janë akuzuar apo dënuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes në forma të ndryshme.***

Nga të dhënat statistikore, vihet re që vepra penale që konsumohet më tepër nga të miturit në vitet 2005-2015 është vjedhja.

Për periudhën 2005-2015, “vjedhja” (e thjeshtë), (neni 134 paragrafi i parë i Kodit Penal), janë dënuar 1118 të mitur. Ndërsa për veprën penale “vjedhja në bashkëpunim”, e cila përkon me nenin 134, paragrafi i dytë, janë dënuar gjithsej 2532 të mitur²⁰⁵. Dënimet e të miturve për veprën penale të “vjedhjes” sipas paragrafit të parë, shënojnë numrin më të lartë në vitin 2011 me 147 të mitur të dënuar. Numri më i lartë i të dënuarve të mitur për veprën penale të “vjedhjes” e kryer në bashkëpunim, sipas paragrafit të dytë të nenit 134, paraqitet në vitin 2012 me 454 të tillë.

Nga të dhënat e paraqitura nga organi i akuzës, gjatë vitit 2014²⁰⁶ janë hetuar dhe janë dërguar për gjykim për veprën penale të “vjedhjes” 437 të mitur. E shprehur në përqindje kjo vepër penale është kryer nga 43 % e të pandehurve të mitur²⁰⁷.

²⁰⁵ Të dhënat janë marrë nga Vjetarët Statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë.

²⁰⁶ Në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit për vitin 2014, janë paraqitur të dhëna të detajuara për të gjitha grupet veprat penale të kryera nga të miturit. Nga statistikat rezulton se një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 21 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”. Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton

Në vitin 2015²⁰⁸, vepra penale e kryer më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç është “vjedhja” e pasurisë. Të pandehurit e mitur që kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, përbëjnë 46 % e të pandehurve në total. Vjedhja e pasurisë e në vitin 2015 rezulton me rritje prej 4 %, në krahasim me vitin paraardhës²⁰⁹.

Në vitin 2016²¹⁰, vjedhja e pasurisë përbën grup veprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç. Sipas statistikave rezulton se kjo veprë penale është kryer nga 44 % e të pandehurve të mitur. Megjithatë në vitin 2016 numri i të miturve të hetuar për këto grup vepra rezulton me ulje prej 2,38 %²¹¹.

Në vitin 2017²¹², paraqitet i njëjti përfundim, ku vepra penale e kryer në përqindje më të lartë është ajo e vjedhjes së pasurisë, e cila është kryer nga 44% e të pandehurve të mitur. Në këtë vit, numri i të miturve të hetuar për këto grup vepra rezulton me ulje prej 24%²¹³.

Në vitin 2018²¹⁴, rezulton se vepra penale e kryer më së shumti është përsëri vjedhja e pasurisë, konkretisht e kryer nga 39 % e të pandehurve të mitur. Të dhënat tregojnë se 96 % e të miturve meshkuj dhe 4 % janë femra²¹⁵.

se 12 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” janë regjistruar 4,8 % e të pandehurve të mitur. Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” janë regjistruar 2,6 % e të pandehurve të mitur. Për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” janë regjistruar 2,4 % e të pandehurve të mitur. Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

²⁰⁷ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2014.

²⁰⁸ Sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit, një veprë tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 24 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”. Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 10 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur. Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur. Për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” janë regjistruar 1 % e të pandehurve të mitur. Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

²⁰⁹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2014.

²¹⁰ Sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit, për vitin 2016. Një veprë tjetër penale, për të cilën janë regjistruar 22 % e të pandehurve të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”. Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 11 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprat penale të parashikuara nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe neni 279 i Kodit Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” janë regjistruar 5 % e të pandehurve të mitur.

²¹¹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2016.

²¹² Sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit, për veprën penale të “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt” janë hetuar 21% e të pandehurve të mitur. Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 15% e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprat penale lidhur me narkotikët rezultojnë 9% e të pandehurve të mitur. Për veprat penale të parashikuara nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe neni 279 i Kodit Penal, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” janë hetuar 2% e të pandehurve të mitur.

²¹³ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2017.

- Në vitet në vazhdim është rritur numri i të miturve të përfshirë në vepra penale që kanë të bëjnë me prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike.
- Të miturit në konflikt me ligjin kanë disa karakteristika të përbashkëta si, mohim apo mosbesim ndaj autoriteteve, vetëkontroll i pakët, stil konjitiv impulsiv, dhe mungesë aftësie në menaxhimin e konflikteve.
- Përgjithësisht të miturit në konflikt me ligjin vijnë nga familje me problematika të mprehta socio-ekonomike.
- Një pjesë e konsiderueshme e të miturve në konflikt me ligjin vijnë nga familje që janë zhvendosur nga zona rurale në zona urbane/suburbane dhe që kanë pasur vështirësi për t'u integruar ekonomikisht dhe kulturallisht.
- Të miturit për periudhën e studiuar rezultojnë të jenë të gjithë meshkuj²¹⁶.

Ky fakt, tregon se meshkujt ka më shumë gjasa të përfshihen në kryerjen e veprave penale. Një rezultat i tillë mund të vijë si pasojë e disa faktorëve siç janë, mungesa e supervizionit prindëror, terreni më favorizues për t'u përfshirë në sjellje të tilla, personalitet më agresiv, apo tendencë më e madhe për të eksperimentuar sjellje me rrezikshmëri.

- Një pjesë e të miturve që kanë kryer vepra penale, kthehen në recidivistë.

Fakti që vepra penale e kryer më së shumti është vjedhja e pasurisë, është në përputhje me faktorë të tjerë si gjendja e vështirë ekonomike, mungesa e arsimimit apo formimit profesional. Rrethana që një pjesë e të miturve kthehen në recidivistë pavarësisht nga puna rehabilituese e kryer në institucionet penitenciare, është tregues i qëndrueshmërisë së faktorëve të riskut "në mjedisin natyror" si dhe i mungesës apo pamjaftueshmërisë së strukturave që punojnë për integrimin e tyre pas lirit. Përsa i përket faktorëve të riskut që ndikojnë në përfshirjen e të miturve në akte kriminale, rezultojnë se roli i faktorëve individualë, familjarë, apo komunitarë është i ndjeshëm në sjelljen e të miturve, ashtu siç referohet dhe nga studime të mëparshme të fushës, të cilat janë sjellë përmes literaturës së përzgjedhur.

²¹⁴Sipas raportit të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit, janë regjistruar 27 % e të pandehurve të mitur për veprën penale të "Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt". Lidhur me veprat penale kundër personit, rezultojnë se rreth 15 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Për veprat penale lidhur me narkotikët rezultojnë 4 % e të pandehurve të mitur. Për veprat penale lidhur me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve janë regjistruar 3,5 % e të pandehurve të mitur.

²¹⁵Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2018.

²¹⁶Kjo periudhë i referohet të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vitet 2007-2015.

Të gjithë këta faktorë bëjnë që të miturit të mos kenë zgjedhje dhe të mundohen për të siguruar burime mbijetese në mënyrë të jashtëligjshme. Nga ana tjetër vihet re se migrimi në mënyrë të çorganizuar dhe problemet kulturore dhe ekonomike si pasojë e tij kanë krijuar një mjedis jostabël për të miturit, që reflektohet në rritjen e kriminalitetit për këtë kategori.

5.4. Kuadri ligjor i procesit penal të të miturit në konflikt me ligjin.

Pas viteve 1990, vendi ynë ka pasur një qasje tjetër për respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, pjesë e të cilit kanë qenë edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Të miturit në konflikt me ligjin përbëjnë një kategori vulnerabël në shoqëri dhe për këtë shkak sistemi ligjor duhet ti ofroj procedura ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore në përmbushjen e të drejtave të tyre. Më konkretisht po zërthehen më poshtë:

5.4.1 Standardet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur dhe raporti me të drejtën kombëtare.

Në fushën e drejtësisë penale për të miturit ekzistojnë standarde ndërkombëtare për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Këto rregulla përcaktojnë standardet minimum që duhet të plotësojnë legjislacionet penale, që në fazën e fillimit të hetimit penal kundër personave që konsiderohen të mitur sipas legjislacionit të këtyre vendeve, duke ofruar një tërësi udhëzimesh për reformimin e sistemeve të procedimit penal në këtë fushë. Konkretisht në aspektin ndërkombëtar janë:

“Rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara lidhur me administrimin e proceseve gjyqësore me të pandehur në moshë të mitur”, (Rregullat e Pekinit)²¹⁷;

Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara “Për parandalimin e krimit të kryer nga të mitur” (Rregullat e Riadit)²¹⁸.

Rregullat e Kombeve të Bashkuara “Për mbrojtjen e të miturve që iu është privuar liria” (Rregullat Havana).²¹⁹

²¹⁷ Rezoluta 40/33, datë 29 Nëntor 1985 e Asamblesë së Përgjithshme, available at: <https://www.refworld.org/docid/3b00f2203c.html> [accessed 4 September 2019]

²¹⁸ miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën Nr.45/112, datë 17.12.1990.

Udhëzuesit “Për veprimet me fëmijët në sistemin e drejtësisë penale”.²²⁰

Në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare, vendi ynë ka ratifikuar disa nga konventat ndërkombëtare në këtë fushë.

Në 28 shkurt të vitit 1992, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e OKB-së, “Për të Drejtat e Fëmijëve”²²¹ e cila parashikon rregulla specifike për hetimin, gjykimin dhe dënimin e të pandehurve të mitur. Me ligjin Nr.86/2013²²², është ratifikuar edhe Protokollin i 3-të opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i cili është një mekanizëm ndërkombëtar ankesash ndaj shkeljeve të Konventës. Nëpërmjet këtij protokollin fëmijëve dhe përfaqësuesve të tyre u jepet aksesin të paraqesin ankesat e tyre individualisht pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (të OKB- së), kur u janë shkelur të drejtat e njohura nga Konventa dhe kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme.

Parimet themelore që duhet të udhëheqin interpretimin e neneve të Konventës “Mbi të Drejtat e Fëmijës” janë katër:

Parimi i mos-diskriminimit²²³. Fëmijët duhet të mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit apo ndëshkimit për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual, etnisë, etj. Në praktikë varfëria është konsideruar si një shkak i rëndomtë i diskriminimit të fëmijëve. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka theksuar se zbatimi i këtij parimi nuk duhet të varet nga kufizimet buxhetore²²⁴.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës²²⁵. Në të gjitha vendimmarrjet si ato administrative, ligjore apo dhe hetimore-gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë me fëmijët, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë prioritar, jo vetëm në legjislacion, por edhe në veprimtarinë praktike. Nëse lind një konflikt me ligje të ndryshme kombëtare, ky parim duhet përdorur si udhërrëfyes për interpretimin.

²¹⁹ miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën Nr.45/113, datë 14.12.1990

²²⁰ Rezoluta 1997/30 e Këshillit Ekonomik dhe Social.

²²¹ Konventa e të drejtave të fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e okb më 20.11.1989.

²²² Ligji Nr.86/2013 “Për ratifikimin e Protokollit të 3 opsional të KDF-së, “Për procedurën e komunikimit”.

²²³ Neni 2 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

²²⁴ Shkelësit e Mitur të ligjit dhe konventa e fëmijëve, Qendra për Zhvillim, Stokolm, faqe 13.

²²⁵ Neni 3 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit²²⁶. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm shëndetin fizik të fëmijës por edhe të drejtën e tij për t'u zhvilluar moralisht, mendërisht dhe në shoqëri. Në çdo shoqëri demokratike kjo e drejtë respektohet që me konceptimin e fëmijës në barkun e nënës, daljen në jetë të tij, mbrojtjen dhe garantimin e jetës dhe mbijetesës në fëmijëri deri sa i mituri të fitoj zotësinë për të vepruar i lirë dhe i pavarur nga familja e tij. Një vend të rëndësishëm në këtë parim zë implementimi i ligjeve që rregullojnë shtatzaninë e sigurtë, mbrojtjen e përkrahjen nga shteti të fëmijëve e nënave të tyre nëpërmjet programeve sociale, shëndetësore, arsimore dhe kulturore.

E drejta për respektimin e mendimit të fëmijës²²⁷. Çdo fëmijë që është në gjendje të shprehë mendimet e tij, duhet të dëgjohet. Organet vendimmarrëse duhet të përshtaten që të miturit të marrin pjesë në to. Komiteti ka vendosur një minimum kërkesash për përmbushjen efektive të kësaj të drejte.²²⁸

Konkretisht: - E drejta e informimit; - Ndihma e nevojshme ligjore; - Aksesimi për të patur përkthyes kur fëmija nuk e kupton gjuhën e përdorur; - Respektimi i jetës private të të miturit në të gjitha fazat e procedimit gjyqësor; - I mituri ka të drejtë të marrë pjesë me vullnet të lirë në fazat e procesit penal dhe nuk duhet të detyrohet të dëshmoj²²⁹.

Garancitë që u njihen të miturve në konflikt me ligjin në “Konventën për të Drejtat e Fëmijëve”, bëjnë pjesë në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, e si të tilla për përmbushjen e tyre duhet të ndërmerren veprime aktive nga ana e shteteve.

Detyrimet që duhet të përmbushi Shteti Kontraktues për të siguruar mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave, janë pozitive, pra duhen ndërmarrë masa të përshtshme për të mundësuar gëzimin efektiv të tyre.

Për të monitoruar pajtueshmërinë e legjislacioneve të shteteve palë me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, është krijuar Komiteti Për të Drejtat e Fëmijëve. Vendet që kanë ratifikuar Konventën kanë detyrimin të dorëzojnë pranë këtij Komiteti, raporte ku shpjegohen masat që

²²⁶ Neni 6 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës

²²⁷ Neni 12 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës

²²⁸ Këto kërkesa janë përpiluar duke iu referuar parashikimeve të neneve 12, 37, 40 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

²²⁹ Shkelësit e Mitur të ligjit dhe konventa e fëmijëve, Qendra për Zhvillim, Stokolm, fq. 16.

janë marrë për zbatimin e Konventës. Raporti i parë paraqitet dy vjet pas ratifikimit, dhe në vijim raportet periodikë dërgohen çdo pesë vjet.

Pas ratifikimit të Konventës Për të Drejtat e Fëmijëve, të OKB-së, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare, shteti ynë ka dorëzuar raporte periodikë pranë Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve. Komiteti, pasi ka marë në konsideratë raportin e dytë dhe të katërt periodik të Shqipërisë²³⁰, ka vlerësuar se legjislacioni shqiptar nuk i plotëson disa nga standardet minimum të përcaktuara në Konventë, duke hartuar dhe rekomandimet përkatëse²³¹.

Komiteti i rekomandon shtetit Shqiptar që të sjellë sistemin e drejtësisë për minorenët në të njëjtën linjë me Konventën (dhe në mënyrë të veçantë me nenet 37, 39 dhe 40) dhe me standarde të tjera të rëndësishme, përfshirë Rregullat Minimum Standard për Administrimin e Sistemit të Drejtësisë për Minorenët (rregullat e Pekinit), Udhëzimet për Parandalimin e Delinkuencës Minorene (udhëzimet e Riad-it) e Udhëzimet e Vienës për Veprimet me Fëmijët.

Në kuadrin ndërkombëtar, në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë ratifikuar disa Konventa si:

-Konventa "Për të drejtat e fëmijës"(UNCRC) e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (miratuar në 20 nëntor 1989), Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në 27.02.1992.

- "Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues" aderuar me ligjin Nr.7727, datë 30.06.1993.

- "Konventa ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor" miratuar me ligjin Nr.7768, datë 09.11.1993.

-"Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët", ratifikuar nga ligji Nr.7833, datë 22.06.1994.

²³⁰ Raportet (CRC/C/ALB/2-4) në mbledhjen e 1738-të dhe 1739-të (CRC/C/SR.1738 dhe CRC/C/SR.1739), mbajtur në 25 Shtator 2012.

²³¹ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Countries.aspx?CountryCode=ALB&Lang=EN

-Konventa evropiane “Për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues”, dhe dy protokollet shtesë të saj, aderuar me ligjin Nr.8135, datë 31.07.1996.

-“Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, dhe protokollet shtesë të saj, miratuar me ligjin Nr.8137, datë 31.07.1996.

-“Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, ratifikuar me ligjin Nr.8624, datë 15.06.2000.

-Konventa 182 e Organizatës Botërore të Punës (ILO)“Për format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe rekomandimi Nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, ratifikuar me Ligjin Nr.8774, datë 23.04.2001.

-“Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokollet shtesë të saj, “Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve” nënshkruar në Palermo, Dhjetor 2001. Ratifikuar me ligjin Nr.8920, datë 11.07.2002.

-Konventa e Evropës “Për marrëdhëniet me fëmijët”²³²,

-Konventa e Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me Ligjin Nr.10071, datë 09.02.2009.

-Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” ratifikuar me ligjin Nr.10425, datë 02.06.2011.

-Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”²³³.

²³² Ratifikuar me ligjin Nr.9359 të vitit 2005.

²³³ Ratifikuar me ligjin Nr.104 të vitit 2012.

-Protokolli i 3-të opsional i Konventës për të drejtat e fëmijës, “Për procedurën e komunikimit”, ratifikuar nga Ligji Nr.86, datë 25.02.2013.

Në funksion të përmbushjes së këtyre detyrimeve, e drejta e brendshme ka pësuar ndryshime duke u përmirësuar. Megjithatë, deri vitet e fundit legjislacioni shqiptar është vlerësuar se nuk plotëson standardet minimale të drejtësisë penale për të mitur. Në Progres Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, është rekomanduar ndër të tjera se: *“- Shqipëria duhet të përmirësojë mekanizmat institucional për mbrojtjen e fëmijëve; dhe në veçanti të përmirësojë legjislacionin ekzistues për drejtësinë e të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare”*²³⁴.

Pas vitit 2016, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin është konsideruar, si një nga prioritetet e shtetit shqiptar, ku në vitin 2017 vërehen ndryshime të rëndësishme në drejtësinë penale për të mitur. Reformimi i sistemit të drejtësisë ka pasur si qëllim realizimin e mbrojtjes efektive procedurale të të miturit dhe forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese ²³⁵.

Ligji *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*²³⁶ ka përcaktuar të drejtat, mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë si dhe ofrimin e përkujdesjes së posaçme për fëmijët. Në të është parashikuar ngritja e mekanizmave dhe autoriteteve institucionale në nivel qendror dhe vendor, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe promovimin e këtyre të drejtave.

De jure Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur²³⁷ (në vijim Kodi) ka realizuar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të miturit²³⁸. Ky ligj ka si *“qëllim të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur që është në përputhje me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera të detyrueshme ndërkombëtare, që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit”*²³⁹. Nëpërmjet tij, është përafëruar

²³⁴ Progres Raporti i Komision Evropian për Shqipërinë 2016, kapitulli 23, faqe 57.

²³⁵ Vkm 541, datë 19.09.2018 “Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të mitur dhe të planit të veprimit 2018-2021.

²³⁶ Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, miratuar më datë 23.02.2017.

²³⁷ Progres Raporti i Komision Evropian për Shqipërinë 2018, kapitulli 24.

²³⁸ I miratuar me ligjin Nr.37, datë 30.03.2017, ka hyrë në fuqi më 01.01.2018.

²³⁹ Neni 2 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

legjislacioni shqiptar me standardet dhe rregullat për drejtësinë për të mitur në nivelin e OKB-së, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian²⁴⁰.

5.4.2. E drejta e brendshme dhe autoritetet institucionale në fushën e drejtësisë penale për të mitur.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregulla të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç.

Kodi është një korpus normash materiale dhe procedurale penale, pasi përmban të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me të miturin në Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

Megjithatë, realizimi i standardeve ndërkombëtare duhet të realizohet edhe *de facto*, ku duhet mbajtur në konsideratë se shumë nga dispozitat e Kodit janë blanketë dhe zbatimimi i tyre do të varet nga aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve përgjegjëse. Vlen të theksohet se, për garantimin me efektivitet të të drejtave të miturve, kërkohet jo vetëm plotësimi i kuadrit ligjor por, edhe ai institucional, ku rëndësi të posaçme do të marrë zbatimimi dhe monitorimi i mekanizmave për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Ministri i Drejtësisë i ka propozuar Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit ka miratuar VKM-të e mëposhtme:

VKM Nr.207, datë 10.4.2019 “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”;

VKM Nr.233, datë 17.4.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta, lidhur me funksionimin e mjedisve dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit dhe të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”;

²⁴⁰ Kodi ka përafuar legjislacionin shqiptar me direktivën 2011/93/BE datë 13.12.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.335, datë 17.12. 2011.

VKM Nr.148, datë 20.03.2019 “Për procedurën që zbaton Shërbimi i Provës në rast të mos përbushjes të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale”;

VKM Nr.314, datë 15.05.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”;

VKM Nr.149, datë 20.03.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit dhe aksesimit, të dhënat parësore dhe dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”;

VKM Nr.541, datë 19.9.2018 “Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit 2018–2021”.

Ndërkohë janë në proces edhe dy projekt vendime të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

Projektvendimi: “Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit, të funksionimit të shërbimit të specializuar, të programeve dhe mënyrës së financimit të tyre, për të miturit në konflikt me ligjin”;

Projektvendimi: “Për disa ndryshime në VKM 437/2015, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve ligjore Ministri i Drejtësisë ka finalizuar paketën e projekt urdhrave dhe konkretisht:

Urdhëri i përbashkët Nr.3348/1, datë 18.04.2018 i Ministrit të Drejtësisë me Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për rregullimin e procesit arsimor në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur”.

Urdhëri Nr.4950, datë 02.05.2018 “Për përcaktimin e formës së rregjistrimit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, “Paralajmërim me gojë”;

Urdhëri Nr.4951, datë 02.05.2018 “Për miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, “Paralajmërim me shkrim”;

Urdhëri Nr.7639, datë 05.07.2018 “Për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”;

Urdhëri Nr.7640, datë 05.07.2018 “Për përcaktimin e formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirim me kusht të të miturit të dënuar”;

Urdhëri Nr.7641, datë 05.07.2018 “Për përcaktimin e elementëve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin”;

Urdhëri Nr.368, datë 15.07.2019 “Për miratimin e formatit të raportit për mospërbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin”;

Urdhëri Nr.367, datë 15.07.2019 “Për miratimin e formatit të planit individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin;

Në lidhje me **Sistemin e Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur**, krijimi i të cilit është detyrim ligjor që rrjedh nga neni 136 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në zbatim të tij është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave përkatës²⁴¹. Në zbatim të detyrimeve ligjore Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit është në proces për ngritjen e Sistemit të Integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Sistemi i Integruar i të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur është një sistem unik digjital, që gjeneron tregues bazë në mënyrë sintetike, për:

“a) gjendjen e kriminalitetit për të miturit;

b) numrin e përsëritësve nga grup-moshat e mitura;

c) shkallën e riintegritimit apo rehabilitimit të të miturve pas kryerjes së dënimit me burgim ose në rastet kur nuk janë dënuar me burg;

ç) numrin e të miturve në konflikt me ligjin të proceduar në gjendje lirë, të arrestuar, të ndaluar;

d) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të trajtuar me procedurën e shmangies nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative;

dh) numrin e të miturve në konflikt me ligjin, të gjykuar e të dënuar;

e) llojin e veprave penale të kryera nga të mitur;

²⁴¹ VKM Nr.149, datë 20.3.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit dhe aksesimit, të dhënat parësore dhe dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”.

ë) numrin e viktimave të mitura dhe llojin e veprave penale të kryera ndaj tyre; si dhe

f) të dhëna të tjera që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin”.²⁴²

Unifikimi dhe kompjuterizimi i të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur, ka si qëllim krijimin e një baze statistikore²⁴³. Të dhënat e sakta statistikore janë të domosdoshme për realizimin e politikave penale të qeverisë në lidhje me drejtësinë penale për të mitur, duke u penguar hartimi i strategjive konkrete dhe të detajuara për përmirësimin e shërbimeve të caktuara. Asnjë organ apo institucion nuk mund të kryejë studime efektive mbi gjendjen e kriminalitetit dhe masat që duhen marrë nga institucionet e drejtësisë, në komunitet e shoqëri civile për parandalimin e tij. Gjithashtu, aksesit i organeve të drejtësisë në këto të dhëna ndikon direkt në efikasitetin dhe mirëadministrimin e drejtësisë penale për të mitur.

Sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ka filluar ngritja e institucioneve të reja për të miturit në konflikt me ligjin. Konkretisht:

-Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

Në këtë kuadër është miratuar VKM Nr.314, datë 15.5.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”;

Aktualisht, strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë janë duke ndjekur procesin për krijimin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve duke bashkëpunuar dhe me Departamentin e Administratës Publike (DAP) për finalizimin e procedurave dhe ngritjen e Qendrës brenda një kohe sa më shpejtë.

-Institucioni i Kufizimit të Lirisë.

Lidhur me Ngritjen e Institutit Multidisiplinor për Rehabilitimin e të Miturve Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në Nr.233, datë 17.04.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve të

²⁴² Neni 8 i VKM Nr.149, datë 20.03.2019.

²⁴³ Në nenin 9 të VKM Nr.149, datë 20.03.2019, parashikohet se: “Sistemi i Integruar i të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur përbëhet nga tërësia e të dhënave që burojnë nga fashikujt e dokumente të krijuara, të dërguara dhe të përpunuara gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose jashtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, gjatë procedurave që ndiqen në hetimin ose gjykimin e çështjeve që lidhen me të miturit në konflikt me ligjin, të miturin viktimë dhe/ose dëshmitar”.

veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”. Institucioni i Kufizimit të lirisë vlerësohet se do të funksionojë si një institucion gjysmë i hapur, ku të miturve do t’ju kufizohet liria e veprimit/lëvizjes në atë masë që parandalohet kryerja e veprave penale prej tyre dhe veçanërisht synohet ri integrimi dhe ri shoqërimi i të miturit në komunitet.

Aktualisht, strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë janë duke ndjekur procesin për ngritjen e Institucionit të Kufizimit të Lirisë.

-Autoritetet Kompetente.

Në dispozitat kalimtare të Kodit²⁴⁴, është ngarkuar Këshilli i Ministrave dhe ministrat përkatës të nxjerrin aktet nënligjore për të mundësuar krijimin dhe funksionimin e autoriteteve kompetente që kryejnë funksione lidhur me:

- a. “vendosjen nën kujdes të të miturit” (sipas nenit 69 të Kodit).
- b. “vendosjen nën mbikqyrje të të miturit” (sipas nenit 83 të Kodit).
- c. “vendosjen e të miturit në një shërbim të specializuar” (sipas nenit 84 të Kodit).
- d. “kufizimin e lirisë të të miturit” (sipas nenit 98 të Kodit).
- e. “përbushjen e detyrimeve të caktuara” ndaj të miturit. (sipas nenit 102 të Kodit)

Me Vendim të Këshillit të Ministrave²⁴⁵, janë përcaktuar autoritetet kompetente dhe procedura që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin të përbushë një nga detyrimet e caktuara, në përputhje me nenin 102 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Autoritetet e caktuara në këtë vendim dhe procedura që do të ndiqet prej tyre janë të njëjta, pavarësisht nëse përbushja e detyrimeve të caktuara jepet si dënim plotësues ose si dënim jo me burgim. *“Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, përgatit e përditëson listat e autoriteteve kompetente dhe të personave përgjegjës dhe ia dërgon ato strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe seksionit/ gjykatës përkatës”*²⁴⁶. Gjithashtu, në këtë VKM janë përcaktuar autoritetet kompetente në nivel vendor, të cilat janë përgjegjëse për

²⁴⁴ Në nenet 140-142 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁴⁵ VKM Nr.207 datë 10.4.2019 “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”

²⁴⁶ Po aty, Në kapitullin II “Autoritetet kompetente”, pika 5.

përmbushjen e detyrimeve të caktuara të vendosura nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të miturin në konflikt me ligjin gjatë hetimeve paraprake, duhet të ekzistojnë alternativa të tjera përta i përket masave të sigurimit. Në këtë kontekst, Kodi²⁴⁷ ka parashikuar masa sigurimit të veçanta për të miturit, si *a) vendosja e të miturit në mbikqyrje dhe b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar*. Aktualisht është në proces projekt vendimi i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit, të funksionimit të shërbimit të specializuar, të programeve dhe mënyrës së financimit të tyre, për të miturit në konflikt me ligjin*”.

1. Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në Bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

Njësitë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve janë nën varësinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, institucion varësie i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjatë vitit 2019 në zbatim të ligjit janë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë dhe bashkive më të mëdha në vend e konkretisht me bashkitë: Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Fier, Elbasan, Berat, Lushnje, Kavajë, Pogradec, Kurbin, Dibër, Tepelenë, Gjirokastër e Kukës.

5.5. Specifikat e procesit penal të të miturit në konflikt me ligjin (sipas legjislacionit të brendshëm).

Në procedimin e të miturit në konflikt me ligjin janë parashikuar rregulla të posaçme që duhet të zbatohen në hetim, gjykim, dënim dhe riedukimin e tij. Në lidhje me procedimin penal ndaj të miturit në konflikt me ligjin, aktualisht Kodi i Drejtësisë për të Miturit reflekton standardet

²⁴⁷ Neni 82 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

minimum të parashikuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe aktet e tjera ndërkombëtare në këtë fushë. I mituri ka të drejtë mbrojtje dhe procedimi të veçantë në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur.²⁴⁸

5.5.1 Faza hetim – gjykim.

Sikundër u fol më sipër dhe rezulton nga literatuara, i mitur në konflikt me ligjin konsiderohet çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç dhe ndaj të cilit ekziston dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale²⁴⁹. Përkufizimi “*i mituri në konflikt me ligjin*”, vërehet se përfshin cilësinë e të miturit që në fazën kur është person nën hetim, është i pandehur, edhe kur i mituri është i dënuar. Garancitë procedurale që i njihen të miturit në procesin penal aplikohen që në momentin që ekziston dyshimi i arsyeshëm se i mituri ka kryer një vepër penale deri pas dënimit me vendim të formës së prerë. Sipas legjislacionit shqiptar, drejtësia penale për të mitur, udhëhiqet nga disa parime specifike në krahasim me procedimin penal të të rriturve, të cilat janë:

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës.²⁵⁰ Sipas këtij parimi çdo organ (edhe administrativ) që merr vendime lidhur me të miturin në konflikt me ligjin duhet të argumentojë në mënyrë të posaçme nevojat e fëmijës për zhvillim, mendimin e fëmijës; historinë e fëmijës, aftësinë e personave që do të kujdesen për mirërritjen e fëmijës si dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve personale të fëmijës. Në çdo rast prioritet duhet të jetë interesi më i lartë i fëmijës.

Pjesëmarrja e të miturit në proces²⁵¹. I mituri ka të drejtë të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrjeje lidhur me të, dhe duhet të dëgjohet dhe të shpreh mendimet e tij sipas nivelit të zhvillimit të tij. Organet kompetente kanë detyrimin të krijojnë kushte të përshtatshme për pjesëmarrjen e të miturit në proces, të nxisin të miturin të marrë pjesë në procedimin penal ndaj tij si dhe të mos rëndojnë pozitën e tij në rast të mos pjesëmarrjes. Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka deklaruar se një i mitur i akuzuar për një krim, duhet të trajtohet në

²⁴⁸ Neni 19 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁴⁹ Neni 3 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁰ Neni 10 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵¹ Neni 16 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

bazë të shkallës së pjekurisë dhe moshës së tij. Procesi duhet të përshtatet për ti siguruar mundësinë për të kuptuar procesin dhe të marrë pjesë në të.²⁵²

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi²⁵³. Të gjitha vendimet dhe veprimet që kanë të bëjnë me të miturin në konflikt me ligjin, që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kryhen në mënyrë të shpejtë, me përparësi dhe pa vonesa të pajustificuara.

E kam theksuar edhe më sipër, e gjithë procedura e hetimit dhe gjykimit të një të mituri në konflikt me ligjin është parashikuar të mos zgjasë më shumë se 9 muaj.

Asistenca e detyrueshme ligjore dhe psikologjike²⁵⁴. Në çdo fazë të procedimit penal me të mitur në konflikt me ligjin, prania e psikologut dhe e ndihmësit ligjor të kualifikuar është e detyrueshme dhe këtë fakt ligjvënësi nuk e lidh me diskrecionin e të miturit. I mituri në konflikt me ligjin ka të drejtën të kërkojë gjatë procesit praninë e prindit ose të një personi të besuar. Ndhima e juridike e specializuar dhe ndihma psikologjike përfitohet pa pagesë, me qëllim realizimin me efikasitet të aksesit të të miturit në drejtësi.

Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi²⁵⁵. Të drejtat që parashikohen në Kod duhet të zbatohen në të njëjtën mënyrë për çdo të mitur në procesin penal, pavarësisht racës, ngjyrës, orientimit seksual, prejardhjes shoqërore, përkatësisë fetare etj.

E drejta për zhvillim harmonik të të miturit dhe parimi i proporcionalitetit²⁵⁶. Këto dy parime janë të lidhura me njëra tjetrën. Në çdo procedurë që vendoset në lidhje me të miturin në konflikt me ligjin, merret në konsideratë e drejta e tij për zhvillim fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Masat që merren ndaj të miturit duhet të jenë proporcionale me: a) të drejtën e të miturit për zhvillim dhe b) rëndësinë ose rrethanat së veprës penale.

²⁵² Çështja penale 60958/00 T-ja kundër Mbretërisë së Bashkuar.

²⁵³ Neni 17 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁴ Nenet 18, 20 dhe 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁵ Neni 11 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁶ Neni 12 dhe 13 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit si dhe përparësia e masave alternative²⁵⁷. Me qëllim realizimin e interesit më të lartë të fëmijës, realizimit të të drejtës së tij për zhvillim harmonik, organi kompetent (prokurori, gjykatë), në të gjitha rastet duhet të marrë në konsideratë zbatimin ndaj të miturit të masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Edhe në rastet kur organi kompetent merr vendimin për procedimin penal të të miturit (nuk zbaton masat e shmangies), kufizimi i lirisë duhet konsideruar si masa e fundit dhe duhet zbatuar për një kohë sa më të shkurtër.

Respektimi i jetës private gjatë gjithë fazave të procesit gjyqësor²⁵⁸. Institucionet kompetente të cilat marrin vendime për një të mitur në konflikt me ligjin duhet të kenë në konsideratë se nuk mund të bëjnë publik asnjë informacion që çon në identifikimin e një shkelësi të mitur të ligjit. Procesi gjyqësor duhet të kryhet me dyer të mbyllura dhe nuk duhet të publikohen të dhënat identifikuese të të miturit në vendim. Në të kundërt, ekziston rreziku i stigmatizimit dhe përkeqësimit të mundësive për arsim, punë, strehim dhe siguri, pra minimizohen mundësitë e ri integritit në shoqëri të të miturit në konflikt me ligjin. Mbrojtja e të dhënave personale të të miturit garantohet edhe nga legjislacioni penal, i cili mbron posaçërisht publikimin e të dhënave identifikuese dhe personale²⁵⁹.

Gjykimi i të miturve në konflikt me ligjin duhet të kryet nga seksionet për të mitur si dhe nga gjyqtarë dhe prokurorë të specializuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve²⁶⁰. Organet kompetente që punojnë me të mitur duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar qëndrueshmërinë në pozicion si dhe specializimin e personave në procesin e drejtësisë penale për të mitur²⁶¹.

Gjykimi i të miturve në konflikt me ligjin duhet të bëhet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore. Me dekret të Presidentit të Republikës Nr.5351, datë 11

²⁵⁷ Neni 14 dhe 15 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁸ Neni 21 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁵⁹ Po aty, pika 7.

²⁶⁰ Ligji Nr.8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr.9414, datë 20.5.2005 e përcakton Shkollën si institucioni që siguron formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë, prokurorë). Formimi profesional përfshin programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë.

²⁶¹ Neni 25 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

qershor 2007²⁶² u krijuan seksione të veçanta për të miturit në 6 gjykata të rretheve gjyqësore, konkretisht Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë. Aktualisht, me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁶³ është rregulluar caktimi i gjyqtarëve në seksionet për të mitur edhe për gjykatat e rretheve gjyqësore të cilat kanë numër të kufizuar gjyqtarësh. Në përputhje me standardet ndërkombëtare²⁶⁴ dhe standardet e të drejtës së brendshme, personat që punojnë me të miturit duhet të specializohen dhe trajnohen në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Në praktikë, deri në nxjerrjen e udhëzimit Nr.79, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u krijuar një situatë konfuze në lidhje me kompetencën territoriale të shqyrtimit të çështjeve me të mitur. Pas ndryshimeve me ligjin Nr.35/2017 të Kodit të Procedurës Penale, në kompetencën e seksioneve të të miturve do të bënin pjesë edhe veprat penale ku i mituri ishte viktimë²⁶⁵. Për këtë shkak, prokuroritë dhe gjykatat e shkallëve të para shpallën moskompetencën për procedimet penale ku i dëmtuar ishte i mituri, dhe i dërguan aktet në seksionet për të mitur në 6 gjykatat e rretheve gjyqësore sipas dekretit të Presidentit Nr.5351, datë 11.06.2007. Kjo situatë krahas konfuzionit procedural bëri të mundur që palët të evokonin parimin se “një drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar”.

Më datë 1 janar 2018, hynë në fuqi dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, të cilat prashikonin se seksionet për të mitur krijohen në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore dhe janë kompetente të shqyrtojnë çështjet e: a) të miturve në konflikt me ligjin dhe b) të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë²⁶⁶. Në këto kushte, duke qenë se kompetente për shqyrtimin e procedimeve penale me të mitur ishin të gjitha gjykatat e shkallëve të para, u vendos moskompetenca dhe u ridërguan materialet procedurale pranë të gjitha prokurorive dhe gjykatave të shkallëve të para.

Gjithashtu, kishte paqartësi për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin në organet me numër të vogël gjyqtarësh apo prokurorësh, pasi nuk mund të krijoheshin seksione të veçanta për shkak të numrit të kufizuar të tyre, pasi ligji përcaktonte se seksioni krijohej me të paktën 3 prokuror ose gjyqtar. Kjo situatë mendoj se ka riviktimizuar të

²⁶² Dekret i Presidentit Nr.5351, datë 11.06.2007

²⁶³ Udhëzimi Nr.79, datë 30.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

²⁶⁴ Neni 29 i konventës Për të Drejtat e Fëmijës; neni 25 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁶⁵ Neni 13 pika 4 i Kodit të Procedurës Penale.

²⁶⁶ Neni 27 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

dëmtuarit në këto procese penale, pasi i ka shkaktuar dëm për shkak të zgjatjes së hetimit dhe gjykimit të çështjes si dhe pjesëmarrjes së përsëritur në procesin penal.

5.5.2 Faza dënim – ndëshkim.

Sanksioni penal është pjesë përbërëse e normës juridike, e cila përcakton sjelljen e personit që shkel dispozitivin e saj, si pasojë e drejtpërdrejtë e konsumimit të veprës penale²⁶⁷. Sanksioni është masa penale që ndërmeret shteti në rastin e një sjellje të kundërligjshme, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti. Sanksionet penale të aplikuara kanë ndryshuar në mënyrë të qenësishme me kalimin e kohës. Disa lloje të dënimeve të cilat fillimisht janë konsideruar të zakonshme, në kohën e sotme në shoqëritë bashkohore nuk janë të pranueshme, si p.sh. ndëshkimi fizik, dënimi me vdekje, goditja me gurë me pasojë vdekjen, puna e detyruar, dëbimi etj. Në Shqipëri, me ratifikimin e protokollit 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, u hoq dënimi me vdekje.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë²⁶⁸, nuk ka një përkufizim të nocionit të dënimit. Në ndryshim nga Kodi Penal aktual, Kodi Penal i vitit 1952²⁶⁹, në nenin 15 të tij parashikonte se, dënimi është masa e shtrëngimit që ka për qëllim: *“1. Të dënojë fajtorin dhe ta ndalojë që të kryejë krim; 2. Të edukojë dhe të përmirësojë fajtorin që ka kryer krimin; 3. Të ushtrojë influencë mbi anëtarët e lëkundshëm të shoqërisë”*.

Qëllimet e dënimit variojnë në legjislacione të ndryshme, në varësi të qasjes që ata kanë. Dy janë shkollat kryesore në këtë fushë. Shkolla neo-klasike e konsideron dënimi si një ndëshkim për veprimin e kundërligjshëm të kryer dhe i shërben dy qëllimeve kryesore, a) ndëshkimit dhe b) parandalimit të përgjithshëm. Sipas shkollës sociale qëllimi i dënimit është trajtimi dhe risocializimi i shkelësit. Të njëjtën qasje ka edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ku pjesë e sistemit të dënimit duhet të jetë edhe trajtimi i të burgosurit sipas qëllimit thelbësor, i cili ka të bëjë me reformimin dhe rehabilitimin social të tij²⁷⁰. Legjislacioni aktual i drejtësisë penale për të mitur afron më shumë me frymën e shkollës sociale, pasi qëllimi i

²⁶⁷ Vllado Kambovski —E drejta Penale|| Pjesa e Përgjithshme|| Botimi i dytë, SHB —Furkan ISM|| —Shkup, 2007, fq 429

²⁶⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995.

²⁶⁹ Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.1516, datë 7.08.1952.

²⁷⁰ Në nenin 5 të Kushtetutës parashikohet se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

dënimit të të miturit është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i kryerjes së veprës penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikqyrje²⁷¹.

Si përfundim, dënimi penal konsiderohet si masë e detyrueshme, e parashikuar nga ligji penal, e cila ka në përmbajtje kufizimin e të drejtave ndaj personit që gjykata deklaron fajtor për një veprë penale. Kodi Penal përcakton figurat e veprave penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Llojet e dënimit kryesor për të miturin sipas Kodit Penal janë dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Ndaj personit që ka qenë nën 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale nuk mund të caktohet dënimi me burgim të përjetshëm²⁷². Për sa më sipër, si për kundërvajtjet ashtu edhe për krimet, llojet e dënimit kryesor janë burgimi dhe gjoba.

Në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur është parashikuar si dënim kryesor edhe “*kufizimi i lirisë*”, i cili ka të bëjë me vendosjen e të miturit në një institucion të caktuar nën mbikqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti.

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur²⁷³ janë klasifikuar si dënime plotësuese:

- a) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- b) kryerja e një pune me interes publik;
- c) përmbushja e detyrimeve të caktuara;
- ç) qëndrimi në shtëpi.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë²⁷⁴, parashikon se për të miturin dënimi nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Pra, sanksioni penal do të llogaritet sa gjysma e dënimit me burgim ose me gjobë që parashikon dispozita konkrete. Po ashtu, gjykata mund ta përjashtojë të miturin nga dënimi duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë e pakët të veprës penale, rrethanat e kryerjes së saj dhe sjelljen e mëparshme të të miturit. Në këto raste, vendoset dërgimi i të miturit në një institucion²⁷⁵.

²⁷¹ Neni 93 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.


²⁷² Neni 31 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

²⁷³ Neni 96 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

²⁷⁴ Neni 51 i Kodit Penal.

²⁷⁵ Neni 52 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

UNICEF në një studim²⁷⁶ të kryer në 10 vende, pjesë e të cilit ishte edhe Shqipëria, ka analizuar caktimin e dënimit me “burg” për të miturit në konflikt me ligjin. Nga vlerësimi i të dhënave për periudhën 2006-2012, janë përfshirë të dhënat e mëposhtme:



Përqindja e dhënies së dënimit me burg për të miturit nga 14- 18 vjeç.

Shtetet vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Shqipëria	88.4%	87.7%	88.7%	61.6%	46.5%	54.8%	30.7%
Armeni	13.7%	17.3%	21.3%	9.6%	12.5%	14.5%	17.9%
Azerbaixhani		27.2%	14.2%	14.9%	13.9%	16.2%	15.3%
Gjeorgjia	13.5%	20.7%	17.5%	11.3%	15.7%		12.6%
Kazakistani	19.1%	15.9%	15.7%	16.1%	12.4%	11.8%	10.1%
Kirgizstani	9.4%	11.1%	9.2%	11.9%	11.3%	8.2%	9.6%
Moldavia	10.5%	13.9%	5.4%	6.9%	8.5%	9.7%	
Mali i Zi	6.3%	7.4%	2.6%	2.8%	4.0%	2.6%	5.1%

²⁷⁶ Vlerësimi i impaktit të reformave në fushën e drejtësisë për fëmijët në disa vende (2006-2012), UNICEF.

Taxhikistani	55.3%	68.8%	67.9%	43.0%	42.8%	30.9%	22.4%
Ukraina	12%	11%	10%	11%	9%	10%	8%

Nga sa më sipër, rezultonte qartë se Shqipëria ishte vendi me përqindjen më të lartë të dhënies së dënimit me burg për të miturit nga 14-18 vjeç. Në këtë kuadër, është vlerësuar edhe caktimi i masës së sigurisë personale “*arrest në burg*”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin. Nga analizimi i të dhënave për kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit të fëmijëve në ambientet e paraburgimit, janë përfituar të dhënat e mëposhtme për vitin 2012²⁷⁷ :

Shqipëria □ 202 ditë.

Armenia □ 45 ditë.

Azerbajxhani □ 132 ditë.


Gjeorgjia □ 80 ditë.

Kazakistani □ 125 ditë.

Kirgizstani □ 60 ditë.

Kosova □ 56 ditë. Moldavia □ 90 ditë.

Ukraina □ 30 ditë. Mali i Zi □ 15 ditë.



Në këtë vlerësim të UNICEF për vitin 2012, vihej në dukje se në 10 vendet e tjera ku u zhvillua vlerësimi, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të fëmijëve në paraburgim në Shqipëri ishte më e larta. Vlerësimi evidentonte edhe përdorimin e shpeshtë të masës së sigurisë “*arrest në burg*” për të miturit në Shqipëri. Në vitin 2012 Shqipëria rezultonte me 186 të mitur në paraburgim, ndërsa Azerbajxhani, Armenia apo Mali i Zi rezultonte përkatësisht me 26,10 dhe 2 të mitur në paraburgim.

²⁷⁷ <https://www.unicef.org/albania/media/1501/file/National%20Justice%20for%20Children%20Strategy%20Alb.pdf> – FQ. 19

Në vitin 2016, qëndrimi mesatar i të miturve në paraburgim në Shqipëri ishte 92 ditë, ku përsëri konstatohet se aplikimi i kësaj mase është ende në nivele të larta dhe larg standardit që ofrojnë qoftë edhe vendet fqinjë si Kosova dhe Mali i Zi. Është për tu theksuar fakti që, vendet që janë marrë në studim nuk paraqesin nivelin më të lartë të zhvillimit bashkëkohor, e megjithatë përsëri vendi ynë renditet i pari për kohëzgjatjen mesatare të kohë qëndrimit të të miturve në paraburgim. Politika penale ndaj shkelësve të mitur të ligjit në vendin tonë ka pasur qasje ndëshkuese, duke vënë theksin se edukimi arrihet nëpërmjet ndëshkimit. Në këtë kontekst, ndaj të pandehurve të mitur në mënyrë të dukshme janë aplikuar masa sigurimi personal të rënda si “arresti në burg” si dhe janë caktuar dënime me burgim.

Të dhënat statistikore për Shqipërinë mbi praktikën e ndëshkimit.

Legjislacioni penal shqiptar parashikon se, të miturit me masë sigurie arrest me burg dhe ata që marrin vendimin e formës së prerë nga gjykatat, akomodohen në institucione për të mitur, ose në institucione me seksione të veçanta për të mitur. Sistemi i burgjeve dhe i paraburgimit në Republikën e Shqipërisë është në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, sipas ligjit²⁷⁸ përcaktohet se *“Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të vuajtjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve dhe të dënuarve me burgim”*²⁷⁹

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim²⁸⁰ janë: Burgu i sigurisë së lartë; Burgu i sigurisë së zakonshme; Burgu i sigurisë së ulët; si dhe Institute të veçanta. Të miturit e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për ta dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji²⁸¹. Të miturit mund të vendosen në burgjet e sigurisë së lartë dhe në seksione të burgut të sigurisë së lartë, për sjellje dhe vepra veçanërisht të rënda²⁸². Në praktikë të gjithë të miturit që kanë kryer vepra penale të rënda janë strehuar pranë Burgut të Vaqarit.

²⁷⁸ Ligj Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, (Ndryshuar me ligjin Nr.9112, datë 24.7.2003; Ndryshuar me ligjin Nr.9694, datë 19.3.2007; Ndryshuar me ligjin Nr.33/2012)

²⁷⁹ Po aty, neni 16.

²⁸⁰ Sipas Ligjit Nr.8328, datë 16.0.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (ndryshuar me ligjin 9071/ 22.5.2003, ndryshuar me ligjin Nr.9888, datë 10.03.2008; ndryshuar me ligjin Nr.10 087, datë 26.2.2009; ndryshuar me ligjin Nr.40/2014, datë 17.4.2014)

²⁸¹ Neni 17 i ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

²⁸² Po aty, neni 13.

Sipas të dhënave të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për periudhën 2007-2015 rezulton se numri i të miturve në konflikt me ligjin ka qënë përgjithësisht në rritje, përveç uljeve në vitet 2011 dhe 2013.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për të miturit të paraburgosur dhe të dënuar sipas grup moshave, për periudhën kohore nga vit 2007 deri në vitin 2015²⁸³. Burimi i të dhënave është marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Moshë	Viti								
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
14	5	5	3	3	5	11	13	4	11
15	13	30	34	32	23	42	33	23	18
16	35	46	58	75	67	79	67	62	43
17-18	73	67	63	100	81	100	86	112	132
Totali	124	148	158	210	176	232	199	201	204

Sipas të dhënave të IEVP-ve rezulton se kriminaliteti i të miturve është shumë më i lartë në zonat urbane me popullsi heterogjene si Tirana apo Durrësi sesa në zonat rurale.

Për të vlerësuar praktikën e ndëshkimit që ka përdorur vendi ynë nga viti 2013 e në vijim, janë analizuar dokumente zyrtare, konkretisht Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm “*Mbi gjendjen e kriminalitetit*”. Nga studimi i të dhënave të raporteve të mësipërme është arritur në konkluzionin se kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur çdo vit. Të

²⁸³ Te miturit ne konflikt me ligjin- analize e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve- Ani Beqo, Blerta Doçi.

dhënat tregojnë se gjatë vitit 2017, për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç rezulton se është kërkuar për 53% të të pandehurve të mitur caktimi i dënimeve alternative, kryesisht janë pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në provë²⁸⁴.

Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur gjatë vitit 2016, rezulton se është kërkuar për 369 të pandehur të mitur caktimi i dënimeve alternative. Kjo shifër e shprehur në përqindje përbën 48,4 % të të miturve të dënuar²⁸⁵.

Gjatë vitit 2015, në lidhje me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur, rezulton se është kërkuar për 385 të pandehur të mitur caktimi i dënimeve alternative, (kryesisht pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në provë), ndërsa në vitin 2014 është kërkuar caktimi i dënimeve alternative për 345 të pandehur të mitur, e shprehur në përqindje një rritje prej 12 % krahasuar me vitin 2014 dhe 30 % krahasuar me vitin 2013. Të dhënat tregojnë se kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur çdo vit, ku konkretisht në vitin 2015 janë ulur 10 % krahasuar me vitin 2014 dhe 26 % krahasuar me vitin 2013²⁸⁶.

Në lidhje me caktimin e dënimit për vitin 2018, ato duhen vlerësuar me kujdes, pasi në 1 janar 2018 ka hyrë në fuqi Kodi i Drejtësisë penale për të Mitur, i cili solli ndryshime të rëndësishme edhe në kuadrin ligjor të caktimit të dënimit. Nga të dhënat e referuara nga Prokurori i Përgjithshëm përsa i përket caktimit të dënimit për të pandehurit e mitur gjatë vitit 2018, rezulton se është kërkuar dhe është dhënë për 80 % të të pandehurve të mitur caktimi i dënimit me burg, në 6 % të rasteve është kërkuar dënimi me gjobë dhe në 14 % të rasteve janë kërkuar dënime plotësuese²⁸⁷. Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin tregojnë se për vitin 2018 janë dërguar për gjykim 235 çështje me 285 të pandehur të mitur, dhe janë pushuar 148 procedime me 148 të pandehur të mitur. Shkaqet e vendimmarrjes në rastet e pushimit të çështjes rezultojnë se në 76% të rasteve (98 procedime penale) janë aplikuar masat alternative të shmangies; në 2% të rasteve është pushuar për shkak ndërmjetësimi (2 procedime penale); në 28.22 % të rasteve procedimi penal është pushuar për shkaqe të tjera.

²⁸⁴ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2017, faqe 241.


²⁸⁵ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2016, faqe 236.

²⁸⁶ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2015, faqe 258.

²⁸⁷ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri", për vitin 2018, faqe 261.

Vlen të theksohet se, në vitin 2018 vërehet se ka një rritje të ndjeshme të kërkesave të prokurorëve për caktimin e dënimit me burgim ndaj të pandehurve të mitur, dënim i cili është kërkuar në 80 % të rasteve. Megjithatë, në vlerësimin e këtyre të dhënave duhet të marrim në konsideratë ndryshimet që ka pësuar ligji penal, ku janë pushuar 100 procedime (98 shmangie dhe 2 ndërmjetësim) si rezultat i aplikimit të masave alternative duke i shmangur të miturit nga ndjekja penale dhe nga dënimi. Mendoj se, në përgjithësi për veprat penale me rrezikshmëri të pakët shoqërore, për të cilin parashikohet dënimi me burgim deri në 5 vjet, të miturit janë shmangur nga përgjegjësia penale. Në këto rrethana janë dërguar për gjykim të pandehurit e mitur të cilët kanë kryer vepra me rrezikshmëri të konsiderueshme shoqërore ose paraqesin rrezikshmëri të autorit. Për këtë shkak, kërkesat e prokurorisë për caktimin e dënimit me burg në 80% janë bërë duke marrë në konsideratë rrethanat.

Grafikisht, të dhënat për kërkimin e dënimeve alternative (kryesisht pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë) nga viti 2013 deri në vitin 2017 paraqiten si vijon. Në grafik janë përjashtuar të dhënat për vitin 2018 për shkak të ndryshimeve ligjore, të cilat reflektohen edhe në kërkesat e prokurorisë në caktimin e dënimit dhe shmangien nga ndjekja penale.



Nga të dhënat statistikore rezulton qartë se vitet e fundit, kanë pësuar një rritje të ndjeshme kërkimi nga prokurorët i aplikimit të dënimeve alternative, ndaj të pandehurve të mitur. Kërkesat e prokurorit në caktimin e dënimeve, duke kërkuar aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, kanë ndryshim më të dukshëm në vitin 2014.

Shkak i ndryshimit të qasjes së prokurorëve në kërkesat për caktimin e dënimit, kanë qenë edhe orientimet e Prokurorit të Përgjithshëm. *“Lidhur me caktimin e masave të sigurimit dhe dënimit, për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2014, prokurorët janë udhëzuar që të jenë proporcional në kërkimet e tyre, duke ruajtur raportin e rëndësisë së shkeljes, të drejtës së të dëmtuarit, nevojës për trajtim të posaçëm të të miturit dhe dënimit që kërkohet të caktohet ndaj tij²⁸⁸”*.

Në raport vlerësohet se gjatë vitit 2014 prokurorët kanë ndjekur një politikë penale **korrektuese** ndaj të miturve. Kërkesa për caktimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin Penal nga organi i akuzës, është konsideruar si masa më e përshtatshme në interes të të miturit, që nxit dhe krijon mundësinë e ruajtjes së kontakteve të të miturit me familjen, shkollën, punën e shoqërinë.

Në raportet e Prokurorit të Përgjithshëm *“Mbi gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri”*, rezulton se nga organi qendror i akuzës i është kushtuar gjithnjë e më shumë rëndësi trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin, duke orientuar praktikën e prokurorive pranë gjykatave të shkallëve të para dhe gjykatave të apelit. Edhe në vetë raportet e përpiluara nga Prokurori i Përgjithshëm është theksuar fakti që prokurorët duhet të ndjekin një qasje më sociale për politikën e dënimit ndaj autorëve të mitur të kryerjes së veprës penale.

E njëjta politikë penale është ndjekur edhe nga qeveria për vitin 2017, ku janë përcaktuar prioritetet e luftës kundër kriminalitetit. Konkretisht, Prokurorit të Përgjithshëm i është rekomanduar ndër të tjera: *“... rritje të numrit të çështjeve penale të hetuara dhe dënuar me vendim të formës së prerë për rastet e nxjerrjes së fëmijëve për të lypur ose punuar në rrugë/shfrytëzimit të fëmijëve; kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo kërkohet/ vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme; hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës penale, në rastet e veprave penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, duke pasur në vëmendje të veçantë rastet*

²⁸⁸ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm *“Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”*, për vitin 2014.

e dhunës në familje; fuqizim të kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e veprave penale me subjekt të procedimit penal të miturit, viktimat e dhunës në familje dhe atyre të trafikimit...’’²⁸⁹.

Në raportin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Ç’njerezor dhe Poshtëruës²⁹⁰, arrihet në konkluzionin se në vendin tonë trajtimi i të miturve nuk përputhet me standardet ndërkombëtare²⁹¹. **Në analizë të situatës faktike të të miturve që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, është vërejtur se fëmijët nuk marrin shërbimet e duhura në institucion.** Në vendin tonë ekzistojnë vetëm dy qendra paraburgimi për të miturit, konkretisht në qytetin e Vlorës dhe të Lezhës. Për riintegrimin e të miturve të dënuar ka vetëm një institucion të ndodhur në Kavajë, Instituti i të miturve në Kavajë. Kapacitetet akomoduese të institucionit janë për 40 persona. Pjesa më e madhe e të dënuarve janë të moshës 16-17 vjeçare. Të dënuarve të mitur u ofrohen aktivitete edukuese, trajnuese, ndërmjetësimi, asistencë ligjore falas, dhe aktivitete ri-integruese.

Personeli që punon me të mitur në konflikt me ligjin duhet të jetë i trajnuar në mënyrë të posaçme, në mënyrë që të kombinojë kërkesat e sigurisë dhe të rregullit në institucionet e vuajtjes së dënimit me detyrimin për të asistuar të miturit të zhvillojnë afësitë pozitive personale. Komiteti i Helsinkit në Shqipëri ka kryer një analizë mbi zbatimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria. Studimi është kryer në të gjitha vendet ku sipas legjislacionit në fuqi personat janë privuar nga liria, për shkak të procesit penal, konkretisht në komisariatet e policisë, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale si dhe në spitalet psikiatrike. Në raport, Komiteti i Helsinkit ka evidentuar mungesë psikologësh e punonjësish socialë të specializuar për të punuar posaçërisht me fëmijët e dënuar. Psikologët janë me profil të

²⁸⁹VKM Nr.324, datë 12.04.2017 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017”

²⁹⁰ Raport i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerezor dhe Poshtëruës, për Shqipërinë për vitin 2018.

²⁹¹ Neni 1 të Konventës kundër Torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjezëzor ose degradues (miratuar me ligjin Nr.Nr.7727, datë 30.6.1993 parashikon se: “Për qëllim të Konventës, me torturë do të kuptohet çdo lloj akti i cili shkakton dhimbje dhe vuajtje si fizike ashtu edhe mendore, i cili shtyn në mënyrë të qëllimshme një person për një qëllim të caktuar duke përfutuar nga ai apo një person tjetër i tretë informacione e rrëfime, duke e dënuar atë apo një person të tretë për krimin e kryer apo për atë që dyshohet të ketë kryer, apo duke e kërcënuar e detyruar të flasë, apo për çdo arsye bazuar në ndonjë tip diskriminimi, kur kjo lloj dhimbje apo vuajtje bëhet nën shtytjen, aprovimin ose dënimin e zyrtareve publike apo të personave të tjerë që vepron në kapacitete zyrtare. Ajo nuk përfshin asnjë lloj dhimbje apo vuajtje që vjen vetëm për shkak të trashëgimisë apo është e rastësishme për shkak të masave të ligjshme.”

përgjithshëm, nuk janë të specializuar në trajtimin e çështjeve me të mitur, dhe si rezultat në intervistat e tyre nuk trajtojnë nevojat specifike të fëmijëve²⁹².

5.5.3 Faza Riedukim.

Riedukimi i autorit të kryerjes së veprës penale është një nga sfidat kryesore të sistemit të drejtësisë. Për vite me rradhë është besuar se ndëshkimi dhe ashpërsia e sanksionit penal do të ishin të mjaftueshëm për realizimin e parandalimit të posaçëm (të autorit të veprës penale) dhe parandalimin e përgjithshëm (të individëve të shoqërisë). Në Shqipëri është konstatuar se pavarësisht ashpërsisë së dënimeve ndaj të miturve (aplikimit të dënimit me burgim), ka rezultuar se 90 % e të miturve kthehen në recidivistë²⁹³.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë²⁹⁴ ka arsyetuar se: “*Në vështrim të parimeve kushtetuese dhe të jurisprudencës e teorisë së konsoliduar evropiane, qëllimi më i qenësishëm i dënimit penal dhe synimi final i tij është riedukimi i autorit të veprës penale dhe riintegrimi i tij në shoqëri pas kryerjes së dënimit*”.

Në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, parashikohet se çdo fëmijë ka të drejtë për të jetuar dhe zhvilluar²⁹⁵. Ky parim nënkupton se të miturit në konflikt me ligjin kanë të drejtë për zhvillim të hershëm. Në këtë kuadër, në përcaktimin e politikave të ndëshkimit dhe riedukimit të autorit të mitur të kryerjes së veprës penale, duhet të merret në konsideratë fakti se i mituri edhe gjatë periudhës së ndëshkimit e riedukimit duhet të vazhdojë të zhvillohet fizikisht, moralisht, shpirtërisht, mendërisht dhe shoqërisht.

Drejtësia penale për të mitur duhet të ketë prioritarë mirëqenien e të miturit dhe duhet të sigurojë që çdo masë e marrë ndaj të miturit do të jetë në proporcion si me të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin ashtu edhe me të drejtat e viktimës²⁹⁶. Në këtë kontekst, dy janë objektivat që duhet të plotësoj një sistemi i drejtësisë për të miturit.

²⁹² Raport “Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike”, korrik 2015–janar 2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

²⁹³ Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016, “Lëvizja Evropiane në Shqipëri “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, kapitulli 23, f. 27–29

²⁹⁴ Vendim i Gjykatës së Lartë Nr.78, datë 06.03.2013.

²⁹⁵ Neni 6 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

²⁹⁶ Neni 5 i rregullave të Pekinit.

Së pari, promovimi i mirërritjes së të miturit, i cili realizohet duke marrë në konsideratë marrjen e masave pa e shpëputur të miturin nga familja dhe shoqëria.

Së dyti, parimi i proporcionalitetit, i cili duhet të ruaj një balancë ndërmjet ndëshkimit (*teoria "just desert"*) me rëndësinë e shkeljes.

Natyrshëm ngrihet çështja se, cila është metoda më efektive që duhet të ndjekë politika penale për të miturit në konflikt me ligjin, përqasje ndëshkuese (nëpërmjet burgimit) apo aplikimin e masave edukative. Studiues të ndryshëm pranojnë pikëpamjen se, dënimi me burgim nuk është mjeti i gjithë fuqishëm për goditjen e kriminalitetit²⁹⁷. Koncepti i dënimit si ndëshkim ka dështuar së bashku me konceptin e rehabilitimit se, "*burgu është shkolla më e mirë*"²⁹⁸.

Në mënyrë të hollësishme raporti ndërmjet kriminalitetit dhe praktikave të ndëshkimit në vendin tonë analizohet në kapitull tjetër. Nga studimi i të dhënave ka rezultuar se aplikimi i dënimeve me qasje drejt ndëshkimit, si burgimi, nuk kanë sjellë ulje të nivelit të kriminalitetit. Përkundrazi, në praktikën shqiptare janë shfaqur efektet negative të izolimit, të cilat kanë sjellë si pasojë rritjen e nivelit të kriminalitetit.

Në këtë aspekt duhet të marrim në konsideratë efektet negative të izolimit si dhe mungesën e infrastrukturës dhe mekanizmave efektivë në institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim, për realizimin e të drejtave të parashikuara në ligj. Izolimi sidomos i të miturve sjell pasoja në personalitetin e tyre, e shoqëruar kjo edhe me mungesën e stafit të specializuar në këto institucione për trajtimin e të miturve, mund të sjellë si rezultat mungesën e riintegritimit të të miturit në shoqëri. "*Legjislacionet më të përparuara botërore, që mbikqyrin sistemin e drejtësisë për të mitur, si dhe të gjitha konventat e rregullat ndërkombëtare në këtë fushë, si: Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, apo Rregullat e Riadit dhe të Pekinit, synojnë mirëqenien, mirërritjen, vazhdimin e edukimit të të miturve, duke konsideruar se ky proces nuk ka përfunduar ende*"²⁹⁹. Sipas këtyre rregullave, sistemet e brendshme duhet të synojnë zbutjen e ashpërsisë të masave të sigurisë "*arrest në burg*" të të miturit autor të veprës penale ose të masave të ndëshkimit me burgim. Legjislacioni i brendshëm për të miturit, duhet të synoj aplikimin e masave edukative në vend të privimit nga liria.

²⁹⁷ Ismet Elezi, "*Parandalimi, drejtësia penale dhe drejtësia restauruese*", Artikuj studimor, Tiranë, faqe 44

²⁹⁸ Ricardi, C "*sistemi italian i ndërmjetësimit në fushën penale, Konverenca kombëtare për Ndërmjetësim, tiranë 2005, f. 62*

²⁹⁹ Dritan Peka, "*I mituri në procesin penal si autori i veprës penale*", Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik, Tiranë 2018, faqe 74.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur³⁰⁰ parashikohen masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale, të cilat janë:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- b) këshillimin për të miturin dhe familjen;
- c) paralajmërimin me gojë;
- d) paralajmërimin me shkrim;
- e) masat detyruese;
- f) vendosjen nën kujdes.

Sipas legjislacionit penal në fuqi³⁰¹, prokurori ose gjykata zbaton masën e shmangies kur plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte:

a) Vepra penale për të cilën akuzohet i mituri paraqet rrezikshmëri të ulët shoqërore. I mituri në konflikt me ligjin ka kryer një vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet maksimum ose gjobë.

b) i mituri e pranon fajësinë në prani të mbrojtësit dhe shpjegon mekanizmin e kryerjes së veprës penale. Ky kusht tregon për rrezikshmërinë e ulët shoqërore të autorit të kryerjes së veprës penale.

c) Shkelësi i mitur i ligjit nuk është recidivist. Edhe plotësimi i këtij kriteri përveç se jep të dhëna për rrezikshmërinë e autorit, në kuadrin e parimit të humanizmin³⁰² i jep mundësi të miturit që për shkelje për herë të parë të ligjit të aplikohen metoda edukuese. Këto metoda vlerësohen si më të përshtatshmet për realizimin e qëllimit të ligjit penal (edukimin e autorit) si dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri.

ç) Duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë e autorit të saj dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, për rastin nuk duhet të ketë interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar. Në këtë vlerësimin duhet të mbahet prioritarë interesi më i lartë i të miturit. Politika penale duhet të shmang

³⁰⁰ Neni 62 i Kodit.

³⁰¹ Nenet 55-61 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

³⁰² Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë në nenin 1/c të tij parashikon se: "Kodi Penal bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve, si dhe të humanizmit".

inkriminimin dhe penalizmin e të miturit për sjellje që nuk dëmtojnë të tjerët dhe marrja e masave izoluese mund ti shkaktojë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij.

d) I mituri në konflikt me ligjin dhe përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural duhet të japë pëlqimin me shkrim për zbatimin e masave të shmangies. Pranimi i masës së shmangies nga ndjekja penale është vullnetar dhe i mituri ka të drejtë të heqë dorë prej saj në çdo fazë. Janë të papërdorshme në gjykatë të gjitha provat që janë mbledhur gjatë procesit të shmangies, në rastin kur i mituri heq dorë për zbatimin e masës.

e) I mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimit. Masa e shmangies merret me qëllim parandalimin e posaçëm të shkelësit të ligjit, dhe kryerja përsëri e një vepre penale nga i mituri tregon qartë se, nuk është arritur qëllimi i shmangies nga ndjekja penale, për këtë shkak duhet marrë masë tjetër me qëllim edukimin e tij.

f) Dënimi i të miturit ti shërbejë edukimit të tij. Në vlerësimin e këtij kriteri organi kompetent duhet të marrë në shqyrtim raportin e vlerësimit individual për të miturin në konflikt me ligjin. Në të parashtrohet në mënyrë të detajuar niveli i zhvillimit të të miturit; mënyra e jetesës, edukimi dhe kushtet e zhvillimit, arsimimi, gjendja shëndetësore, mjedisi familjar dhe kushte të tjera që shërbejnë për vlerësimin e karakteristikave të personalitetit të të miturit³⁰³. Drejtësia penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet ti siguroj atij atij mundësinë e edukimit dhe të shërbej si një kuadër mbështetës për zhvillimin personal të të gjithë të miturve, veçanërisht të atyre që kanë nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë.

Në Axhendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve³⁰⁴, citohet se: “*Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ende ka një përjasje ndëshkuese ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Në një masë të madhe nuk arrin të marrë parasysh nevojat e tyre për mbrojtje, në respekt të të drejtave të tyre njerëzore dhe dinjitetit megjithëse ka pasur disa përmirësime gjatë viteve të fundit*”. Në kuadrin ligjor vendi ynë ka bërë përparime të dukshme duke parashikuar shmangien nga ndjekja penale dhe nga dënimi i të miturve në konflikt me ligjin, përmes masave alternative³⁰⁵.

³⁰³ Neni 47 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

³⁰⁴ Agjenda Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve për vitin 2017-2020.

³⁰⁵ Neni 55 pika 3/a e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Shmangia nga procesi penal nuk anatemon rolin e dënimit penal, por përkundrazi i hap rrugë drejtësisë dhe normalizimit të marrëdhënieve viktimë -autor të veprës penale, ku një nga mënyrat më efektive është drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi. Drejtësia restauruese ka si qëllim kthimin e gjendjes së mëparshme për viktimën e veprës penale, duke u përqendruar në dy drejtime kryesore. **Së pari**, në riparimin e marrëdhënies midis të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimës. **Së dyti**, në kompensimin e dëmit të shkaktuar viktimës.

Drejtësia restauruese dallohet nga drejtësia penale (tradicionale) për arsye se, protagonistët e vërtetë të konfliktit janë viktimat dhe i akuzuari. Ata marrin pjesë aktivisht në procesin e zgjidhjes së konfliktit, për ripërtëritjen e të akuzuarit dhe shpërblimin moral e material të viktimës. Në drejtësinë penale, në përfundim të procedimit gjykata zgjidh çështjen dhe nuk ndërmerr ndonjë veprim në planin moral apo material për viktimën. Përrjashtim për zgjidhjen e çështjes së dëmit material (jo moral) të viktimës bën padia civile në procesin penal, megjithatë edhe në rastet kur kjo padi ngrihet nga pala e dëmtuar, praktika e gjykatës është veçimi i padisë civile pasi ndikon në zgjatjen e procesit penal. Në drejtësinë restauruese pjesëmarrës aktiv mund të jetë edhe komuniteti, në ndryshim nga drejtësia penale. Mbrojtja e të drejtave të viktimës, vihet në qendër të drejtësisë restauruese pasi shpërblen dëmin material dhe moral të viktimës, si dhe nuk lë mënjanë edhe kujdesin për riintegrimin e autorit të veprës penale.

Në progres raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë³⁰⁶ janë reflektuar shqetësime për nivelin e lartë të përsëritjes së shkeljes së ligjit penal nga të miturit. Si shkaqe për dështimin e parandalimit të posaçëm janë vlerësuar **mungesa e mundësive për ofrimin e riedukimit**, ku duhet theksuar se edhe aktualisht **institucionet e riedukimit janë të pamjaftueshme** (ekziston vetëm një i tillë në Kavajë) dhe në përgjithësi **të miturit vuajnë dënimin në seksione të veçanta dhe nuk marrin shërbimet e parashikuara nga ligji për integrimin e tyre në komunitet**. Një shkak tjetër është konsideruar **mungesa e koordinimit ndërmjet drejtësisë dhe sistemeve të mbrojtjes së të miturve që dalin nga sistemi i drejtësisë**. Në përmbushje të detyrimeve të të parashikuara nga Kodi janë ndërmarrë hapa për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, e cila ka për qëllim mbikqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit pas kryerjes së dënimit. Kjo qendër, e rëndësisë së veçantë, akoma nuk është vënë në funksionim.

³⁰⁶ Progres raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2015.

Në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, për shkak të rëndësisë që paraqet, i është kushtuar një kre i posaçëm³⁰⁷ rehabilitimit dhe rishoqërizimit të të miturit në konflikt me ligjin. Në veprimtarinë rehabilituese kanë rol vendimtar administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur; Shërbimi i Provës, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve si dhe Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës³⁰⁸. Për çdo të mitur të liruar duhet të përgatitet plani i rishoqërizimit dhe rehabilitimit, për një periudhë deri në tre muaj nga lirimi i të miturit. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës dhe administrata e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur bashkëpunom me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të miturve dhe të Rinjve, organet e qeverisjes vendore të njësisë administrative dhe Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ku i mituri banon³⁰⁹.

Për sa më sipër, riintegrimi dhe përfshirja sociale e autorëve të mitur të veprave penale, është një proces gjithëpërfshirës. Për rehabilitimin e të miturit është i domosdoshëm një ndërveprim dhe bashkëpunim pro-aktiv midis institucioneve të ndryshme shtetërore, sidomos të atyre që kanë fushë të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Rehabilitimi i të miturit ka si objektiv zhvillimin dhe inkurajimin e të miturit me ndjenjën e respektimit të ligjit; si dhe zhvillimin e shëndoshë mendor, fizik, moral, shpirtëror e shoqëror për ta përgatitur të miturin të rikthehet në shoqëri. Në realizimin e këtij qëllimi rol vendimtar ka familja, komuniteti dhe mjedisi shoqëror. Për këtë shkak, në programet e riintegrit të të miturit në konflikt me ligjin duhet të përfshihet edhe familja e tij, duke u nxitur të bashkëpunojnë mbi trajtimin që do ti jepet fëmijës së tyre.

Me qëllim që të shmanget kthimi i shkelësve të mitur të ligjit në rrethanat sociale të cilat kontribuan në kryerjen e veprës penale, duhet të analizohen faktorët e riskut dhe masat mbrojtëse. Profesionistë të sektorit të drejtësisë kanë konkluduar se për 77% të të miturve, të cilët bien në kontakt me sistemin gjyqësor shkaqet lidhen me dhunën, abuzimin dhe neglizhencën në familje³¹⁰ që është ushtruar ndaj tyre në mënyrë të vazhdueshme. Në progres

³⁰⁷ Kreu XIV, "Përgatitja për lirim nga IEVP-ja, kujdesi, rehabilitimi dhe rishoqërizimi", përmban nenet nga 133 deri në 135 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

³⁰⁸ Me ligjin Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", janë përcaktuar të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

³⁰⁹ Neni 133 pika 10 e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

³¹⁰ UNICEF "Children's Equitable Access to Justice: Central and Eastern Europe and Central Asia".

https://www.unicef.org/ceecis/Equitable_access_to_justice_for_children_in_Central_and_Eastern_europe_and_Central_Asia_-_v2_1.pdf, aksesuar dhjetor 2016, f. 52

raportet e Komisionit Evropian³¹¹, janë bërë rekomandime konkrete për marrjen e masave për trajtimin e viktimave të trafikimit, viktimave të abuzimit seksual, dhe viktimave të mitura të dhunës në familje. Duke marrë parasysh këtë situatë, në muajin janar 2016, Prokuroria e Përgjithshme ka ngritur Zyrën e Ndhmës së Viktimave. Objekt i punës së saj është sigurimi e informimit dhe këshillimit të viktimave të krimit, ku prioritet kanë viktimat e mitura apo me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës ose shfrytëzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore dhe terrorizmit³¹².

Për sa më sipër, është e nevojshme krijimi i strukturave të posaçme për realizimin e studimeve për faktorët e riskut dhe shkaqet që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve. Ky fenomen duhet të analizohet në të gjitha dimensionet e tij duke përfshirë disa nivele si shkollë, familje, komunitet.

Politika penale duhet të parashikoj mënyra të specializuara për të krijuar shërbime me qëllim reduktimin e motivimit dhe kushteve që inkurajojnë shkeljen e ligjit. Në qendër të këtyre masave duhet të vendoset fëmija, të cilit i duhet siguruar një zhvillim harmonik, duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fazat e hershme të fëmijërisë. Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria, ku të miturit duhet të kenë një rol aktiv dhe partneriteti brenda shoqërisë dhe mos të trajtohen si objekte kontrolli. *Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën. Duhet të zhvillohen shërbime dhe programe të bazuara në komunitet për parandalimin ekriminalitetit të të miturve, në mënyrë të veçantë aty ku ende nuk ka agjenci. Agjencitë formale të kontrollit social zakonisht duhen përdorur vetëm si mjet i fundit*³¹³.

Sjelljet ose veprimet e të miturve që nuk përputhen me vlerat e përgjithshme të shoqërisë shpesh janë pjesë e procesit të rritjes. Në pjesën më të madhe të individëve, këto sjellje antishoqërore kanë prirje të zhduken spontanisht, gjatë kalimit në moshën e rritur. Për këtë shkak duhet të krijohen struktura përkatëse në shkollë, familje dhe komunitet për edukimin e të rinjve me frymën e ligjit, me pasojat që sjell kryerja e veprave penale jo vetëm për ta, por edhe për viktimat

³¹¹ Progresraporti i Komisionit Evropian i vitit 2014 dhe ai i vitit 2016.

³¹² Raport i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2015 i mundshëm në: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/03/Raporti-PP-2015-FINAL.pdf> aksesuar në dhjetor 2016.

³¹³ Drejtësia për të mitur, Një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri, UNICEF, Komisioni Evropian dhe SIDA, fq. 19.

e krimit. Një ndër masat e parashikuara nga legjislacioni ynë janë **masat edukuese, për ekzekutimin e të cilave duhen të ngrihen qendra të veçanta që ofrojnë këto shërbime vetëm për të mitur**. Ky proces duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës, i cili duhet të identifikojë të miturit që në momentet e para kur fëmija gjendet në konflikt me ligjin.

Në fokus të të gjithë programeve parandaluese të kriminalitetit të të miturve është mirëqenja e të miturit. Politikat e parandalimit të kriminalitetit përveçse duhet të bazohen në studime, ato duhet të jenë fleksibël dhe të azhurnuara me studimet sistematike e përpunimit të masave të nevojshme më adeguate. Mungesa e statistikave të sakta (nuk funksionon akoma Sistemi i Integruar i të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur) pengon hartimin e strategjive konkrete dhe të detajuara për përmirësim e shërbimeve të caktuara. Pra, **programet e edukimit duhet të jenë koherente me faktorët dhe shkaqet që paraqet kriminaliteti te të miturit**.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në disa nivele është faktor kyç në realizimin e rezultateve të dëshiruara. Për sa është analizuar edhe më sipër, ngritja e insitucioneve të reja duhet të shoqërohet me ngritjen e mekanizmave efektivë për bashkëpunimin e vazhdueshëm të organeve të sistemit të drejtësisë, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në parandalimin e krimit. Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë midis organeve të sistemit të drejtësisë dhe insitucioneve shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit të Provës, Policisë, Prokurorisë, Organeve të Vetëqeverisjes Vendore dhe njësisive për mbrojtjen e fëmijës, Shërbimit Social, insitucioneve të arsimit, shëndetësisë dhe aktorëve të tjerë me ndikim në komunitet. Diskutimi i rregullt nga profesionistët e ligjit nëpërmjet takimeve të përfaqësuesve të organeve të mësipërme është e domosdoshme, pasi secili prej tyre sjell përvojën e problematikave e hasura në trajtimin e çështjeve nga perspektiva e tyre. Ata duhet të identifikojnë format e përshtatshme të bashkëpunimit, pasi sjellja e secilit është kritike për arritjen e një rezultati pozitiv në drejtësinë penale për të mitur.

Parandalimi i kriminalitetit duhet të ketë aspekt sa më të gjerë, e në këtë kontekst nuk mund të përjashtohet edhe media, e cila konsiderohet si pushteti i katërt. Media është informatori kryesor dhe ka një ndikim të padiskutueshëm sidomos te të rinjtë. Në këtë kuadër, qeveria duhet të parashikojë se pjesë e detyrueshme e programeve televizive duhet të jetë edhe informimi i publikut për njohjen e ligjeve në këtë fushë, rastet e përhapjes së përvojës pozitive për

respektimin e ligjeve, rastet pozitive të parandalimit të veprave penale etj. Drejtësia penale për të mitur duhet të ketë në mënyrë të detyrueshme hapsirën e vetë në media. Ngritja e vetëdijes së publikut është një element shumë i rëndësishëm në njohjen e pasojave negative dhe parandalimin e kriminalitetit të të miturit.

5.6 Marrëdhënia midis kriminalitetit, kuadrit ligjor dhe praktikave të ndëshkimit.

Në të gjitha vendimmarrjet që kanë të bëjnë me fëmijën, si nga institucionet publike ashtu edhe nga institucionet private, interesi më i lartë i të miturit duket të jetë prioritar³¹⁴. I mituri në konflikt me ligjin është në proces zhvillimi, dhe udhërrëfyes në marrjen e vendimeve kundrejt tij duhet të jetë realizimi i mirëqenies së tij, pra realizimit të zhvillimit psikologjik, fizik dhe social të të miturit³¹⁵.

Nga interpretimi logjik dhe sistematik i dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijës³¹⁶, arrihet në përfundimin se privimi nga liria është e dëmshme për fëmijët. Në këtë kuadër, në pikën “b” të këtij neni parashikohet se ndalohet privimi i lirisë së të miturit në mënyrë të paligjshme dhe kjo masë mund të përdoret vetëm si masa e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër që të jetë e mundur.

5.6.1 Marrëdhënia ndërmjet praktikave të ndëshkimit dhe kuadrit ligjor, tendenca ndër vite.

Në vlerësimin e marrëdhënies ndërmjet praktikave të ndëshkimit dhe kuadrit ligjor janë analizuar të dhënat e raportuara nga Prokurori i Përgjithshëm në lidhje me gjendjen e kriminalitetit. Nga të dhënat statistikore rezulton qartë se, organi i akuzës ka ndryshuar qasje në lidhje me kërkesat në gjykatë për caktimin e dënimit ndaj shkelësve të mitur të ligjit. Deri në vitin 2013 politika penale ndaj të miturve në konflikt me ligjin ka qënë drejt edukimit të autorit nëpërmjet ndëshkimit, ku shumicën dërmuese është kërkuar nga prokuroria dhe vendosur nga gjykata, caktimi i dënimeve me burgim.

Nga të dhënat statistikore rezulton qartë se vitet e fundit, kanë pësuar një rritje të ndjeshme kërkimi nga prokurorët i aplikimit të dënimeve alternative, ndaj të pandehurve të mitur. Kërkesat

³¹⁴ Neni 3 i Konventës së OKB-së Për të Drejtat e Fëmijës.

³¹⁵ Rregullat e Pekinit vënë në themel të tyre mirëqënien e të miturit.

³¹⁶ Neni 37 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

e prokurorit në caktimin e dënimeve, duke kërkuar aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, kanë ndryshim më të dukshëm në vitin 2014. Në vazhdim, organi i akuzës ka ndjekur një politikë penale korrektuese ndaj kërkimit të dënimit me burgim, duke konsideruar si masë më të përshtatshme aplikimin e pezullimit të dënimit me burgim dhe vënien e të miturit në konflikt me ligjin në provë. Qasja sociale ndaj caktimit të dënimit nga prokurorët është vlerësuar se është në interes të miturit, që nxit dhe krijon mundësinë e ruajtjes së kontakteve të të miturit me familjen, shkollën, punën e shoqërinë

Nga analiza e kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë penale për të mitur rezulton se në ligjin penal nuk ka pasur ndryshime në lidhje me caktimin e dënimeve për të miturit në konflikt me ligjin. Ndryshimi i qasjes së organit të akuzës në lidhje me përshtatshmërinë e llojit të dënimit ka ardhur si rezultat i politikave qeveritare dhe orientimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në vitin 2013, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin “*Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar*”³¹⁷. Nëpërmjet tij është unifikuar praktika dhe garancitë proceduriale për të miturin, ku i është kushtuar vëmendje mbrojtjes së të drejtave të të miturve në procesin penal.

Në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2014, është referuar shprehimisht orientimi i prokurorëve ndaj caktimit të masave të dëmit. Kërkesat për caktimin e dënimit me burgim duhet të jenë proporcionale duke marrë në konsideratë rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të kryerjes së saj.

Po ashtu, në Qarkoren e Prokurorit të Përgjithshëm, datë 06.04.2016, Prokuroria e Përgjithshme ka orientuar prokurorët të zbatojnë parimin e proporcionalitetit në kërkesat drejtuar gjykatës për aplikimin e masave të sigurisë personale. Prokurorëve pranë gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, i është rekomanduar se në kuadër të efikasitetit të veprimtarisë hetimore, ti kushtojnë vëmendje të veçantë grupeve vulnerabël, të miturve dhe grave si dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tyre, në masat e sigurimit personal të kërkuara ndaj tyre. Masat e sigurimit ekstreme si “*arrestimi në burg*”, të bazohen në parimin e proporcionalitetit duke mbajtur në vlerësim rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe të autorit.

³¹⁷ Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr.3, datë 25.11.2013 “*Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar*”.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave çdo vit përcakton prioritetet e politikës penale në luftën kundër kriminalitetit. Me vendimin Nr.324, datë 12.04.2017, i janë përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin 2017. Ndër të tjera është parashikuar se: “ ... ii) *Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme; ... iv) Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e veprave penale me subjekt të procedimit penal të miturit, viktimat e dhunës në familje dhe atyre të trafikimit;...*”³¹⁸. Gjithashtu, organi i akuzës duhet të ketë në vëmendje të veçantë shkurtimin e kohës së paraburgimit për rastet e të miturve në konflikt me ligjin.

Nga sa është analizuar edhe më sipër, nga studimi i të dhënave është arritur në konkluzionin se **kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur nga viti 2014 e në vazhdim**. Ndryshimi i legjislacionit penal në lidhje me caktimin e dënimit për të miturit në konflikt me ligjin ka hyrë në fuqi në vitin 2018³¹⁹, pra ndryshimi i qasjes së organit të akuzës për praktikën e ndëshkimit nuk ka ardhur si pasojë e ndryshimit të kuadrit ligjor.

5.6.2 Marrëdhënia ndërmjet kriminalitetit dhe praktikave të ndëshkimit.

Kriminaliteti i të miturve është bërë gjithnjë e më i komplikuar dhe më universal me kalimin e viteve. Në vendin tonë programet e parandalimit të kriminalitetit të të miturit në konflikt me ligjin ose janë të pakta në numër, ose gati nuk ekzistojnë. Për zgjidhjen e problemit të kriminalitetit të të miturve pjesa më e madhe e vendeve në zhvillim kanë bërë pak ose aspak për të miturit në konflikt me ligjin. Programet parandaluese në këtë drejtim, në nivel kombëtar apo rajonal kanë qënë të pamjaftueshme dhe efekti i tyre ka qënë i dobët. Vërehet se aktualisht ka vështirësi në adresimin e situatës ekzistuese, marrjen e veprimeve sistematike, si dhe në përcaktimin e objektivave efektiv edukativo-socialë për të miturit në konflikt me ligjin.

³¹⁸ VKM Nr.324, datë 12.04.2017 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017”

³¹⁹ Datë e hyrjes në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Në lidhje me efektet e dënimit me burgim në sjelljen e të miturit në të ardhmen, janë kryer studime të cilat kanë arritur në përfundime të ndryshme. Disa studime³²⁰ kanë arritur në përfundimin se aplikimi i llojit të dënimit me burgim të të miturit rrit recidivizmin³²¹. Analistë të tjerë kanë konkluduar se heqja e lirisë nuk ka efekt mbi recidivizmin, (qëndrim i mbajtur nga Gottfredson në vitin 1999³²² ; Smith dhe Akers në vitin 1993³²³). Në këtë kuadër është arritur në përfundimin se nga të dhënat e analizuara, burgimi nuk ka sjellë uljen e recidivizmit të të miturit³²⁴. Ndërsa, studiues të tjerë pranojnë se dënimi me burgim ka efekte pozitive në reduktimin e recidivizmit. Këto përfundime janë mbajtur relativisht me herët në kohë, si studimi i Murray dhe Cox në vitin 1979³²⁵ dhe studimi i Brennan dhe Med-nick në vitin 1994³²⁶. Pjesa më e madhe e studimeve³²⁷ pranon se, efektet e heqjes së lirisë sidomos të rinjë janë negative kryesisht në dy drejtime³²⁸.

Së pari, duke u “*infektuar*” nga ambienti i izolimit, pasi i mituri akumulon sjellje negative nga të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, i mituri i cili akoma nuk e ka formuar plotësisht personalitetin e tij, fillon ta konsiderojë pasojë normale izolimin nga shoqëria, për shkak të veprës penale.

Së dyti, gjatë izolimit veçanërisht i mituri, pengohet të zhvillohet normalisht duke vështirësuar riintegrimin, përshtatjen me tregun e punës dhe rrjedhimisht ul mundësinë e punësimit³²⁹. Në këtë aspekt, vlen të theksohet edhe ndërprerja e proceseve të edukimit, si vazhdimi i shkollës së mesme, ku reduktimi i viteve të shkollimit zvogëlon tregun e punës³³⁰. Mungesa e të ardhurave është konsideruar si një faktor që ndikon në rritjen e sjelljes kriminale sidomos të të miturit që

³²⁰ Spohn, Cassia, and David Holleran. 2002. "The Effects of Imprisonment on Recidivism Rates of Felony Offenders: A Focus on Drug Offenders." *Criminology* 40: 329-357

³²¹ Bernburg, Jon Gunnar, Marvin D. Krohn and Craig J. Rivera. 2006. "Official Labeling, Criminal Embeddedness and Subsequent Delinquency: A Longitudinal Test of Labeling Theory." *Journal of Research in Crime and Delinquency* 43(1): 67- 88

³²² Gottfredson, Don. 1999. *Effects of Judges' Sentencing Decisions on Criminal Careers* Washington, D.C. National Institute of Justice: Research in Brief.

³²³ Smith, Linda. and Ronald Akers 1993. "A comparison of recidivism of Florida's Community Control and Prison: A five-year Survival Analysis." *Journal of Research in Crime and Delinquency* 30(3): 267-292

³²⁴ Wilson, David B, Catherine Gallagher and Doris MacKenzie. 2000. "A Meta Analysis of Corrections-Based Education, Vocation and work Programs for Adult Offenders." *Journal of Research in Crime and Delinquency* 37(4): 347-368

³²⁵ Murray, Charles and Louis Cox. 1979. *Beyond Probation: Juvenile Corrections and the Chronic Delinquent* Beverly Hills: Sage Publications

³²⁶ Brennan, Patricia A. and Sarnoff A. Mednick. 1994. "Learning Theory Approach to the Deterrence of Criminal Recidivism." *Journal of Abnormal Psychology* 103(3): 430-440.

³²⁷ Bernburg, Jon Gunnar, Marvin D. Krohn and Craig J. Rivera. 2006. "Official Labeling, Criminal Embeddedness and Subsequent Delinquency: A Longitudinal Test of Labeling Theory." *Journal of Research in Crime and Delinquency* 43(1): 67- 88

³²⁸ Spohn, Cassia, and David Holleran. 2002. "The Effects of Imprisonment on Recidivism Rates of Felony Offenders: A Focus on Drug Offenders." *Criminology* 40: 329-357.

³²⁹ Granovetter, Mark. 1995. *Getting a Job: A Study of Contacts and Careers* Chicago: University of Chicago Press

³³⁰ Sampson, RJ and JH Laub. 1997. "A Life Course Theory of Cumulative Disadvantage and the Stability of Delinquency." *Advances in Criminological Theory* 7:133-161

kanë qënë një herë në konflikt me ligjin³³¹. Të miturit e dënuar me burgim në përgjithësi etiketohen nga shoqëria si persona me sjellje devijante³³². Kjo situatë gjithashtu ndikon në punësimin (të ardhurat) e të miturve³³³ si dhe në shkallën e recidivizmit³³⁴.

Aktualisht është konstatuar se ekziston një lidhje shkakësore midis mos vazhdimit të shkollës së mesme dhe kryerjes së aktivitetit kriminal në të ardhmen të të miturit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës³³⁵ dhe në Mbretërinë e Bashkuar janë kryer studime të mirëfillta, për të përcaktuar ndikimin që kanë politikat e ndjekura nga qeveria në lidhje me arsimimin e të miturve dhe pasojave që sjellin këto politika në kriminalitetin e të miturve. Në të dyja shtetet u arrit në konkluzionin e njëjtë se, ekzistonte një lidhje e zhdrejtë ndërmjet shkollimit dhe nivelit të delinkuencës të të miturit. Konkretisht, ulja e viteve të shkollimit të të miturit shkaktonte si pasojë rritjen e nivelit të kriminalitetit, përfundim ky i arritur edhe në studimet e viteve të fundit³³⁶.

Në vitin 2013, Anna Aizer dhe Jesef J Doyle kryen një studim në Çikago mbi efektet e burgimit të të miturit³³⁷. Në studim u ekzaminua në mënyrë të hollësishme rreth 35.000 të rritur, të cilët në kohën e miturisë kanë qënë në konflikt me ligjin. Metodologjia e punimit ka qënë identifikimi dhe krahasimi i dy grupeve të të miturve të cilët kanë kryer vepër penale. Në grupin e parë, bënë pjesë të miturit që ishin dënuar me burgim. Ndërsa, në grupin e dytë përfshiheshin të miturit që kishin kryer vepra penale të njëjta ose të ngjashme me ata të grupit të parë dhe nuk ishin dënuar me heqje lirie. Ndryshimi i dënimit vjen si rezultat i bindjes së brendshme të gjyqtarëve të ndryshëm për politikën e ndëshkimit që ndjek gjithsecili prej tyre. Në këto kushte, ndodh që për vepra penale të njëjta ose të ngjashme të miturit të jenë dënuar në disa raste me lloj dënimi me burgim dhe në disa raste të tjera me masa edukuese.

Rezultatet u analizuan në dy nivele të ndryshme:

³³¹ Sampson, RJ and JH Laub. 1997. "A Life Course Theory of Cumulative Disadvantage and the Stability of Delinquency." *Advances in Criminological Theory* 7:133-161

³³² Bernburg, Jon Gunnar, Marvin D. Krohn and Craig J. Rivera. 2006. "Official Labeling, Criminal Embeddedness and Subsequent Delinquency: A Longitudinal Test of Labeling Theory." *Journal of Research in Crime and Delinquency* 43(1): 67- 88

³³³ Cameron, Stephen and James J. Heckman, 1993. "Determinants of Young Male Schooling and Training Choices," NBER working Paper 4327

³³⁴ Kling, Jeffrey and John Tyler. 2007. *Barriers to Reentry? The Labor Market for Released Prisoners in Post-Industrial America* Edited by Shaën Bushway, Michael Stoll, and David Weiman (New York: Russell Sage Foundation Press).

³³⁵ Lochner, Lance and Enrico Moretti. 2004. "The Effect of Education on Crime: Evidence from Prison Inmates, Arrests and Self-Reports." *American Economic Review* 94(1): 155-189

³³⁶ Cook, Philip and Songman Kang. 2013. "Birthdays, Schooling and Crime: new Evidence on the Crime-Dropout Nexus" NBER working Paper 18791

³³⁷ Anna Aizer dhe Jesef J. Doyle "Juvenile incarceration, human capital and future crime: Evidence from random-Y-assigned judges, revista National Bureau of Economic Research, Qershor 2013.

1. Përqindjen e ndjekjes së studimeve të mesme nga të miturit në konflikt me ligjin dhe

2. Përqindjen e dënimit me burgim kur ata rriteshin.

Nga studimi rezultoi se burgimi i të miturve kishte “*efekte të rëndësishme negative*”. Në lidhje me edukimin, të miturit që kishin qenë në burg kishin 39% më pak mundësi të vazhdonin shkollën e mesme se të miturit e tjerë në të njëjtin komunitet. Gjithashtu, të miturit e burgosur kishin 13% më pak mundësi se të miturit e tjerë të dënuar me masa edukative, për të vazhduar arsimin e mesëm.

Megjithëse, supozohet se aplikimi i dënimit me burgim duhet të ndikojë në uljen e nivelit të kriminalitetit, nga të dhënat e analizuar rezultoi se, burgimi i të miturve shtonte mundësinë e recidivizmit të tyre në të ardhmen. Të miturit që ishin dënuar me burgim si rezultat i procesit penal kishin 67 % më shumë mundësi të burgoseshin përsëri deri në moshën 25 vjeçare. Nga studimi rezultoi gjithashtu se, të miturit ndaj të cilëve ishte aplikuar masa e dënimit me burgim ishin më të prirur të kryenin krime të dhunshme, të vetëvriteshin, të kryenin krime kundër pronës dhe krime në fushën e narkotikëve.

Si përfundim, arrijmë në konkluzionin se politikat penale që kanë qasje drejt ndëshkimit me burgim të të miturit, duhet të marrin në konsideratë faktin se efekti i tyre mbi recidivizmin është i dyanshëm. Nga njëra anë ndëshkimi, sidomos me lloje dënimi ekstreme, si heqja e lirisë, ndikon në reduktimin e recidivizmit për shkak të frikës nga sanksioni. Nga ana tjetër, potencialisht burgimi si rezultat i kryerjes se veprës penale ndikon në rritjen e recidivizmit, për shkak të influences negative në formimin social të individit, dhe akumulimit të faktorëve të tjerë negativë gjatë burgimit, të cilët rrisin mundësinë e kryerjes se veprave penale në të ardhmen.

Për të arritur në përfundime në lidhje me marrëdhënien që ekziston ndërmjet kriminalitetit të të miturit në vendin tonë dhe praktikave të ndëshkimit, do të analizojmë të dhënat e marra nga dy burime informacioni zyrtar. **Së pari**, të dhënat statistikore të raportuara nga Prokurori i Përgjithshëm³³⁸, të cilat paraqesin gjendjen e kriminalitetit nga organi i akuzës, pra të miturit të

³³⁸ Në këtë studim janë analizuar të dhënat e paraqitura nga Prokurori i Përgjithshëm në Raportin “Mbi gjendjen e kriminalitetit” për secilin nga vitet për periudhën kohore 2007-2018.

hetuar. **Së dyti**, të dhënat e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë³³⁹, të cilat paraqesin gjendjen e kriminalitetit duke iu referuar të miturve të dënuar.

Sipas statistikave të raportuara nga Prokurori i Përgjithshëm³⁴⁰, për periudhën 2007-2018, rezulton se **nga viti 2007 deri në vitin 2012 do të vëmë re një tendencë rritje të ndjeshme të numrit të të miturve të përfshirë në aktivitete kriminale**. Në vitin 2012 rezultojnë 1310 të mitur në konflikt me ligjin, që përbën një rritje prej 29,06 % në krahasim me vitin 2011³⁴¹. **Nga viti 2013 deri në vitin 2018, konstatojmë një tendencë ulje të numrit të të miturve të moshës 14 deri 18 vjeç, të përfshirë në një hetim penal**. Megjithatë, kriminaliteti i të miturve ka qëndruar në nivele të larta deri në vitin 2015. Konkretisht, në vitin 2013 rezultojnë 911 të mitur në konflikt me ligjin³⁴²; në vitin 2014 rezultojnë 1013 të mitur në konflikt me ligjin³⁴³; dhe në vitin 2015 rezultojnë 978 të mitur në konflikt me ligjin³⁴⁴.

Të njëjtat përfundime marrim edhe nga të dhënat e Vjetarit Statistikor³⁴⁵ të Ministrit të Drejtësisë. Në periudhën 2005-2015 janë dënuar nga gjykatat penale Shqiptare 5696 (pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) të mitur. Viti gjatë të cilit ka pasur më shumë raste të të miturve të dënuar është përsëri viti 2012 me 883 (tetëqind e tetëdhjetë e tre) raste. Mesatarja e të miturve të dënuar çdo vit është afërsisht 570 (pesëqind e shtatëdhjetë) raste çdo vit. Krimet në raport me kundërvajtjet penale të kryera nga të miturit janë më të shumta në numër, ku krimet zënë 85 % të kriminalitetit në total, ndërsa kundërvajtjet vetëm 15 %. Kriminaliteti i të miturve shënon një raport tepër dinamik kundrejt kriminalitetit në total. Në vitin 2012, të dënuarit në moshë të mitur shënuan 10% të totalit, duke e bërë situatën kriminale të këtij viti mjaft problematike sa i takon kriminalitetit me autor të miturit. Në vite të ndryshme ky raport lëviz me 3 deri 10 për qind.

Për të vlerësuar praktikën e ndëshkimit që ka përdorur vendi ynë janë analizuar dokumente zyrtare, konkretisht Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit”. Në raporte citohet shprehimisht se deri në vitin 2013 nga prokuroria është ndjekur një qasje ndëshkuese ndaj autorëve të mitur, që nënkupton se lloji i dënimit të kërkuar ka qënë kryesisht ai

³³⁹ Në këtë studim janë analizuar të dhënat e paraqitura nga Ministri i Drejtësisë në dokumentin “Vjetarë Statistikorë” për secilin nga vitet për periudhën kohore 2005-2018.

³⁴⁰ Shih më sipër në pjesën 2.1 Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri, ku janë paraqitur në mënyrë të detajuar këto të dhëna.

³⁴¹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2012, faqe 221-222.

³⁴² Shifër e cila përbën një ulje prej 30 % të kriminalitetit në krahasim me vitin 2012.

³⁴³ Shifër e cila përbën një rritje prej 11 % të kriminalitetit në krahasim me vitin 2013.

³⁴⁴ Shifër e cila përbën një ulje prej 3,5 % të kriminalitetit në krahasim me vitin 2014.

³⁴⁵ Vjetari Statistikor në Ministrinë e Drejtësisë, e mundshme në <https://drejtesia.gov.al/statistika/>

me “burgim”. Sistemi i administrimit të drejtësisë për të miturit, rezulton se për shkak edhe të dispozitave edhe të mënyrës së zbatimit të tyre ose pamundësisë së zbatimit të tyre³⁴⁶, të ketë pasur më shumë karakter ndëshkues se sa edukues, rehabilitues dhe riintegruer. Po ashtu, UNICEF³⁴⁷ në vitin 2012 ka kryer një studim në 10 vende, pjesë e të cilit ishte edhe Shqipëria. Nga të dhënat e analizuara rezultonte se **Shqipëria ishte vendi me përqindjen më të lartë të dhënies së dënimit me burg për të miturit nga 14-18 vjeç.**

Nga të dhënat statistikore rezulton qartë se, vitet e fundit duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim, kanë pësuar një rritje të ndjeshme kërkitimi nga prokurorët i aplikimit të dënimeve alternative, ndaj të pandehurve të mitur. Për shkaqet e paraqitura në mënyrë të hollësishme më sipër në këtë punim³⁴⁸, gjatë vitit 2014 prokurorët kanë ndjekur një politikë penale korrektuese³⁴⁹ ndaj të miturve. Kërkesa për caktimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin Penal nga organi i akuzës, është konsideruar si masa më e përshtatshme në interes të të miturit. Si rrjedhim, nga viti 2014, kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg kanë ardhur duke u ulur çdo vit.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme arrijmë në përfundimin se në vendin tonë janë aplikuar deri në vitin 2014, lloje të dënimit me efekt ndëshkues, ku në përgjithësi është caktuar dënimi me burgim. Pavarësisht ndëshkimit të të pandehurve të mitur me lloje dënimi ekstreme, duke u hequr lirinë, ka rezultuar se ky fenomen nuk ka ndikuar në uljen e kriminalitetit. Përkundrazi, niveli i kriminalitetit ka ardhur duke u rritur, ku në vitin 2012 ka qënë në pikën e vetë më të lartë dhe ka vazhduar të ketë nivele të tilla deri në vitin 2015. Dënimi me burgim nuk e ka arritur qëllimin e parandalimit të përgjithshëm dhe të posaçëm të kriminalitetit. Duke iu referuar të dhënave rezulton se ky lloj dënimi, më shumë ka shfaqur prezencën e “efekteve negative” të burgimit sesa efektin parandalues të tij.

Edhe po të analizojmë pjesën e dytë të kurbës së kriminalitetit (pjesa ku kriminaliteti vjen duke u ulur) në relacion me praktikën e ndëshkimit, rezultati është i njëjtë. Qasja më sociale ndaj

³⁴⁶ P.sh në nenin 46 të Kodit Penal parashikohet se masat edukuese mund të jepen nga gjykata ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masa edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi. Aktualisht, (në vitin 2019) akoma nuk është plotësuar kuadri i nevojshëm ligjor dhe mekanizmat institucional për zbatimin e këtyre masave. Në këto kushte, kjo dispozitë nuk ka gjetur zbatim në praktikë, pasi gjykata nuk mund të caktonte një masë edukuese e cila nuk mund të ekzekutohej.

³⁴⁷ Vlerësimi i impaktit të reformave në fushën e drejtësisë për fëmijët në disa vende (2006-2012), UNICEF, faqe

³⁴⁸ Shih pjesën “Të dhënat statistikore për Shqipërinë mbi praktikën e ndëshkimit”.

³⁴⁹ Shkak i ndryshimit të qasjes së prokurorëve në kërkesat për caktimin e dënimit, kanë qënë edhe orientimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për më tepër shih Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitin 2014.

praktikave të dënimit, duke aplikuar alternativat e dënimit me burgim nga viti 2014 e në vazhdim, rezulton se reflektohet me ulje të nivelit të kriminalitetit.

Në këto kushte, në hartimin e politikave penale si dhe në specializimin e organeve që merren me administrimin e drejtësisë, duhet tu kushtohet vëmendje e posaçme efekteve negative të izolimit. Në vendin tonë këto efekte shtohen edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës aktuale në institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim, ku të miturit akoma vuajnë dënimin në seksione të posaçme të institucioneve të krijuara për të rriturit. Ashtu si është konstatuar edhe nga institucionet ndërkombëtare, realizimi i të drejtave të parashikuara në ligj, akoma hasin vështirësi për tu realizuar, në institucionet e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit³⁵⁰.

Standardet ndërkombëtare të vendosura për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, jo pa qëllim, synojnë mos ndërprerjen e proceseve të zhvillimit shoqëror, moral, shpirtëror dhe fizik të miturit në çdo rast³⁵¹. Të gjitha vendimmarrjet që kanë të bëjnë me të miturit duhet të synojnë mirëritjen dhe vazhdimin e edukimit, pasi në të kundërt do të vështirësohej riintegrimi i miturit në shoqëri, faktor ky kyç për parandalimin e posaçëm të të miturit. Për sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se zbatimi i legjislacionit i brendshëm për të miturit, duhet të synoj aplikimin e masave edukative në vend të privimit nga liria.

³⁵⁰ Nga Komiteti i Helsinkit është vlerësuar se institucionet e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit kanë mungesë stafi të specializuar për tu marrë me fëmijët.

³⁵¹ Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Rregullat e Riadit, Rregullat e Pekinit etj.

KAPITULLI 6 –

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME BAZIKE MBI KRIMINALITETIN MINOREN NË SHQIPËRI

Rekomandimet shërbejnë si udhëzues për përpjekjet që bën e gjithë infrastruktura shtetërore e shoqërore shqiptare për reformim e për të promovuar pavarësinë e sistemit të prokurorisë, gjyqësorit dhe përgjegjshmërinë për të inkurajuar një zbatim më efektiv, efikas e të drejtë të kodit penal për të mitur.

Sikundër e demonstroi ky punim, zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin në vendin tonë, duhet të realizohet duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale.

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve duhet të jetë një ndër prioritetet kyçe të agjencive ligjzbatuese shqiptare. Rekomandimet shërbejnë gjithashtu si udhëzues për të promovuar pavarësinë e gjyqësorit dhe përgjegjshmërinë e tij për të inkurajuar një zbatim më efektiv, efikas e të drejtë të dispozitave ligjore në fushën objekt studimi.

PËRFUNDIME:

1. Shqipëria çdo ditë e më shumë po e përshtat legjislacionin e saj për të miturit me legjislacionin e përparuar të vendeve Europiane, por si çdo sistem gjykimi europian edhe sistemi ynë, nuk arrin të plotësojë 100 % nevojat e veçanta të të miturve në konflikt me ligjin.
2. **Kriminaliteti tek të miturit në vendin tonë ka kulmuar reth vitit 2012 me një tendencë drejt rënies vitet e fundit. Ai aktualisht shfaqet i një shkalle mesatare agresiviteti.**

- 3. Veprat penale më të shpeshta të kryera nga të miturit në Shqipëri janë vjedhjet, por vitet e fundit konstatohet përfshirja e të miturve në vepra penale të rënda, si plagosjet, vrasjet, tregtimi i lëndëve narkotike etj.**
- 4. Studimi ashtu si konkluzionet recente të Këshillit të Europës, tregoj se të drejtat e fëmijëve dhe veçanërisht të atyre në konflikt me ligjin për t'u dëgjuar, informuar, mbrojtur dhe për të mos u diskriminuar nuk garantohen gjithmonë në praktikën juridike shqiptare të hetimit, gjykimit e vuajtjes së dënimit.**
- 5. Heqja e lirisë me anë të masavë të sigurimit personal ekstreme (ndalimit, arrest në burg, arrest në banesë) si dhe dënimi me burg i të miturve në Shqipëri, në kundërshtim me kërkesat e Konventave ndërkombetare për të Drejtat e Fëmijëve, nuk konsiderohet vetëm si masa e fundit ekstreme e miratuar për kohën më të shkurtër të mundshme, por si procedurë normale hetimi e gjykimi.**
- 6. Paraburgimi i të miturve dhe privimi i lirisë së tyre përbëjnë pengesa serioze për të realizuar të drejtat e tyre civile të cilat për fat të mirë janë të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore. (konventa, kushtetutë, kode, ligje, vendime etj.)**
- 7. Praktikrat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, praktikrat e gjykatave të zakonshme, media e rrjetet sociale raportojnë situata të shumta të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve që janë dhe shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndë, duke iu referuar nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), nenit 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), nenit 14 (ndalimit të diskriminimit).**
- 8. Evidentohet mungesë spcializimi për aktorët kryesorë që merren me implementimin e derjtësisë penale ndaj të miturve në konflikt me ligjin (oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë, gjyqtarë, punonjës të shërbimit të provës dhe administratës së burgjeve),**

9. Evidentohet mungesë psikologësh e punonjësish socialë të specializuar për të punuar posaçërisht me fëmijët e dënuar. Duke qenë se psikologët janë me profil të përgjithshëm dhe intervistat e tyre nuk trajtojnë nevojat specifike të fëmijëve

REKOMANDIME

1. Ashtu si jurisprudenca e konsoliduar Europiane edhe Shqipëria ka nevojë të hedhë hapa konkret për një drejtësi miqësore për fëmijët e për të gjithë të miturit. Në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve ndaj të miturve, mund të sigurohet mundësia që i mituri të dëgjohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe të garantohen procedura administrative/ gjyqësore të pavarura të apelit dhe të paanshmërisë kur të drejtat e tyre janë shkelur.
2. Ka nevojë të njihet e drejta e çdo fëmije në konflikt me ligjin për t'u trajtuar në përputhje me dinjitetin e vet duke marrë parasysh moshën e fëmijës dhe objektivin kryesor të shoqërisë i cili duhet të jetë riintegrimi i tij shoqëror. Interesat më të mira të fëmijës të kenë rëndësi parësore në të gjithë veprimet në lidhje me të miturit, të kryera nga institucione kompetente publike ose private në çështjet sociale, gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative.
3. Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Shqipëria ka nevojë të promovojë zbatimin e Udhëzimeve për Drejtësi në masën e fëmijëve duke arritur në forcimin e aksesit, trajtimit dhe pjesëmarrjes së të miturve në procedura civile, administrative dhe penale. Kjo arrihet në një seri veprimesh të Komitetit Evropian për Bashkëpunimin Juridik (CDCJ), të Programit për arsimin e të drejtave të njeriut për profesionistë juridikë (HELP) dhe organeve të tjera përkatëse. Duke bërë këtë, mund të merren masa për të zbatuar Protokollin e Tretë Fakultativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës në procedurën e komunikimit.
4. Gjithë organet ligjzbatuese në Shqipëri të jenë koshiente të mbrojnë fëmijët nga privimi i lirisë. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve privimi i

lirisë duhet të përdoret si një masë ekstreme dhe për periudhën më të kufizuar kohore që të jetë e mundur.

5. Dënimi me burgim për të miturit të mund të mënjanohet për veprat me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Institucionet kompetente duhet të marrin në konsideratë rrethanën që i mituri është në proces zhvillimi dhe udhërrëfyes në marrjen e vendimeve kundrejt tij duhet të jetë realizimi i interesit më të lartë të miturit. Në këto kushte, për vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore, brenda parashikimeve ligjore, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të orientohen të aplikojnë shmangien nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative.
6. Do të duhet të përmirësohen kushtet materiale për regjimin e paraburgimit e burgimit të të miturve, në përputhje me standardet e Këshillit i Evropës, për zbatimin e rregullave evropiane për të miturit që kryejnë krime e janë subjekt i masave sanksionuese duke parandaluar torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruës.
7. Institucioni i Avokatit të Popullit, prokuroria, OJF-të e ndryshme të mund të vijojnë kontrollin nëpër institucionet e burgimit në lidhje me mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria prej keqtrajtimit dhe dhunës, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve periodike e të befasishme si dhe të përgatitjes së udhëzuesve praktikë për monitorimin e vendeve të privimit të lirisë. (IEVP-të dhe Ambjentet e paraburgimit.)
8. Interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm, i cili duhet të gjejë zbatim së pari në të drejtën penale, por edhe atë administrative dhe civile. Në këtë këndvështrim këshillohet që për krime të cilat viktimë është “shteti” dhe jo individi, për “mikrokrime” të rritet mosha për përgjegjësi penale duke e bërë tetëmbëdhjetë vjeç. Por këta idividë të “mbikqyren dhe këshillohen” si të mitur shoqërisht të rrezikshëm.
9. Ofrimi i sesioneve trajnuese për të miturit në komunitet, duke i ofruar mbështetje nga njëra anë subjektit të veprës penale që në këtë rast është i mitur dhe nga ana tjetër edhe viktimës dhe dëshmitarit të mitur, nëpërmjet përcimit të mbrojtjes sa më efektive të të

drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

10. Një mekanizëm i pavarur nga mekanizmat e brendshëm duhet të ekzistojë për monitorimin konstant të progresit në arritjen e objektivave, efektit të këtyre masave nëpërmjet monitorimit dhe planit fillestar të azhurnuar rregullisht. Kjo strategji të mund të implementohet dhe të monitorohet nga një organ i pavarur.
11. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve prokurorë dhe personelit të gjykatave në lidhje me mënyrat se si trajtohet një i mitur në konflikt me ligjin;
12. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor në raport me të miturit, duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij, në përputhje me standardet evropiane/ndërkombëtare; përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin në mënyrë të veçantë për mikrokriminalitetin e të miturve.
13. Sistemi audi-video incizues, i cili është element i rëndësishëm për drejtësinë e të miturve është instaluar thuajse në të gjitha gjykatat, duhet punuar për përdorimin i tij efektiv. Në mënyrë të veçantë kërkohet që i mituri në konflikt me ligjin në momentin e intervistimit të tij të gjendet në ambient familjar për të dhe lidhja audovizive të bëhet vetëm një herë me qëllim evitimin e “riviktimizimin” e të miturit.
14. Në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar ligji Nr.37/2017, datë 30.03.2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*” dhe ligji Nr.18/2017, “*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve*” që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Nevojë për vendin tonë është “*jetësimi*” i

institucioneve të përfshira në të. Institucione si Bashkia apo ente të tjera të përfshira në të pa llogaridhënie të drejtpërdrejtë në pushtetin egzekutiv, të mund të monitorohen nga një organ i pavarur në lidhje me veprimtarinë e tyre në fushën e të miturve nën përgjegjësi penale.

- 15.** Të mund të krijohen struktura të specializuara në institucionet e drejtësisë penale, të pajisura me kapacitetet, infrastrukturën, si dhe burimet e nevojshme (si financiare, ashtu edhe njerëzore) përgjegjëse për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin të adresuara për moshën të ndryshme të delinkuencës të miturve duke filluar nga 14 deri në 18 vjeç.
- 16.** Vazhdimi i programeve të trajnimit për përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale (oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë, gjyqtarë, punonjës të Shërbimit të Provës dhe administratës së burgjeve), në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.
- 17.** Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga moshën mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme. Aktualisht, kanë në strukturën e tyre psikolog, prokuroritë e vetëm disa retheve gjyqësore. Psikologët të mund të jenë të specializuar për grupmosha të ndryshme në raport me grupmoshat e deviancës fëmijërore.
- 18.** Bazuar në të dhënat e mbledhura në vite, rekomandohet si nevojë realizimi i analizave që trajtojnë fenomenet në mënyrë ndërdisiplinore, për të kuptuar cilat janë shkaqet dhe për të përcaktuar rrugët për përmirësimin e situatës.
- 19.** Rekomandohet krijimi i një plani kombëtar për të miturit nën moshën për përgjegjësi penale. Mungesa e një plani të tillë për parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në krim është sjellë në vëmendje edhe nga Avokati i Popullit.
- 20.** Forcimi i shtetit ligjor është një kusht themelor për konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social në vend. Suksesi i reformave të

drejtësisë varet në shkallë të madhe nga ndërveprimi mes institucioneve të pavarura gjyqësore dhe bashkëpunimi i ngushtë me palët e interesuara dhe shoqërinë civile.

- 21.** Drejtësi të aksesueshme, të përshtatshme me moshën, të shpejtë, efektive, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, si dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, integritetit dhe dinjitetit të fëmijës.
- 22.** Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit duke mbajtur në konsideratë detyrimin e vendit për të respektuar dhe për të garantuar të drejtat e parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- 23.** Rekomandohet ngritja dhe vënia në funksionim e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të Miturve dhe të Rinjve, si dhe të programit për parandalimin e ripërfshirjes së të miturve në vepra penale (recidivizmit), të cilat do të kenë në qendër të vëmendjes mbështetjen për fëmijët dhe familjet, veçanërisht, fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale dhe grupeve në risk apo të cënueshme (vulnerabël). Ky rekomandim nis nga parimi se parandalimi i krimit është zgjidhja më e mirë për fëmijët, familjet e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.
- 24.** Rekomandohet rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin nëpërmjet përfshirjes sociale të të miturve autorë të veprave penale dhe përfshirjen efektive të tyre në komunitet. Ky proces nuk duhet të lidhet domosdoshmërisht me kohën pas dënimit penal, por duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës që në momentet e para kur fëmija gjendet në konflikt me ligjin. Për realizimin e këtij objekti strategjik rekomandohet të parashikohet ndërveprim dhe bashkëpunim proaktiv mes institucioneve të ndryshme shtetërore, veçanërisht, të atyre që kanë fushë të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; bashkëpunim dhe koordinim midis organeve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve shtetërore: Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit të Provës, Policisë, Prokurorisë, organeve të

vetëqeverisjes vendore dhe njërive për mbrojtjen e fëmijës, Shërbimit Social, institucioneve të arsimit, shëndetësisë dhe aktorëve të tjerë me ndikim në komunitet.

- 25.** Bashkëpunimi, ndërveprimi dhe bashkërendim i institucioneve dhe i autoriteteve në nivel qendror dhe vendor të përfshira në administrimin e drejtësisë për të mitur. Kjo mundësohet nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të rrjetit ndërinstitutional në nivel qendror dhe funksionimin e komunitetit të praktikantëve në nivel vendor.
- 26.** Ofrimi i ndihmës juridike për përfituesit e mitur (dhe familjarët e tyre) që ky shërbim të jetë i shpejtë, profesional dhe efektiv. Skemë e re të ofrimit të ndihmës nga shteti për fëmijët nën dhe në moshën për përgjegjësi penale me tendenca delinkuenciale/recidiviste.
- 27.** Organizimin e fushatave sensibilizuese për aksesin e të miturve në drejtësi duke përfshirë këtu dhe fushatat për ndërgjegjësimin lidhur me moshën për përgjegjësi penale. Këshillohet që këto fushata të trasmetohen në masmedia (përfshi këtu dhe mediat sociale) në të cilat kanë akses tek të miturit.
- 28.** Parandalimin e kriminalitetit duke e konkretizuar me aktivitete që lidhet me krijimin e Qendrës për Parandalimin e Kriminalitetit të Fëmijëve dhe të Rinjve pranë Ministrisë së Drejtësisë, vlerësimin e kriminaliteti për të miturit nën 14 vjeç, identifikimin e grupeve në risk, si dhe sigurimin e kuadrit infrastrukturor për zbatimin e programeve të parandalimit. Kjo do të realizohet nëpërmjet funksionimit të Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- 29.** Për prindërit e të miturve autorë, të miturve nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe viktima të veprave të paligjshme, do të jenë vënë në zbatim programet e këshillimit dhe të rehabilitimit.
- 30.** Lehtësimin nga bara e taksave dhe tatimeve për biznese që punesojnë prindërit, angazhojnë të të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit që skanë arritur moshën për përgjegjësinë penale por që janë shoqërisht të rrezikshëm. Kjo gje te behet nëpërmjet

kontratave “atipike” të punës ku të përmbajnë kushte të favorshme për palët dhe tejet favorizuese për të miturit në konflikt me ligjin.

- 31.** Ashtu sikurse është përmendur edhe më sipër, parandalimi i kriminalitetit duhet të këtë aspekt sa më të gjerë, e në këtë kontekst nuk mund të përjashtohet edhe media, i cili konsiderohet si pushteti i katërt. Qeveria rekomandohet të parashikojë si alokim të buxhetit që mediat të mund të trasmetojnë programeve televizive me qëllim informimin e publikut për njohjen e ligjeve në këtë fushë, përhapjes së përvojës pozitive për respektimin e ligjeve, rastet pozitive të parandalimit të veprave penale etj. Ngritja e vetëdijës së publikut është një element shumë i rëndësishëm i në njohjen e pasojave negative dhe parandalimin e kriminalitetit të të miturit.
- 32.** Sipas parashikimeve të Kodit penal për të miturit dhe AMA³⁵² të miturit në kronikat televizive dhe jo vetëm duhet të përmenden me iniciale. Në respekt të këtyre parashikimeve ligjore të aktualizohet sanksioni administrativ me gjobë deri në pezullimin e licensës për ato media me frekuencë lokale apo kombëtare që nuk respektojnë këtë parashikim ligjor.
- 33.** Studimi i kriminalitetit të të miturve në disa nivele (shkollë, familje, komunitet), me qëllim eksplorimin e fenomenit në të gjitha dimensionet. Duke konsideruar sa më sipër, është e domosdoshme të krijohen struktura të posaçme për realizimin e studimeve në këtë fushë, të cilat duhet ta studiojnë kriminalitetin e të miturit si një fenomen kompleks jo vetëm ligjor por edhe social.
- 34.** Krijimin e strukturave përkatëse në shkollë, familje dhe komunitet për edukimin e të rinjve me frymën e ligjit, me pasojat që sjell kryerja e veprave penale jo vetë për ta, por edhe për viktimat e krimit. Duhet të zhvillohen shërbime dhe programe të bazuara në komunitet me qëllim parandalimin e kriminalitetit të shkelësve të mitur të ligjit.

³⁵² Autoriteti i mediave audiovizive

- 35.** Nga sa është cituar edhe më sipër, një problem mjaft i mprehtë në delikuecën e të miturve është recidivizmi. Një element shumë pozitiv në parandalimin e posaçëm është hartimi dhe zbatimi i programeve rehabilituese të të miturve në institucionet penitenciare. Megjithatë, trajtimi i të miturve në vendin tonë nuk përputhet me standardet ndërkombëtare, pasi të miturit në konflikt me ligjin nuk marrin shërbimet e duhura³⁵³. Në këto kushte, qeveria duhet të marrë masa urgjente për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në ambientet e para-burgimit dhe të burgimit për të miturit³⁵⁴. Niveli i kriminalitetit dhe i të miturve të izoluar me masa sigurimi “arrest në burg” ose të miturve që janë duke vuajtur dënimin me burgim është shumë më i lartë se kapacitetet që ofrojnë institucionet e mësipërme, duke i çuar në një trajtim diskriminues dhe degradues të të miturve që janë izoluar jashtë këtyre institucioneve (të ndodhura në I EVP-të Vlorë, Lezhë dhe Kavajë).
- 36.** Të merren masat e përshtatshme që të garantojnë që fëmijët e privuar nga liria kanë akses në arsimim, shërbime shëndetësore, përfshirë shërbime të shëndetit mendor. Seksionet e veçanta të institucioneve të paraburgimit dhe të institucioneve të ekzekutimit të dënimit me burgim, aktualisht nuk arrijnë ti realizojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare këto shërbime.
- 37.** Komiteti i Helsinkit në Shqipëri, në raportet e tij ka evidentuar mungesë psikologësh e punonjësish socialë të specializuar për të punuar posaçërisht me fëmijët e dënuar³⁵⁵. Psikologët janë me profil të përgjithshëm dhe intervistat e tyre nuk trajtojnë nevojat specifike të fëmijëve³⁵⁶.
- 38.** Tërheqja nga metoda ndëshkuese për të rinjtë që shkelin ligjin, duke aplikuar një sistem të drejtësisë më të përshtatshëm dhe më miqësor për fëmijët. Aktualisht, duke marrë në konsideratë statistikën zyrtare për paraburgimin dhe burgimin e shkelësve të mitur të

³⁵³ Raport i Komitetit kundër torturës për Shqipërinë në vitin 2017

³⁵⁴ Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Gjenevë sipas nenit 44 të Konventës. Vëzhgime përfundimtare –Shqipëria Tetor 2012. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Countries.aspx?CountryCode=ALB&Lang=EN

³⁵⁵ Raport “Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisariatet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike”, korrik 2015–janar 2016, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

³⁵⁶ Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016, “Lëvizja Evropiane në Shqipëri ‘Gjyqësori dhe të drejtat themelore’”, kapitulli 23, f. 27–29.

ligjit, procesi i drejtësisë për të miturit nuk është miqësor me të miturit në konflikt me ligjin. Procesi penal i drejtësisë për të mitur duhet të mund të garantojë që burgimi është mjeti i fundit, për një kohë sa më të shkurtër, dhe me mundësi rishikimi në mënyrë periodike me qëllim uljen e tij. Për promovimin e dhënies së dënimeve alternative për të miturit si dhe aplikimit të masave alternative të shmangjes për shkelje me rrezikshmëri të ulët shoqërore, duhet të parashikohen aktivitete për ndërgjegjësimin e përdorimit të këtyre masave. Aktivitetet ndërgjegjësuere duhet të kryhen si në rrafshin e trajnimit të profesionistëve (gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore) ashtu edhe në rrafshin e shoqërisë (shkollë, familje, komunitet), me qëllim nxitjen e formave alternative të dënimit si shërbimi i provës, këshillimi, punë në komunitet, masave të tjera të drejtësisë restauruese, sa herë që kjo është e mundshme.

39. Janë bërë përpjekje për të ngritur kapacitetet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë për specializimin e tyre në fushën e drejtësisë për të mitur. Me aktin Nr.79, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është rregulluar caktimi i gjyqtarëve në seksionet për të mitur. Autori në cilësinë e anëtarit të K.L.P është duke ndërmarë hapa konkretë në realizimin e vendimarrjes kolegjale nga ana e K.L.P si organi më i lartë i Prokurorisë. Nëpërmjet kësaj vendimarrje do i mëshohet përcaktimit të numrit të prokurorëve të specializuar, afatit të caktimit të tyre në këto gjykata dhe kontrollit periodik të aktivitetit të tyre nëpërmjet vlerësimeve periodike. Caktimi i prokurorëve do të bëhet me kriter karrierë afatgjate në sistem, specializime konkrete dhe monitorimit të vazhdueshëm nga ana e organeve përkatëse.

40. Implementimi i sistemit të integruar të të dhënave. Konkretisht në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur është parashikuar krijimi i Sistemit të Integruar i të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe për këtë qëllim është miratuar Vendimi Këshillit të Ministrave Nr.149, datë 20.03.2019 *“Për krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit dhe aksesimit, të dhënat parësore dhe dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”*. Aktualisht, rezulton se Sistemi i Integruar i të dhënave nuk është implementuar akoma. Në këtë aspekt, rekomandohet të merren të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë dhe

institucional për krijimin si dhe funksionimin me efikasitet të këtij sistemi. Baza e të dhënave të drejtësisë penale për të mitur ka rol kyç në përmirësimin e aksesit në drejtësi të të miturve, mirëadministrimin e drejtësisë, si dhe përmisimin e politikave në lidhje me drejtësinë penale për të mitur. Në mënyrë që të ndërmeren politika progresive për parandalimin e kriminalitetit, faktor kyç është studimi sistematik i të dhënave në lidhje me të miturit dhe marrja e masave të nevojshme.

- 41.** Pavarësisht përmisimit të kuadrit ligjor, ende mungojnë planifikimi, buxhetimi dhe riedukimi i përshtatshëm i bazuar në komunitet dhe programet e riintegritit të fëmijëve që shkelin ligjin. Për të pasur një drejtësi penale për të mitur eficiente dhe në standardet e parashikuara në Kod, natyrisht që rol determinant ka edhe buxheti i parashikuar. Nga qeveria është e domosdoshme të kryet një planifikim konkret për masat afatshkurtra dhe afatgjata për riedukimin e bazuar në komunitet dhe programet e riintegritit, i shoqëruar edhe me kostot në buxhet. Për sa më sipër, për përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të mitur është e nevojshme të ndryshohet ligji për buxhetin e shtetit, ku një zë të veçantë duhet të kenë masat që do të merren në kudër të drejtësisë penale për të mitur, deri në arritjen e standardeve ndërkombëtare. Pjesë e të ardhurave në buxhetin e shtetit (në këtë zë) duhet të jenë edhe të ardhurat që krijohen nga shitja në ankand e produkteve të veprës penale, puna në interes publik e të miturve në konflikt me ligjin etj

- 42.** Rekomandohet trajtim të diferencuar ndërmjet të miturve të ndaluar, që nuk kanë dalë akoma para gjyqit, të cilët duhet të veçohen nga të miturit që kanë marrë dënimin. Kushtet, në të cilat ndalohet një i mitur, duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuar më poshtë, me dispozita të veçanta kur është e nevojshme apo e duhur, duke pasur parasysh kërkesat e prezumimit të pafajësisë, kohëzgjatjen e ndalimit, statusin ligjor dhe rrethanat e të miturit. Këto dispozita do të përfshinin, po jo domosdoshmërisht kufizoheshin në:
 - a) *Të miturit duhet të kenë të drejtën e këshillimit ligjor dhe u krijohet mundësia për të kërkuar ndihmë ligjore falas, aty ku një ndihmë e tillë është e disponueshme, si dhe të komunikimit sistematik me këshilltarët e tyre ligjorë. Jeta private dhe konfidencialiteti duhet të garantohen për një komunikim të tillë;*

b) Të miturve duhet t'u sigurohen, aty ku është e mundur, mundësitë për të punuar, me shpërblim, dhe për të vazhduar shkollën ose trajnimin, por nuk u duhet vënë kusht që ta bëjnë një gjë të tillë. Puna, arsimi apo trajnimi nuk duhet të bëhen shkak për vazhdimin e ndalimit.

c) Të miturve duhet t'u jepen dhe të kenë mundësi të ruajnë materiale për kohën e tyre të lirë në përputhje me interesat e vënies të drejtësisë.

d) Të gjithë veprimet procedural të ndërmarra në lidhje me fëmijët që përfshihen në kryerjen e veprave penale apo edhe ku ata janë viktime të trafikimit, duhet të udhëhiqen dhe duhet të jenë të bazuara në parimet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, sikurse është parashikuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989).

43. Bashkëpunim të ngushtë ndërdisiplinor ndërmjet qeverisjeve kombëtare, shtetërore me ato rajonale, vendore me përfshirjen e përfaqësimit qytetar të sektorit privat për t'i shërbyer bashkësisë dhe agjencive të punës, përkuajtjes për fëmijët, edukimit shëndetësor, shoqëror dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit duke ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë;

SI REKOMANDIME KRYESORE PROPOZOJ:

- 1. Në fazën që ndodhet sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri kur u hartua ligji i posaçëm për hetimin e gjykimin e tyre, rekomandoj krijimin e gjykatave të të miturve në (një numër 4-5 në) gjithë territorin e vendit që do të kënaqte mjaftueshëm pëmbushjen e kërkesave të akteve më të mira ndërkombëtare që rregullojnë drejtësinë për të miturit në konflikt me ligjin.**
- 2. Rekomandoj gjithashtu ndryshimin (ngritjen) e moshës për përgjegjësi penale nga 14 vjeç që është aktualisht në legjislacionin tonë për kryerjen e të gjitha krimeve në**


atë 16 vjeç për kryerjen e veprave penale (krimeve) ku i dëmtuar është shteti. (si psh: kreu VIII Krime kundër autoritetit të shtetit, kreu IX vepra penale kundër drejtësisë etj).

3. Rekomandoj ngritjen e një qendrave të edukimit dhe riintegrimit për fëmijët në konflikt me ligjin ose për të miturit shoqërisht të rrezikshëm nën moshën për përgjegjësi penale nëpërmjet implementimit tek kjo qendër të programeve më të mira bazuar në praktikën ndërkombëtare.



TABELA, GRAFIKË, TË DHËNA

Mosha për përgjegjësi penale në evropë dhe në disa shtete të botës paraqitet si më poshtë:

	SHTETI	MOSHA/VJEÇ	SHTETI	MOSHA/VJEÇ
	Albania	14-16	Australia	10
	Austria	14	United States	6-12
	Belgium	16	Brazil	18
	Croatia	14	India	7
	Czech Republic	15	Myanmar	7
	Denmark	15	Nigeria	7
	Estonia	14	Pakistan	7
	Finland	15	Singapore	7
	France	13	Sudan	7
	Germany	14	Tanzania	7
	Hungary	12	Indonesia	8
	Iceland	15	Kenya	8
	Ireland	12	Bangladesh	9
	Italy	14	Ethiopia	9
	Netherlands	12	Iran	9 (vajzat); 15 (djemtë)
	Norëay	15	Israel	12
	Poland	15	Hong Kong	10
	Portugal	16	Nepal	10
	Romania	14	neë Zealand	10
	Russia	14	South Africa	10
	Sëitzyerland	10	Algeria	13
	Slovenia	14	China	14
	Spain	14	Thailand	10
	Sëgëden	15	Japan	14
	Scotland (UK)	12	Bolivia	14
	Turkey	12	Canada	12
	United Kingdom	10	Costa Rica	12
	Ukraine	14	Vietnam	14
	DR Congo	16	Morocco	12
	Colombia	18	Uganda	12
	Ecuador	18	Chile	16
	Mexico	18	Paraguay	14
	Peru	18	South Korea	14
	Uruguay	18	Taiçan	14
	Argentina	16	Egypt	15
	Uzbekistan	15	Philippines	15




Të mitur në konflikt me ligjin




Shtetet vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Shqipëria	88.4%	87.7%	88.7%	61.6%	46.5%	54.8%	30.7%
Armeni	13.7%	17.3%	21.3%	9.6%	12.5%	14.5%	17.9%
Azerbaixhani		27.2%	14.2%	14.9%	13.9%	16.2%	15.3%
Gjeorgjia	13.5%	20.7%	17.5%	11.3%	15.7%		12.6%
Kazakistani	19.1%	15.9%	15.7%	16.1%	12.4%	11.8%	10.1%
Kirgizstani	9.4%	11.1%	9.2%	11.9%	11.3%	8.2%	9.6%
Moldavia	10.5%	13.9%	5.4%	6.9%	8.5%	9.7%	
Mali i Zi	6.3%	7.4%	2.6%	2.8%	4.0%	2.6%	5.1%
Taxhikistani	55.3%	68.8%	67.9%	43.0%	42.8%	30.9%	22.4%
Ukraina	12%	11%	10%	11%	9%	10%	8%

Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit



Mosha	Viti								
	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
14	5	5	3	3	5	11	13	4	11
15	13	30	34	32	23	42	33	23	18



BIBLIOGRAFIA:

I- PARËSORE:

1. *“Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut” miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (10.12.1948).*
2. *“Tërësia e regullave standarde minimale në lidhje me drejtësinë e të miturve”, (“The Beijing Rules” (Rregullat e Pekinit), miratuar në datë 29.11.1985 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 40/33).*
3. *“Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit” Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, A/RES/40/34, 29.11.1985.*
4. *“United Nations Standard Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules) Adopted by General Assembly resolution 45/110 of 14 December 1990.*
5. *Konventa “Për të drejtat e fëmijës” (UNCRC) e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (miratuar në 20 nëntor 1989), Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në 27.02.1992.*
6. *“Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues” aderuar me ligjin Nr.7727, datë 30.06.1993.*
7. *“Konventa ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor” miratuar me ligjin Nr.7768, datë 09.11.1993.*
8. *“Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët”, ratifikuar nga ligji Nr.7833, datë 22.06.1994.*
9. *Konventa evropiane “Për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues”, dhe dy protokollet shtesë të saj, aderuar me ligjin Nr.8135, datë 31.07.1996.*
10. *“Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, dhe protokollet shtesë të saj, miratuar me ligjin Nr.8137, datë 31.07.1996.*
11. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për ekstradimin” dhe dy protokollet shtesë, ratifikuar me ligjin Nr.8322, datë 02.04.1998.*
12. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e Personave të dënuar” miratuar me ligjin Nr.8499, datë 10.06.1999.*

13. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, miratuar me ligjin Nr.8497, datë 10.06.1999*
14. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale” dhe protokoli i saj shtesë, miratuar me ligjin Nr.8498, datë 10.06.1999.*
15. *“Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, ratifikuar me ligjin Nr.8624, datë 15.06.2000.*
16. *Konventa e Këshillit të evropës “Për shtypjen e terrorizmit”, ratifikuar me ligjin Nr.8642, datë 13.07.2000.*
17. *Konventa e OKB “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope”, aderuar me ligjin Nr.8722, datë 26.12.2000.*
18. *-Konventa 182 e Organizatës Botërore të Punës (ILO) “Për format më të këqija të punës së fëmijëve” dhe rekomandimi Nr.190, “Format më të këqija të punës së fëmijëve”, ratifikuar me Ligjin Nr.8774, datë 23.04.2001.*
19. *“Konventa penale për korrupsionin”, e Këshillit të Evropës, bërë në Strasburg më 27.01.1999, ratifikuar me ligjin Nr.8778, datë 26.04.2001 dhe ndryshuar me ligjin Nr.9369, datë 14.04.2005.*
20. *Konventa ndërkombëtare (O.K.B), “Kundër marrjes së pengjeve”, ratifikuar me ligjin Nr.8837, datë 22.11.2001.*
21. *Konventa ndërkombëtare “Për luftën kundër financimit të terrorizmit”, ratifikuar me ligjin Nr.8865, datë 14.03.2002.*
22. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për krimin në fushën e kibernetikës” ratifikuar me rezervë me ligjin Nr.8888, datë 25.04.2002.*
23. *“Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokollet shtesë të saj, “Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve” nënshkruar në Palermo, Dhjetor 2001. Ratifikuar me ligjin Nr.8920, datë 11.07.2002.*
24. *Statuti i Romës: “Për gjykatën ndërkombëtare penale” bërë në Romë më 17.07.1998, ratifikuar me ligjin Nr.8984, datë 23.12.2002.*
25. *Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”, miratuar me ligjin Nr.9068, datë 15.05.2003.*

26. Konventa e Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me Ligjin Nr.10071, datë 09.02.2009.
27. Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” ratifikuar me ligjin Nr.10425, datë 02.06.2011.
28. Protokollin i 3-të opsional i Konventës për të drejtat e fëmijës, “Për procedurën e komunikimit”, ratifikuar nga Ligji Nr.86, datë 25.02.2013.
29. Konventat në www.hcch.net
30. Konventat në www.ilo.org
31. Kushtetuta e Republikës (Popullore, /Socialiste) të Shqipërisë, me ndryshimet e viteve 1946, 1976, 1998, 2016.
32. Raport i Komitetit (të Organizatës të Kombeve të Bashkuara) të të Drejtave të Fëmijës për vitin 2012.
33. Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit: “Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisaritet e policisë së shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrike”, korrik 2015–janar 2016.
34. Raport i Avokatit të Popullit “Me zërin e të miturve të privuar nga liria-vlerësimi i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, për vitin 2016.
35. Progres Raporti Komision Evropian për Shqipërinë për vitin 2016, 2018.
36. Raport i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar, për Shqipërinë për vitin 2018.
37. Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri”, për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018.

DEKRETE TË PRESIDENTIT:

38. Dekret Nr.2110, datë 29.05.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre.”

39. Dekret Nr.6218, datë 07.07.2009 “Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.”
40. Dekret Nr.6265, datë 16.09.2009 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit.”

K O D E.

41. “Kodi Penal i Perendorisë Osmane”. Tiranë, 1924;
42. Kodi Penal i Monarkisë i vitit 1928.
43. Kodet Penale të Republikës (Popullore/Socialiste) të Shqipërisë, vitet 1952, 1977, 1995 (me gjithë ndryshimet në vite).
44. Kodet e Procedurës Penale të Republikës (Popullore/Socialiste) të Shqipërisë së viteve 1953, 1977, 1995 (me gjithë ndryshimet në vite).
45. Kodi i Familjes duke filluar nga ai i miratuar me ligjin Nr.6599, datë 29.06.1982 e deri aktualisht.
46. Kodi Penal Italian, “Codice Penale”, Libro II. Milano, dott Giuffrè, editore 2000;
47. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar nga ligji Nr.37/2017,

L I G J E:

48. Ligj Nr.3766, datë 17.12.1963, “Për Kujdesin Shëndetësor”, (I ndryshuar).
49. Ligj Nr.7635, datë 11.11.1992 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.4624, datë 24.12.1969 “Për Sistemin e ri Arsimor”.
50. Ligj Nr.7650, datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”.
51. Ligj Nr.7710, datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore.” i përditësuar.
52. Ligj Nr.7761, datë 19.10.1993, “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”.(i përditësuar).
53. Ligj Nr.7939, datë 25.05.1995 “Për migracionin”, (neni 15 krijon lehtësira për marrjen e lejes së qëndrimit të fëmijëve që janë nën moshën 18 vjeç.)

54. Ligj Nr.7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, (i përditësuar.)
55. Ligj Nr.7986, datë 13.09.1995 “Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës”, (i përditësuar.)
56. Ligj Nr.8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”,(i ndryshuar).
57. Ligj Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve“ (i përditësuar).
58. Ligj Nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale“ (i përditësuar).
59. Ligj Nr.8389, datë 05.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, (i përditësuar.)
60. Ligj Nr.8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë.”
61. Ligj Nr.8427, datë 14.12.1998 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, Interpol.”
62. Ligj Nr.8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar)
63. Ligj Nr.8492, datë 27.05.1999 “Për të Huajt”,
64. Ligj Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
65. Ligj Nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë “(i çfuqizuar).
66. Ligj Nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. (i ndryshuar)
67. Ligj Nr.8689, datë 16.11.2000 “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV- AIDS në Republikën e Shqipërisë”.
68. Ligj Nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor.“ (i përditësuar).
69. Ligj Nr.8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

70. Ligj Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë.” (i përditësuar).
71. Ligj Nr.9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin opsional të OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve” “Për Përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura.”
72. Ligj Nr.9834, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin opsional të OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve, “Për Shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”
73. Ligj Nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i shfuqizuar).
74. Ligj Nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat.”(i përditësuar).
75. Ligj Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve.” (i ndryshuar).
76. -Ligji Nr.10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” (i përditësuar).
77. Ligj Nr.10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.”
78. Ligj Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”
79. Ligj Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.”
80. Ligj Nr.98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
81. Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

VENDIME TE KËSHILLIT TE MINISTRAVE

82. V.K.M Nr.39 datë 22.08.1994, “Për arsimin 8 vjeçar në gjuhën amtare të Personave të pakicave kombëtare”,
83. V.K.M Nr.384, datë 20.05.1996, “Për mbrojtjen e të miturve në punë”.

84. V.K.M Nr.327, datë 15.5.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë“.
85. V.K.M Nr.487, datë 30.06.2005 “Për miratimin e planit të veprimit të strategjisë kombëtare Për fëmijët”
86. V.K.M Nr.368, datë 31.05.2005 “Për miratimin e strategjisë kombëtare Për fëmijët”
87. Vendim i KM Nr.471, datë 06.05.2009 “Për miratimin e llojeve të armëve dhe të mënyrës së përdorimit të tyre nga Policia e Burgjeve.“
88. V.K.M Nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”
89. V.K.M Nr.303, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve“ Ndryshuar me V.K.M Nr.187, datë 17.03.2010
90. V.K.M Nr.480, datë 06.05.2009 “Për mbrojtjen e veçantë Përsonele, të familjes dhe të pronës së gjyqtarëve dhe për sigurimin e jetës e të pronës së tyre “
91. V.K.M Nr.439, datë 04.08.2000, “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohen edhe të miturit.
92. V.K.M Nr.934, datë 17.11.2010 “Për miratimin në parim të Konventës evropiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.” (Strasburg 25.01.1996)
93. V.K.M Nr.201, datë 16.03.2011 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.”
94. V.K.M Nr.346, datë 29.04.2011 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e agjencisë Shtetërore Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
95. V.K.M Nr.324, datë 12.04.2017 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017”
96. V.K.M Nr.541, datë 19.09.2018 “Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të mitur dhe të planit të veprimit 2018-2021.
97. V.K.M Nr.635/2018, “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer vepër penale”.

98. *V.K.M Nr.148, datë 20.03.2019 “Për procedurën që zbaton Shërbimi i Provës në rast të mos përmbushjes të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale”*
99. *V.K.M Nr.149, datë 20.03.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin dhe karakteristikat e përdorimit dhe aksesimit, të dhënat parësore dhe dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”;*
100. *V.K.M Nr.233, datë 17.04.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta, lidhur me funksionimin e mjediseve dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit dhe të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”;*
101. *V.K.M Nr.314, datë 15.05.2019 “Për përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”;*
102. *V.K.M Nr.207, datë 10.04.2019 “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.”*

URDHËRA / UDHËZIME:

103. *Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.6325, datë 31.07.2009 Për miratimin e rregullores “Për bashkëpunimin e shërbimit të provës me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit”*
104. *Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.3125/1, datë 04.09.2009 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e Policisë së Burgjeve”.*
105. *Urdhër Nr.3348/1, datë 18.04.2018 i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për rregullimin e procesit arsimor në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur”*
106. *Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.4950, datë 02.05.2018 “Për përcaktimin e formës së rregjistrimit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, “Paralajmërim me gojë.”*

107. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.4951, datë 02.05.2018 “Për miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, “Paralajmërim me shkrim.”
108. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.7640, datë 05.07.2018 “Për përcaktimin e formës dhe rregullave të përgatitjes së dokumentit për lirimin me kusht të të miturit të dënuar.”
109. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.7641, datë 05.07.2018 “Për përcaktimin e elementëve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin.”
110. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.7639, datë 05.07.2018 “Për miratimin e rregullave të detajuara për përdorimin e sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”;
111. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.367, datë 15.07.2019 “Për miratimin e formatit të planit individual për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.”
112. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë Nr.368, datë 15.07.2019 “Për miratimin e formatit të raportit për mospërmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin.”
113. Udhëzim i Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr.79, datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur. “
114. Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm Nr.03, datë 25.11.2013.”Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe /ose dëshmitar”

II- DYTËSORE:

AUTORË E BOTIME TË NDRYSHME SHKENCORE:

1. Donald J. Neëman and Patrick R. Andersonr. 1990. “Introduction to Criminal Justice”. Random House.
2. Moore, S.A. (2007). Restorative Justice. In R.B. Hoëe and K.Covell (eds.), A Question of Commitment: “Children's Rights in Canada“ (Ëilfred Laurier University: Èaterloo, ON).

3. Moore, S.A. & Mitchell, R.C. (2007). *Rights-Based Restorative Justice: 'Towards Critical Praxis with Young People in Conflict with the Law*. In A. Ang, I. Delens-Ravier, M. Delplace, C. HermaNr.
4. D.Reynaert, V.Staelens, R.Steel and M.Verheyde (Eds.), "The UN Children's Rights Convention: theory meets practice". *Proceedings of the International Interdisciplinary Conference on Children's Rights, 18-19 May 2006, Ghent, Belgium, Mortsel, Intersentia*.
5. Moore, S.A. & Mitchell, R.C. (2007) "Herstelrecht volgens de menselijke principes" (or "Rights- Based Restorative Justice", *Het Tijdschrift voor Jeugdrecht*.
6. S.Di Nuovo, G. Grasso, "Diritto e procedura penale minorile, Giuffrè,(2)
7. A. Forza, "Il diritto di difesa nel processo penale minorile: contenuti minimi ed effettività delle garanzie, in per uno statuto europeo dell'imputato minorenne", a cura di G. Giostra, Giuffrè, 2005, 71 s.
8. P.Giannino, "Il processo penale minorile", Cedam, 2^a ed., 1997,
9. G.Deleo, "Garanzie e discrezionalità nel processo penale minorile", in *Giust. Cost.*, 1989.
10. G.Assante, P.Giannino, F. Mazziotti, "Manuale di diritto minorile", 2000 Editori Laterza.
11. A.Casoni, "Adolescenza liquida", *Atti del Convegno IPRS, Roma, 28 maggio 2007*.
12. F. Dalla Casa, "Prove di rientro da una lunga rimozione: il primo organico progetto di riforma dell'esecuzione penale minorile, in *Nuove Esperienze di Giustizia Minorile*" Nr.2/2008
13. L.Decantoni, C.Scivoletto, "L'inesistente ordinamento penitenziario, in *Minori e giustizia* Nr. 1/2001.
14. P. Giannino, "Il processo penale minorile", Cedam, Padova, 1997.
15. R. Ianniello, L. Mari (a cura di), "Minori, Famiglie e Tribunale" Giuffrè editore 2007.
16. ISTAT, "La criminalità minorile nei grandi centri urbani", Anno 2001.
17. ISTAT, "Statistiche giudiziarie e penali – anno 2004", *Collana Annuari*, Nr.13/2006.

18. I. Mastropasqua, M.M.Leogrande, “L’iter penale minorile: il ruolo e l’apporto del terzo settore” in *Atti del seminario 13-14 settembre 20078 Catania “Gi.gi” Giovani e Giustizia” un confronto tra buone prassi e sperimentazioni in atto nel territorio nazionale.*
19. A.Maggiolini “Adolescenti delinquenti. L’intervento psicologico nei servizi della Giustizia Minorile”, Franco Angeli 2002.
20. I.Mastropasqua, “Architettura delle reti sociali”, Carocci, 2004.
21. A.Mestiz, “Processo penale minorile: tra interpretazione e applicazione”, 1997.
22. A.Mestiz M. Colamussi, “Il difensore per i minorenni”, Carocci, 2003.
23. A.Mestiz, “Messa alla prova: tra innovazione e routine”, Carocci, 2007.
24. S.di Nuovo, G. Grasso, “Diritto e procedura penale minorile”, Giuffrè editore, 2005.
25. P.Pazé, relazione presentata al convegno “Ripartiamo dalle radici. Porte aperte sulla Giustizia Minorile”, organizzato dal Centro per la Giustizia Minorile di Piemonte, Valle d’Aosta e Liguria il 17-18 giugno 2008 a Torino, presso l’Aula Magna dell’Università degli Studi.
26. P.Patrizi, “Responsabilità partecipate”, Giuffrè 2007.
27. M.Vittore, “Il lavoro d’équipe nei servizi alla persona, Del Cerro, 2006.
28. Gaetano De Leo: “La devianza minorile: il dibattito teorico, le ricerche, i nuovi modelli di trattamento”, Carocci, 1998.
29. F.Palomba, “Il sistema del nuovo processo penale minorile”, Giuffrè editore 1991.
30. Crisafulli, A. dhe B di Tulio: “Aspetti della criminalita militare nel settore Albanese”, Tirana, 1942.
31. Centro nazionale di documentazione e analisi per l’infanzia e l’adolescenza (2006), *L’eccezionale quotidiano-“Rapporto sulla condizione dell’infanzia e dell’adolescenza in Italia”*, Istituto degli Innocenti, Firenze.
32. *European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs (ESPAD)*, studio condotto dal 1995 ogni quattro anni in trenta paesi europei; si veda, al proposito, anche il rapporto sull’andamento del fenomeno delle tossicodipendenze a cura dell’Osservatorio Epidemiologico sulle tossico-dipendenze della Regione Liguria.
33. “Gli Alunni stranieri nel sistema scolastico italiano” A.S. 2007/2008 MIUR Direzione Generale per gli Studi e la Programmazione e per i Sistemi informativi – Servizio Statistico.

34. *Cittadini in crescita Nr.1/2007 Rivista del Centro di Documentazione e Analisi dell'Infanzia e dell'Adolescenza Istituto degli Innocenti di Firenze.*
35. *D.Chicco, "Il discernimento dei fanciulli: il tema dell'imputabilità dei minori nella cultura giuridica contemporanea", in Famiglia e diritto, 11/2011.*
36. *I.Baviera, Diritto minorile, II, Giuffrè, Milano 1976.*
37. *M.Talamanca, Istituzioni di diritto romano, Giuffrè, Milano, 1990.*
38. *C.Neri, Campo e fantasie transgenerazionali, in Riv. Psicoanalisi, vol. XXXIX – NR. 1, P. 43-82; R. Losso, Psicoanalisi della famiglia, Persorsi teorico-clinici, Franco Angeli, 2000.*
39. *Sample. B., "Law and punishment", OUP 2000.*
40. *Tome Tamame, C.J., "La responsabilidad penal de los menores" në Noticias Juridicas 2002.*
41. *Allen, M., "Criminal Law text book" 1999, OUP.*
42. *Basilio, L., "Imputabilita, minore eta e pena: aspetti giuridici e sociologici", 2001.*
43. *Brumond, J., "Friendly approach" në www.les.ac.uk*
44. *Candanil Valencia, M.I., Echeverry Vargas, D.M., Villa Ruiz, A.M., "Delincuencia juvenil" në Noticias juridicas, 2002.*
45. *Children and Violence, Innocenti Digest No 2, UNICEF.*
46. *Cole, B., "Inside the courtroom" OUP 2004.*
47. *Giunchi, A., "Mediazione penale minorile" në www.justiziapenale.gov.it*
48. *Gomien, D., "Udhëzues i shkurtër për Konventën evropiane për të Drejtat e Njeriut" shtator 1998.*
49. *Grajper, S., "Repressive legal measures against juvenile crime" në www.les.ac.uk*
50. *Herbert,C., "Institutionalisation and other forms of juveline's crime treatment" në www.city.ac.uk/icsl*
51. *Hodgson, R., "Narcotics and crime" në www.les.ac.uk*

52. Huck.B., "Crime and punishment" 2d edition 2002.
53. Mc Peake, R., "Juvenile modern crimes" në www.city.ac.uk/icsl
54. Morant Vidal, J., "Delincuencia juvenil" në Noticias juridicas 2003.
55. Ęright. S., "Drugs and crime" në www.cleansociety.com/drugsrelations
56. Yonah. A., "The war on terror" 2003.
57. Di Persio, G., "Delitti e i minori", Prisma 2000.
58. Douglas, J., "Mindhunters" Mandarin 1997.
59. Fojerbah., vepra në www.ut.com/citime
60. Huntington. S., "The clash of civilizations" Cambridge 2001.
61. Jane. T., "Trafficking of human beings" 2002 në www.cps/traffickingofhumanbeings/impressions
62. Jane. B., "Treatment and restitution for juvenile crime" në www.wikipedia.com
63. Jokel. N., "Scandinavian Law reform" 2005 në www.city.ac.uk/icsl
64. Pepin. L., "Imputato minorene" në Digesto delle discipline penali, UTET, 1992.
65. L. Milani, "Devianza minorile", Vita e pensiero, Milano 1995.
66. Ęinnicott, "Disa aspekte psikologjike të kriminalitetit të të miturve", Cortina, 1986.
67. Duncan, NR., "Role of police in preventing juvenile crime" në www.cambridge.ac.uk
68. ICMPD., Manual i trajnimit të policisë në fushën e trafikimit.
69. Novicki, M. A., "Gurët udhërrëfyes", Jurisprudencia e Gjykatës evropiane të të Drejtave të Njeriut, Tiranë 1999.
70. Olschaker, M., "Journey into darkness" Mandarin 2001.
71. Pettijohn, F.T., "Hyrje në Psikologji", botim i Lilo, Tiranë 1996.

AUTORË SHQIPTARË.

72. Ledi Bianku, "Jurisprudencia e Gjykatës së Strasburgut" 2005.

73. *“Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut kundër Shqipërisë”, QPZ 2009.*
74. *Aida Bushati, Geron Kamberi, Florian Xhafa, Holta Ymeri, Mona Xhexhaj, Nirvana Deliu, Sajmira Kopani “Konventa për Integrimin evropian, Vlerësime dhe Rekomandime 2015–2016”. Shtëpia Botuese FLESH.*
75. *Ismet Salihu. 2005. “E drejta penale për të mitur”. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.*
76. *“Shkelësit e Mitur të ligjit dhe konventa e fëmijëve” Qendra për Zhvillim, 2016, Stockholm.*
77. *“Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Shtjefën Gjeçovi, shtëpia botuese Kuvendi 2001.*
78. *“Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri”, grup autorësh, Shtëpia botuese Luarasi.*
79. *Hysi V. “Hyrje në kriminalogji dhe penalogji”, Shtypshkronja Ilar, 2000.*
80. *Gjonçaj L. “Kriminologjia”, Shtypshkronja Adelprint 2009.*
81. *Xhafo. J. “I mituri dhe procesi penal”, Monografi, shtypshkronja Geer 2012.*
82. *Elezi. I. “Kanuni i Zhurisë” (sipas origjinalit në AQSH), ‘Jeta juridike’, Nr.2, 2007.*
83. *Elezi.I, Kaçupi.S, Haxhia.M, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009.*
84. *Elezi, I.: “Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri”, Shtypshk. Albin, Tiranë, 1998.*
85. *Elezi, I., Kanuni i Labërisë, Tiranë 2006.*
86. *Vinjau, S.: “E drejta konstitucionale”, Tiranë, 1923.*
87. *Toçi, T.: “E drejta ndëshkimore”, (pjesa e përgjithshme), Shkodër, 1926.*
88. *Pipa, M.: “Fryma”, Shkodër, 1944.*
89. *Floqi, K.: “Pendesa në zhvillimin e së drejtës penale”, në “Leka” III, 1935.*
90. *Manual për matjen e treguesve të drejtësisë për të miturit, botim i United Nations, Office on Drugs and Crime dhe UNICEF, në York 2006;*
91. *“Drejtësia për të mitur në Shqipëri”, Studim CRCA;*
92. *“Përmbledhje e akteve ndërkombëtare”, botim i UNICEF;*
93. *Konventa për Integrimin Evropian, Vlerësime dhe rekomandime 2015-2016, “Lëvizja Evropiane në Shqipëri “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.*

94. Raporti “Me zërin e të miturve të privuar nga liria-vlerësim i kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit”, Avokati i Popullit dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve, me mbështetjen e UNICEF, Dhjetor 2016.
95. Raport -Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Janar 2004.
96. Vendim, Gjykata Kushtetuese Italiane, sez.III, Nr. 12501/2000;
97. Brestovci, F., Cikël leksionesh, Prishtinë 2002.
98. Drejtësia Popullore Nr.1., Tiranë 1952.
99. Drejtësia Popullore Nr.1., Tiranë 1990.
100. E Drejta Zakonore Shqiptare., Tiranë 1989.
101. Kanuni i Skënderbegut., Shkodër 1993.
102. Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe., Tiranë 1980.
103. Halili, R., Kriminologjia, Prishtinë 2008.
104. Halili, R., Viktimologjia, Prishtinë 2007.
105. Latifi, V., Kriminalistika, Prishtinë 2006.
106. Lloshi, Xh., Jorgaqi, NR., “Antologji e fjalës së mënçur”, Tiranë 1993.
107. Mustafaj, B., “Aspekte teorike mbi kriminalitetin e të miturve” magistratura 2003-2004.
108. Papandile, J., Mandro, I., Kriminologji-Penologji, Tiranë 2002.
109. Petrika, Grosi., Elona Demollari., 12 Mar 2007.
110. Prifti, L., “Psikologjia e Krimin” (ose penale), Tiranë 2003.
111. Puhani, I., “E Drejta Romake”, Gjilan 1989.
112. Sahiti, E., “E Drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë 2005.
113. Salihu, I., “E Drejta Penale për të Mitur”, Prishtinë 2005.
114. Sipas raportit “Varfëria në Shqipëri” të vitit 2001.
115. Trafiku i fëmijëve shqiptarë në Greqi, Janar 2003 – botim i Terre des Hommes.
116. Vjetarët dhe të dhëna statistikore të Ministrisë së Drejtësisë të viteve 2000 – 2018;

WEBPAGES:

117. “Kodi Penal i Republikës së Italisë, Zvicrës, Legjislacioni penal Anglez” në www.magistratura.org.it/comparazioni.
118. “Zhvillimi i fëmijërisë së hershme në Shqipëri”, studim i Qendrës së Zhvillimeve Humane dhe Save the Children, 2001 në www.stch.gov.al.
119. Department of State report 2004 në www.dos.gov/reports

120. Rey, B., "Psychological study on juvenile crime" në www.cps.gov/juvenilecrime
121. Smith, B., "Juveniles crimes and videogames" në www.kc.ac.uk
122. UN—"Prevention of juvenile organized crime 2003", në www.unr.org/articles/
123. Archon, B., "Social environment and crime" në www.crimepreventioNr.com/selection
124. Betti, S., "Exploited children" në www.magistratura.it/articoli
125. Black's Law dictionary definition në www.bLaw.com.uk
126. <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/ojdp/186162.pdf> - Child delinquency, May 2003,
127. <https://aabedu.net/uploads/docs/librat/Kriminologjia%20%20Alisabri%20%20C5%A0ABANI%20&%20Muhamed%20BUDIMLI%20C3%86.pdf>
128. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Countries.aspx?CountryCode=ALB&Lang=EN
129. <https://www.refworld.org/docid/3b00f2203c.html>
130. <https://drejtësia.gov.al/statistika/>
131. <https://www.unicef.org/albania/media/1501/file/National%20Justice%20for%20Children%20Strategy%20Alb.pdf>;
132. https://drejtësia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/01_Strategjia_e_Drejtësisë_për_te_Mitur_2017-2020_Shqip.pdf
133. <https://drejtësia.gov.al>
134. www.albaniasavethechildren.net
135. www.doj/article/questionnaireonjuvenilecrime/2004
136. www.unicef.org/statements/
137. www.Who.org/statements
138. http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/childjustice/Source/GuidelinesChildFrienlyJustice_Enr.pdf
139. <http://www.crca.org.al/newsletters/2007/neësletter385.htm>
140. http://www.crimelibrary.com/criminal_mind/profiling/victimology/2.htm

- 141.** *“Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri”, Pr. Dr. Adem Tamo., Pr. Dr. Theodhori Karaj., -Raport Studimor i financuar nga UNICEF, Tiranë 2006 në www.unicef.org/statements/*
- 142.** *Dhuna në familje -Studim i Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim dhe Ministrisë së Kulturës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta -Prill 2006, në www.mksb.gov.al*